

PARIMI I VETËVENDOSJES SË POPUJVE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE BASHKËKOHORE

Elton Musa


Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil e Drejtë Ndërkombëtare, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr.Ksenofon Krisafi

Numri i fjalëve: 64,213

Tiranë, Maj 2018



DEKLARATA E AUTORËSISË

© E drejta e autorit: Elton Musa. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

Në përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje sipas kërkesave të Shkollës Doktorale të Universitetit Evropian të Tiranës. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara dhe nuk është botuar apo prezantuar më parë.

ABSTRAKTI

Ky punim ka si qëllim një analizë përshkruese dhe në të njëjtën kohë kritike të parimit të “vetëvendosjes”, si një nga shtyllat e të drejtave të njeriut, por edhe si një nga temat më të debatuar nga doktrina ndërkombëtare, qoftë për rastet e shumta që janë shfaqur në sferën gjeopolitike, të lidhura në një fare mënyre me këtë parim, qoftë për parimin në vetvete që ende sot paraqet karakteristika të diskutueshme.

Ky punim synon që të japë një panoramë të plotë të parimit të vetëvendosjes në përmasat e ndryshme të evoluimit të tij, duke analizuar parimet bazë të së drejtës dhe çdo dispozitë ligjore në kuadër të përcaktimeve të akteve ndërkombëtare. Kjo nisur nga fakti se koncepti i “vetëvendosjes” mund të ketë një numër kuptimesh shumë larg njëri-tjetrit, ku veçanërisht rëndësi të veçantë do t’i kushtohet raportit midis Shteteve dhe Qytetarëve të tyre në lidhje me të drejtën e këtyre të fundit që të vendosin vetë për veten e tyre, e parë kjo në perspektivën e së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore.

Bashkësia e njerëzve brenda një shteti ka si qëllim t’i garantohen të drejtat për të shprehur veten, për të jetuar sipas besimit që kanë, zakoneve dhe traditave që i karakterizojnë për ta ruajtur gjuhën e tyre ,fenë dhe në fund të fundit, identitetin e tyre.

Në këtë drejtim, ajo që duhet të mbahet mend, është se janë shtetet ato (dhe jo popujt), subjekte formale të normave materiale dhe të rregullave, ndërsa popujt janë përfituesit e këtyre të fundit, prej nga lind dhe nevoja që të bëhet dallimi midis koncepteve të tilla, si: popull, pakicë (minorancë) dhe grupe kryengritëse, të gjitha shpesh të përfshira në diskutime dhe dokumente që kanë të bëjnë me parimin e “vetëvendosjes”.

Debati për vetëvendosjen është diskutuar fuqishëm vitet e fundit në të gjithë Evropën dhe në mbarë botën. Duke qenë se dukuria në fjalë përfshin një tërësi emocionesh politike dhe interesash ekonomike, është e vështirë për të gjetur informacion të qartë për atë që me të vërtetë është dhe atë që po ndodh në rajonet separatiste në Evropë dhe më gjerë.

Kështu që, nëse mendojmë rreth ekzistencës së të drejtës për vetëvendosje, duhet gjithashtu të bëjmë dallimin ndërmjet vetë kësaj të drejte dhe mundësisë reale për ta ushtruar atë.

Fjalët kyçe: Vetëvendosje, Doktrinë ndërkombëtare, Të Drejtat e Njeriut, Shtet, Popull.

ABSTRACT

This dissertation tents to give a descriptive analysis and at the same time critics of “self-determination ” convention as the most significant civil rights units, but as well as one of the most disputed topic of the international doctrine. Either concerning the numerous cases presented in the geo-politics regarding to this convention, but simultaneously concerning with the convention itself being disputable even recently.

This dissertation aims to present a detailed view of the convention self-determination into the altered dimensions of its evolutions, analysing the basic conventions of civil rights and each legal disposition with its international and regional intruments. Due to this fact, the concept of self – determination might have a range meanings different from each –other, particularly the emphasis on the report among the state and its citiziens will be on the focus, whereas the right of the citiziens to determine by their own will is the backbone of the contemporary international rights.

The community of people posseses its own right to garantuee their free expression, having thier own religious beliefs, traditions and customs, preserving their own language, faith, and after all their own identity.

In this respect, are the states not people those which can be considered as fomal subjects of material norms, of which comes out as a neccessity the differentiation between concepts such as people, minorities, indigen people and rebellious ones all involved in the disputable topics.

The debate on self-autonomy is strongly discussed recently throughout Europe and worldwide. Infusing an entire political emotions and economic interests is not hard to find an accurate data of what’s occuring and will occur into the separatist European area and overseas.

This considering the existence of the right for self- determination, is necessary thinking as well for the difference between the itself right and the real possiblity to master that.

Key words: self- determination, international doctrine, Civil right , state and people.

Përkushtimi

Ia përkushtoj familjes sime...!

FALENDERIME

Jeta është provë. Kjo është një moto që më ka shoqëruar gjatë gjithë formimit tim akademik. E njëjta provë ishte dhe në momentin kur u regjistrova në shkollën Doktorale pranë Universitetit Evropian të Tiranës, por një provë kjo më e bukur, jo shumë e lehtë, e nxitur dhe e mbështetur me besim dhe dashuri nga njerëzit e mi më të shtrenjtë, nga prindërit e mi. Prandaj, mirënjohja dhe falenderimi im i përzemërt shkon për prindërit e mi, të cilët me sakrificat, besimin dhe dashurinë që më kanë dhënë gjatë gjithë formimit tim akademik, kanë qenë një muzë frymëzimi dhe një mbështetje e padiskutueshme në kristalizimin e shpresës dhe shtimin e forcës për ta përballuar me sukses edhe këtë provë të jetës.

Falenderoj përzemërsisht udhëheqësin tim shkencor, Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit Evropian të Tiranës, Prof.Dr Ksenofon Krisafi për gadishmërinë, përkushtimin dhe ndihmën e tij të pakursyer, për mbështetjen, këshillat dhe rekomandimet që më ka dhënë, duke mos i kursyer përvojën dhe profesionalizmin e tij, duke më nxitur, e drejtuar gjatë gjithë ciklit të studimeve të doktoraturës dhe gjatë punës sime kërkimore-shkencore, duke luajtur rol të rëndësishëm në ideimin, hartimin dhe deri në përfundimin me sukses të një rruge të gjatë, të vështirë por jo të pamundshme, siç është edhe përmbyllja me sukses e këtij studimi.

Një falenderim i sinqertë dhe i përzemërt i shkon Shkollës Doktorale për përkushtimin dhe fleksibilitetin e treguar gjatë studimeve të mia doktorale, për Rektorin e Universitetit Evropian të Tiranës, Prof. Dr. Tonin Gjura, për përkrahjen dhe mbështetjen e tij gjatë ciklit të Doktoraturës.

Së fundi, dua të falenderoj kolegët e mi, dhe në veçanti, vëllain, mikun, shokun, Dr. Aldo Shkëmbi, për ndihmën, kurajën dhe mbështetjen e çmuar që më ka dhënë gjatë viteve të studimeve doktorale me bashkëpunimin dhe gadishmërinë e tij të pakursyer.

Faleminderit !

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KREU I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1. Hyrje.....	1
2. Hipotezat e punimit.....	3
3. Pyetjet kërkimore të punimit.....	3
4. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit.....	4
5. Kufizimet Metodologjike.....	5
6. Rëndësia e punimit.....	5

KREU II: VËSHTRIM HISTORIK I PARIMIT TE VETËVENDOSJES

1. Parimi i vetëvendosjes së popujve nga formulimet e tij të para deri ne Paktin e Atlantikut të vitit 1941.....	6
2. Karta e Kombeve të Bashkuara për Parimin e vetëvendosjes së popujve.....	7
3. Evolucion i juridiko-institucional i parimit të vetëvendosjes së popujve pas vitit 1960 të shekullit të kaluar.....	9
3.1. Rezoluta 1514-XV e Asamblesë së Përgjithshme e 15 dhjetorit 1960.....	9
3.2. Paktet Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut te vitit 1966.....	10
3.3. Deklarata mbi parimet e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1970.....	11
4. Akti final i Helsinkit i vitit 1975, Karta e Algjerit e vitit 1976.....	13

KREU III: PËRMBAJTJA E PARIMIT TË VETËVENDOSJES

1. Mbajtësit e së drejtës, marrësit e detyrimit, përfituesit.....	16
2. Popujt dhe vetëvendosja.....	17
3. Minoritetet dhe format e vetëvendosjes së tyre	19
4. Lëvizjet nacionalçlirimtare	24
5. Interpretime të ndryshme në lidhje me të drejtën për vetëvendosje.....	28

KREU IV: VETËVENDOSJA E JASHTME DHE VETËVENDOSJA E BRENDSHME, ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

1. Shfaqjet e shumta të vetëvendosjes: vetëvendosja e brendshme dhe e jashtme, vetëvendosja politike, ekonomike, sociale e kulturore.....	36
2. Mosndërrhyrja dhe e drejta për vetëvendosje.....	42
3. Vetëvendosja e jashtme e parë në këndvështrimet e saj klasike.....	43
3.1. Kufizimi fillestar i aplikimit të parimit të vetëvendosjes në situatat e popujve të ndodhur nën regjimin kolonial.....	43
3.1.1. E drejta për vetëvendosje në sistemet e vendeve koloniale.....	44
3.1.2. Trashëgimënia koloniale.....	46
3.2. Popujt e territoreve të pushtuara dhe të zëna me force.....	50
3.3. E drejta e vetëvendosjes së popujve nën regjime raciste.....	51
3.4. Instrumentet ndërkombëtare dhe parimi i vetëvendosjes në përmasën e saj të jashtme.....	53
4. Parimi i vetëvendosjes së popujve në përmasën e saj të brendshme.....	53
4.1. Analiza historike e procesit që solli në lindjen dhe afirmimin e parimit të vetëvendosjes në përmasën e saj të brendshme.....	53
4.2. Kritikat e përkufizimit të vetëvendosjes në përmasën e saj të brendshme.....	55
4.3. Parimi i vetëvendosjes së brendshme si sinonim i demokracisë.....	55
4.4. Mundësia për të konfiguruar parimin e vetëvendosjes së brendshme si një ndalim të ndërhyrjeve nga jashtë.....	56
4.5. Marrëveshja e parimit të vetëvendosjes së brendshme në kuadrin e Shteteve shumëkombëshe.....	57
4.6. Teoria federaliste dhe parimi i vetëvendosjes.....	60

KREU V: VETËVENDOSJA DHE PËRDORIMI I FORCËS

1. Shkelja e një norme të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, shkelja e parimit të vetëvendosjes (<i>Jus cogens</i>).....	62
2. Ndalimi i përdorimit të forcës në konfliktet e brendshme dhe kundër vetëvendosjes së popujve.....	64
3. Përdorimi i forcës nga ana e qeverisë në pushtet.	69
4. E drejta popujve për t'i bërë qëndresë me forcë akteve të dhunës së ushtruar në mbrojtje të së drejtave të tyre.....	71

5. Terrorizmi shtetëror.....	74
6. Mbështetja e qeverisë në fuqi.....	76
7. Mbështetja e popujve në luftë për vetëvendosje.	78
8. E drejta për t'u shkëputur dhe integriteti territorial.....	81
9. Rastet e Lëvizjes Separatiste.....	85
9.1. Rasti i Eritreas.....	85
9.2. Rasti i Timorit Lindor.....	86
9.3. Vetëvendosja dhe shpërbërja në BRSS.....	88

KREU VI: VETËVENDOSJA DHE KRYENGRITJA. KËNDVËSHTRIMI PËRGJITHSHËM

1. Kryengritësit.....	90
2. Levizjet e qeverive kolonialiste dhe raciste.....	93
3. Kryengritja e një pakice të lokalizuara territorialisht kundër një qeverie as kolonialiste, as raciste.	98
4. Kryengritja kundër një qeverie jopopullore.....	101

KREU VII: TRAJTIMI I PARIMIT TË VETËVENDOSJES NË PRAKTIKEN E GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË, DHE ORGANEVE TË DREJTËSISE

1. Mendimi këshillmor i Gjykatës Ndërkombëtare në lidhje me çështjen e pranisë së Afrikës së Jugut në Namibi e vitit 1971.....	103
2. Vendimi i GJND i vitit 1975 për Saharanë Perëndimore	104
3. Vendimi i GJND për çështjen e ndarjes së kufijve ndërmjet Burkina Faso dhe Malit e vitit 1986.....	105
4. Vendimi i GJND për çështjen e Timorit Lindor e vitit 1995	107
5. Vendimi i GJND për ndërtimin e murit në Palestinë viti 2004	111
6. Krijimi i Komisionit të Arbitrazhit të Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, e vitit 1991.....	112
7. Vendimi i Gjykatës së Lartë Kanadeze në lidhje me çështjen e Shkëputjes të Kuebekut, viti 1996. Ndikimi dhe pasojat e tij në lidhje me çështjen e Kosovës.....	113

8. Rëndësia e jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për parimin e vetëvendosjes së popujve dhe pasojat politike dhe juridike në kontekstet e prekura nga zhvillime të tilla	114
--	-----

KREU VIII: ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME PARIMIN E VETËVENDOSJES SË POPUJVE DHE ME MUNDËSITE PËR T’ITRAJTUAR NË DRITËN E INSTRUMENTAVE NDËRKOMBËTARE DHE DOKTRINALE

1. Parimi i vetëvendosjes dhe Jus Cogens.....	116
2. Parimi i vetëvendosjes dhe e drejta për shkëputje.....	118
3. Njohja ndërkombëtare e legjitimitetit dhe çështja e lindjes së një shteti të ri, Analizë e fenomenit në dritën e ngjarjeve në Kosovë.....	120
4. Ratsi Krimesë-Vështtrim Historik.....	123
4.1. Aneksimi Rus i Krimesë dhe e drejta për tu shkëputur (Mars 2014).....	126
5. Krimea dhe Kosova, dy raste të ndryshme.....	131

KREU IX: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....137

BIBLIOGRAFIA.....147

LISTA E SHKURTIMEVE

VV	Vetëvendosje
AJIL	American Journal of International Law
ASIL Proc.	Proceedings of the American Society of International Law
KN	Komiteti Ndërkombëtar
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
CIDCM	Centre for International Development and Conflict Management
KSBE	Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunim në Europë
EJIL	European Journal of International Law
FRSJ	Federata e Republikave Socialiste të Jugosllavisë
FYIL	Finnish Yearbook of International Law
GYIL	German Yearbook of International Law
ICLQ	International and Comparative Law Quarterly
ILM	International Law Magazine
MJIL	Michigan Journal of International Law
NATO	North Atlantic Treaty Organization
KB	Kombet e Bashkuara
NYIL	Nederland Yearbook of International Law
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OUA	Organizata për Unitetin Afrikan
RBDI	Revue Beige de Droit International
RFGJ	Republika Federale e Gjermanisë
RGDIP	Revue Général de Droit International Public
BE	Bashkimi Europian
UK	United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland
UNHCR	United Nations High Committee for Refugees
BRSS	Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
USA	United States of America
YJIL	Yale Journal of International Law

KREU I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1. Hyrje

Ky punim propozon një analizë përshkruese dhe kritike të parimit të vetëvendosjes, si një nga shtyllat e të drejtave të njeriut dhe gjithashtu një prej temave më të debatuar në teorinë juridike ndërkombëtare, si për rastet e shumta që kanë ndodhur në sferën gjeopolitike, të lidhura në një farë mënyre me këtë parim, ashtu edhe për shkak se, parimi ka ende shumë domethënie të diskutueshme.

Së pari, duhet të sqarohet se koncepti i “vetëvendosjes” mund të ketë disa kuptime, edhe larg njëri-tjetrit, por kuptimi më me interes për këtë punim është ai që merr në konsideratë marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe shtetasve të tyre, në lidhje me të drejtën e këtyre të fundit për të vendosur për veten e tyre në dritën e normave të së drejtës ndërkombëtare. Bashkësia e njerëzve brenda një shteti dëshiron t’i shohë të garantuara të drejtat për t’u shprehur, për të jetuar sipas besimeve, zakoneve dhe traditave si dhe për të ruajtur gjuhën, fenë e identitetin e saj.

Duhet të bëhet dallimi midis koncepteve të popullit, pakicave (minoriteteve), indigjenëve, grupit kryengritës, të cilët shpesh janë të përfshirë të gjithë në diskutimet dhe dokumentet në lidhje me parimin e vetëvendosjes.

Edhe pse për parimin e vetëvendosjes, ka disa qasje në bazë të pikëpamjeve të ndryshme, si ai i shkencave politike, i filozofisë të së drejtës, i të drejtës kushtetuese, në këtë studim do të përqëndrohemi në trajtimin e këtij parimi në dritën e së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kuadër, një rëndësi e veçantë do t’i kushtohet analizës së parimit të respektimit të së drejtave themelore të njeriut, përfshirë të drejtën për të mos u diskriminuar për arsye të racës, seksit, gjuhës apo fesë, si dhe analizës së akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, që trajtojnë parimin e vetëvendosjes.

Ndër këto, dua të theksoj “Deklaratën për pavarësinë e popujve koloniale”¹, një sërë Rezolutash, si ajo e 14 dhjetorit 1962, për sovranitetin e përhershëm mbi resurset natyrore (1803-XVII), raportet e Sekretarit të Përgjithshëm, rezolutat e Këshillit të Sigurimit, rezolutat e Këshillit të së Drejtave të Njeriut, Paktet Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut² dhe gjithashtu, Deklaratën për marrëdhëniet

¹E përfshirë në Rezolutën e datës 14 dhjetor 1960, nr. 1514-XV.

²Gjithashtu i njohur si *Konventa* për të Drejtat Civile dhe Politike dhe *Konventa* mbi të Drejtat ekonomike Sociale dhe Kulturore.

miqësore³.

Për të kuptuar më mirë përmbajtjen e parimit të vetëvendosjes, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe analizës së vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të Gjykatave Ndërkombëtare dhe atyre të brendshme të disa shteteve, që në fokus të tyre kanë pasur trajtimin e parimit të vetëvendosjes.

Së fundi, një referim i nevojshëm do t'i bëhet doktrinës ndërkombëtare që ka trajtuar parimin e vetëvendosjes, meqënëse ka një debat pak a shumë të zgjeruar, në lidhje me përmbajtjen që duhet t'i jepet parimit të vetëvendosjes dhe përcaktimit të natyrës së tij (nëse bëhet fjalë për një parim vetëm politik apo edhe juridik⁴). Në fakt, vetëvendosja ka një përmbajtje shumë më të gjerë me argumente, që tregojnë natyrën e saj, si një parim i cili është objekt i detyrimeve ndërshtetërore që burojnë nga traktate ndërkombëtare, si dhe nga e drejta zakonore ndërkombëtare.⁵

Më poshtë do të japim një përkufizim të detajuar të parimit të vetëvendosjes së popujve, në bazë të përcaktimeve të së drejtës së brendshme të shteteve dhe të së drejtës ndërkombëtare. Në vijim do të trajtojmë aspektet problematike të konceptit të vetëvendosjes dhe shfaqjes së tij në ditët e sotme, duke u bazuar kryesisht në doktrinën ndërkombëtare që e ka trajtuar këtë parim.

Më shumë do t'u referohemi mendimeve më të fundit mbi vetëvendosjen, pas Luftës së Dytë Botërore deri në ditët e sotme, edhe pse situata gjeopolitike ka ndryshuar dukshëm. Teksa gjendemi përpara një bote të ndarë në dy zona influence dhe me një tërësi kolonializimesh dhe regjimesh diktatoriale, ku ka pasur shumë shkëputje dhe shpërbërje shtetesh dhe në të cilat hipoteza koloniale është thuarje e zbehur, e rëndësishme është të përqendrohemi jo vetëm tek shtetet, që janë subjekte të njohura të së drejtës ndërkombëtare, por edhe tek përfituesit e parimit që nënkuptohen: popujt, minoritetet, lëvizjet çlirimtare dhe kryengritëse.

Pjesa e fundit do t'i kushtohet një analize gjithëpërfshirëse të parimit të vetëvendosjes së popujve. Kjo analizë do të sqarojë shumë pyetje që në vitet e fundit janë shfaqur mbi parimin e vetëvendosjes, mbi të drejtat dhe detyrimet e shtetit në

³E përfshirë në Rezolutën e datës 24 tetor 1970, n. 2625-XXV.

⁴Pomerance. M. (1992). *Self-Determination in Law and Practice : The New Doctrine of the United Nations*, The Hague, pp.70; Hannum. H. (2002). Edited by, Beck. R. J and Ambrosio.T. *Rethinking selfdetermination in International law and the rise of nations. The state system and the challenge of ethnic groups*, New York-London, pp. 31.

⁵Palmisano.P. (1997). *Nazioni Unite e autodeterminazione Il principio alla luce degli strumenti rilevanti dell' ON U*, Milano, pg. 1-32.

lidhje me këtë parim, mbi pasojat që mund të ketë shkelja e kësaj të drejte në renditjen ndërkombëtare dhe mbi rolin e Kombeve të Bashkuara. Në fazën e parë të periudhës pas Luftës II Botërore, vetëvendosja ka përfaqësuar një instrument të rëndësishëm për dekolonializimin dhe fundin e skemës së luftës së ftohtë, që brenda këtij sistemi kishte detyruar një logjikë “imperialiste”, në të cilën sovraniteti i disa shteteve ishte i kufizuar, duke krijuar në këtë mënyrë probleme⁶.

Rëndësinë dhe kritikën e parimit të vetëvendosjes së popujve mund t'i vërtetojmë me një konstatim të thjeshtë: në periudhën 1956-2002, 76 shtete kanë qenë të përfshira në konflikte lidhur me zbatimin e parimit të vetëvendosjes dhe sovranitetit, nga këto vetëm 12 prej tyre janë zgjidhur me marrëveshje paqësore, ndërsa 12 të tjerë janë përcaktuar si rezultat i konflikteve të armatosura. Pjesa e mbetur e konflikteve janë akoma të hapura (22), ndërsa rastet e tjera (29) në një farë mënyre janë nën kontrollin e misioneve paqeruajtëse ndërkombëtare. Çështja është shumë komplekse dhe kjo duket nga fakti që këto konflikte kanë pasur një zgjatje mesatare 30- vjeçare, gjatë të cilave janë shfaqur shkelje të gjata e të rënda të të drejtave të njeriut⁷.

2. Hipoteza e Punimit

Vetëvendosja nuk është një "e drejtë për t'u shkëputur", por një e drejtë e një populli për ta vendosur lirisht organizimin e tij politik.

Në kuadër të kësaj të drejte ka shumë përfundime të mundshme politike: shkëputja nga një shtet, përfshirja në një shtet tjetër ose vetëm ripërcaktimi i një statusi politik dhe juridik brenda një shteti.

3. Pyetjet kërkimore të punimit

A. Pyetja kërkimore qendrore

Pyetja qendrore që shtrun studimi është cilat janë format e shfaqjes së parimit të vetëvendosjes në të drejtën ndërkombëtare bashkëkohore, e parë kjo në këndvështrimin e trajtimit të këtij parimi nga aktet ndërkombëtare.

⁶ Arangio.G.R. (1989). *Diritto dei popoli alla*, in *enciclopedia giuridica*, vol. IV, Roma, pg. 6.

⁷ Paul.R.W. And Francesca. J. P. (2003). *Earned Sovereignty: Bridging the Gap Between Sovereignty and Self-Determination*, 26–30. e akseueshme online në adresën e web-it:

<http://www.cidcm.umd.edu/inscr/pc03print.pdf>, (vizituar më 22 dhjetor 2016).

B. Pyetjet kërkimore dytësore

- 1) Çfarë është vetëvendosja?
- 2) A ka një të drejtë vetëvendosjeje bazuar në normat ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare publike?
- 3) A mund të konsiderohet parimi i vetëvendosjes si një parim “*erga omnes*” (ndaj të gjithëve)?
- 4) Cili është raporti ndërmjet parimit të vetëvendosjes dhe parimit “*uti possidetis juris*”⁸?
- 5) Cilat janë format e para dhe aktuale të shfaqjes së parimit të vetëvendosjes në këndvështrimin e akteve ndërkombëtare?

4. Metodat dhe metodologjia e kërkimit

Në përgatitjen e këtij punimi kam përdorur disa metoda shkencore, të cilat kanë për objekt studimin e fenomenit të parimit të vetëvendosjes në përmasat e ndryshme të evoluimit dhe shfaqjes së tij në arenën ndërkombëtare dhe rajonale.

Ky punim bazohet kryesisht në analizën e instrumenteve ndërkombëtare dhe në çështjet e trajtuara nga doktrina dhe jurisprudenca mbi parimin e vetëvendosjes së popujve, mbështetur jo vetëm në metodologjinë historike, por edhe në atë analitike dhe përshkruese.

Tema ka karakter historik dhe juridik, por që projektohet me karakteristika të veçanta dhe të diskutueshme në arenën ndërkombëtare, për shkak të natyrës globale që ka sot parimi i vetëvendosjes së popujve.

Metoda historike është përdorur për të pasqyruar zhvillimin e parimit të vetëvendosjes, si dhe proceset zhvillimore të përqaqjes së tij në këndvështrimin e akteve ndërkombëtare dhe ndihmesës së jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Gjykatave të tjera ndërkombëtare dhe atyre të Shteteve të ndryshme.

Metoda analitike bazohet kryesisht në analizën e akteve dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi parimin e vetëvendosjes.

Metoda përshkruese ka si qëllim identifikimin e qasjeve të ndryshme të doktrinës dhe jurisprudencës mbi parimin e vetëvendosjes së popujve.

⁸Parim i së drejtës ndërkombëtare i përdorur gjerësisht gjatë procesit të dekolonializmit, sipas të cilit, në fund të një konflikti, territori dhe prona të tjera mbeten në kufijtë e poseduesit të mëpërparshëm.

5. Kufizimet Metodologjike.

Ky kërkim shkencor, bazohet kryesisht në literaturën e trajtuar nga doktrina dhe jurisprudenca mbi fenomenin e parimit të vetvendosjes dhe evoluimin e tij, në analizën e akteve dhe instrumentave ndërkombëtarë dhe rajonal dhe jo vetëm, është një punim i vështirë që kërkon një referim më shumë në metodologjinë analitike, historike, përshkruese dhe cilësore, pasi realizimi nëpërmjet metodave sasiore apo empirike nuk është i përshtatshëm për temën e zgjedhur për studim, duke qënë se është një temë që në vetevte mbart vështirësi për shkak të karakterit të saj historiko-juridik, dhe si e tillë e vështirë për ta trajtuar nëpërmjet metodave të mbledhjes së të dhënave siç janë; intervistimi i drjpërdrejtë, pyetsorët, sondazhet, statistikat etj.

6.Rëndësia e punimit.

Vetëvendosja është e drejta e popujve për të përcaktuar lirisht statusin e tyre politik dhe për të vazhduar lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Edhe pse duket një pyetje e lehtë, a rrjedh kjo e drejtë nga ajo çfarë një "popull" është? Cilët elemente janë përcaktuesit e një kombi? Shumë politikanë deklarojnë pa asnjë ndrojtje se cilët popuj konkretë janë me të vërtetë kombe, dhe cilët prej tyre nuk janë tillë. Në fakt, si një çështje sociologjike, nuk ekziston asnjë mënyrë objektive për të përcaktuar se çfarë është ose çfarë nuk është një komb, si çdo gjë tjetër në shkencat shoqërore, prandaj kjo mbetet një çështje për t'u diskutuar. Pra, para së gjithash, duhet të jemi dyshues për të gjithë ata që në mënyrë të qartë pohojnë se ky është një komb, apo ky nuk është i tillë.

Natyrisht ka faktorë që përcaktojnë identitetet sociale, si gjuha e përbashkët, kultura, historia, etj, por duke qënë se këta faktorë perceptohen në mënyrë të ndryshme nga çdo individ, askush nuk mund të flasë në emër të të gjithëve. Kjo nuk mund të na çojë neve në skepticizëm sociologjik -asgjë nuk mund të provohet, kështu që asgjë nuk ekziston. Faktorët e sipërpërmendur zakonisht të perceptuar nga një grup njerëzish, janë rrënjët e një kombi. Kur një komb është i vetë-pranuar, e drejta e vetëvendosjes është rruga politike për të krijuar një shoqëri të organizuar, në formën e vendosur lirisht nga anëtarët e atij populli. Pikërisht ky kërkim shkencor synon të sjelli një tablo të plotë të fenomenit të parimit të vetvendosjes në të drejten ndërkombëtare bashkohore duke kontribuar sadopak në trajtimin e problematikave që mabrt fenomenin për tu shëndrruar kështu në një pike referimi për doktrinën, jurisprudencën dhe ekspertët e fushës.

KREU II: ZHVILLIMI HISTORIK I PARIMIT TË VETËVENDOSJES

1. Parimi i vetëvendosjes së popujve nga formulimet e tij të para deri në Paktin e Atlantikut të 1941-shit.

Një analizë e plotë e këtij institucioni nuk mund të fillojë pa trajtuar një periudhë historike, e cila na shfaq që në hapat e parë karakterin universal të parimit, falë Revolucionit Francez dhe lëvizjes për themelimin e SHBA-së. Formulimi i parë shfaqet në Deklaratën e të drejtave të popujve, përgatitur nga Abbe Gregoire, në Konventën e 23 prillit 1795, (por jo e miratuar nga Kuvendi) që konfirmon nevojën për t'i ndihmuar të gjithë popujt që duan të fitojnë lirinë e tyre, qytetarët për kauzën fisnike të lirisë⁹, për të legjitimuar ndërhyrjen e armatosur në shtetet evropiane.

Parimi i vetëvendosjes në kuptimin e tij të parë (mbështetur fuqimisht, siç do ta shohim, nga politikanë, si Lenini dhe Wilson-i) synonte ta tejkalonte optikën tradicionale, në nivel ndërkombëtar, bazuar në sovranitetin e shtetit. Sipas këtij vizioni, në fakt, bashkësia ndërkombëtare ishte e përbërë nga fuqitë (shtetet sovrane), ku secila prej tyre kishte për qëllim, pothuajse të veçantë, kënaqjen e interesave të klasës sunduese. Në të vërtetë, me vetëvendosjen ata duhej ta vinin theksin tek aspiratat e popujve, të cilët në drejtimin e punëve të brendshme dhe atyre ndërkombëtare, duhet ta thoshin fjalën e tyre përmes votës dhe referendumit. Pra, vetëvendosja u shpall si parim demokratik, si liri dhe mundësi e popujve për të zgjedhur nga kush të qeverisen, natyrisht të lirë nga çfarëdolloj shtypjeje koloniale.

Në vitin 1917 pati një ndarje në nivel ndërkombëtar, për shkak të hyrjes së një fuqie të re në arenën ndërkombëtare ku Bashkimit Sovjetik shpalli një ideologji dhe filozofi politike radikale, e cila binte në kundërshtim me atë të shteteve të tjera.

Lenini, në mënyrë të përsëritur, mbajti dhe shpalli qëndrimin e tij për parimin e vetëvendosjes së popujve dhe në të njëjtën kohë, ky parim u konfirmua dhe nga Presidenti amerikan Wilson, por më i moderuar dhe me ndryshime të rëndësishme. Presidenti Wilson besonte se ishte e nevojshme që të shqyrtoheshin edhe njëherë mbas Luftës së Parë Botërore kufijtë ekzistues, duke i ftuar kështu të gjitha shtetet sovrane që t'i rishikonin dhe t'i merrnin sërish në konsideratë kërkesat e tyre dhe ato të grupeve e bashkësive (komuniteteve) që shpresonin për një autonomi më të

⁹ Lattanzi. F. (1987). *Autodeterminazione dei popoli in Digesto delle discipline Pubblicistiche*, 4^o edizione, Torino, pg. 1-32.

madhe. Pika e pestë, ndër 14 pikat e famshme, që shpalli Wilsoni në Konferencën e Paqes, të zhvilluar në Paris më 18.01.1918, kërkonte “një zgjidhje të lirë, të hapur dhe të paanshme të situatës koloniale e bazuar në respektimin e rreptë të parimit, sipas së cilit, për t’i zgjidhur çështjet mbi sovranitetin duhej të merreshin parasysh interesat e popullit të prekur drejtpërdrejt dhe pretendimet e barabarta të qeverive, mbi titujt ligjorë për të cilat diskutohej¹⁰”.

Karakteri revolucionar i parimit u theksua më vonë dhe nga Sekretari i Shtetit Amerikan, Robert Lansing. Sipas tij, programi i Leninit, thirrja për vendosje demokratike e popujve të kolonializuar, ishin kërcënim për qëndrueshmërinë në të ardhmen e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke vënë në dukje se “nëse parimi do të aplikohet në mënyrë të barabartë, do të zhdukej qëndrueshmëria e kufijve kombëtarë, detyra e nënshtrimit dhe qëndrueshmëria politike”¹¹.

Pavarësisht nga përmbajtja e këtij parimi, gjatë periudhës historike midis dy luftërave botërore dhe njohjes në shkallë ndërkombëtare, tashmë, edhe në Traktatet e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, ky parim kishte karakter tërësisht politik. Nuk ekzistonte asnjë detyrim ndërkombëtar ndaj shteteve për t’i njohur një bashkësie të drejtën e vetëvendosjes. Megjithatë, një ngjarje e rëndësishme ishte marrja e pushtetit nga ana e regjimeve totalitare në vende të ndryshme të Evropës në periudhën midis dy konflikteve botërore, i ndërtuar mbi mohimin e plotë të të drejtave të njeriut, në veçanti, të atyre grupeve që për arsye etnike ose ideologjike që ndryshonin nga grupi i cili ishte në pushtet. Meqë situata ishte e paracaktuar të ndryshonte me Luftën e Dytë Botërore dhe vuri përballë problemin e rimodelimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia formuluan Kartën e Atlantikut (1941), në të cilën shfaqej parimi i vetëvendosjes, (neni 1 dhe 3), megjithëse në version të mjergullt¹².

2. Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Parimi i vetëvendosjes së popujve.

Një pranim shumë më i gjerë, i përmbajtjes së parimit deri tani, është ilustruar e realizuar në një traktat ndërkombëtar me prirje universale, Karta e Kombeve të Bashkuara. Diskutimet, që çuan në shpalljen e këtij dokumenti të rëndësishëm, janë karakterizuar nga kontrasti ndërmjet tezës së Bashkimit Sovjetik dhe vendeve perëndimore, të cilat morën pjesë në marrëveshjen e Konferencës së San Franciskos.

¹⁰ Cassese . A. (1984). *Diritto internazionale nel mondo contemporaneo*, pg. 155.

¹¹ Po aty.

¹² Shih nenin 1 dhe 3 Kartën e Atlantikut (1941).

Përfundimisht, parimi u pranua dhe u përkthye në mënyrë të paqartë dhe të ndërlikuar në nenin 1, paragrafi 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara¹³. Respektimi i këtij parimi shihet dhe në dispozitat e Kartës kushtuar veprimit të anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, për krijimin e kushteve të qëndrueshmërisë dhe të mirëqenies së popujve me anë të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën ekonomike, sociale dhe kulturore.

Dhe është pikërisht në nenin 55¹⁴, ku parimi prezantohet për herë të parë në aspektin ekonomik, kuptuar si e drejta e një populli për t'i gëzuar burimet e veta natyrore (më vonë e përparuar në të drejtën për një shpërndarje të korrekte të burimeve në nivel ndërkombëtar dhe në të drejtën për zhvillim), si dhe nevojë për të siguruar për të gjithë popujt, mundësinë për të pasur shpërndarje të barabartë të burimeve të brendshme të vendit. Objektivat e nenit 55 konfirmohen më pas nga neni 56¹⁵. Kjo do të thotë se, jo vetëm organizata, por edhe shtetet anëtare individualisht, në rast se bashkohen për një qëllim të përbashkët, duhet të veprojnë për t'i realizuar qëllimet e përcaktuara në nivel ndërkombëtar ,dhe para së gjithash, duke respektuar të drejtën për vetëvendosje brenda kufijve të tyre. Referuar kontekstit kolonial, parimit të vetëvendosjes i referohen dhe dispozita të tjera të Kartës, në veçanti, nenet 73 dhe 76.

Neni 73 i referohet faktit se fuqitë koloniale janë të detyruara që t'i çojnë në vetëqeverisje popujt e territoreve që nuk janë të pavarur, por duke patur gjithmonë parasysh qëllimet tyre politike dhe duke iu ofruar atyre ndihmë në zhvillimin progresiv të institucioneve të lira politike. Në këtë rast duket qartë se objektivi është më i kufizuar dhe kujton në veçanti, dispozitat e Statutit të Lidhjes së Kombeve, edhe pse ideja që e frymëzon atë është sigurisht më demokratike.

Për ta shprehur më qartë se çfarë solli pas luftës Karta e Kombeve të Bashkuara, në fushat specifike që na interesojnë këtu, nuk mund të mos theksohet se përfshirja e këtyre parimeve në këtë Kartë, ishte një hap i madh përpara, megjithatë i kufizuar nga disa faktorë:

¹³ Neni 1 i Kartës së Kombeve të Bashkuara. Hartuar në vitin 1945 nga përfaqësues të 50 vende të botës në San Francisco të Kalifornisë, ShBA.

¹⁴ Po aty, Neni. 55.

¹⁵ Lattanzi. F. (1987). *Autodeterminazione dei popoli in Digesto delle discipline Pubblicistiche*, 4° edizione, Torino, pg. 6-30.

1. Më shumë sesa një detyrim për t'u zbatuar menjëherë, ishte një program i përgjithshëm për organizatën dhe për shtetet që u zotuan për ta zbatuar atë, duke vepruar kolektivisht dhe individualisht në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara (neni 56)¹⁶.
2. Perandoritë koloniale nuk u preken, sepse nga gjendja aktuale e sovranitetit të padiskutueshëm të një shteti mbi to, u kalua në “kujdestarinë ndërkombëtare”, ose në formulime të përgjithshme që i gjejmë tek neni 73¹⁷.
3. Në veçanti, termi “vetëvendosje” merret më shumë si “vetëqeverisje” sesa “pavarësi” dhe kjo e fundit, ishte e rezervuar vetëm për popujt që i nënshtroheshin “kujdestarisë ndërkombëtare” (neni 76/b)¹⁸;
4. Integriteti territorial i shteteve u konceptua në vitin 1945, si një vlerë me një rëndësi të madhe, kështu që vetëvendosja nuk duhet të ketë epërsinë që të shkaktojë shkëputjen.

3. Evolucion i juridiko-institucional i parimit të vetëvendosjes së popujve, pas vitit 1960 të shekullit të kaluar.

Në vitet në vijim, mbas miratimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe sidomos pas përfundimit të viteve '50, në sajë të veprimit të vendeve socialiste dhe rritjes së numrit të vendeve të Botës së Tretë, u bë i mundur shndërrimi i dispozitave në një parim të rëndësishëm universale. Kështu, ndërsa pas luftës ndodhi copëtimi gradual i perandorive, praktika e Kombeve të Bashkuara u angazhua për një akt avancues për mospranim të nenit 73, për të krijuar një rregull që i angazhonte shtetet që ishin edhe mbajtësit e territoreve koloniale, të mos pengonin pavarësinë.

3.1. Rezoluta 1514-XV Asamblesë së Përgjithshme e 15 dhjetorit 1960.

Në vitin 1960, Asambleja e Përgjithshme u pozicionua, duke pohuar solemnisht në Deklaratën për pavarësinë e popujve kolonialë¹⁹ se nënshtimi i një populli ndaj sundimit të huaj, duhej konsideruar në kundërshtim me Kartën.

Një deklaratë e tillë vazhdon të ndikojë ende sot në opinionin e bashkësisë ndërkombëtare dhe për këtë arsye është miratuar nga praktika e përditshme²⁰.

¹⁶ Neni 56 i Kartës së OKB-së.

¹⁷ Po aty, Neni 73.

¹⁸ Po aty, Neni 76/b.

¹⁹ Rezoluta e 14 dhjetorit 1960, n. 1514-XV.

²⁰ Paragrafi 2 i Rezolutës.

Elementi gjeografik i vendosur në Rezolutën nr.1541, vetëm një ditë pas miratimit të rezolutës nr.1514²¹, i referohej situatës klasike të sundimit kolonial dhe idesë së parë, sipas të cilës parimi i vetëvendosjes duhet të çojë në krijimin e një shteti të ri sovran dhe të pavarur.

Duhet theksuar se, rezoluta n.1541 e vë theksin në natyrën vullnetare të vendimit, mbi nevojën për t'i ruajtur karakteristikat e popullsisë dhe territorit si dhe të drejtën e të dy popujve për t'u përfaqësuar në të njëjtën mënyrë, në të gjitha nivelet²².

3.2. Paktet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut të 1966-ës.

Në vitin 1966, miratimi i njëzëshëm i Pakteve ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, çoi në një fazë të re të zhvillimit të konceptit të vetëvendosjes.

Ashtu si Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, edhe ai mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore pohojnë në nenin 1 se : “...*Të gjithë popujt kanë të drejtën që të vendosin për veten e tyre...*”²³. Duke u mbështetur në këtë të drejtë, ata përcaktojnë lirisht regjimin e tyre politik dhe sigurojnë zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor”. Vetëvendosja konsiderohet si një e drejtë njerëzore, duke iu drejtuar të gjithë popujve dhe jo vetëm atyre kolonialë.

Me miratimi e Pakteve ndërkombëtare për të Drejtat, vlera e parimit të vetëvendosjes fillon të zgjerohet, duke u njohur me zgjedhjen nga ana e popullit të mënyrave të ndryshme të organizimit politik dhe institucioneve të përshtatshme për ta përfaqësuar atë.

Megjithatë, popujve nuk u njihet një rol aktiv, por janë shtetet e tyre që vendosin marrjen e masave të nevojshme për ta mundur vetëvendosjen. Në këto pakte është folur dhe për përmasën ekonomike të parimit, që përbëhet nga liria e zgjedhjes së sistemit ekonomik dhe e drejta për zhvillimin dhe përdorimin e lirë të burimeve të tyre natyrore.

Duhet përmendur që Asambleja e Përgjithshme dhe Komiteti për dekolonializimin (Komiteti i 24-të) nuk u kufizuan vetëm në shpalljen abstrakte, por

²¹Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e 15 dhjetorit 1960, në UN Yearbook. "*I principi guida per determinare l'obbligo di Sati di trasmettere informazioni alle Nazioni Unite sui territori non autonomi*", pp.509 .

²² Neni. 1 , par.2. Rezoluta 3281 (XXIX) e 2 dhjetorit 1974, Për të drejtat ekonomike dhe detryrimet e Shteteve.

²³Lattanzi, F. (1987). *Autodeterminazione dei popoli in Digesto delle discipline Pubblicistiche*, 4o edizione, Torino, pg. 14.

ishin edhe aktivë në ndihmën për ta lehtësuar arritjen e integritetit politik dhe ekonomik të territoreve të ndara²⁴.

Kombet e Bashkuara kanë punuar në mënyrë aktive për të organizuar së bashku me pushtetin që i administronte, disa paqartësi në territoret koloniale, siç ka ndodhur në Togon Britanike²⁵, Kamerunin Britanik²⁶, në Samoa-n Perëndimore²⁷ dhe në Ruanda-Urundi²⁸. Megjithatë konstatohen edhe raste kur Kombet e Bashkuara e kanë mohuar ekzistencën e një të drejte për vetëvendosje, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në situata të tilla si: Katanga, Biafra dhe Kurdistan, ku mbizotëronte parimi i integritetit territorial, sepse është konsideruar se shtetet, përkatësisht, të Kongos, Nigerisë dhe Irakut nuk do të mund t'igjarantonin të drejtat e pakicave²⁹. Zgjidhja në raste të tilla, duhet të ishte paqësore dhe në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet shteteve të interesuara dhe jo me akte të forcës. Pra, ishte e nevojshme që qeveritë e shteteve që pretendonin sovranitetin, të ishin në gjendje për t'isiguruar të drejtat e pakicave dhe të drejtën për vetëvendosje të popullit të tyre.

3.3. Deklarata mbi parimet e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1970.

Një hap tjetër, në lidhje me identifikimin e përmbajtjes së parimit të vetëvendosjes, u bë me “Deklaratën për parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin mes shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara”, të vitit 1970³⁰. Deklarata vërtetoi globalizimin e parimit të vetëvendosjes dhe theksoi se të gjithë popujt kishin të drejtën për ta përcaktuar lirisht, pa ndërhyrje nga jashtë, statusin e tyre politik, ekonomik, social dhe kulturor, dhe kjo ishte detyra e çdo shteti për të respektuar këtë të drejtë³¹.

Gjithashtu e njëjta deklaratë u përpoq të përcaktojë përmbajtjen e parimit

²⁴ Lattanzi F.(vep e cit), pg. 14.

²⁵ As. Përgjithshme. Rezoluta 1044-XI e dt.13-12-1956.

²⁶ As. Përgjithshme. Rezoluta 1350-XIII e dt.13-3-1959.

²⁷ As. Përgjithshme. Rezoluta 1569-XY e dt. 18-12-1960.

²⁸ As. Përgjithshme. Rezoluta. 1605-XV e dt. 7-4-1961.

²⁹ Rezolutat e Këshillit të Sigurimit nr. 143 e dt. 14-7-1960, 145 e Dt. 22-7-1960, 146 e dt. 9-8-1960.

³⁰ As. Përgjithshme. Rezoluta. n.2625 e dt. 24-11-1970.

³¹Ruiz. A.(1988). *Autodeterminazione diritto dei popoli* cit, pg.4: Palmisano. G. (1997). *Nazioni Unite e autodeterminazione*, pg. 213 .

duke shtuar një mënyrë të re të zbatimit të tij, përkatësisht “...qasje në statusin politik, e dëshiruar dhe e përcaktuar nga populli...” (paragrafi IV).

Një dukuri shumë e rëndësishme në rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, në këtë kontekst, ishte ndalimi i përdorimit të forcës. Kjo u përsërit në Deklaratën për dhënien e pavarësisë popujve kolonialë, si edhe në dokumente të tjera të miratuara në mënyrë të njëanshme nga shtetet, por së shpejti situata gjeopolitike dhe veprimi i shteteve socialiste dhe atyre afro-aziatike çuan në një ndryshim. Që prej viteve ‘60 kemi parë që para shumëfishimit të luftërave për çlirim kombëtar, në territoret nën sundimin kolonial, të huaj ose racist, popujt nuk kishin asnjë mundësi për ta mbrojtur veten e tyre. Si rrjedhojë, u miratuan një seri rezolutash që e konsideruan si të drejtë luftën nga popujt e shtypur, veçanërisht, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr. 2621-XXV e vitit 1970, e cila rikonfirmoi të drejtën e natyrshme të popujve kolonialë për të luftuar me të gjitha mjetet e nevojshme kundër fuqive koloriale, që shtypnin lirinë dhe pavarësinë³² e tyre; dhe Rezoluta nr. 3314-XXIX e vitit 1974. Ligjshmëria (legjitimiteti) e kësaj lloji lufte ishte sinonimi i dëshirës për t’ieliminuar shkaqet e konflikteve dhe padrejtësive që mund t’i rrezikonin paqen dhe sigurinë³³. Luftërat për çlirim kombëtar nuk mund të zhvilloheshin të përkufizuara si forma të paligjshme të dhunës, sepse ata janë përdorur për të arritur qëllimet kryesore për bashkësinë ndërkombëtare dhe me prirjen për të shmangur krijimin e konflikteve të mëtejshme³⁴.

Pavarësisht kësaj, është e qartë që e drejta e zhvillimit të kësaj lufte nuk do të mund të jetë e mirëpritur, kryesisht nga vendet perëndimore, sepse njohja e së drejtës së popujve të shtypur për përdorimin e forcës nuk ka qenë gjithmonë e njëzëshme (unanime). Deklarata mbi marrëdhëniet paqësore, për shembull, përmend vetëm popujt që reagojnë dhe i rezistojnë shtypjes së kolonizatorëve, ndërsa është më e saktë Deklarata për përcaktimin e agresionit, e cila siguron në nenin 7 “...të drejtën e popujve për të luftuar për arritjen e vetëvendosjes...”. Situata të tilla futen në kategorinë “konflikt i armatosur ndërkombëtar” të Protokollit të Parë të Konventës së Gjenevës mbi të drejtën njerëzore të vitit 1977, ku bën pjesë kategoria “popujt që janë duke luftuar kundër sundimit kolonial dhe pushtimit të huaj dhe kundër

³² <http://www.un.org>.

³³ Lattanzi. F. (1987). *Autodetennino zione dei popoli in Digesto delle discipline Pubblicistiche*. 4o edizione, Torino, pg.24.

³⁴ Rezoluta 2625 (XXV) dhe Rezoluta 3314 (XXIX) e 14 dhjetorit 1974.

regjimeve raciste në ushtrimin e së drejtës së popujve për vetëvendosje”. Interesante për t’u përmendur është se rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr. 3103-XXVIII e vitit 1973, mbi parimet bazë dhe statusin ligjor të luftëtarëve, që luftojnë kundër sundimit kolonial dhe regjimeve raciste, në të cilën sqarohen disa karakteristika të këtyre konflikteve, duke përfshirë ndalimin e pakundërshtueshëm të rekrutimit, përdorimit, financimit dhe krijimit të trupave mercenare. Sigurisht, lufta e armatosur është e përligjshme vetëm kur nuk ka mjete të tjera. E sigurt është se një popull i shtypur, i organizuar në një lëvizje çlirimtare kombëtare, nuk mund të thuhet që është mbajtës i të drejtës së përdorimit të forcës, nga ana tjetër, nuk mund edhe të jetë fajtor për shkelje të së drejtës ndërkombëtare, nëse populli e përdor këtë forcë për të reaguar ndaj agresionit të armatosur të shtetit shtypës. Kjo është në fakt një zgjidhje përshtatshme e bashkësisë ndërkombëtare, ku nëse dikush ngre zërin ndonjëherë për ta dënuar dhe kritikuar luftën e armatosur, e bën për arsye politike apo për interesat e veta.

Kjo shihet qartë në rastin e Çeçenisë, ku lufta për pavarësi konsiderohet si një çështje e brendshme e Rusisë, dhe jo si një luftë për vetëvendosje. Kjo është arsyeja pse përdorimi i forcës nga çeçenët nuk u njoh si e drejtë, prandaj dhe veprimet e tyre konsiderohen akte terroriste, të cilat shkelin të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare njerëzore në përgjithësi³⁵.

Përdorimi i forcës, nëse fillimisht ishte objekt i një ndalimi *absolut dhe gjithëpërfshirës*, më tej u bë një mjet-çelës për të siguruar arritjen e qëllimit përfundimtar të Kombeve të Bashkuara domethënë, paqen ndërkombëtare, në bazë të orientimit të Kombeve të Bashkuara, rezolutave dhe deklaratave³⁶.

4. Akti Final i Helsinkit i vitit 1975 dhe Karta e Algjerit e vitit 1976.

Një nga formulimet më të plota të parimit të vetëvendosjes vjen nga Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, nënshkruar në Helsinki, më 1

³⁵Brandt .A. C. (2004). *Chechnya and the Right of Self – determination*, in Columbia Journal of Transnational Law, Columbia Law School- New York, Vol. 42, pp.609.

³⁶Guarino. G. (2006). *Autodeterminazione dei popoli e successione di norme contrattuali aile radici di un conflitto, Il ruolo del diritto interna zionale generale nella Carta Araba dei diritti dell “uomo*, in Rivista della cooperazione giuridica internazionale. Quadrimestrale dell’ Istituto Interna zionale di Studi Giuridici, anno VII, n°22, Gennaio-Aprile, pg.45.

gusht 1975. Akti Final i Helsinkit, i miratuar nga shtetet nënshkruese, i referohet parimit të vetëvendosjes, në aspektet e brendshme dhe të jashtme, dhe meqë teksti u miratua në nivel evropian, qëllimi i bashkëpunimit është theksuar në përfitim të popujve të këtyre vendeve, duke theksuar aspektin e brendshëm të parimit. Një aspekt tjetër për t'u nënvizuar është përpjekja për ta larguar vetëvendosjen nga referimet klasike të pavarësisë për të njohur një profil tjetër më të rëndësishëm të saj, duke e konsideruar atë si një të drejtë padiskutueshme të popujve ("të gjithë popujt kanë gjithmonë të drejtën, në liri të plotë, për të vendosur kur dhe si duan ata, regjimin e tyre politik të jashtëm dhe të brendshëm"). Kjo do të thotë se vetëvendosja është dhe duhet të jetë një parim global³⁷.

Një dokument tjetër, që konfirmon globalizimin e parimit të vetëvendosjes, është Karta e miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Algjerit (01-04 korrik 1976) nga një grup studiuesish dhe politikanësh, me udhëzimin dhe nën vëzhgimin e fondacionit "Lelio Basso" për të drejtat dhe çlirimin e popujve. Kjo Kartë është shumë e rëndësishme, sepse vjen pikërisht nga ata popuj të Botës së Tretë, që përfaqësojnë subjektet më të interesuara rreth parimit të vetëvendosjes dhe është e qartë që karta u referohet të gjithë popujve në botën koloniale.

Në veçanti, Karta duket që vepron në përkrahje të këtyre popujve kolonialë, të cilët duke u liruar nga një fuqi bien sërish nën kontrollin e një fuqie tjetër, ose më saktë nënshtrohen nga një qeveri totalitare e çdo ngjyre ose besimi. Tekstualisht neni 5³⁸ i Kartës së Algjerit shpreh të drejtën e padiskutueshme dhe të patjetërsueshme të të gjithë popujve për vetëvendosje. Populli është gjithashtu i lirë të vendosë statusin e tij politik pa asnjë ndërhyrje të huaj³⁹.

Nëse neni 6 i Kartës u referohet rasteve të sundimit kolonial ose të huaj, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për nenet 5 dhe 7, që i referohen vetëvendosjes për të gjitha rastet. Neni 5 parashikon të drejtën e të gjithë popujve për të përcaktuar statusin e tyre politik, pa ndërhyrje nga jashtë, drejtpërdrejt apo tërthorazi. Ndërsa neni 7 parashikon, se çdo popull ka të drejtë për një regjim demokratik dhe përfaqësues, duke iu referuar vetëvendosjes së brendshme.

³⁷ Akti Final i Helsinkit, nënshkruar në Helsinki, më 1 gusht 1975.

³⁸ Neni 5 i Kartës së Algjerit, 4 korrik 1976. seksioni II – E drejta e vetëvendosjes politike.

³⁹ Neni 6 dhe 7, i Kartës së Algjerit, 4 korrik 1976.

Në këtë drejtim mund të themi se nenet 5-7 përshkruajnë, pothuajse në mënyrë të përkryer, të drejtën e përhershme të të gjithë popujve për vetëvendosje të brendshme dhe të jashtme të të gjithë popujve kolonialë, Veriut dhe Jugut, Lindjes dhe Perëndimit. Çdo interpretim kufizues i kësaj pjese të Deklaratës së Algjerit do të ishte arbitrar”⁴⁰.

⁴⁰Arangio. G. R. (1988). *Autodeterminazione (dirillo dei popoli alia)*, in Enciclopedia Ciuridica, Roma, pg. 42.

KREU III: PËRMBAJTJA E PARIMIT TË VETËVENDOSJES

1. Mbajtësit e së drejtës, marrësit e detyrimit, përfituesit.

Këtu bëhet fjalë për të shqyrtuar se cilët janë, për të drejtën ndërkombëtare, mbajtësit e së drejtës dhe marrësit e detyrimit të përfshirë në parimin e vetëvendosjes. Për ta zgjidhur këtë problem, duhet të përcaktojmë se cilët janë anëtarët e shoqërisë në të cilën manifestohet dhe vepron e drejta ndërkombëtare. Mirëpo, së pari duhet të konstatojmë se cilët janë protagonistët jetësorë të raportit ndërkombëtar. Në rastin e parimit të vetëvendosjes, problemi është i ndërlikuar nga fakti se, pavarësisht nga dispozitat përkatëse të cilat padyshim i referohen popullit si “protagonist” në veprime konkrete dhe historike të njohura si ushtrim i vetëvendosjes, populli nuk konsiderohet si subjekt i së drejtës ndërkombëtare.

Marrësit e detyrimit, që rrjedh nga parimi i vetëvendosjes, janë shtetet në mënyrë individuale si anëtarë të Kombeve të Bashkuara. Për sa i përket të drejtës së ndërsjellë, nuk ka arsye të forta për të deklaruar se ajo është në dorë të kombeve të veçanta; siç thamë më parë, fakti që flasim për “vetëvendosje të popujve” nuk është i mjaftueshëm për tu përfunduar, se popujt janë në të vërtetë mbajtësit e kësaj të drejte. Një analizë e ngjarjeve historike mund të jetë një dritë në këtë drejtim: në procesin e shkolonizimit, popujt më parë u kanë dhënë jetë entiteteve të pavarura dhe vetëm nën këtë ide, e kanë udhëhequr luftën e tyre çlirimtare si subjekte të së drejtës ndërkombëtare, të barasvlershme me shtetet. Si përfundim, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara janë në të njëjtën kohë marrësit e detyrimit dhe mbajtësit e të drejtës për vetëvendosje⁴¹.

Megjithatë duhet të theksohet se jo të gjithë janë dakord me këtë përfundim dhe disa studiues janë të prirur për ta aneksuar parimin e vetëvendosjes në një vlerë politike⁴², ndryshe nga parimet e tjera, të cilat janë të përfshira edhe në nenin 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara (ndalimi i përdorimit të forcës, zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve etj.), të cilat duhet të zbatohen menjëherë dhe në tërësinë e tyre⁴³.

⁴¹Lattanzi. F. (1987). *Autodeterminazione dei popoli*, in *Digesto delle Discipline pubblicistiche*, vol.II, pg.4.

⁴²Cassese. A. (1995). *Self-determination of Peoples*, Oxford University Press pp,56; Pomerance. M. (1982). *Self-Determination in Law and Practice, the New Doctrine in the United Nations*, pp.98

⁴³Ruiz. A. (1988). *Autodeterminazione(diritto dei popoli alla)*, in *Enciclopedia Giuridica*, vol.IV, pp.1

-Teza e supozimit me vlerë të pastër politiko-morale e parimit të vetëvendosjes nuk duket shumë e përhapur. Në fakt, Karta e Kombeve të Bashkuara nuk mund të interpretohet si një deklaratë e parimit ose deklaratë e qëllimit, e cila do duhej të frymëzonte përfshirjen e shteteve në jetën e marrëdhënieve ndërkombëtare⁴⁴. Nuk mund të mohohet se Karta përbën në të gjitha çështjet një traktat, i cili përmban norma me funksion detyruese, që shtetet anëtare duhet ta përshtatin me sjelljet e tyre. Në këtë kuadër, një nga dispozitat më të rëndësishme, pa dyshim, është e përfaqësuar, së bashku me konkluzionet e shumta të saj, nga ajo që imponon detyrimin për shtetet që të zhvillojnë marrëdhënie paqësore midis tyre. Dhe një nga parakushtet e këtij detyrimi të pandërprerë është pikërisht parimi i vetëvendosjes, referuar nenit 2 dhe 55 të Kartës.

Duke përfunduar, mund të pohojmë se e drejta e popujve për vetëvendosje është objekt i një raporti detyrues të përbashkët mes shteteve në respektim të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe (siç do të shohim) të traktateve të tjera ndërkombëtare, bazuar në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare. Sipas saj të gjitha shtetet kanë si detyrimin të reagojnë në mënyrë që t'u sigurojnë popujve të drejtën e vetëvendosjes, ashtu edhe të drejtën për ta kërkuar përputhjen me këtë detyrim nga secili prej shteteve të tjera.

2. Popujt dhe vetëvendosja.

Siç kemi theksuar në paragrafin e mësipërm, popujt janë përfituesit e së drejtës së vetëvendosjes. Kjo e drejtë është vendosur në të mirën e të gjithë popujve, pa asnjë kufizim subjektiv, siç del më poshtë edhe nga neni 1 pag. 2 dhe neni 55 i Kartës.

A mund të biem dakord se populli është patjetër mbajtësi i të drejtës së vetëvendosjes?

Ky përfundim është vetëm një çështje e debatit më të gjerë në lidhje me doktrinën dhe praktikën, për mundësinë e njohjes së personalitet juridik ndërkombëtar të popujve, duke i atribuar atyre legjitimitetin për të qenë mbajtësit e të drejtave dhe detyrimeve, e midis të tjerash, veçanërisht, të së drejtës së vetëvendosjes. Në fakt, këtë pikëpamje e pranojnë vetëm një pjesë e studiuesve të së

⁴⁴Tomuschat. C. (1994). *L'adaptation institutionnelle des Nations Unies au nouvel ordre mondial*, in Ben Achour, Laghmani, *Les nouveaux aspects du droit international*, Paris, vol.I, pp.125.

drejtës ndërkombëtare dhe në veçanti ata që përqafojnë të ashtuquajturën tezë të “të drejtave të popujve”, të nisur nga supozimi se një institucion ka kuptim dhe vërtetësi vetëm nëse shpreh nevojat dhe të drejtat e popullit që ai përfaqëson⁴⁵, duke argumentuar se funksioni që shteti kryen si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, është vetëm pasqyrim i rolit të përfaqësimit të popullit, i cili është shprehur (investuar) në mënyrë institucionale. Në këtë drejtim, Deklarata për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë⁴⁶, i jep fund menjëherë dhe pa kushte kolonializmit në të gjitha format dhe shfaqjet e tij, duke njohur dëshirën e pasionuar për liri të të gjithë popujve të varur dhe rolin vendimtar të këtyre popujve në rrugën e pavarësisë, duke ripohuar kështu të drejtën e vetëvendosjes së popujve, si e drejtë për të përcaktuar lirisht statusin e tyre politik dhe për të ndjekur lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor.

Për pasojë, Deklarata për Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare, që lidhet me marrëdhëniet dhe bashkëpunimin miqësor në mes shteteve, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara⁴⁷, argumenton ndër të tjera, se popujt që reagojnë dhe rezistojnë ndaj një akti shtrëngimi në ushtrimin e së drejtës së tyre për vetëvendosje, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin mbështetje në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës.

Ndërkaq nuk duhet të neglizhohet këtu referenca e jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila nuk ka lënë pa shqyrtuar në mënyrë analitike çështjen e të së drejtës për vetëvendosje dhe në mënyrë të veçantë pretendimit se parimi “*i përgjigjet nevojës për të respektuar vullnetin e lirë të shprehur nga populli*”. Me këtë, dua të theksoj faktin se detyrimet, padyshim, rëndojnë mbi shtetet të cilat janë të detyruar për t’ifavorizuar rastet e vetëvendosjes së popujve.

Në përfundim të diskutimit tonë, ne vetëm mund të vëzhgojmë se si koncepti i popullit dhe institucioni i vetëvendosjes janë të ndërthurur ngushtësisht midis tyre, çka do të thotë se janë të lidhura ngushtë në kontekstin social-politik dhe ekonomik të zhvilluar në një epokë të caktuar historike.

⁴⁵Rigaux. F. (1988). *La Carta di Algeri-La Dichiarazione universale dei diritti dei popoli*, pg.124,

⁴⁶Asambleja e Përgjithshme. Rezoluta n.1514-XV e 1960, *Yearbook of the United Nations*, 1960, pp.46.

⁴⁷Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta n.2625-XXV e 1970, *American Journal of International Law*,1971, pp.243.

3. Pakicat dhe format e vetëvendosjes së tyre.

Para së gjithash, koncepti i pakicës mund të kuptohet lehtë⁴⁸. Pakica është përshkruar si "një grup numerikisht më i vogël sesa pjesa tjetër e popullsisë së një shteti të caktuar, në pozitë jo dominuese, anëtarët e së cilës kanë shtetësinë e të njëjtit shtet, por në aspektin etnik, fetar apo gjuhësor karakteristika të ndryshme nga pjesa tjetër e popullsisë, dhe manifestojnë një ndjenjë solidariteti, duke u kujdesur për të ruajtur kulturën e tyre, traditat e tyre, fenë e tyre apo gjuhën e tyre". Praktikisht, këtu bëhet fjalë për një bashkësi (komunitet) që e bashkon karakteri historiko-politik, tipike të një populli, që, megjithatë, janë minoritet në territorin e një shteti të caktuar⁴⁹.

Sipas këtyre supozimeve, realizimi i parimit të vetëvendosjes duhet të bëhet, duke përfshirë së bashku me të drejtën e popullit për të formuar vetë një entitet politik autonom dhe të pavarur, interesin primar për të parandaluar shpërbërjen e shtetit paraekzistues, në të cilin pakica është vetëm një pjesë e vogël, edhe pse e kualifikuar. Më saktësisht, në prani të një pakice relativisht të vogël në territorin e një shteti të veçantë, pak a shumë homogjen, duke imponuar detyrimin e këtij të fundit për të siguruar vetëvendosjen, nuk mund të hamendësosh automatikisht nevojën për të rënë dakord për shkëputjen e këtij minoriteti, madje as me hipotezën se ajo është e gatshme të qëndrojë si shtet i pavarur. Në këto raste pakica në vend që të marrë një rol udhëheqës, duhet më tepër të sigurojë një nivel të pranueshëm të ruajtjes së identitetit të saj dhe mbrojtjen e të drejtave të saj nga ana e shtetit në të cilin ndodhet, sesa të sigurojë statusin politiko-institucional autonom. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Boutros Boutros Gali në vitin 1992, ndërsa nga njëra anë vërejtë se, në qoftë se secili prej grupeve etnike, gjuhësore apo fetare do të pretendonte të kushtëzonte shtetin, fragmentimi nuk do të kishte më kufij dhe siguria, paqja dhe përparimi ekonomik për të gjithë do të bëhej më i vështirë për t'u arritur nga ana tjetër, vuri theksin në mbrojtjen e të drejtave të tyre, si një nga kushtet që duhet të plotësohet për të shmangur problemet që dalin nga rreziqet e fragmentarizmit, në të cilat Vetëvendosja mund të çojë⁵⁰.

⁴⁸Përkufizimi vjen nga Raporti Special i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave, "*Etude des droits des personnes appartenant aux minorités ethniques, religieuses et linguistiques*".

⁴⁹ Treves. T. (2005). *Diritto Internazionale problemi fondamentali*, Giuffrè, pg.192.

⁵⁰Asambleja e Përgjithshme. *Ne Boutros-Ghali, Agenda pour la paix, doc.A/47/277 e S/24111*, parag.17 e 19.

Në këtë kontekst, pra, një rol të çmuar luan e ashtuquajtura “vetëvendosje e brendshme” e cila duhet të çojë në një strukturë të brendshme që siguron garantimin e të drejtave themelore të njeriut për pakicat.

Prandaj, përballë mohimit të të drejtave themelore të njeriut, të personave që u përkasin minoriteteve, bashkësia ndërkombëtare është përqendruar në promovimin e një shteti pluralist, bazuar në garanci të forta të stilit perëndimor të *rule of Law*, respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe atyre themelore të çdo individi. Sipas kësaj logjike, vetëvendosja bëhet një parim themelor organizues i institucioneve qeverisëse në shtetet shumëkombëshe, me përfshirjen e të gjitha grupeve funksionale në njohjen e vendimeve politike dhe kështu ndihmon në parandalimin e qëllimeve separatiste, të cilat janë burim i pashmangshëm kërcënimi serioz për paqen.

Roli i garancisë së vetëvendosjes së brendshme intensifikohet pastaj, në rastet e "*failed States*", d.m.th. në rastet kur shtetet kalojnë situata të brendshme shpërbërjesh, për shkak të së cilave nuk janë më në gjendje për t'u siguruar qytetarëve, duke përfshirë edhe ato që i përkasin grupeve minoritare, gëzimin e të drejtave të tyre themelore. Në këtë drejtim duhen përmendur si raste të shteteve të dështuara ato të Somalisë, Ruandës, Libanit dhe Kamboxhias. Në këtë kontekst, vetëvendosja është kërkuar të shprehë tre bërthamat e përmbajtjes që kanë karakterizuar zhvillimin e brendshëm në epokën post-koloniale: ato që lidhen me të drejtën për një demokraci procedurale, mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, dhe në fund, në gëzimin e regjimit institucional të autonomisë. Në këto raste, me pak fjalë, e drejta ndërkombëtare e ka konsideruar krizën e shtetit jo si një mundësi për të krijuar baza të reja të bashkëjetesës sociale, por më tepër si një burim i rrezikshëm për vetë bashkëjetesën, sinonim i një vakumi ligjor, një vakum që komuniteti demonstroi si frikë, për jo stabilitet dhe dhunim të vlerave themelore të të njëjtave shkaqe. Megjithatë, duhet parë gjithmonë, nëse bashkëjetesa midis parimit të mbrojtjes së minoriteteve dhe të drejtës për vetëvendosje të jashtme është bërë një fakt i papajtueshëm në një kontekst në të cilin të flasësh për mbrojtjen apo një sistem garantues nuk do të thotë shumë përballë dëshirës për të ndërtuar një shtet që ka një zë të vetin, të pavarur dhe sovran. Në këtë drejtim, rasti më simbolik është ai i Jugosllavisë: për sa i përket karakteristikave të një regjimi autoritar, shteti ballkanik ishte një model i respektit në fushën e mbrojtjes së minoriteteve përmes institucioneve federale, por pak a shumë doli kundër dëshirës për vetëpërcaktim në

kuptimin kombëtar, të Kroacisë dhe Sllovenisë më parë dhe me pas, Serbisë dhe Kosovës⁵¹.

Në fund të fundit, është e panevojshme të përqendrohemi në faktin se nuk mund të mohojmë që parimi i mbrojtjes së integritetit territorial nuk është absolut, por është mbi të gjitha një kusht i qëndrueshmërisë humanitare. Është e qartë se “vetëvendosja e jashtme” (e ashtuquajtura shkëputja korrigjuese) duhet të konceptohet vetëm si mjete i fundit. Ndalimi që përjashton paraqitjen e kërkesave separatiste shprehet paradigmatisht në Deklaratën e parimeve për marrëdhëniet miqësore e të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së⁵², nëpërmjet klauzolës së mbrojtjes së integritetit territorial të një shteti, që gjithsesi, është “...doté d’un gouvernement représentant l’ensemble du peuple appartenant au territoire sans distinction de race, de croyance ou de couleur...”, dhe në përputhje me parimin e të drejtave të barabarta dhe të drejtës së popujve për vetëvendosje. Si pasojë, përballë një shteti shumëkombësh apo multi-etnik, quajeni si të doni, i cili respekton të drejtat e njeriut, në përgjithësi, dhe ato të minoriteteve, në veçanti duket e besueshme se parimit ynë, larg nga nxitjet e ambicieve separatiste, sjell më realisht detyrimin për të, siç kemi thënë tashmë, për siguri të pjesëmarrjes së pakicave në regjimet institucionale dhe politike të përfaqësimit në barazi të plotë dhe nisur me pjesën e mbetur të popullsisë, ose më shumë t’u garantojë atyre autonomi të gjerë administrative dhe qeverisje.

Sigurisht, më pas perspektivat ,që edhe në këto raste vetëvendosja lejon për t’u vendosur, varen si gjithmonë nga konteksti historik në të cilin ndodhin, duke lejuar një pakicë të një shteti të caktuar të bëhet shumice në rajonin e saj dhe transformohet në faktorin e përmbysjeve të madha politike (p.sh. rënia e komunizmit, lidhur me Bashkimin Sovjetik apo Jugosllavinë), në një shtet të ri. Por këtij argumenti do t’i rikthehemi. Për me tepër, duhet theksuar se, që nga fundi i Luftës së Parë Botërore dhe në vazhdim, si rezultat i ndryshimeve territoriale që kanë ndodhur me traktatet e mëvonshme të paqes, u nënshkruan konventa të shumta në trajtimin e minoriteteve dhe në thelb, të frymëzuara nga nevoja për mbrojtjen e tyre, vendosur brenda territorit të një shteti të caktuar. Pra, nëse ende sot mund të themi se burimet ligjore ndërkombëtare nuk i njohin të drejtat e minoriteteve si subjekte kolektive, por vetëm disa të drejta të njeriut si individ, që u përkasin njësoj të gjitha pakicave, janë

⁵¹Asambleja e Përgjithshme ne ris.2625- XXV del 1970. *Autonomie, minoranze,nazionalismi,Unione Europea,Comuni d’Europa,estratto dal n.5,Maggio 1992.*

⁵²Asambleja e Përgjithshme ne, ris.2625-XXVdel 1970,cit me siper .

të panumërta aktet ligjore që kanë të bëjnë me të, në mënyra të ndryshme. Për shembull, neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë së një pakice gjuhësore, ndërsa dokumenti i miratuar në Kopenhagen, më 29 Qershor 1990, nga shtetet pjesëmarrëse në Konferencën për Dimensionin Njerëzor të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunimi në Evropë, i kushtoi rëndësi të drejtave të personave, që u përkasin pakicave kombëtare. Është vërejtur më pas Deklarata mbi të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe etnike, fetare dhe gjuhësore⁵³, ku u shpallën jo vetëm të drejtat e personave që u përkasin pakicave, por edhe detyrimet e shteteve për të mbrojtur këto të drejta. Megjithatë, meriton konsideratë të posaçme edhe neni 27 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili parashikon: "Në ato shtete ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, personave që u përkasin pakicave të tilla nuk mund t'u mohohet e drejta të kenë jetën e tyre kulturore, të praktikojnë fenë e tyre, ose të përdorin gjuhën e tyre në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre". Nga kjo e fundit, nuk mund të neglizhohet, si nga një perspektivë e kufizuar në kontinentin evropian, konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare⁵⁴, që duket e frymëzuar nga një mbrojtje e konsiderueshme për minoritetet (për shembull, sanksionon të drejtën individuale të çdo personi që i përket pakicës për të zgjedhur nëse do të trajtohet apo jo si i tillë, vetëm nëse nga kjo zgjedhje mund të dali ndonjë disfavor, apo edhe duke siguruar për angazhimin e shteteve, që të marrin masat e duhura për të promovuar në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një pakicë kombëtare dhe atyre që i takojnë shumicës), nuk u konsiderua mjaft më e mprehtë dhe të mos jetë në gjendje të veprojnë brenda kufijve të atyre shteteve, që kanë vepruar më shumë në shkeljen e të drejtave të pakicave, për shkak të kufizimit të shprehur të efekteve të saj në minoritetet kombëtare.

Megjithtë duket e përshtatshme për të thënë diçka më shumë rreth këtij traktati, i cili ndër të tjera ishte paraprirë nga themelimi i një "Komiteti ad hoc për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare", i përbërë nga përfaqësues të emëruar nga secili prej 32 shteteve pjesëmarrës në konventë, me detyrën e kryerjes së funksionit të parashikuar nga konventa e ardhshme, monitorimin me raporte periodike lidhur me aktivitetet e shteteve dhe informimin e opinionit publik dhe të vetë shteteve.

⁵³E adoptuar me Rezoluten me nr 47/135 del 1992, nga *Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara*.

⁵⁴E adoptuar me rezoluten me nr 10 Nentor 1994, nga *Këshilli I Ministrave Të Këshillit Të Evropës*.

Pjesa e parë dallohet nga fakti se ajo sjell mbrojtjen e pakicave në kuadër të detyrimeve të bashkëpunimit ndërmjet shteteve, ndërsa e dyta i referohet një seri kërkesash, që shtetet duhet të plotësojnë për të siguruar respektimin e të drejtave të tyre, në veçanti, detyrimin për të siguruar një arsimim në harmoni me kulturën e grupeve të veçanta etnike, bashkëpunimin mes shteteve që "mikpresin" brenda kufijve të tyre të njëjtat pakica dhe promovimi aktiv i mosdiskriminimit dhe barazisë midis pakicës dhe shumicës. Në anën tjetër, pjesa e tretë duhet të shënojë hapin drejt stabilitetit së bashku me detyrimin për të siguruar një nivel të lartë të respektimit të të drejtave të njeriut, atë të mosndërhyrjes me veprimtaritë e kontrollit, në ushtrimin e sovranitetit të Shtetit, i cili po investigohet, ndërsa pjesa e katërt dhe e pestë kanë karakteristika teknike dhe përcaktojnë mënyrat e monitorimit.

Duke parë më pranë, interes të veçantë ka zbulimi i Shtojcës IV të Traktatit të Paqes midis Italisë dhe Fuqive Aleate, nënshkruar në Paris, më 10 shkurt 1947. Në të gjendet i shprehur detyrimi i Shtetit Italian për t'u dhënë banorëve gjermanofolës provincën e Bolzanos, një "barazi të plotë të të drejtave të respektueshme nga banorët e gjuhës italiane, në kuadrin e dispozitave të veçanta të dizajnuara për të mbrojtur zhvillimin etnik dhe kulturor dhe ekonomik të grupit gjerman-folësor." Ndaj mund të tregohemi të guximshëm e ta themi pa frikë, se mbrojtja e personave që u përkasin pakicave ka hyrë në brendësi të interesave themelore të mbrojtura nga komuniteti ndërkombëtar dhe është burimi i detyrimeve të parimit *erga omnes*, i tillë që secili prej këtyre subjekteve, mund të kërkojë pajtueshmërinë me këto obligime, të kërkojë riparimin e dhunimit të tyre dhe kur është e përshtatshme, të përdorë kundërmasa deri në masën e lejuar nga sistemi⁵⁵. Si rezultat, është e mundur të themi se situata e të ashtuquajturave "shkeljeve të rënda" (d.m.th., shkeljet masive, në vazhdimësi të të drejtave themelore të personave që u përkasin pakicave), nuk mund të konsiderohen si ndërhyrje në sferën e dominimit të ndonjë shteti dhe se vendet e treta janë të shtrënguara të respektojnë detyrimin e mosndërhyrjes. Së fundi, më duket e drejtë për të parë rreth disa njohurive mbi konceptin "Popull pa shtet". Kjo shprehje i referohet atyre popujve, që duke mos pasur mundësi të kenë një entitet autonom politik, karakterizohen nga një identitet etnik, gjuhësor dhe kulturor, i spikatur dhe për më tepër, shfaqin tiparet e mundshme për krijimin e një shteti të mëvetësishëm.

⁵⁵Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në vendimin "Barcelona Traction" të 1970, në C.I.J., *Recueil*, 1970, 32.

Është e qartë, se në këto raste, problemi i të drejtave të kombeve është i komplikuar, për shkak se ata nuk kërkojnë vetëm të bëjnë thirrje për mosdiskriminim dhe mbrojtje të karakteristikave të tyre të veçanta brenda vendit, por mbi të gjitha, shtrohet çështja e pavarësisë politike dhe territoriale dhe kështu e vetëvendosjes së jashtme. Pra, gjithçka, në mënyrë të pashmangshme çon në shfaqjen e konflikteve të armatosura për çlirim dhe në qoftë e suksesshme lufta, vjen formimi i shteteve të reja kombëtare si shprehje e vullnetit të këtyre popujve. Natyrisht, realizimi i rasteve të vetëvendosjes varet nga radikalizmi dhe përhapja e këtyre idealeve dhe si gjithmonë, konteksti historik dhe politik në të cilin rriten. Po ta shohësh mirë, duket se vija e demarkacionit midis konceptit të pakicës dhe atij të popujve pa shtetësi, është shumë e ngushtë dhe e diskutueshme.

Për këtë arsye kualifikimi në një kuptim apo në një tjetër, varet kryesisht nga pikëpamja e vëzhguesit dhe në fund të fundit, nga kushtet politike dhe ligjore në të cilën komuniteti është e vendosur në shtetin e referencës. Kur një grup i veçantë etnik, kulturor, fetar, gjuhësor i një grupimi të caktuar janë në mënyrë të përshtatshme, të mbrojtur me dispozita të veçanta të sistemit të përgjithshëm dhe jo subjekt i pabarazisë apo më keq, të diskriminimit, është e qartë se pretendimet për vetëvendosje të këtij populli i adresohen njohjes më të madhe të identitetit të tyre në kuadër të një sistemi plotësisht demokratik dhe pluralist.

Në anën tjetër, kur këto parakushte nuk plotësohen, pretendimet e “popujve pa shtetësi” ose minoriteteve mund të çojë në konflikt social apo një luftë civile për pavarësi dhe kështu del në plan të parë të parimit të vetëvendosjes, një pamje e re në funksion të formimit të një shteti autonom. Është e qartë pra, se çështja e shtruar në këto terma, që ka të bëjë me pakicat dhe popujt pa shtetësi, rrezikon të transformohet në çështje thjeshtë terminologjike, duke përjashtuar rëndësinë e thelbit, ndërsa boshti i problemit zhvendoset në shkallën e barazisë që një shtet shumëkombësh mund të sigurojë.

4. Lëvizjet nacionalçlirimtare.

Në radhën e subjekteve që përfitojnë nga e drejta e vetëvendosjes, një vend me siguri të rëndësishëm zënë lëvizjet çlirimtare kombëtare që përfaqësojnë entitete të popujve prej nga vijnë, të cilëve u është mohuar realizimi i rasteve për vetëvendosje. Rreth rolit të këtyre organizatave, në funksion të prezantimit të parimit tonë, tezat e propozuara në doktrinë janë të ndryshme.

Sipas disa studiuesve të së kaluarës, ishte e domosdoshme që një popull, i cili reagon në ushtrimin e të drejtës së tij për vetëvendosje, të organizohet në lëvizjen nacionalçlirimtare, në mënyrë që të gëzojë mbrojtjen që i jepet nga ndërkombëtarët. Vetëm në këtë mënyrë, populli në fjalë mund t'i japi jetë një lufte të çlirimit kombëtar dhe pastaj të gëzojë të drejtat dhe garancitë, që normalisht sigurohen nga palët ndërluftuese. Në fakt, ka një version ku ilustron një supozim i gabuar se përfituesit e parimit tonë janë lëvizjet çlirimtare dhe jo vetëm populli si i tillë, me rezultatin, se populli në luftë për vetëvendosje do duhet të ndërtojë domosdoshmërisht, transportimin e çështjes nga pozitat e tyre, në nivel ndërkombëtar. Për sa kohë, populli jep jetën për një lëvizje të tillë, në fund pritet të gjykohet si legjitime, ose së paku në planin ndërkombëtar, pritet ndërhyrja nga jashtë e palëve të treta, në konfliktin midis popullit dhe shtetit që i mohon lirinë. Në të vërtetë, kjo ndërhyrje është e ligjshme vetëm nëse populli do të organizohet në lëvizjen çlirimtare.

Nga ana tjetër, orientimi zotëruar sot konfirmohet nga praktika e Kombeve të Bashkuara dhe ajo ndryshon nga këto teza, për të cilat njohja e rëndësisë ndërkombëtare të konfliktit është e pavarur nga ekzistenca e një lëvizjeje të vërtetë përfaqësuese të popullit në luftë dhe bazohet në interpretimin e kombinimit të dispozitave të nenit 2, paragrafi 4 (që detyron shtetet anëtare të përmbahen nga përdorimi apo kërcënimi i forcës në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare, si ndaj integritetit territorial dhe pavarësisë politike të çdo shteti, ashtu edhe në ndonjë mënyrë tjetër që është mospërshtatshme me qëllimet e Kombeve të Bashkuara) dhe nenit 1 paragrafi 2 i Kartës së San Franciskos (që siç e dimë, tregon një nga qëllimet e Kombeve të Bashkuara për stabilizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare bazuar në respektimin e parimit të vetëvendosjes së popujve).

Kjo qasje interpretuese është legjitimuar plotësisht me mbështetjen e organeve të Kombeve të Bashkuara, kur ata u morën me luftërat koloniale, dhe konfliktet e shkurtra në vijimësi të pushtimeve të huaja, ose si reagim ndaj regjimeve raciste: në këto raste, OKB-ja e konsideroi luftën çlirimtare të përshtatshme ndërkombëtarisht, pavarësisht se në masë të gjerë ato u karakterizuan nga mungesa e një subjekti alternativ për të qenë të fuqishme dhe parimisht, përfaqësuese të bashkësisë vetëvendosëse, ashtu siç lindi shkelja e parimit të vetëvendosjes. Sigurisht mundësia për të qenë ose jo, pjesë e njohjes nuk ishte pa pasoja, sepse nga kjo varej zbatimi e ligjit ndërkombëtar të luftës (*ius in bello*), dhe parimi themelor i asnjësisë (neutralitetit), i cili kërkon nga shtetet që të përmbahen nga ndërhyrja në

konflikt. Gjithsesi, nëse pranohet natyra dhe efektet e kësaj njohje të komunitetit ndërkombëtar për njohjen me kusht të shteteve, përfundimi do të ishte se një praktikë e tillë nuk do të kishte as faktin kushtetues, as atë deklarativ për ekzistencën e lëvizjes. Ajo ekziston dhe do të ndikojnë në jetën e marrëdhënieve ndërkombëtare vetëm në atë masë sa për të përmbushur disa veprimtari aktuale, pavarësisht nga aktet e njohjes. Kjo do të zbulojë më shumë se si reflekton vullneti i një shteti për të vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me atë lëvizje, u duhet të huazojnë nga ata ndihmë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, u duhet të mbrojnë interesat e tyre territoriale dhe politike kundër profesioneve të mundshme. Pra, pasi lëvizja çlirimtare ka marrë njohje të tillë, që rrjedh në fakt nga legjitimiteti i kërkesave dhe dhënia e ndihmës nga ana e shteteve të treta, anëtare të organizatës, por edhe nga dhënia e statusit të luftëtarëve të ligjshëm, militantëve të njëjtë, siç është e njohur në deklaratën e rëndësishme të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara⁵⁶.

Për më tepër, referuar lëvizjeve nacionalçlirimtare, paraqiten zhvillime të mëdha e të rëndësishme të së drejtës humanitare që janë pasqyruar në dy Protokollin Shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e hapur për nënshkrim në vitin 1977. Ato veprojnë, në fakt, me një dallim thelbësor, në kontekstin e konflikteve të brendshme apo civile, themeluar në fund të fundit, të shtyrë nga ata që luftojnë kundër qeverisë, të vendosin për popujt, që ngrihen kundër regjimeve koloniale, raciste ose të huaja, në ushtrimin “e së drejtës së popujve për shkatërrimin e tyre”, të aplikojnë protokollin e parë, i cili është i vlefshëm për konfliktet tradicionale mes shteteve⁵⁷, për kryengritësit që luftojnë për qëllime të tjera, të zbatohet protokollin i dytë, që siguron një mbrojtje më të kufizuar. Në veçanti, duhet theksuar se aplikimi i Protokollit të Parë nënkupton ekzistencën e një strukture institucionale përfaqësuese e popullit vetëvendosës, pra të arrijë funksionimin e Konventave dhe Protokollit me anë të një deklaratë të thjeshtë të një angazhimi të njëanshëm, adresuar depozituesit. Në këtë kontekst, është bërë një llogaritje praktike (së cilës nuk duket t’ijetë kushtuar rëndësia e përgjithshme) ndjekur nga Kombet e Bashkuara për të ftuar si vëzhgues të përhershëm, lëvizjet nacionalçlirimtare të njohura nga Organizata e Unitetit Afrikan ose nga Lidhja e Shteteve Arabe. Për më tepër, do të ishte arbitrare të supozojmë se nga ky status ligjor i njohjes së lëvizjeve çlirimtare kombëtare nga e drejta

⁵⁶Asambleja e Përgjithshme. Rezoluta. n.3013-XVIII; Ronzitti, *Le guerre di liberazione nazionale e il Diritto Internazionale*,Pisa,1974,p.200 e ss.

⁵⁷Ronzitti. N. (1975). *Wars of National Liberation-A Legal definition*,in Italian Yearbook of International Law, pp.192 .

ndërkombëtare, rrjedh t'i dedikohet atyre, një subjektivitet i plotë dhe i krahasueshëm me atë të një shteti⁵⁸. Megjithatë praktika ka treguar se si ndërhyrja e një entiteti të tillë në procesin e vetëvendosjes mund të pritët që të kontribuojë për arritjen e objektivave të këtij procesi. Në terma të përgjithshme ka disa që vënë në dukje se si *"...në çdo proces të çlirimit, është, gjithmonë, mbrapa një grup i vogël njerëzish i caktuar për të organizuar dhe që, pak nga pak, zhvillon një aktivitet në plan intelektual, politik dhe ushtarak deri në pavarësinë e vendit të vetë ..."*⁵⁹.

Pasi organizohet në mënyrë institucionale dhe bën të qarta objektivat e veta, këto lëvizje dalin nga emigrimi dhe nisin të punojnë në planin politik dhe diplomatik, përveç asaj ushtarake dhe guerilje. Megjithatë, elementi që paraqitet kritik për suksesin apo dështimin e misionit të tij, nuk është dhe aq shumë fakti i lindjes së tij, por nevoja e konkurrencës në pjesën e saj të vullnetit të përbashkët në lidhje me popullin që përfaqëson dhe në fund të fundit, është verifikimi i fushës ndërkombëtare të aktiviteteve të saj. Këto dimensionë mund të gjenden vetëm kur ajo bëhet një ngjarje jo normale në jetën e një shteti, e tillë si nxitja e saj për të marrë masa të jashtëzakonshme, në mënyrë që të përpiqen të kontrollojnë ngjarjet.

Bazuar më sipër, ne mund të biem dakord me doktrinën tradicionale duke besuar se në qëllimin e kujdesshëm të njohjes, duke pasur parasysh njohjen e madhe në nivel ndërkombëtar të lëvizjes për çlirim kombëtar, duhet të integrohen këto dy elemente: 1) Një organizatë e themeluar institucionalisht. 2) Ndjekja aktuale e aktiviteteve që kanë shtrirje ndërkombëtare, ose më shkurtimisht shtjellimi i një autoriteti qeveritar embrional, i strukturuar politikisht dhe ushtarakisht, në një pjesë territori.

Ajo që merret parasysh në fund ka të bëjë me dallimin në drejtim të motivit politik, që drejton lëvizjet nacionalçlirimtare dhe përkatësisht, kryengritësit. Ndërsa këto të fundit janë organizuar me rastin e një lufte civile apo lëvizjet e brendshme revolucionare, me qëllim kryesor për të zëvendësuar qeverinë aktuale me një qeveri të re (e ashtuquajtura qeveria de facto e përgjithshme), ose për të krijuar një shtet të ri në një pjesë të territorit ekzistues (i njohur si qeveria de facto lokale), puna e parë për çlirimin e popullit që përfaqësojnë nga një sundim kolonial ose racist, ose përgjithësisht të huaj.

⁵⁸Marcelli. F. (1994). *Gli accordi fra Israele e OLP nel diritto internazionale*, in Rivista di diritto internazionale, pp.430 .

⁵⁹ Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, më 31 korrik 1989, në *rastin e caktimit e kufijve shelfit kontinental midis Guinea-Bissau dhe Senegalit*.

5. Interpretime të ndryshme në lidhje me të drejtën për vetëvendosje.

Problemet themelore me të drejtën për vetëvendosje janë natyrisht paqartësia e saj, pasi objekti i së drejtës nuk është i përcaktuar qartë, si dhe dualiteti i saj për shkak të dy elementeve kontradiktore, përkatësisht të drejtën e integritetit territorial dhe lirisë ndaj ndërhyrjes, nga një anë, dhe e drejta e popujve për të qeverisur veten e tyre nga ana tjetër. Kjo natyrisht krijon shumë interpretime të ndryshme në skenën ndërkombëtare çka është demonstruar në mënyrë të qartë prej dy pikëpamje të ndryshme të botës së industrializuar dhe botës së zhvilluar.

Duke shfletuar literaturën dhe materiale të tjera gjatë procesit të kërkimit në lidhje me të drejtën e vetëvendosjes, ishte shumë e dukshme se cili ishte fokusi për autorët perëndimorë. Në sytë e perëndimit procesi i dekolonizimit përfundoi rreth viteve '80, dhe sot nuk është aspak i rëndësishëm⁶⁰, me përjashtim të pak kolonive të mbetura në botë. Në fakt ditët e sotme, shumë autorë në perëndim kritikojnë formën që e drejta për vetëvendosje mori gjatë dekolonizimit, çka nuk duhet të kuptohet si kritikë ndaj vetë atij. Mendimi është se rezultatet antikoloniale u bënë më të rëndësishme se vetë realizimi i vetëvendosjes⁶¹. Deklarata e mëposhtme është mjaft tipike:

“... vetëvendosje, në periudhën gjatë së cilës zëri afro-aziatik në Kombet e Bashkuara dhe çështjet botërore ka pasur jehonën më të madhe, ishte përcaktuar si e drejta e mbajtur nga shumica e territorit të përcaktuar kolonial, për pavarësi të jashtme prej dominimit kolonial nga fuqitë metropolitane të huaja për kontinentin apo sundimi kolonial pseudo-evropian. Kjo nuk zbatohet mbi grupet etnike brenda këtyre territoreve dhe as mbi shumicat që ishin duke u shtypur prej elitave” të huaja” indigjene. As ndarja e as përfaqësimi demokratik nuk konsiderohej si pjesë e kësaj të drejte fisnike për vetëvendosje...”⁶²

Mospërfillja e mjeteve të tjera të vetëvendosjes siç janë autonomia, decentralizimi dhe ndarja është kritikuar ashpër. Megjithatë, nuk nënkuptohet se të gjitha këto modele janë pa të meta, në të kundërt, është pranuar se çdo model ka probleme që duhet të zgjidhen. E rëndësishme është se po zhvillohet një diskutim, ku

⁶⁰James. C. (2001). “E drejta për vetëvendosje në të drejtën ndërkombëtare: Zhvillimi i saj dhe e ardhmja”, në Alston, Filipit, të drejtat e Popujve “, New York, pp.39; Gerry. J. S. (1996),” Shpërndarja e sovranitetit: Vetëvendosja në epokën post-koloniale “, Oxford / Washington DC, pp, 45.

⁶¹ Simpson në Sellers, pp. 45.

⁶² Po aty. faqe 45.

po konsiderohen zgjidhje të ndryshme⁶³. Në fund të fundit, besohet se mënyra më e mirë për t'uidhënë fund konflikteve të natyrës etnike është pikërisht me anë të këtyre modeleve. Kjo ilustron nga kjo deklaratë:

*“... vetëvendosja duhet të jetë mbushur me kuptim në rast se do të posedojë rëndësinë e përtërirë ligjore. Shtrembërimi i parimit pas statutit lindi pjesërisht për shkak të përpjekjes për të konturuar të drejtën e vetëvendosjes, duke mohuar të drejtat për autonomi apo transferim dhe përfaqësim demokratik ose, në raste ekstreme, edhe ndarje. Me fjalë të tjera, vetëvendosja ka qenë e shkëputur nga modalitetet e shumtë, nëpërmjet të cilëve me shumë gjasa do të gëzonte sukses.”*⁶⁴

Për sa i përket vetëvendosjes, fokusi është zhvendosur diku tjetër në krahasim me periudhën e dekolonizimit. Periudha post-koloniale përfshin dy kontekste të rëndësishme, përkatësisht kontekstin e dy Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në njërin anë, dhe periudhën pas Luftës së Ftohtë me rënien e Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërjen e shteteve në Evropën Lindore, nga ana tjetër. Në rastin e ish-Jugosllavisë, siç e dimë të gjithë, kjo ka ndodhur me luftëra të hidhura dhe të përgjakshme dhe me konflikte etnike. Komunizmi u zëvendësua nga nacionalizmi i cili në shumë raste ishte dhe ende është, ekstrem dhe shkatërrimtar. Gjatë kësaj periudhe u rrit rëndësia e të drejtave të njeriut, ashtu si edhe e të drejtave të popujve⁶⁵, që ndonjëherë barazohen me të drejtat e pakicave (etnike). Pyetja që kërkon përgjigje është se si të mundësohet jetësimi i të gjitha të drejtave të njeriut, pjesërisht nëpërmjet respektimit të së drejtës për vetëvendosje. Shprehjet e së drejtës përfshijnë vetëvendosje të brendshme në të gjitha format e saj, të tilla si qeverisja demokratike apo autonomia. E drejta për vetëvendosje shfrytëzohet edhe si një justifikim për ndarjen, edhe pse ndarja është një çështje mjaft kontraverse.

Vetëvendosja përtej kolonializmit merr shkas prej shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera kundër grupeve etnike. Këto shkelje nuk konsiderohen më si

⁶³ Po aty, faqe 56.

⁶⁴ Po aty, faqe 56.

⁶⁵ Koncepti i të drejtave të popujve është zhvilluar aktualisht në kuadër kolonial nga avokatët e Botës së Tretë (shih seksionin më poshtë) dhe nuk ishte me interes të madh për juristët perëndimor. Megjithatë, epoka post Luftës së ftohtë e vetëvendosjes ka kapur vëmendjen e komentatorëve perëndimorë mund, sipas Crawford (Shih f. 21 në Alston, 2001), të japë frymëmarrje një jete të re në idenë e të drejtave të njerëzve.

problem i disa qenieve njerëzore që vuajnë brenda juridiksionit të një shteti sovran, por konsiderohen gjithashtu si një kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Kjo na sjell në temën e ndërhyrjes. Disa e interpretojnë ndërhyrjen në ato raste të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut kundër grupeve etnike, si një formë mbështetjeje dhe mbrojtjeje të së drejtës të këtij grupi të veçantë për vetëvendosje. Një shembull i tillë është parë në rastin e ndërhyrjes së sanksionuar prej OKB-së për mbrojtjen e kurdëve, në veri të Irakut në vitin 1991, në bazë të Rezolutës 688 të Këshillit të Sigurimit. Një autor e konsideron të pakuptimtë dallimin ndërmjet ndërhyrjes për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ndërhyrjes në mbështetje të së drejtës për vetëvendosje, apo ndoshta edhe për ndarje⁶⁶.

Pikëpamja e përgjithshme është se vetëvendosja në epokën postkoloniale është më e rëndësishme në kontekstin e pakicave apo grupeve etnike, të cilat e pretendojnë të drejtën për vetëvendosje si ndreqje për të drejtat e mohuara politike, civile, kulturore dhe të drejta të tjera njerëzore dhe kjo ndonjëherë është përdorur si një përlygje (justifikim) për ndarjen. Përgjigjja këtu, sipas komentatorëve perëndimorë, është që të rishikohet pozicioni aktual në integritetin territorial. Parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve konsiderohen ende si rregulli kryesor, por nuk duhet të zbatohen pa përjashtime. Për sa i përket shprehjes më të skajshme të vetëvendosjes, asaj të njëanshme, edhe pse e diskutueshme, ideja ende nuk konsiderohet plotësisht në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Për të filluar një entitet që është shkëputur, ka më shumë gjasa që të njihet nga bashkësia ndërkombëtare, nëse ndarja ishte e qetë, e suksesshme dhe rezultoi me kontroll efektiv mbi këtë entitet. Për më tepër, sa më serioze ose më të tmerrshme janë krimet kundër grupit të njerëzve në fjalë, aq më shumë është i arritshëm pranimi i ndarjes. Në përputhje me këto pikëpamje, shumë komentatorë perëndimorë e quajnë të rëndësishëm përcaktimin e fushëveprimit të saktë të së drejtës dhe për këtë arsye theksojnë nevojën për një përkufizim më të mirë ose më të saktë të “popullit” ose të “vetvetes”⁶⁷. Në fakt, kjo është menduar si “çështja-çelës në analizimin e fushës së të drejtës”⁶⁸.

Unë kam vënë re se ligjërimi kushtuar vetëvendosjes në Perëndim rrallë e përfshin të drejtën për vetëvendosje ekonomike. Ekziston një mungesë interesi në apelimet nga avokatët e Botës së Tretë në lidhje me tregun global dhe sistemin

⁶⁶ Simpson, në Sellers, 1996, pp, 55.

⁶⁷Raic. H dhe Rosalyn. H, (2000). *Të drejtat e njeriut në kontekstin Ndërkombëtar*, New York, fq 1285.

⁶⁸ McCorquodale. R. (2000), *Self-determination in International Law*, Ashgate, Dartmouth, pp. 229.

ekonomik ndërkombëtar, si dhe të institucioneve përkatëse. Kjo shpërfillje apo mungesë e interesimit mund të ekzistojë në nivelet politike dhe akademike, por në nivelin e medias është ndryshe. Mediat Perëndimore gjithnjë e më shumë po u kushtojnë vemendje kërkesave dhe apeliemeve të Botës së Tretë, duke përfshirë kritikën ndaj politikave dhe korporatave perëndimore, që veprojnë në vendet në zhvillim. Pjesa më e madhe e kritikave që shënjestrojnë botën e industrializuar mund të lidhen me sistemin kolonial, shprehjet dhe mekanizmat e tij, për aq sa janë interesuar avokatët e Botës së Tretë. Do të rikthehem në këtë çështje më poshtë. Ndërkohë që ishte duke u zhvilluar lufta për dekolonializim, çështjet e shfrytëzimit dhe të varësisë të Botës së Tretë dhe padrejtësia e rendit ekonomik ndërkombëtar ishin një pjesë e natyrshme e shqyrtimit. Megjithatë rëndësia e këtyre çështjeve nuk u pakësua, aq më pak nuk u zhduk, me përfundimin e procesit të dekolonizimit, të paktën aq sa i përket Botës së Tretë. Këto çështje janë ende në agjendën dhe në marrëdhëniet ekonomike postkoloniale midis Perëndimit, “bërthama”, dhe Botës së Tretë, “periferia”. Teoricienët e varësisë e përshkruajnë atë si shfrytëzuese si kurrë më parë. Kanë kaluar disa dhjetëvjeçarë që kur problemet u shfaqën së pari dhe kanë kaluar 25 vjet kur Mohammed Bedjaoui, një avokat ndërkombëtar i njohur algjerian dhe ish kryetar i GJND-së, i cili përfaqësonte pikëpamjen e Botës së Tretë, shkruante: “Drejt një rendi ndërkombëtar ekonomik të ri “69. Megjithatë ligjërimet asnjëherë nuk reshtën në OKB dhe në Botën e Tretë. Autori Balakrishnan Rajagopal, një profesor i së drejtës dhe zhvillimit ndërkombëtar dhe drejtori i Programit për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësi në MIT shkroi në vitin 2003: “Ligji Ndërkombëtar nga Poshtë, zhvillim, lëvizje sociale dhe Rezistenca e Botës së Tretë” dhe puna e tij ka marrë lëvdata nga autorë të rëndësishëm.

Një çast i rëndësishëm në këtë kontekst ishte kur blloku i Botës së Tretë në OKB shkaktoi një krizë politike dhe ekonomike ndërkombëtare, në një përpjekje për të krijuar atë që është quajtur si një Rendi i Ri Ekonomik Ndërkombëtar (NIEO) në krahasim me rendin e vjetër me formë ekonomike koloniale. Deklarata për themelimin e një Rendi të Ri Ekonomik Ndërkombëtar u miratua në vitin 1974. NIEO nënkuptonte një thirrje për ndryshime themelore strukturore dhe institucionale në ekonominë botërore. Deklarata bëri thirrje për një mënyrë “...të bazuar në barazi,

⁶⁹Bedjaoui, M. (1979). *Drejt një rend të ri ekonomik ndërkombëtar*, UNESCO, Paris.

në barazi sovrane, në ndërvarësinë e interesit të përbashkët dhe në bashkëpunimin ndërmjet të gjitha shteteve...”⁷⁰.

Vendet në zhvillim po ngriheshin kundër botës së industrializuar, SHBA-së, aleatëve të saj evropianë, Izraelit dhe Japonisë⁷¹. Megjithatë shumë shtete dënuan jo vetëm imperializmin perëndimor, por edhe kolonializmin sovjetik, duke dëshmuar se “... në kundërshtim me keqkuptimin popullor dhe shkencor në Perëndim, përpjekja për ta artikuluar zërin e Botës së Tretë ishte e sinqertë dhe nuk ishte një zgjerim i dominimit sovjetik”⁷².

Periodha që i parapriu vitet 1950, 1960 dhe 1970, duke filluar me konferencën e Bandung-ut më 1955, ishte karakterizuar nga fryma e re e solidaritetit ndërmjet Afrikës dhe Shteteve të Azisë, kur ato për herë të parë ngritën krye kundër Perëndimit. Këto shtete morën kontrollin e OKB-së dhe agjencitë e saj, dhe u krijua Grupi i 77-ës (G-77) dhe Lëvizja Kundër Shtrirjes (Deklarata mbi NAM e 1967-ës) dhe përmes rezolutave të GA-së u bënë përpjekje për ta ndryshuar rendin e gjërave. NIEO përmban shumë elemente të tilla, si doktrinën e Sovraniteti të Përhershëm mbi Burimet Natyrore dhe rregullimin e korporatave shumëkombëshe⁷³. Më pas u miratua edhe Karta mbi të Drejtat Ekonomike dhe Detyrat e Shteteve, në vitin 1974, si dhe Deklarata mbi të Drejtën për Zhvillim, në vitin 1982 nga GA. Këto kërkesa ishin të rëndësishme në shumë nivele. Sovraniteti ishte tashmë duke u përdorur edhe si mburojë, edhe si shpatë nga shtetet e dobëta të cilat, siç e dimë, ka raste edhe në kohët e sotme dhe me anë të NIEO-s, ku Bota e Tretë përpiqet të zhvendosë peshoren politike në ligjin ndërkombëtar. Ajo synonte gjithashtu, të merrte disa fuqi kundër korporatave perëndimore të cilat ndërhyjnë jashtëzakonisht shumë në politikën vendore.

Megjithatë deri në fund të 1970-ës, NIEO u konsiderua si dështim. Perëndimi me SHBA-në në krye kishte bllokuar çdo mundësi për reforma themelore të rendit ekonomik ndërkombëtar dhe bashkëpunimi i bllokut të Botës së Tretë filloi të shpërbëhej. Kritikët e shpërndanë NIEO-n, se ishte shumë radikal dhe i mangët në realizim. Autori, Thomas Franck, i kritikoi rëndë strategjitë e Botës së Tretë, sepse ishte shumë kundërshtuese (konfrontuese) dhe sipas tij ata ishin të bazuar vetëm në

⁷⁰Cituar në Rajagopal, 2003, f. 79.

⁷¹Rajagopal, 2003, f. 77-79.

⁷²Shtetet që e mbështetën këtë pikëpamje përfshirë Pakistanin, Iranin, Irakun, Turqinë, Libanin, Libinë, Liberinë, Filipinet dhe Sudanin. Shih Rajagopal, 2003, f. 75.

⁷³Rajagopal, 2003, f. 73-75.

strategji fituese antikoloniale. Ai vazhdon: “...fushata kundër kolonializmit, në fund të fundit, nuk u fitua në Indi dhe në Algjer - përveç se në trillimin *a fortiori* të mitologjisë postkoloniale nacionaliste, por në Londër dhe në Paris”...⁷⁴. Rajagopal-i e komenton këtë thënie të Franck-ut si tërësisht mospërfillëse ndaj rolit të luajtur nga rezistenca masive kundër kolonializmit në Botën e Tretë⁷⁵. Sipas mendimit tim, ajo që shpreh Thomas Franck-u është jo vetëm një qëndrim mospërfillës, por edhe fyes, sepse mbështet idenë se popujt e kolonizuar ishin të porealizuar dhe inferiorë ndaj perëndimorëve të cilët u dhanë atyre pavarësi, në krahasim me idenë e tyre të të luftuarit për pavarësinë e vet.

Rajagopal-i parashtrohet një analizë të NIEO-s, të ndryshme nga ajo që bëhet tradicionalisht (më së shumti nga historiografët perëndimorë). Sipas mendimit të tij, NIEO nuk ishte aq radikale sa pretenduan kritikët, po edhe nuk ishte një dështim. Ajo solli efekte të rëndësishme: “... NIEO përbënte një çast radikal të sfidës të së drejtës ndërkombëtare që rezultoi në shndërrimin dhe zgjerimin e shtrirjes së të drejtës ndërkombëtare ...”⁷⁶.

Nuk është nevoja të thuhet se sistemi nuk ishte i përsosur. Sipas Rajagopal-it, kufizimet e sistemit qëndrojnë në përsëritjen ose kopjimin e mënyrës koloniale dhe zhvillimore të të menduarit, në kërkim të modernizimit ku “primitivja” duhej të arrinte nivelin e modernitetit perëndimor, sipas të njëjtit model, duke iu përmbajtur të po njëjtave rregulla. Kjo çoi në kufizimin e efekteve që NIEO-ja duhet të kishte pasur dhe propozimet e bëra nga avokatët ndërkombëtarë nuk kanë për qëllim t’ i sfidojnë racionalitetin dhe modernitetin perëndimor në sistemin politik dhe ekonomik dhe që ishin të mbështetur nga e drejta ndërkombëtare. Këto prirje nuk dallohen vetëm në qëndrimin ndaj zhvillimit ekonomik, por edhe në lidhje me DUDNJ-në, ku janë parashikuar standarde të përbashkëta të arritjeve. Vendet e Botës së Tretë nuk janë në kundërshtim me këtë, edhe pse ato kishin rol shumë të vogël në hartimin e deklaratës.

Avokatët e Botës së Tretë kanë prirje ta shohin të drejtën e vetëvendosjes (dhe të drejtën për zhvillim), jo vetëm si një të drejtë themelore, por si një kusht për realizimin e demokracisë, e të drejtave individuale të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Georges Abi-Saab-i është një nga avokatët ndërkombëtarë që i mbron këto pikëpamje. Abi-Saab-i, gjithashtu parashtrohet pamjen e Botës së Tretë në lidhje me përkufizimin e “popullit”. Ai thotë se, ndërsa në teori është i rëndësishëm të bëhet

⁷⁴ Po aty, f. 80-81.

⁷⁵ Rajagopal, 2003, f. 81.

⁷⁶ Po aty, f. 73.

dallimi ndërmjet popullit dhe shtetit, si në kontekstin e vetëvendosjes edhe në atë të zhvillimit, nuk është po aq i rëndësishëm në praktikë⁷⁷. Për më tepër, këta avokatë janë të palëkundshëm në qëndrimin e tyre, pasi ato janë në kundërshtim me idenë e një të drejte të ndarjes në krahasim me homologët e tyre perëndimorë. Abi-Saab-i, për shembull, i trajton pretendimet për t'u ndarë si një çështje të brendshme të shtetit në fjalë dhe kërkon përgjegjësi nga shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, për ta trajtuar atë në të njëjtën mënyrë, sepse përndryshe do të përbënte një shkelje të parimit të mosndërhyrjes⁷⁸. Abi-Saab-i nuk e refuzon kategorikisht njohjen e ndarjes, pasi nëse rezulton efektivisht e suksesshme, ndarja mund të njihet si udhëheqëse drejt pavarësisë. Kjo gjë nuk qëndron jashtë fushës së vetëvendosjes, edhe pse fenomeni nuk është i rregulluar nga e drejta ndërkombëtare⁷⁹.

Për sa i përket shkeljes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe konflikteve me natyrë etnike, avokatët Botës së Tretë janë të mendimit që zgjidhja do të arrihet vetëm nëpërmjet respektimit dhe vënies në zbatim të të drejtave themelore të vetëvendosjes dhe zhvillimit. Sipas mendimit tim këndvështrimi i Botës së Tretë synon tablonë e madhe, ku vendet e fuqishme të industrializuara ndërhyjnë politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në punët e brendshme të vendeve në zhvillim. Praktikantët e kompanive shumëkombëshe, duke e pasur epiqendrën e pushtetit të tyre në vendet perëndimore, synojnë vënien e qeverive të tyre nën tryzni (presion) dhe ndërhyjnë në politikën vendore të vendeve të Botës së Tretë. Për më tepër, nuk është sekret se shumë prej regjimeve totalitare (nëse jo shumica) në këto vende marrin mbështetje nga jashtë prej grupeve të interesit, qeveritë dhe kompanitë jo vetëm në rajon, por edhe në Perëndim. Këto pikëpamje duket të jenë shumë të përhapura ndërmjet njerëzve, që jetojnë në vendet e Botës së Tretë. Ose të paktën, kjo është përshtypja që kam krijuar sa herë që zëri i njerëzve të Botës së Tretë është dëgjuar në media. Një çështje tjetër, së cilës i është dhënë shumë vëmendje nga avokatët e Botës së Tretë, është ajo e konflikteve të përgjakshme, veçanërisht ato në Afrikë. Ato në një masë të madhe ndërlidhen me kompleksin ushtarako-industrial, që gjithashtu kontrollohet kryesisht nga Perëndimi, ku SHBA-ja është aktori kryesor në këtë fushë. Çështja e armatimit çon apo ndikon në destabilizimin e shteteve ku tashmë mungon stabiliteti politik, duke u konsideruar në këtë mënyrë, së bashku me mungesën e plotë të demokracisë, apo edhe mundësinë e

⁷⁷Po aty, f. 1321.

⁷⁸James. C. (2001), *Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts* Alston, pp. 48.

⁷⁹Po aty, f. 49.

demokratizimit, si një pengesë e madhe për realizimin e të drejtave të njeriut, duke filluar me të drejtat themelore, të drejtën për vetëvendosje dhe të drejtën për zhvillim⁸⁰. Shembulli më i njohur i këtyre lloje ndërhyrjesh janë ndërhyrjet rekord të Shteteve të Bashkuara në “oborrin” e tyre, në Amerikën Jugore dhe Qendrore, por edhe në Lindjen e Mesme dhe në Azinë Juglindore⁸¹. Dhe në rastin Nikaragua-s janë gjetur efektivisht fajtorë për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare.

Së fundmi, unë do të doja të përmbyllja me disa komente. Kam arritur në përfundimin se në sytë e avokatëve të Botës së Tretë, mbrojtja e të drejtave të grupeve mund të bëhet në mënyrë efikase, vetëm nëse trajtohen problemet e sipërpërmendura. Megjithatë, në këtë drejtim, sipas mendimit tim, është shumë e rëndësishme të bëhet dallimi midis avokatëve të Botës së Tretë dhe regjimeve të Botës së Tretë. Të parët nuk ia atribuojnë të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut në vendet e tyre, procesit historik të kolonizimit dhe vazhdimin e tij në formën e neokolonializmit dhe imperializmit, por pranojnë se shumë faktorë kompleksë, duke përfshirë kushtet e brendshme politike, bashkëveprojnë për të krijuar gjendjen e tanishme. Këta të fundit nga ana tjetër, përdorin si t’u vijë përshtat dhe i shtrembërojnë argumente të tilla si: sovraniteti, integriteti territorial, relativizmi kulturor, imperializmi kulturor perëndimor, përparësia e të drejtave kolektive dhe solidare (të tilla si të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore) mbi të drejtat civile dhe politike e kështu me radhë, për t’ipërligjur (justifikuar) veprimet e tyre, prandaj dhe çdo formë të kritikave të jashtme e etiketojnë si ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti.

⁸⁰ N. J. Udombana. (2000). *Bota e tretë dhe e drejta për Zhvillim: Agjendën për mijëvjeçarin e ardhshëm*, Universiteti Press, në http://muse.jhu.edu/journals/human_rights_quarterly/v022/22.3/uombana.html.

⁸¹ Jack. D. (1998). *Të drejtat njerëzore ndërkombëtare*, Boulder, kapitullin mbi të Drejtat e Njeriut dhe Politika e Jashtme.

KREU IV: VETËVENDOSJA E JASHTME DHE VETËVENDOSJA E BRENDSHME, APEKTE TE PERGJITHSHME

1. Shfaqjet e shumta të vetëvendosjes: vetëvendosja e brendshme dhe e jashtme, vetëvendosja politike, ekonomike, sociale e kulturore.

Kemi përmendur tashmë faktin, se radhitja e burimeve ligjore të së drejtës ndërkombëtare, që për arsye të ndryshme e trajton parimin e vetëvendosjes, karakterizohet nga një prirje përparimtare për zgjerimin e përmbajtjes së saj. Në aktet e para ligjore që përmban ajo, është shfaqur si parim me karakter krejtësisht politik, i frymëzuar nga idealet e lirisë dhe me synimin e sigurimit të çlirimit të popujve nga mënyrat e ndryshme të shtypjes, sikurse dëshmohet në formulimet e para që datojnë që prej epokës së revolucioneve amerikano-veriore dhe francez.

Pjesa më thelbësore e këtij karakteri është konfirmuar në zhvillimet e mëtejshme, që nga periudha e Luftës së Parë Botërore, kur teoricieni marksist, Lenini nga njëra anë, dhe Presidenti amerikan, Wilson, e paraqitën atë si vlerën bazë të nevojshme për të siguruar bashkëjetesë të rregullt dhe paqe të qëndrueshme midis kombeve. Tashmë, në Kartën e Kombeve të Bashkuara (1945), parimi i vetëvendosjes është pasuruar me përmbajtje të re, prandaj edhe pse sjell risi në legjislacionin e përgjithshëm, nuk duhet mbivlerësuar: nga njëra anë, në paragrafin 2 të nenit 1 dhe në nenin 55 shenjtërohet rregulli për të cilin marrëdhëniet midis shteteve duhet të bazohen në të drejtat e barabarta të popujve dhe në respektimin e të drejtës së tyre për vetëvendosje, nga ana tjetër, ajo nuk e njeh të drejtën e popujve për të vetëvendosur, por më tepër një detyrim shteteve për t'i përputhur disa të drejta në marrëdhëniet e ndërsjella.

Gjithnjë e më shumë gjenden në Kartë norma të tjera që i rrudhin (ridimensionojnë) në mënyrë të konsiderueshme disa njohuri që kërkojnë kujdes: nëse, neni 75 parashikon të drejtën për popujt joautonomë, që të shkojnë gradualisht drejt vetëqeverisjes apo pavarësisë, neni 73 nuk u jep të drejta të ngjashme popujve që ndodhen nën regjime koloniale, por sanksionon vetëm në ngarkim të shteteve që kanë përgjegjësinë e qeverisjes së territoreve joautonome, një detyrim "...për zhvillimin e vetëqeverisjes së popullsisë, për të marrë parasysh aspiratat politike dhe të asistojë në zhvillimin progresiv të institucioneve të tyre të lira politike ...". Mund të themi, mandej, se në Kartën e KB-së, në parim, ka kuptime të ndryshme në lidhje me situata të ndryshme: në kontekstin e administrimit të besimit, kjo nënkupton të drejtën e pranueshmërisë për pavarësi; ndërsa, për territoret koloniale, nuk shihet si i

menjëhershëm problemi i qasjes për pavarësi. Pamja kufizuese ndoshta përligjet nga fakti se në kohën e hartimit të Kartës, qëndronin në krye disa prej anëtarëve themelues të Kombeve të Bashkuara me zotërime të gjera koloniale. Nga ana tjetër, ka një kontradiktë midis dy grupligjeve, duke parë se në faza të ndryshme historike, parimi i vetëvendosjes është konceptuar në terma negativë, domethënë u ndalohej shteteve të ndërhyjnë në zgjedhjen e lirë të një tjetër shteti dhe nuk imponon detyrimin, në kuptimin pozitiv, mbi një qeveri pushtuese të një territori që s’i përket, t’i lejojë banorët e tij të vendosin vetë rreth fatit të tij.

Por shpejt historia do të vendoste drejtësi mbi këtë pikëpamje kufizuese dhe tashmë me Deklaratën për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme)⁸², është zgjidhur në të mirë të gjithë popujve, e drejta për vetëvendosje të lirë, që do të thotë vendosja e statusit politik me vullnet të lirë.

Në të vërtetë, disa autorë⁸³ argumentojnë se kjo njohje do të jetë e kufizuar, pikërisht , për popujt që ndodhen nën sundimin kolonial. Megjithatë, duket më e saktë teza e atyre⁸⁴ që për popujt, që ndodhen nën zotërimin kolonial, në një periudhë të caktuar historike, besojnë në zbatimin e parimit, mirëpo tashmë Kombet e Bashkuara nuk e kanë qëllim të afirmojnë një koncept të ngushtë të vetëvendosjes, por të zbatohet një rregull i përgjithshëm lidhur me situatën emergjente të zhvillimeve të skajshme ,shtypjen e popujve kolonialë. Për të konfirmuar tezën e sapocilësuar më lart, mjafton të përmendim “rolin dinamik” të parimit të vetëvendosjes, pra aftësinë e tij për t’u modeluar dhe përshtatur me nevojat e ndryshme të ngutshme, të realitetit historik. Një rritje të vërtetë cilësore, në mënyrën e të kuptuarit të vetëvendosjes së popujve, u regjistrua më pas në deklaratën për marrëdhëniet miqësore, në të cilën dispozitat e përgjithshme në lidhje me të drejtën e popujve për vetëvendosje i janë referuar në mënyrë të posaçme qëllimit “mettre rapidement fine au colonialisme”, por në të njëjtën kohë janë shtuar regjimet raciste dhe rastet e shtypjeve të popullit nga qeveria e vet.

Por risia më domethënëse është për sa i përket shfaqjes së një përmase të re të parimit tonë: krahas aspektit të jashtëm që e bën të ligjshëm një popull për t’ishpëtur një regjimi kolonial dhe racist, (gjë që shumë herë është parë të ndodhë) ,për herë të

⁸²Rezoluta nr. 1514 e OKB-së, 1960, fq. 46

⁸³Pallieri .B. *E drejta publike ndërkombëtare*, Giuffrè, fq. 3.

⁸⁴Ruiz. A. (1988). *Autodeterminazione (diritto dei popoli alla)* EG, vol.IV; Guarino.(1984). *Autodeterminazione dei popoli e diritto internazionale*, Jovene, pg.93 .

parë është vënë theksi në aspektin e brendshëm, i cili në thelb parashtron nevojën që qeveritë e të gjitha shteteve të jenë përfaqësuese të të gjithë popullit, ndaj të cilit nuk do të kryejnë asnjë diskriminim, as në bazë të racës, besimit apo ngjyrës. Kjo vlerë e re e vetëvendosjes që thekson dallimin midis qeverisësve, nga njëra anë, dhe të qeverisurve, nga ana tjetër, përcakton detyrimin e çdo shteti të gëzojë dakortësinë e shumicës së qytetarëve të tij dhe për t'i garantuar popullit, jo vetëm mundësinë për t'u shprehur lirisht në lidhje me strukturën politike, por edhe për ta ndryshuar atë, në rast të mosnjohjes nga regjimi ekzistues. Në këtë mënyrë, afirmohet vërtet hamendësimi i pajtueshmërisë së vullnetit të popullit me atë të qeverisë, në kuptimin që ekzistenca brenda një shteti e një regjimi përfaqësues të të gjithë popullit, e plotëson zbatimin e parimit të vetëvendosjes.

Pra, është fjala për vetëvendosjen e jashtme, që do të thotë e drejta e një populli për ta zgjedhur lirisht formën politiko-institucionale (të pavarur, të federuar ose integruar në një shtet të mëparshëm) prej nga bëhet pjesë e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërsa kur bëhet fjalë për vetëvendosje të brendshme, kemi të bëjmë me lirinë e popullit për ta zgjedhur dhe për ta miratuar regjimin politik "shtëpiak" më të përshtatshëm dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat. Jo vetëm kaq, por në këtë kuptim për më tepër parimi i vetëvendosjes nyjëtohet në formën më komplekse në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), dispozitat e së cilës janë zhvilluar më tej në Aktin Final të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (1975), si dhe në Kartën Afrikane mbi të drejtat e individëve dhe popujve (Karta Banjul, miratuar në vitin 1981). Vetëvendosja bën të qartë kështu, jo vetëm fuqinë e popullit për ta vendosur regjimin politik që e konsideron të përshtatshëm për qëllimet e përcaktuara më sipër, por edhe për të vendosur mbi organizimin ekonomik, social dhe kulturor të pëlqyeshëm për të. Në këtë mënyrë profilizohet jo vetëm një e drejtë për vetëvendosje tradicionalisht politike, por edhe në kuptimin ekonomik, social dhe kulturor.

Këto aspekte, nga njëra anë shfaqin një dëshmi të procesit të evolucionit të parimit tonë në praktikë dhe doktrinë, ndërsa nga ana tjetër janë ende duke u finalizuar dhe në kohët e fundit kanë zbuluar ide interesante për këtë çështje. Vlen të përmenden këtu pretendimet e ndryshme të lëvizjes së ashtuquajtur "anti-globalizim", në denoncimet e ndryshme për pabarazitë ekonomike në lidhje me popullatat në zhvillimin dhe rreziqet për mirëmbajtjen e diversitetit kulturor dhe biologjik të

popujve dhe pakicave që rezultojnë nga i ashtuquajtimi "globalizëm"⁸⁵, të cilat u shfaqën në demonstratën mbresëlënëse të Seattle-së (1999) në takimin e tretë të OBT-së, në rang ministror. Në këtë kontekst, nese mund ta quajmë zbulimi i "integritit" të vetëvendosjes, një pozicion i kualifikuar duhet t'i njihet, siç u përmend, Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, në Banjul (1980), i cili duket i frymëzuar nga nevoja për integrimin e "virtyteve e traditave historike dhe vlerave të qytetërimit afrikan" në sistemin universal të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Prandaj, pohimi solemn i të drejtave të popujve nuk mbyllet vetëm me shpalljen e së drejtës së vetëvendosjes, por shërben edhe për ta theksuar lidhjen e pazgjidhshme midis të drejtave individuale dhe të drejtave kolektive të solidaritetit, sikurse edhe në njohjen e të drejtave individuale të ndërthurura me pjesëmarrjen në bashkësi, ku individi është pjesë dhe që në lidhje me të ka detyrime përcaktuara. Ky është çelësi që shpjegon rëndësinë që Karta u jep të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, por edhe më shumë të ashtuquajturit "brezit të tretë", të cilat janë pikërisht të drejtat e solidaritetit, si për shembull, e drejta për paqen, zhvillimin dhe për mjedisin. Por, në kuadrin e asaj për të cilën jemi të interesuar dhe për të cilën është e domosdoshme të ndalemi, është dukuria se në kontekstin e veçantë rajonal, në të cilën zbatohet Karta, me specifikën e vet në fushën e të drejtave të njeriut, ka ndikim të rëndësishëm me përmbajtjen e saj.

Pra, nëse është e vërtetë se Afrika është karakterizuar nga një shumësi vendesh në zhvillim, apo në kërkim të pavarësisë politike, ajo ndjek logjikisht shfaqjen imponuese të kërkesave për zhdukjen e pabarazive ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat janë bërë nga vendet në zhvillim në kuadër të organizatave të ndryshme ndërkombëtare (kryesisht të Kombeve të Bashkuara). Kjo gjendje më pas, në aspektin praktik, përfton një theksim të tepruar ndaj planit ndërkombëtar në afirmim të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, individuale dhe kolektive, të gjitha këto si pjesë e qëllimit për të krijuar një rend të ri botëror, i cili të jetë përfundimisht i bazuar në drejtësi dhe barazi sociale; postulatet themelore të këtij rendi duhet të përfaqësohen në të drejtën e çdo shteti për ta zgjedhur sistemin e vet ekonomik, social dhe kulturor, si dhe sovranitetin e përhershëm të burimeve të tij natyrore, barazinë e mundësive ekonomike, detyrimin për të bashkëpunuar me synim zhvillimin.

⁸⁵Treves. T. (2003). *Elementi di diritto internazionale, problemi fondamentali*, pg.31-32.

Realizimi i këtyre objektivave natyrisht paravendos plotësimet e nevojshme të një numri angazhimesh nga vendet ekonomikisht të përparuara, konkretizuar në promovimin dhe financimin e projekteve të veçanta zhvillimore, në zbutjen e barrës së borxhit në PSV, për sa u përket nismave të para dhe të tjera në vijim nën logon "humanitare". Megjithatë, nuk mund të mos themi se nga njëra anë, njohja e këtyre kërkesave duket e përshtatshme me supozimin e përmirësimit të kushteve të jetesës në vendet në zhvillim; pastaj, nga ana tjetër, njohja e plotë e të drejtave të tyre politike, të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore është thelbësore për të siguruar paqen dhe parandalimin e konflikteve të reja të brendshme dhe ndërkombëtare. Kjo qasje përmban sidomos në doktrinë, shumë shqetësime që lidhen me vështirësinë për t' i përcaktuar pronësinë, përmbajtjen dhe mënyrën e ushtrimit të njëjtë⁸⁶.

Nuk mund të harrohen luftërat e ndryshme të popujve indigjenë⁸⁷, me karakter kryesisht kulturor dhe mjedisor për mbijetesë, të cilat kanë gjetur shprehje në përfundime marrëveshesh të ndryshme, edhe nën patronazhin e OKB-së, ashtu siç duket interesante, bashkimi i këtyre ideologjive, në lëvizje të ndryshme, që luftojnë kundër modeleve ekonomike dhe kulturore zotëruese, të cilat kulmuan në Forumin Botëror Social, në Porto Alegre (2001), dhe në Konferencën e mëvonshëm të popujve indigjenë (2002)⁸⁸.

Në përgjithësi ajo që ka theksuar doktrina ndërkombëtare është pasojë e proceseve të globalizimit dhe përballet me rritjen e ndërlikueshmërisë së problemeve dhe e shtimit të ndërvarësive dhe marrëdhënieve të pushtetit dhe sistemeve të ndryshme kombëtare, gjë që nuk pëputhet me forcimin e një organizate publike ndërkombëtare, as me sistemin e kufijve dhe pengesave në logjikën e tregut të hapur. Kjo çoi në mënyrë të pashmangshme në dobësimin e garancive minimale të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, një sulm ndaj të mirave të përbashkëta dhe jetësore të njerëzimit (para së gjithash, të mirës së mjedisit) dhe së fundi, rritja e dukshme e pabarazisë midis kombeve të zhvilluara (gjithnjë e më të pasura) dhe masave të pafundme e gjithnjë në rritje të njerëzve në varfëri të skajshme. Me pak fjalë, siç ka

⁸⁶Castangia. I. (1966). *Diritti fondamentali dei cittadini del mondo*, pubblicazioni del Movimento Federalista Europeo, pg.4.

⁸⁷Maria. J. (1996) *Arguedas y las ficciones del indigenismo*, Fondo de Cultura Economica, Mexico.

⁸⁸Cammarat. R. (2004) *I diritti dei popoli indigeni, lotte per il riconoscimento e principio di autodeterminazione*, Pubblicazioni del Dipartimento di studi sociali e politici, Università degli studi di Milano, pg. 7.

thënë edhe një jurist i shquar në një shkrim kritik⁸⁹, sot mund të flasim për një racizëm të ri i cili çon në varfëri, uri, sëmundje dhe vdekje të miliona qenieve njerëzore tashmë të pavlera, që përballë deklaratave të panumërta të barazisë dhe shpalljeve të shpërndarjes së barabartë të burimeve, lind pabarazi të mëdha të të ardhurave midis vendeve të pasura dhe të varfra, si dhe dhjetëra miliona të vdekur çdo vit, për shkak të mungesës së ujit, ushqimit dhe barnave esenciale. Se çfarë pasojash shkatërrimtare rrjedhin prej tyre, në aspektin e vetëvendosjes (ekonomike, dhe jo vetëm), mund të përfytyrohet lehtë. Shpalljet *de jure* e zgjidhjeve të parashikuara për këto probleme të vështira, shkojnë në drejtimin e krijimit të institucioneve të garancisë që ndërmjetësojnë midis shteteve për të gëzuarit e të drejtave ekonomike dhe sociale, të mishëruara në paktin e 1966-ës (dhe mbi të gjitha, të parimit tonë), jo vetëm në anën e mjeteve dytësore të natyrës juridike, por tashmë në nivelin e garancive parësore dhe konkrete. Megjithatë disa prej tyre, tashmë ekzistojnë dhe përpiqen të veprojnë në drejtimin e dëshiruar, si FAO-ja dhe OBSH-ja; bëhet fjalë për pajisjen me mjetet dhe strukturat e nevojshme për të qenë në gjendje të veprojnë në mënyrë sa më efektive. Organet e tjera, pikërisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit, të garancisë arsimore, strehimit dhe të drejtave të tjera themelore duhet të projektohen dhe të vendosen nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare. Por para së gjithash, kërkohet përpunimi i një "Karte ndërkombëtare të mallrave bazë", e cila i bën të pacenueshme dhe të patjetërsueshme mallra të tillë dhe krijon vijat e një politike të re për mbrojtjen e mallrave të konsumit, në bazë të një kontrate të re natyrale, midis njerëzimit dhe natyrës⁹⁰.

Përveç kësaj, ka edhe nga ata që thonë se vetëvendosja merr gjithmonë forma të reja dhe paraqet probleme të ndryshme, sidomos kur shihet nga këndi i vetëvendosjes ekonomike. Kështu ndodhi me vendimin e Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj perëndimorë për liberalizimin e kapitalit financiar, në fillim të viteve '70, kështu u shemb sistemi i Bretton Woods-së, i cili rezultoi pikërisht në ato pasoja që ithtarët e Protokollit kërkonin t'i shmangnin kur ndërtuan sistemin e përmbajtjes së liberalizimit, me kufizime në vërshimet e kapitalit dhe me kurse këmbimi relativisht fikse. Në fakt, ata kishin kuptuar se liberalizimi i tregjeve financiare mund të bëhet një armë e fuqishme kundër vetëvendosjes dhe vlerave demokratike në përgjithësi. Në një situatë të tillë, investitorët spekulatorë dhe institucionet e fuqishme

⁸⁹Ferrajoli. L. (2002). *Diritti fondamentali*. Un dibattito teorico, Laterza. pg.56.

⁹⁰Serres. M. (1994). *Atlas*, Paris. pp. 25.

financiare rrezikojnë të bëhen një "senat virtual", në gjendje të ndikojnë në politikat e shteteve dhe madje t'i dekurajojnë zgjidhjet politike funksionale të individëve dhe t'i shkëpusin nga logjika e fitimit, duke përdorur kërcënimin e humbjes së kapitalit, me rritjen e njëkohshme të normave të interesit dhe lidhjet me fenomenet shqetësuese të recesionit⁹¹.

Përgjithësisht është thënë qartë⁹² (në të vërtetë, skajshmërisht) se politikat e shumë shteteve përfundojnë të jenë të varura nga zgjedhjet e institucioneve financiare ndërkombëtare, që më pas pasqyrojnë për së largu orientimet e Shteteve të Bashkuara që përcakton një depërtim të kufizuar të vetëvendosjes, para së gjithash ekonomik, për njësitë e vetme shtetërore dhe transferimin e fuqisë vendimmarrëse të klasave sunduese të shteteve më të fuqishme. Bëhet fjalë për fenomene dhe procese që pavarësisht sa të rëndësishme dhe interesante të jenë, mbeten ende duke u finalizuar dhe që për këtë arsye, nuk duket e përshtatshme për të shkuar përtej këtyre vërejtjeve të shkurtra.

2. Mosndërrhyrja dhe e drejta për vetëvendosje.

Ky parim, me kalimin e kohës, është shndërruar në një sundim të së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe në një parim thelbësor të së drejtës ndërkombëtare, ku veçoria më e dukshme e saj është ndalimi i kërcënimit ose përdorimit të forcës. Ka një rëndësi parësore lidhja me "parimin e të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve" në nenin 1 (2) dhe me barazinë e shteteve në nenin 2 (1) të Kartës së OKB-së. Interpretimi dhe praktikimi nga çdo shtet i Kartës, si brenda ashtu edhe jashtë sistemit të OKB-së, ka çuar në zhvillimin e parimit të mosndërrhyrjes që shkon përtej interpretimit të ngushtë të mospërdorimit të forcës. E drejta për vetëvendosje dhe neni 1 (2) në veçanti, tani zbatohet në zona të tjera, përpos asaj të shtypjes koloniale, gjë që parakupton se popujt dhe shtetet, edhe pse të lirë dhe të pavarur, kanë të drejtën e lirisë nga ndërhyrja e jashtme. Për më tepër, në praktikë, kjo parakupton detyrimin për të mos ndërhyrë, drejtpërdejt ose tërthorazi, në punët e brendshme të një shteti me qëllimin për të ndikuar ose manipuluar jetën politike dhe mekanizmat politikë të vendimmarrjes së atij shteti. Thelbi i parimit u miratua më parë nga SHBA-ja dhe shtetet latino-amerikane dhe u riafirmua në Kartën e

⁹¹Chomsky .N. (1999). *A guardia del mondo*, da Il Manifesto, 4 Dicembre.

⁹² Po aty.

Organizatës së Shteteve Amerikane (OAS), në vitin 1948⁹³. Në anën tjetër, kjo gjë ka ndikuar në punën e OKB-së dhe në vitin 1970 u miratua Deklarata e Marrëdhënieve Miqësore. Kjo deklaratë i kushton një pjesë të madhe ndërhyrjes në të gjitha format e saj, ekonomike, politike apo edhe të tjera, shfaqur drejtpërdrejt ose tërthorazi. Kjo deklaratë ka ndikuar edhe në shtetet evropiane, përderisa në Aktin e Helsinkit, në vitin 1975, u miratuan dispozita të ngjashme në lidhje me mos-ndërhyrjen⁹⁴. Kjo e fundit është vetëm politikisht e detyrueshme, por përmban shumë parime themelore, që janë ligjërisht të detyrueshme në të drejtën ndërkombëtare⁹⁵. Me pak fjalë, të gjitha këto mjete ligjore dhe politike, së bashku me praktikën e shtetit dhe aktvendimet nga ana e GjND-së, si në çështjen Nikaragua-s⁹⁶, përbëjnë faktin se parimi i mosndërhyrjes është një parim i fortë dhe thelbësor në të drejtën ndërkombëtare, i cili natyrisht duhet të interpretohet kështu edhe në kontekstin e të drejtës për vetëvendosje, duke pasur parasysh lidhjen e fortë mes këtyre të dyjave.

3. Vetëvendosja e jashtme e parë në tri këndvështrimet e saj klasike

3.1. Kufizimi fillestar i zbatimit të parimit të vetëvendosjes në situatat e popujve të ndodhur nën regjimin kolonial.

Parimi i vetëvendosjes, për një periudhë të gjatë, ishte i kufizuar në zgjidhjen e situatave të tilla si ato të tipit kolonial, por duhet theksuar se në kuptimin e saj “klasik” shtrihet në tri situata, në një farë kuptimi të ngjashme midis tyre. Sipas doktrinës ndërkombëtare, kjo zbatohet tradicionalisht në rastet e popujve të nënshtruar në një regjim racist, popujve të territoreve të pushtuara dhe të zëna me anë të forcës, si dhe popujve objekt i dominimit kolonial. Duhet pranuar që për një kohë të gjatë, përmasa e parimit të vetëvendosjes ishte pikërisht ajo e jashtëmja dhe në

⁹³Neni 3 në Kartën e OAS(organizata e shteteve amerikane). Në nenin 3 e) për shembull është pohuar se:“Çdo shtet ka të drejtë të zgjedhë, pa ndërhyrje të jashtme, sistemin e tij politik, ekonomik dhe social dhe për të organizuar veten në mënyrën më të mirë të përshtatshme për të, dhe ka për detyrë të përmbahet nga ndërhyrja në punët e një shteti tjetër. Në varësi të sa më sipër, Shtetet amerikane do të bashkëpunojnë plotësisht midis tyre, pavarësisht nga natyra e sistemeve të tyre të politike, ekonomike, sociale.”

⁹⁴Akti i fundit i Helsinkit 1975 pas Konferencës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë. Shih Nenet I-II, IV dhe VI, ku parimet e barazisë sovrane, mosndërhyrjes, integritetit territorial etj, afirmohen dhe në nenit VIII në të cilën pohohet e drejta për vetëvendosje.

⁹⁵Bring, 2002, pp. 107-108.

⁹⁶Aktivitetet në dhe kundër Nikaragua (Nicaragua v. Shtetet e Bashkuara), Gjykimi 27 qershor 1986, GjND-ja Reports 1986, f. 14.

veçanti, ai i kryengritjeve kundër kolonializmit⁹⁷.

Ne fakt, e vërteta është që në atë periudhë duhej përballuar një situatë si ajo e kolonializmit, e rënduar së tepërmi dhe për këtë arsye vëmendja ishte përqendruar mbi një aspekt të pjesshëm të parimit të vetëvendosjes, që në të vërtetë kishte lindur me një natyrë universale dhe si i tillë duhej të mbetej. Nga ana tjetër, edhe Deklarata mbi lejimin e pavarësisë së popujve të kolonializuar e përshkruan vetëvendosjen si një atribut të këtyre popujve, edhe pse parimi bënte pjesë në nenin 1 paragr. 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, përfshirje kjo që përputhej vetëm me një “program politik”. Në këtë kuptim shprehen edhe emra të mëdhenj të doktrinës ndërkombëtare, ndër të cilët mund të përmendim Cassese-n⁹⁸, Pellet-in⁹⁹ dhe Brandt Ahrens-in¹⁰⁰. Por me kalimin e kohës dhe me anë të veprimtarisë së Kombeve të Bashkuara, si dhe të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ndodhi siç e kemi parë, të arrihej zhdukja e perandrive koloniale, për të bërë që parimi të merrte statusin e një të drejte.

3.1.1. E drejta për vetëvendosje në sistemet e vendeve koloniale.

E drejta për vetëvendosje në kuadër të dekolonializimit, praktikisht nuk shtron asnjë problem. Se pari dekolonializimi është një nga ngjarjet më të rëndësishme historike në kohët moderne dhe procesi i vendeve të kolonializuara që çoi në pavarësi. Ai rezultoi në refuzimin e përgjithshëm të pikëpamjes së vjetër të “evropianëve të qytetëruar”, të cilët kanë të drejtë t’izotërojnë dhe t’ishfrytëzojnë “të paqytetëruarit”. Kjo thjesht u bë moralisht e papranueshme, edhe pse ishte krejtësisht e vlefshme dhe e zakonshme përpara kësaj periudhe. Së dyti, kjo “etikë” e re këndvështrimi ishte aq e fortë, sa që ajo u shtri edhe në fushën e së drejtës. Sot është e papërfytyrueshme të dyshosh mbi statusin ligjor të së drejtës për vetëvendosje në këtë kontekst të veçantë.

Thënë këto, nuk duhet të harrojmë çka besoj se ndodh shpesh në Perëndim, se procesi i dekolonializimit nuk ishte një ngjarje historike as e përsosur, as e

⁹⁷Summers. J. J. (2003). *The Status of Self determination in International Law: A Question of Legal Significance or Political Importance?* in Finnish Yearbook of International Law, Voi. XIV, pp.275.

⁹⁸Cassese. A. (1995), *Self Detennination of Peoples - A legal Reappraisal* , Cambridge, pp. 120.

⁹⁹Pellet. A. (1994). *Quel avenir pour le droit des peuples a disposer d’eux - memes*, in Internacional en Mundo en Trosfonnocidn, Montevideo, pp. 265.

¹⁰⁰Brandt. A. C. (2004). *Chechnya and the Right of Self – determination*, in Columbia Journal of Transnational Law. Columbia Law School - New York, Vol. 42, pp. 5X I.

lavdërueshme. Pasojat e kolonializimit dhe e gabimeve të bëra, gjatë dekolonializimit ndihen ende sot në mbarë Botën e Tretë. Fuqitë koloniale, ndërsa ndanin zonat e kolonializuara mes tyre, natyrisht që nuk morën parasysh përbërjen etnike të popujve të kolonializuar, gjë që është veçanërisht e dukshme në kontinentin afrikan. Po të shohim hartën e kontinentit, duket qartë se si janë hartuar kufijtë. Ata përbëhen kryesisht nga vija të drejta, të cilat dëshmojnë faktin se udhëheqësit kolonialë thjesht rrëmbyen një hartë dhe një vizore dhe i vizatuan kufijtë, por me bindje e bënë këtë, më së shumti, duke marrë parasysh burimet natyrore sesa gjithçka tjetër. Skena në fakt, ishte caktuar për konflikte të përgjakshme dhe të tmerrshme, me ngjyrimet etnike të cilat nuk kanë pushuar ende sot. Ruanda, duke qenë shembulli më famëkeq dhe më i tmerrshëm, megjithëse tepër vonë, u soll në vëmendjen e pjesës tjetër të botës. Ndërsa shumë shembujve të tjerë për fat të keq, nuk u është dhënë në media vëmendja që meritojnë dhe për botën ata janë atje vetëm nëpërmjet OKB-së, e cila manifeston edhe një herë tjetër paralizën e tyre.

Duke pasur parasysh faktin se, me disa përjashtime, nuk ka më koloni të mbetura në botë, dikush mund ta pyesë veten: Pse ky kontekst është ende i rëndësishëm? Natyrisht, ky rregull i së drejtës ndërkombëtare e kapërcen përkufizimin klasik të një kolonie, për të kuptuar format e tjera të nënshtrimit, zotërimit ose shfrytëzimit të jashtëm, të huaj apo racial, siç është deklaruar dhe rishikuar nga OKB-ja, që prej Deklaratës për Popujt Kolonialë dhe në Deklaratën e Marrëdhënieve Miqësore. Çështja e veçimit (apartaidit) në Afrikën e Jugut ishte një rast i qartë, ku pjesa më e madhe e dominuar e popullsisë me ngjyrë kishte të drejtë të luftonte për vetëvendosje, në kuptimin që ata kishin të drejtë t'i ndryshonin strukturat e shoqërisë të veçimit për të krijuar struktura të reja demokratike dhe një themel të ri për shoqërinë e tyre, ku ligjet raciste ua privonin të drejtat e tyre themelore politike dhe njerëzore¹⁰¹. Një tjetër shembull i padiskutueshëm është e drejta e popullit palestinez për vetëvendosje, të cilit i është dhënë vëmendje e madhe në OKB dhe nga bashkësia ndërkombëtare; me gjithë kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e kësaj çështjeje të veçantë, edhe pse më shumë se një gjysmë shekulli ka kaluar që nga fillimi i konfliktit, ka mangësi të praktikës konsistente të shtetit dhe të ndonjë zgjidhjeje reale.

¹⁰¹ Rezoluta e As. Përgjithëshme nr. 48/94 mbi rëndësinë e realizimit universal të së drejtës së popujve për vetëvendosje dhe dhënien e shpejtë të pavarësisë në vendet koloniale dhe popujve për garanci efektive dhe respektimin e drejtave të njeriut, <http://www.un.org/documents/ga/res/48/a48r094.htm>.

3.1.2. Trashëgimia koloniale.

Që nga dekolonizimi dhe deri më sot, avokatët e Botës së Tretë kanë kërkuar pa pushim, ta ndreqin tablonë konceptuale të marrëdhënieve ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare. Kjo u soll në vëmendje nga shqetësimi i tyre mbi rritjen e hendekut midis Veriut të pasur dhe Jugut të varfër. Ata u përpoqën të zhvillojnë një grup të ri të të drejtave, ato të njerëzve. Vetëvendosja është e drejtë e njerëzve dhe ajo i përkiste një tabloje më të gjerë, përkatësisht asaj që përmbante vetëvendosjen ekonomike dhe doktrinën e mosndërhyrjes. Ajo ishte e lidhur me Kartën e të Drejtave Ekonomike dhe Detyrave të Shteteve dhe është evokuar kryesisht nga vendet në zhvillim kundër vendeve të zhvilluara¹⁰². Në sytë e përkrahësve të vendeve në zhvillim, efektet e kolonializmit jo vetëm që ekzistojnë ende, por janë më të rënduara se kurrë, ndonëse jo në formën flagrante të kolonializmit klasik. Termi neokolonializëm është përdorur në këtë mënyrë. Në fund të fundit e drejta për vetëvendosje është e lidhur në një rën anë me integritetin territorial të shteteve dhe me parimin e mosndërhyrjes e në anën tjetër me të drejtën për zhvillim, pikërisht me të drejtën për t'i disponuar lirisht pasuritë dhe burimet natyrore dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të njeriut. Ne thjesht, duhet jemi të qartë në lidhje me një gjë, avokatët e Botës së Tretë nuk pranojnë të shohin tjetër gjë përpos tablosë së madhe, sepse sipas mendimit të tyre, çdo gjë (varfëria, hendeku i gjerë mes Perëndimit dhe të Botës së Tretë, shkeljet e të drejtave të njeriut, konfliktet etnike dhe çështjet e pakicave etj.) lidhet dhe çdo gjë (jo ekskluzivisht por në thelb) është e lidhur me trashëgiminë koloniale. Kështu është duke u zhvilluar një rezistencë postkoloniale kundër kolonializmit. Siç e kam theksuar tashmë, shpesh neglizhohet fakti se procesi dekolonizimit jo vetëm që ishte me të meta dhe me mangësi, por edhe u ndërpre pjesërisht, qëllimisht nga fuqitë koloniale, në mënyrë për të shpëtuar ç'ka të mundnin në një betejë humbëse kundër popujve që luftojnë për pavarësi.

Pas disa dhjetëvjeçarë përpjekjesh për pavarësi, në të gjithë Afrikën dhe Azinë, fuqitë koloniale nuk mundën ta mbajnë më pushtetin e tyre sidomos, në periudhën e Luftës II Botërore. Gjithçka, që nënkuptonte në aspektin e shfaqjes së të drejtave të njeriut, siç i njohim ne sot, ishte dhe dënimi i ideve të zotërimit dhe epërsisë (superioritetit). Dhe ndonëse kolonizatorët ishin të gatshëm t'i humbnin kolonitë e tyre, ata iu nënshtruan një rës nga kërkesat për pavarësi dhe të drejtës për

¹⁰² Crawford, në Alston, 2001, f. 21.

vetëvendosje. Njëkohësisht po ndodhte, nga njera ane , pozicioni nga fuqitë evropiane dhe bashkësia ndërkombëtare si një e tërë, e përfaqësuar në formën e OKB-së dhe popujt që duan pavarësinë, nga ana tjetër. Ky gabim do të kishte pasoja të rënda. Popujt kolonialë nuk ishin plotësisht të gatshëm, në kuptimin e të pasurit të strukturave të duhura të shoqërisë, apo sistemin për të vazhduar si popuj të pavarur. Strukturat e tyre anase ishin shkatërruar nga kolonizatorët në mënyrë që të sundonin kolonitë efektivisht, ose siç e përshkroi Mohammed Bedjaoui: “Ai [kolonializmi] nënkuptonte shkatërrimin apo shtrembërimin e strukturave të caktuara vendore dhe krijimin e të tjerave që ishin shprehje e faktit të varësisë”¹⁰³.

Natyrisht, nuk u bënë përpjekje për t’irivendosur këto struktura para ose pas pavarësisë. Megjithatë, ky ishte i vetmi pozicion i përshtatshëm që duhej marrë, duke parë sa ishte shpallur në Deklaratën mbi Popujt Kolonialë: “Pamjaftueshmëria e përgatitjes politike, ekonomike, shoqërore apo kulturore nuk duhet të shërbejë si pretekst për ta vonuar pavarësinë”¹⁰⁴, përndryshe pikërisht, kjo do të ndodhte, pavarësia nuk do të jepej si një pretekst nga fuqitë koloniale.

Një tjetër problem serioz ka të bëjë me parimin e *uti possidetis*, i cili në mungesë të një marrëveshjeje, thjesht i “ngrin” kufijtë kolonialë në kohën e pavarësisë. Në radhë të parë, ky parim ishte i përshtatshëm për fuqitë kolonializuese për t’i pastruar emrat e tyre nga turpi moral që shkaktoi kolonializimi dhe për ta dhënë shpejt pavarësinë, pa pasur nevojë t’i zgjidhin problemet e konflikteve territoriale me origjinë nga diversiteti i kulturës dhe i përkatësisë etnike në ato koloni, që kolonizatorët i kishin injoruar më parë dhe që nuk kishin shfaqur asnjë interes për to. Së dyti, nga bashkësia ndërkombëtare në tërësi , besohej me të vërtetë se, duke përdorur parimin e *uti possidetis*, do të parandaloheshin konfliktet dhe destabilitet që do ta kompromentonin jetën e shteteve “të reja” . Megjithatë ky ishte një nga faktorët kryesorë të paqëndrueshmërisë politike dhe konflikteve të armatosura për të gjitha ditët në vijim, madje deri në ditët e sotme. Për shumicën e ish kolonive në Afrikë dhe Azi, ekuilibri politik në fakt është sinonim i diktaturave, përkundrajt paqëndrueshmërisë së një grushti shteti, ushtarak ose jo, njëri pas tjetrit në periudha të shkurtra kohore. Faktori tjetër që çon peshë në paqëndrueshmërinë politike dhe sjell luftëra të përgjakshme është fakti që pushteti iu dha elitave të trajnuara koloniale, për t’i qeverisur shtetet e reja të pavarura. Ish fuqitë koloniale, duke pasur

¹⁰³Bedjaoui. M. (1979). *Towards a New International Economic Order*, UNESCO Holmes and Meier Publishers: London, Paris, pp.82.

¹⁰⁴Neni 3 i (Rezolutës 1514 (XV)) së Asamblesë së Përgjithshme.

marrëdhënie miqësore me grupe të caktuara në këto koloni, natyrshëm do të parapëlqenin t'i shikonin këto grupe të sundonin në mënyrë që ata të mund të vazhdonin të kujdeseshin për interesat e veta. Në të njëjtën kohë, këto grupe do të konsideroheshin, nga grupe të tjera, si simbole të padrejtësisë dhe do të urreheshin për këtë gjë. Kjo do të nxiste rivalitetin për pushtet, me një urrejtje aq të madhe sa do të çonte në konflikte afatgjata dhe të përgjakshme. Në Ruandë, për shembull, rishfaqja e dhunës etnike dhe e konflikteve gjatë dhjetëvjeçarëve që pasuan kolonizimin, çoi në një gjenocid të tmerrshëm. Klasifikimi kolonial racist i popujve dhe dhënia e privilegjeve një grupi të caktuar, në këtë rast Tutsis-ve, të cilët shiheshin si më inteligjentë dhe eprorë, dhe në të njëjtën kohë duke ua mohuar grupeve të tjera, kryesisht Hutu-ve, të cilët ishin klasifikuar si një popull më i ulët (inferior) me të drejta të kufizuara, krijuan shkaqet për konfliktet e shëmtuara etnike.¹⁰⁵

Një praktikë tjetër shkatërruese që përdoret sot në vendet në zhvillim dhe që vijon të jetë pengesë e madhe për arritjen e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është përdorimi i ligjeve të emergjencës. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme është shumë “popullore” në mesin regjimeve që e përdorin atë për ta shtypur popullin e vet dhe ia mohojnë atij të drejtat civile dhe politike në emër të ligjit dhe rendit. Kjo praktikë është sipas Rajagopal-it dhe të tjerëve, një trashëgimi e mënyrës se si britanikët i trajtuan luftërat antikoloniale dhe betejat në vitet 1940 dhe 1950¹⁰⁶. Faktori i parë dhe që ndikoi dukshëm në vënien në zbatim të emergjencave, ishte nevoja e Perandorisë Britanike të merrej me rezistencën masive kundër kolonializmit. Faktori i dytë është frika e tyre ndaj “masave të egra”. Mënyrat e të menduarit racist e kolonial përcaktuan nacionalizmin perëndimor si “një koncept racional dhe universal të lirisë politike”¹⁰⁷, ndërsa nacionalizmin lindor si irracional, të egër e primitiv, të drejtuar nga “misteret e kohërave të lashta” dhe kështu me radhë. Kjo nuk është gjetur vetëm në mënyrën e të menduarit kolonial britanik, por edhe në shkencat sociale anglo-amerikane, shkruan Rajagopal-i. Në çdo rast, kjo praktikë, pra përdorimi i gjendjes së jashtëzakonshme, iu kalua liderëve pas pavarësisë¹⁰⁸.

¹⁰⁵Pamphile Sebahara, “*Krijimi i ndarjes etnike në Ruanda*”, UN-NGLS (Jo- Shërbimi Ndërlidhëse Qeveritare OKB) në <http://www.unngls.org/documents/publications.en/voices.africa /number 8/7 sebahara.htm>.

¹⁰⁶ Rajagopal, 2003, fq. 176-180.

¹⁰⁷Hans.K. (1994). *Ideja e nacionalizmit, citon në Furedi Frank, Luftat Koloniale dhe Politika nacionalizmit e Botës së Tretë*, fq. 117.

¹⁰⁸ Rajagopal, 2003, fq. 176-180.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, më shkatërrimtarja prej trashëgimive koloniale është mendësia që vendet e Botës së Tretë janë në gjendje varësie për shkak të rendit ekonomik ndërkombëtar. Ka dy teori për ta shpjeguar situatën në vendet e Botës së Tretë sot. E para është teoria e modernizimit. Sipas teoricienëve të modernizimit, modernizimi dhe zhvillimi përbëjnë një proces të pashmangshëm zhvillimor të rritjes së dallimeve shoqërore, që do të rezultojë në strukturat dhe institucionet ekonomike, politike dhe sociale të ngjashme me ato në Perëndim. Në këtë mënyrë, një sistem i lirë i tregut dhe institucionet liberale demokratike politike do ta ndjekë sundimin e ligjit¹⁰⁹.

Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT) përfaqëson mishërimin e modernizimit, duke jetësuar një sistem tregtar ndërkombëtar liberal. Kjo teori është kritikuar shpesh nga mbrojtësit e Botës së Tretë, duke qenë se shpreh idenë e epërsisë perëndimore dhe përfaqëson atë se çfarë duhet të përpiqet të arrijë pjesa tjetër e botës, që të bëhet aq e zhvilluar sa Perëndimi, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara prej tij. Për më tepër, sistemi tregtar liberal i kodifikuar në GATT, u bazua në barazinë midis partnerëve tregtarë, kur në të vërtetë ishte një histori tjetër. Vendet Botës së Tretë ishin në disavantazh nga masat dhe trysnia e jashtme, që në fakt, do të thoshte se nuk kishte barazi në skenën ekonomike ndërkombëtare¹¹⁰.

Teoria tjetër, që avokatët e Botës së Tretë zakonisht zgjedhin, është teoria e varësisë. Në dallim nga teoricienët e modernizimit, teoricienët e varësisë kanë shpjegime të tjera për prapambetjen. Ata ua atribuojnë prapambetjen faktorëve historikë dhe politikë të kolonializmit, imperializmit dhe neokolonializmit ku varësia, plaçkitja e burimeve dhe krijimi i zonave të ndikimit në formën e sistemit të çrregullimit “të institucionalizuar”, në marrëdhëniet ndërkombëtar janë te pranishme. Gjatë kohës së kolonializmit, kolonializatorët i shfrytëzuan burimet dhe fuqinë punëtore të vendeve të kolonizuara. Prodhimet nga zonat e kolonizuara ndaloheshin të konkurronin me produktet e prodhuara në vendet e kolonializatorëve. Strukturat koloniale përfshinin licencimin përjashtues (ekskluziv) dhe të drejtat tregtare, si dhe regjimet juridike prej kombeve kolonializuese. Në të njëjtën kohë, vendet e kolonializatorëve ishin udhëheqës të revolucionit industrial dhe duke qenë se

¹⁰⁹Udombana, N. (2000), *Toward the African Court on Human and Peoples Rights, Better late than never* pp. 759.

¹¹⁰ Rajagopal, 2003, fq. 84.

ishin fuqitë e para botërore, e natyrisht ata, për qëllimet e veta, mund t'i kontrollonin kushtet e jashtme të zhvillimit, në dobi të tyre dhe në dëm të të kolonializuarve. Për më tepër, shfrytëzimi i tyre kolonial u dha atyre përparësi dhe përvetësime edhe më të mëdha. Ky fakt kishte filluar pa pengesa për fuqitë perëndimore që mundësonin zhvillimin e ndarë në dy pjesë: Lindje-Perëndim dhe Veri-Jug. Për t'i bërë gjërat edhe më keq, rregullat dhe kushtet e tregtisë së lirë rënduan mbi vendet në zhvillim në një fazë të hershme, duke i shpërfillur plotësisht kushtet vendase (indigjene), gjë që rezultoi në strukturat bujqësore me një kulturë dhe çrregullime të tjera, si pasojat fatale të cilat ne jemi dëshmitarë ende edhe sot¹¹¹.

Avokatët e Botës së Tretë dhe kushdo që ka njohuri mbi kushtet e vendeve të Botës së Tretë, do të thonë se kjo pabarazi ekziston ende edhe sot. Shembulli tipik janë politikat e tregtisë së Bashkimit Evropian. Produktet e BE-së përfitohen nëpërmjet masave të ndryshme. Mbi produktet e shteteve në zhvillim vendosen tarifa. Për shembull, këto vende mund t'i eksportojnë prodhimet e para, por sapo një produkt rafinohet, madje edhe nëse është diçka e rëndomtë, si p. sh., pjekja e kokrrave të kafesë, atëherë vendosen tarifa të rënda. Një tjetër shembull shkatërrues, i shkaktuar nga Perëndimi, janë sasi të shumë të mëdha të ushqimit, si drithëra, të cilat janë dhënë në Etiopi. Kjo e ashtuquajtur "ndihmë lehtësimi" ka vetëm efekte "damping-u" tek çmimet, të cilat kanë sjellë rezultate katastrofike për fermerët e vendit¹¹². Me pak fjalë, ne jemi dëshmitarë që në skenën ndërkombëtare kushtet nuk mund të kundërshtohen.

3. 2. Popujt e territoreve të pushtuara dhe të zëna me forcë.

Nga vitet '50 e më vonë, shtetet që ishin në zhvillim dhe shtetet socialiste, filluan ta shihnin parimin e vetëvendosjes së popujve një bazë të fortë, mbi të cilën mund t'i zhduknin perandoritë koloniale. Mund të themi që për hir të veprimeve të tyre pati një sërë zhvillimesh në arenën ndërkombëtare mbi vetëvendosjen e popujve kolonialë, që sollën një thyerje në një version të moderuar të parimit, siç ishte vendosur nga Karta e Kombeve të Bashkuara. Filluan të merreshin në konsideratë edhe situatat e atyre popujve të pushtuar me forcë, siç qe rasti i shqyrtuar i territoreve të zëna nga Izraeli, në vitin 1967¹¹³. Kjo pati një rëndësi thelbësore, sepse pikërisht

¹¹¹Udombana, N. (2000), *Toward the African Court on Human and Peoples Rights, Better late than never*, pp.759-760.

¹¹²Shih dokumentarin, "Jordan, maten, makten, folket", Dokument Utifrån, e 11 dhjetor 2003 për SVT.

¹¹³ Rezoluta 2625 (XXV) e Asamblesë së Përgjithshme.

mbas Luftës së 6 Ditëve dhe pushtimit të territoreve arabe nga Izraeli, ndodhi që pjesa më e madhe e Shteteve të Botës së Tretë dhe bashkë me to edhe shtetet socialiste, filluan të vepronin për të zhvilluar një sistem dispozitash ndërkombëtare, në lidhje me të drejtën e popujve të pushtuar nga ushtria e një Fuqie të huaj, për të zbatuar vetëvendosjen¹¹⁴.

Në një situatë të ngjashme mund t'ireferohemi rastit kur një shtet merrte me forcë një territor, por mbështetej nga një qeveri vendore, e cila ndoshta kishte “provokuar” një kërkesë ndërhyrjeje. I referohem praktikës së “ndihmës vëllazërore” që ndiqej nga shtetet socialiste, si (prania ruse në Afganistan, prania vietnameze në Kamboxhia e shumë shembuj të tjerë)¹¹⁵.

Ndër shumë rezoluta që Asambleja e Përgjithshme i kushtoi kësaj pjese, mund të kujtojmë ato në lidhje me pushtimin rus të Afganistanit¹¹⁶, rezolutën e pushtimit të Kamboxhias nga Vietnami, në 1979-1990¹¹⁷, si edhe rezolutën e 2.11.1883 kundër ndërhyrjes së SHBA-së në Grenada, kërkesa për t'u lejuar këtyre popujve të drejtën për ta zgjedhur qeverinë e vet, në mënyrë demokratike. Këtu bën pjesë edhe situata e Irakut, mbas krijimit të një qeverie të përkohshme në 2004, dhe të paktën deri në zgjedhjet e përgjithshme të janarit 2005, duke qenë një qeveri e kontrolluar nga fuqitë pushtuese¹¹⁸.

Gjithsesi, parimi i vetëvendosjes nuk mund të zbatohet nëse pushtimi ka ndodhur mbas Luftës së Dytë Botërore, ose të paktën, mbas epokës në të cilën praktika filloi ta konfirmojë të drejtën e vetëvendosjes. Për shembull, një e drejtë e tillë nuk mund t'i njihej as Kroacisë dhe Sllovenisë, duke qenë se bënë pjesë në ish-Republikën Jugosllave prej shumë kohe.

3.3. E drejta e vetëvendosjes së popujve nën regjime raciste.

Kuptimi i tretë, në të cilin shfaqet parimi i vetëvendosjes së jashtme, përputhet me atë të popujve që diskriminohen nga një pakicë për arsye raciale. I referohem në veçanti situatës së Rhodesisë së Jugut dhe Afrikës së Jugut në të cilën praktikohesh “aparteid-i”, që mbështetej mbi diskriminimin dhe ndarjen e popullit dhe

¹¹⁴ Cassese A. (vep. e cit), pg. 322.

¹¹⁵ Conforti. B. (2003), *Scritti di diritto internazionale II*, Napoli, pg. 230-231 .

¹¹⁶ Rezoluta . 30-10-1984 n. 39/5 Asamblesë së Përgjithshme.

¹¹⁷ Rezoluta . 8-6-2004 n. 1546 e Asamblesë së Përgjithshme.

¹¹⁸ Conforti. B dhe Leanza.U. (2002). U *Da diritto per gli Stati a diritto per gli individui* ,Torino, pg. 90.

individëve në bazë të etnisë, duke garantuar mbijetesën politike dhe zotërimin e subjekteve me origjinë evropiane, që sot konsiderohet krim kundër njerëzimit¹¹⁹.

Sipas shumë autorëve, kjo situatë e fundit sillte në një vetëvendosje të jashtme vetëm për shkak të analogjisë, në çastin që karakteristikat që e dallojnë të bëjnë të mendosh më shumë për një situatë të vetëvendosjes së brendshme. Shohim në fakt, se për sa i përket situatës së popujve në regjimet që praktikonin veçimin (“aparteid-n”), duhet thënë se kjo situatë bën pjesë në të ashtuquajturin “dimension i brendshëm i vetëvendosjes”, meqë del në pah mënyra sesi një shtet është i organizuar së brendshmi. Studimi i fenomenit të “apartheid-it” në pjesën e kushtuar proceseve klasike të vetëvendosjes përligjet në dritën e rrethanave, që siç rezulton nga shumë akte ndërkombëtare të marra në sferën e Kombeve të Bashkuara, persa i përket fenomenit, është asimiluar si atij kolonial, meqë pjesa më e madhe e popullit nuk lejohet të marrë pjesë në jetën politike të vendit të vet, rezulton e qeverisur nga një regjim i huaj¹²⁰.

E drejta e vetëvendosjes mund të çojë në vetëvendosje, kur një grupi i është mohuar në mënyrë të rreptë pjesëmarrja në qeveri dhe mundësia për ta ndjekur zhvillimin e vet politik, ekonomik, shoqëror dhe kulturor¹²¹. Praktikrat e racizmit duhej të zbatoheshin në mënyrë sistematike duke i mohuar një pjese të popullsisë, në pakicë apo shumicë qoftë, të shprehej dhe të ndihej e përfaqësuar. Për shembull, në rastin e Afrikës së Jugut është parë se këto praktika diskriminuese konkretizoheshin në kufizimin ose ndalimin e ndërhyrjes në disa shërbime për qytetarët me ngjyrë, në përjashtimin e së drejtës elektorale aktive apo pasive, në ndërtimin e një muri të vërtetë që ndante çdo rrugë, vend publik apo vend pune. Në këtë situatë del e drejta e popullit për të zbatuar vetëvendosjen e jashtme, meqë i mohohet mundësia për të pasur vetëvendosjen e tyre të brendshme. Kjo është edhe në ditët e sotme, teoria e të drejtës ndërkombëtare, që kufizonë parimin e vetëvendosjes në tri situatat klasike të sipërpërmendura.

¹¹⁹ Conforti. B. (1996). *Diritto internazionale*, Napoli, pg. 18.

¹²⁰ Leanza. U. (2002). *Da diritto per gli stati a diritto per gli individui*, Torino, pg. 90-91.

¹²¹ Council P.C. 1996-1497, dated the 30th day of September, 1996 Indexed as: Reference re Secession of Quebec.

3.4. Instrumentet ndërkombëtare dhe parimi i vetëvendosjes në përmasën e saj të jashtme.

Parimi i vetëvendosjes së popujve në përmasën e tij të jashtme, rezulton i pohuar në shumë dokumente zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe jo vetëm. Asambleja e Përgjithshme në fakt, ishte e vemendshme për të kontrolluar, që normat të zbatoheshin në mënyrë konstante, sepse situatat koloniale dhe ato të zotërimit të huaj ose të zëna me anë të forcës, nuk kishin mbaruar ende. Marrim në veçanti shembullin e fjalëve të shprehura nga Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën nr.59 e 03.03.2005¹²², që ripohon se një nga kushtet thelbësore për respektimin e të drejtave të njeriut është e parashtruar në realizimin universal të së drejtës së vetëvendosjes së popujve. Në veçanti, interesante në këtë vështrim ishte dhe Deklarata e Millenaire, në rezolutën 55-2 të 13 shtatorit 2000¹²³, në të cilën rikonfirmohet vetëvendosja e popujve në tri kuptimet e sipërpërmendura dhe shumë deklarime ndërkombëtare, ndër të cilat përmenden: dokumenti përfundimtar i “Sommet mondial” i vitit 2005¹²⁴, për marrjen e vendime në fushën e zhvillimit të sigurisë, të të drejtave të njeriut dhe reformën e Kombeve të Bashkuara, shumë rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme¹²⁵ dhe Këshillit të Sigurimit¹²⁶, si dhe ndërhyrjet e paraqitura në Këshillin Social dhe Ekonomik dhe në Komisionin e të Drejtave të Njeriut.

4. Parimi i vetëvendosjes së popujve në përmasën e saj të brendshme

4.1. Analiza historike e procesit që solli në lindjen dhe afirmimin e parimit të vetëvendosjes në përmasën e saj të brendshme.

Përmbajtja e parimit nisi si një proces natyral ndryshimi të domethënies së tij, në çastin kur bashkë me situatat koloniale, bien ne sy dukuri të tjera të padrejtësisë kundrejt popujve prej qeverive shtypëse, të cilat u shfaqën në skenën ndërkombëtare. Duhet dalluar që, nëse në Deklaratën “koloniale” të 1960, përmbajtja e së drejtës mund të ishte kufizuar në arritjen e pavarësisë nga ana e popujve kolonialë, në Paktin e Kombeve të Bashkuara të vitit 1966, kuptimi i saj nisi të rritet dhe ta rishikojë

¹²² Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën nr.59 e 03.03.2005.

¹²³ Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën nr. 55-2 të 13 shtatorit 2000.

¹²⁴ <http://www.un.org/french/ga/document/overview2005summit>.

¹²⁵ Asambleja e Përgjithshme në Rezolutat nr. 59/178 del 3-3-2005, 59/1180 del 3-3-2005, 60/14 dell “8- 12-2005.

¹²⁶ Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën nr. 1783.

mënyrën e të paraqiturit të një shteti apo qeverie përpara shtetasve të vet. Kuptohet edhe që krahas një përmase të jashtme dhe të pavarur të parimit, është i pranishëm edhe karakteri i brendshëm që në rastin e shteteve shumëkombëshe, u dikton fuqive ta respektojnë vullnetin e të gjithë popujve që janë të pranishëm në territorin e shtetit, në zgjedhjen e institucioneve politike dhe formave organizative, që nxjerrin në pah individualitetin e tyre pa kushte, si në rastin kur sjellin ndryshime në organizimin e brendshëm, por edhe në anën e jashtme ndërkombëtare¹²⁷.

Një dokument tjetër, që e zgjeron përmbajtjen e parimit të vetëvendosjes së popujve, është Deklarata mbi marrëdhëniet miqësore¹²⁸, në të cilën shumë elemente konfirmojnë universalitetin e dispozitave të Kartës së OKB-së. Nga kjo rrjedh një përdorim më korrekt i parimit të vetëvendosjes së popujve, që e tejkalon ankthin e pavarësisë dhe të profilit të jashtëm të së drejtës, dhe u drejtohet për t'u dhënë kënaqësinë atyre popujve, që kërkojnë një qeveri më demokratike dhe përfaqësuese të aspiratave të tyre¹²⁹.

Nuk ka asnjë dyshim rreth pranimit të parimit të vetëvendosjes së popujve nga ana e Aktit përfundimtar të Konferencës së Helsinkit, të vitit 1975, dhe nga deklarata e Algjerit, që dëshmojnë se parimi u drejtohet të gjithë popujve, metropolitanë apo kolonialë. Kjo përmbajtje e brendshme e vetëvendosjes gjeti vend edhe në rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme si edhe në deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi drejtën e popujve anas (indigjenë). Është e nevojshme që të shikohen edhe praktikrat e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, për të kuptuar sesi verifikimi i zbatimit të nenit 1 të Konventës, ka të bëjë jo vetëm me aspektet e jashtme të parimit, por edhe me sjelljen e çdo shteti përballë popullit që qeveris, në veçanti, mbi pjesëmarrjen efektive në jetën politike dhe institucionale të vendit.

¹²⁷Rosa. R. (2006). *Evoluzione e prospettive della protezione delle minoranze nel diritto internazionale e nel diritto europeo*, Milano, pg, 321.

¹²⁸ Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën nr. 2625 del 24 tetor 1970.

¹²⁹Cassese. A. (1995). "The main thrust of the section on the Declaration on Friendly Relations devoted to self-determination is the right of external self-determination" in *Self-determination of Peoples - A legal Reappraisal*, pg. 322.

4.2. Kritikat e përkufizimit të vetëvendosjes në përmasën e saj të brendshme.

Duhet shënuar se përkufizimi i parimit të vetëvendosjes në kuptimin e saj të brendshëm është vlerësuar se ka shumë aspekte të pasqaruara mirë nga ndërkombëtare dhe që bien në kundërshtim me shumë opinione rreth përmbajtjes që i duhet dhënë konceptit. Shumë vendime të cilat kanë krijuar jurisprudencën në nivel ndërkombëtar dhe shumica e doktrinës, pranojnë që parimi i vetëvendosjes së popujve të jetë i kufizuar në tri hipotezat klasike të sipërpërmendura. Ndryshe nga aspekti i jashtëm, nuk ka asnjë normë ndërkombëtare që t'i imponojë një qeverie, pa asnjë dyshim, të garantojë respektimin e të drejtave demokratike. Ndër të tjera, varet edhe nga situata konkrete specifike, por edhe nga ajo që populli, pakica apo etnia e marrë në konsideratë kërkon, pasi nuk ekziston një model unik i mëvetësisë, por koncepti në të kundërt shfaqet në kuptime të ndryshme¹³⁰. Nuk mbetet gjë tjetër vetëm të shqyrtohet cilat janë aspektet e ndryshme që dalin në pah në aspektin e brendshëm të parimit të vetëvendosjes dhe të vendoset, sipas praktikës dhe jurisprudencës ndërkombëtare, cilat nga normat konvencionale janë ndërkombëtarisht të pranuar.

4.3. Parimi i vetëvendosjes së brendshme si sinonim i demokracisë.

Forma e parë e vetëvendosjes së brendshme, që do ta analizojmë nisur nga hamendësimet, është që një popull i organizuar në një formë shtetërore, të jetë i lirë ta vendosë formën e vet të qeverisjes, pa lejuar asnjë ndërhyrje të jashtme (ose të brendshme), që mund ta pengojë këtë liri. Por kjo, gjithsesi nuk mjafton. Thuhet një qeveri e cila është në detyrë në një vend të caktuar, duhet t'i sigurojë kushte minimale të demokracisë, por edhe kushte të denja popullit të vet, si dhe lidhjen me ata persona që përfaqëson. Ky aspekt i vetëvendosjes së brendshme, edhe pse nuk është pranuar në mënyrë universale, merret parasysh nga një pjesë e mbështetësve të doktrinës, sipas të cilëve nuk mund të pretendohet që një qeveri të ketë në çdo moment mbështetjen e plotë të shumicës së qytetarëve të vet, por nëse një nga elementet e një shteti është sovraniteti së bashku me popullin dhe territorin, kjo garantohet nga përputhja e qëllimeve të një populli dhe formës së qeverisë që ofrohet. Në fakt, kur qeveritarët nuk merreshin me detyrimet e tyre thelbësore kundrejt popullit, ose një pjese të tij, atëherë ky i fundit kishte të drejtën që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ta tërhiqte mbështetjen që kishte treguar

¹³⁰ Errico, S. (2007). *Popoli e minora ze, La Dichiarazione delle Nazioni Unite sui diritti dei popoli indigeni in Dirilli umani e Dirillo intemazionale*, Vol. In. I, Milano, pg. 170.

kundrejt shtetit dhe sovranitetit të tij¹³¹. Mbetet bindja se çdo formë e qeverisjes që nuk i respekton parimet demokratike, sidomos nëse ndodhet në kushtet e tiranisë apo diktaturës, përveç se bie në kundërshtim me të drejtat e njeriut, bie në kundërshtim edhe me vetëvendosjen e popullit. Në fakt, kur flasim për “demokraci” duam ta kuptojmë atë si një instrument, që i lejon çdo qytetari të marrë pjesë në zgjedhjen e qeverisë. Rreth marrëveshjeve ndërkombëtare, praktika e Kombeve të Bashkuara tregon që kohët e fundit e ka pranuar plotësisht këtë referim, pasi duhet thënë që termi “demokraci” nuk gjendet në asnjë praktikë, veçanërisht të OKB-së, në temën e vetëvendosjes. U përdor për herë të parë në vitet 1992-1993, në lidhje me Amerikën Jugore dhe në veçanti, në lidhje me çështjen e Haitit¹³². Kohët e fundit, gjithsesi, lidhja mes vetëvendosjes dhe demokracisë, u bë shumë më e pranishme dhe për të konfirmuar këtë i referohemi rezolutës 60, të 24 tetorit të 2005, në të cilën pohohet se “...demokracia ka karakter universal, që vjen nga vullneti i popujve për ta shprehur lirisht sistemin e vet ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor. Nuk ka një model unik të demokracisë dhe demokracia nuk është privilegj i një shteti apo një tjetri dhe në riafirmimin e saj duhen respektuar gjithmonë parimet e sovranitetit territorial dhe vetëvendosjes së popujve...”.

4.4. Mundësi për ta konfiguruar parimin e vetëvendosjes së brendshme si një ndalim të ndërhyrjeve nga jashtë.

Një aspekt tjetër i parimit të vetëvendosjes në kuptimin e saj të brendshëm ka të bëjë me të drejtën e popujve, që të shprehen lirisht për mënyrën sesi duan të qeverisen dhe të mos kenë ndërhyrje nga jashtë. Sipas një pjese të doktrinës, vetëvendosja e brendshme ngjan me atë të jashtme, ndërshtetërore dhe duhet kuptuar si një e drejtë për popujt në shtete të pavarura për t’i konfirmuar sistemin dhe zgjedhjet e veta politike, ekonomike dhe shoqërore, duke u mbrojtur nga çdo ndërhyrje e jashtme¹³³.

Kjo, në veçanti, nënkupton që çdo formë presioni i jashtëm që synon për të sjellë një formë të veçantë qeverie ose për ta mbështetur mbajtjen e qeverisë aktuale, duhet të konsiderohet një ndërhyrje ndërkombëtare e ndaluar. E gjithë kjo mund të

¹³¹ Mekinda Beng A (2004), Pg. 51 3.

¹³²Guari. G. (2006). *Autodeterminazione dei popoli e successione di norme contrattuali alle radici di un conflitto. II ruolo del diritto internazionale generale nella Carta Araba*Gennaio-Aprile, Pg. 37.

¹³³Palmisano. G. (1997). *Nozioni Unite e autodeterminazione interna. Il principio alla luce degli strumenti rilevanti dell'ONU*, Milano, pg. 18.

lejohej vetëm nëse vjen nga një bashkësia ndërkombëtare, me anë të një traktati të veçantë, sepse sjell kufizim të parimit të vetëvendosjes. Kujtojmë se në këtë kuptim, e famshmeja “*Doktrina Brezhnjev*” ishte për ta kufizuar ekzekutimin e së drejtës për vetëvendosje të vendeve që bënin pjesë në Paktin e Varshavës dhe që mbronin të drejtën e çdo shteti për ta zgjedhur lirisht formën e qeverisjes, por kjo e drejtë nuk ishte e vlefshme për një shtet, i cili ishte anëtar i Bashkimit Sovjetik dhe që kishte pranuar një qeveri komuniste, pavarësisht se kishte tentuar ta ndryshonte këtë sistem qeverisjeje e për të dalë nga “familja” e vendeve socialiste. Kjo doktrinë ekuilibron në një përmasë të re sovranitetin e shteteve, që mund të ishin vënë përballë masave nga shtetet e tjera socialiste, të cilat ishin të autorizuara për ta penguar, qoftë edhe me anë të forcës, çdolloj ndryshimi të formës qeverisëse komuniste¹³⁴.

4.5. Konfigurimi i parimit të vetëvendosjes së brendshme në kuadrin e shteteve shumëkombëshe.

Fenomeni që do të analizoj tani është me i ndërlikuari nga të tjerët, sepse ka ende mangësi në përkufizimin e temës, por edhe sepse, ndoshta është ai më i zhvilluari në kohët e fundit. Në veçanti, ka të bëjë me situatat në të cilën brenda një shteti ka më shumë se një popull, si në rastin e shumë nacionaliteteve që përbëjnë një shtet multinacional të tipit federal, ashtu edhe kur kemi të bëjmë me popuj apo grupe pakicash.

Në këtë rast nocioni i vetëvendosjes së brendshme njih të drejtën e çdo populli ose grupi të tillë për ta njohur dhe respektuar, brenda shtetit në të cilin jetojnë, identitetin e tyre, por edhe aspiratat e vetëqeverisjes¹³⁵. Kjo është shumë e rëndësishme, nëse mendojmë për interesat e popujve dhe grupeve të tilla, nga një anë, dhe shtetit nga ana tjetër, të interesuar për t'i ruajtur unitetin dhe integritetin territorial. Nuk duhen harruar edhe ato vlera të bashkësisë ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe sigurimit ndërkombëtar, për ndalimin e konflikteve ndëretnike, që shumë shpesh kanë përfunduar me tragjedi.

Nëse flasim për pakicat shumë të kërkuara brenda një shteti homogjen, por edhe nëse flasim për etni të ndryshme brenda një shteti shumëkombësh, detyrimet që u imponohen shteteve në këtë kuptim janë dy llojesh : 1-T'i lejohej bashkësisë respektim i plotë i çdo të drejte dhe lirie thelbësore ,dhe krahas me këto, edhe pjesëmarrja në një

¹³⁴Tomuschat. C. (Edited by) Simma B. (1995). *The Charter of the United Nations, A commentary*, Oxford, pp. 65.

¹³⁵ Palmisano, G. (vep e cit). pg. 17.

regjim përfaqësues në të njëjtën mënyrë me pjesën tjetër të popullsisë, që do të thotë garantimi i të drejtës së pjesëmarrjes demokratike, e shprehur në nenin 1 të Konventës së 1966. 2-T'i sigurohej kësaj bashkësie ruajtja dhe respektimi i traditave, gjuhës, karakteristikave kulturore dhe fetare. Duke i vëzhguar këto dy pika kemi sigurinë se shteti përshtatet me respektimin e parimit të vetëvendosjes së popujve¹³⁶, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe duke iu pëmbajtur “klauzolës së shpëtimit”, të formuluar në Deklaratën e Marrëdhënieve Miqësore¹³⁷, ndërsa në rast të kundërt, “vetëm atëherë kur njeri apo tjetri detyrim hidhet poshtë në dëm të një pakice ose etnie, lind një hipotezë shpëtujeje, e legjitimuar ndërkombëtarisht: “hipotezë në të cilën detyrimet e shteteve të tjera për ta respektuar integritetin territorial do të ishin më të pakta”¹³⁸.

Kjo do të shpjegonte për shembull, sjelljen e bashkësisë ndërkombëtare në rastin e shpëtujes së Bangladeshit, kundër të cilit kishte pasur akte të shkeljes së të drejtave të njeriut¹³⁹. Është e qartë se mëtimi për ta ndaluar të drejtën e pakicës për të patur shtetin e vet të pavarur në disa çështje të kufizuara, ishte fryt i vullnetit politik të bashkësisë ndërkombëtare e cila ka dashur ta kufizojë parimin. Mjafton të mendojmë që për hir të parimit të vetëvendosjes së jashtme, u krijuan 80 shtete të reja dhe në shumë raste, popujt e territoreve zgjodhën lirisht, me anë të votimit ose referendumit, të bëheshin pjesë e një shteti sovran që ekzistonte. Duke filluar nga vitet '50, u braktis dhe u la në hije për arsye politike, një pjesë e potencialitetit të parimit të vetëvendosjes së popujve dhe në veçanti, ajo e legjitimitetit të demokracisë së qeverisë dhe lirisë së pakicës. Në këtë mënyrë, një pjesë thelbësore e parimit u sakrifikua në “altarin e sovranitetit të shtetit”¹⁴⁰. Kjo prirje që ishte ende për t'i kufizuar mundësitë e zgjidhjeve, që mund ta çonin përpara të drejtën e vetëvendosjes së popujve në përmasën e saj të brendshme, përligjet, siç e kam përmendur më parë, për arsye politike, që mund t'i përfshijmë në tri argumente të rëndësishme:

1. Shumë shtete shumëkulturore dhe shumë raciale, anëtarë të bashkësisë ndërkombëtare, janë të bashkuara. Nëse kjo është gjithmonë e më shumë e vërtetë për shtetet Perëndimore, mjafton të mendojmë se nga ana tjetër, në të gjithë kontinentin afrikan vetëm katër shtete sovranë (Botsëana, Lesotho,

¹³⁶ Tomuschat C. (Edited by) Simma B. (vep e cit). pg. 65.

¹³⁷ Paragrafi 7 i Deklaratës së Marrëdhënieve Miqësore.

¹³⁸ Ruiz, A.(vep e cit), pg. 6.

¹³⁹ Lattanzi, F. (vep e cit), pg. 7.

¹⁴⁰ Cassese A. (par le soin de) Cot J.P. e Pellet A. (1991), *La Charte des nations Unies, Commentaire article par article*, 2^o edition, Paris, pg. 54.

Somalia dhe Sëaziland), sigurisht jo ndër më të fuqishmit, paraqiten si popuj etnikisht homogjenë. Do të ishte absurde që të presim nga këta “aktorë” ndërkombëtarë miratimin e politikave shkatërruese, ndarëse ose që mund t’ikeqësojnë konfliktet ndëretnike.

2. Një grup i konsiderueshëm i shteteve anëtare në bashkësinë ndërkombëtare është i mbështetur nga qeveritë autoritare. Do të ishte e kotë që të pretendojmë se pikërisht këto shtete dëgjojnë dhe janë të vëmendshme kundrejt aspiratave dhe vullnetit të qytetarëve.
3. Përndarja e fuqisë ekonomike, politike dhe ushtarake në Botë tregon qartë prirjen se që të përqendrohet më shumë në duart e sa me pak shteteve, dhe subjektet e mbetura ndërkombëtare duhet të afrohen dhe të jenë në anën e njërit prej tyre ose të bëhen “taksa” e tyre politike. Nëse është kjo situata dhe nëse shtetet (që janë legjislatorët dhe përgjegjësit e zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare) tentojnë që gjithmonë e më shumë të bëhen heterogjenë, “bashkësia ndërkombëtare pa dyshim do vazhdojë ta hedhë poshtë çdo propozim, që favorizon sektorët e popullsisë që e kërcënojnë integritetin territorial të shtetit, shkëputja do mbetet sigurisht një mallkim”¹⁴¹. Mënyra sesi kuptohet parimi duhet të riorientohet, sepse deri në çastin që e drejta e vetëvendosjes do të vazhdojë të kuptohet (nga pakica) si një e drejtë e një statusi të pavarur, kjo mbetet më shumë si burim konfliktesh, sesa një element thelbësor për t’i zgjidhur kontradiktat. Shtetet do të vazhdojnë në fakt, t’i kundërshtojnë me forcë popujt që kërkojnë të drejtën për vetëvendosje, duke i cilësuar anëtarët e lëvizjes për liri si terroristë që duan të shkatërrojnë unitetin e shtetit. Nga ana tjetër, ata që e mbështesin idenë se kanë një të drejtë të tillë për vetëvendosje, do të mbajnë një qëndrim edhe më të rreptë, të bindur që kanë të drejtën për pavarësi absolute dhe do të jenë të gatshëm të pranojnë çdo marrëveshje që nuk e hedh poshtë hipotezën e të pasurit sovranitet të plotë për popullin e vet¹⁴². Duket qartë se popujve në luftë është e nevojshme t’u ofrohen një sërë mundësish më largvajtëse dhe që parakuptojnë zgjidhje të ndryshme që mund të kalojnë nga mëvetësia (autonomia) në vetëqeverisje, deri në pjesëmarrjen në procesin vendimtar kombëtar.

¹⁴¹ Cassese, A. (vep e cit), pg. 349.

¹⁴² Lattanzi, F. (vep e cit). pg. 28.

4.6. Teoria federaliste dhe parimi i vetëvendosjes.

Së fundi, është e nevojshme të shihet tani, sesi është konsideruar nga një pjesë e doktrinës dhe organizatave ndërkombëtare, tema e vetëvendosjes dhe aq më shumë nga shtetet, që u morën me këtë temë dhe cilat janë në këto raste mjetet dhe zgjidhjet më të mira për mënyrat e bashkëjetesës paqësore mes një shteti dhe popullit ose një pjese të tij. Forma kushtetuese, që garanton më së miri ushtrimin e kompetencave të veçanta brenda një shteti sovran, është sigurisht, sipas një doktrine të re dhe për shumë arsye zhvillimi, forma federale e cila duke mbrojtur unitetin më të lartë të një shteti, mundet që t'i largojë rreziqet dhe frikën e një shpërbërjeje territoriale jo të kërkuar dhe shpesh jo të përshtatshme. Edhe pse mund të duket paradoksale, të drejtat e grupeve etnike, fetare, gjuhësore e kulturore mund të mbrohen më mirë në kuadrin e federatave të shumta, dhe jo me anë të krijimit të shumë shteteve të vogla kombëtare, brenda të cilave mund të shfaqeshin shumë probleme të pakicave¹⁴³. Në këtë perspektivë federalizmi, autonomie apo vetëqeverisjeje, transferimet e pushtetit japin zgjidhje konkrete për t'i shmangur lëvizjet ndarëse dhe për ta ruajtur integritetin e një shteti, edhe pse në praninë e shumë komponentëve të larmishëm shoqërorë. Në lidhje me këtë duhet kujtuar se shkëputja nuk është sinonim i demokracisë, në fakt, nuk është e thënë që nëse arrihet shkëputja, shteti i ri i pavarur të jetë më demokratik se ai i mëparshmi¹⁴⁴.

Ata të cilët e kërkojnë të drejtën e shkëputjes dhe ndihmë nga jashtë duhet të kujtojnë frazën e thënë nga një kryetar shteti afrikan, presidenti De Benin, me rastin e çështjes Biafrana: "...*Gomme la quasi totalité des Etats africains, je suis contre la secession. ...parce qu'en Afrique il y a des dizaines de "Biafras" en puissance et que nous ne pouvons admettre un précédent...*" (Ashtu si pothuajse të gjitha shtetet e Afrikës, unë jam kundër shkëputjes... sepse në Afrikë ka me dhjetëra pushtete "Biafras" dhe, sepse ne nuk mund të lejojmë një precedent).

Zgjidhja me anë të federatës është e mbështetur dhe nga një pjesë e doktrinës anglosaksone, ku mund të përmendim David Held-in¹⁴⁵, Thomas Pogge-në dhe në veçanti Iris Marion Young-un, e cila në tekstin e saj të botuar kohët e , mbështet faktin se ashtu si drejtësia ndërkombëtare dhe parimi i vetëvendosjes, do të mbrohej

¹⁴³Po Aty.

¹⁴⁴Pecoraro M. L. (2003). *La protezione interna zionale delle minoranze*. Napoli, pg. 103- 104; Hannum H. (1996). *International Responses to Secessionist Conflicts*, 90 ASIL Proceedings, pp. 316.

¹⁴⁵Held, D. (1995). *Democracy and the Global Order*. Capitoli X e XII.

më mirë me anë të centralizimit të disa fuqive që një shtet normalisht i posedon, në një nivel më të ulët, nga një kontroll vendor dhe rajonal. Një sistem global në të cilin anëtarët, rajonet dhe shtetet janë të lidhur në një sistem federal, fuqia e centralizuar do të ishte e “lehtë”, në kuptimin që kjo do t’i stabilizonte vetëm parimet e përgjithshme që duheshin vëzhguar, ndërsa interpretimi dhe zbatimi i parimeve do t’i mbeteshin juridiksionit rajonal. Administrata publike, sipas kësaj teorie të formuluar së fundmi, do të ishte e përqendruar si në qendër, ashtu dhe në rrethinat, në mënyrë të tillë që çdo territor të kishte fuqinë për të vendosur, si të përputheshin me sistemin e përgjithshëm të parimeve bazë¹⁴⁶.

Një nga arsyet për të këmbëngulur mbi lokalizimin dhe decentralizimin e fuqisë është që transferimi i fuqisë dhe autoritetit në një nivel vendor, lejon që ta promovojë më së miri dhe ta garantojë demokracinë e sistemit, edhe pse regjimi federal duhet gjithmonë të ruajë një aparat global të *decision-making*. Juristi amerikan, James Tully, duke rënë dakord me frymën pozitive dhe nevojën e një sistemi politik dhe shoqëror të ndërtuar nga nivele të pjesëmarrjes afër bashkësive të ndryshme, në veprën e tij “Strange Multiplicity”¹⁴⁷, mbështet faktin që palët e përfshira në çështje të kësaj natyre, duhet pikë së pari, të njihen me njëra-tjetrën si entitete politike të ndryshme, por komunikuese e secila me interesat, traditat e ,zakonet e veta. Sistemi i qeverisë federale ruan karakteristika klasike, si ajo e një qeverie dhe kontrolli i disa aspekteve të skenës politike në një nivel më qendror lë gjithsesi, disa detyra të rëndësishme në duart e grupeve bazë. Mundësitë për një lidhje mes federatës dhe grupeve nuk duhet të jenë domosdoshmërisht uniforme, në kuptimin që marrëveshjet dhe rregullat mund të zbatohen në kontekste, mënyra dhe gradë të ndryshme, ose edhe të zbatohen vetëm për disa. Në këtë aspekt, një pjesë e doktrinës e shikon federalizmin si formën më të zhvilluar të vetëvendosjes dhe garantimin e respektimit të së drejtës të çdokujt.

¹⁴⁶ Young Y. M. (2007). *Global challenges. War, Self-Determination*. Cambridge, pp. 34.

¹⁴⁷ Tully. J. (1995). *Strange Multiplicity: Constitutionalism in an Age of Diversity*, Cambridge, pp.22.

KREU V: VETËVENDOSJA DHE PËRDORIMI I FORCËS

1. Shkelja e një norme të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, shkelja e parimit të vetëvendosjes (*jus cogens*).

Menjëherë, pasi kemi njohur karakterin e detyrueshëm të normës që sanksionon parimin e vetëvendosjes, në planin logjik imponohet nevoja për t'i përballuar problematikat e një shkeljeje të mundshme të saj dhe përgjegjësinë e vazhdueshme ndërkombëtare të shtetit që është autor i aktit të kundërt me parimin e vetëvendosjes. Në përputhje me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, shtetet që përfundojnë traktate në kundërshtim me rregullat e detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, vihen përpara përgjegjësisë ndërkombëtare. Referuar neneve 65 e 66 të Konventës, duket sikur vetëm shteti që ka nëshkruar apo ratifikuar një marrëveshje ndërkombëtare, në kundërshtim me të drejtën e detyrueshme, mund ta bëjë të pavlefshëm të njëjtin akt, por në realitet, një zgjidhje e detyruar duket se është vendosur nga karakteri i përgjithshëm i vlerave të mbrojtura nga normat e të së drejtës ndërkombëtare. Të themi se zgjidhja më e mirë për të cilën çdo shtet mund ta deklarojë dhunimin e normës së *jus cogens*¹⁴⁸, duket e pëlqyer në konsideratën e përgjithshme të shpërndarjes së gjithë bashkësisë ndërkombëtare. Së këtejmi, është e mundshme të nxjerrim probleme të tjera rreth mundësisë së secilit shtet, të ndryshëm nga ai i paragjykuar si i jashtëligjshëm, për të reaguar ligjërisht lidhur me ndonjë shkelje të normave të detyrueshme. Nëse hipoteza tipike është ajo që në përputhje me paradigmen e vetëmbrojtjes, njeh ekskluzivisht në krye atë që ankohet për një dëm moral e financiar të drejtpërdrejtë, si efekt i një dhunimi të tillë, titulluar “e drejtë e reagimit”. Ishte Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ajo që e shtriu këtë mundësi edhe tek shtetet e treta. Në këtë optikë të rëndësishme, pranohet për herë të parë ekzistenca e së drejtës ndërkombëtare e detyrimeve të ashtuquajtura *erga omnes*, ose më mirë të detyrave të caktuara të shteteve të veçanta përballë bashkësisë ndërkombëtare, vëzhgimi i së cilës është me pasoja të detyrueshme për të gjithë pjesëtarët e tjerë të saj¹⁴⁹. Ky orientim ndër të tjera, vjen duke i përcaktuar detyrimet e lartpërmendura, (*erga omnes e erga omnes partes*), atëherë kur: a) detyrimi i shkelur është për shkak të një grupi shtetesh që e përfshijnë edhe këtë shtet i cili është vendosur për të mbrojtur interesin kolektiv të grupit, ose b) detyrimi i shkelur është

¹⁴⁸Orakhelashvili, A. (2006). *Peremptory Norms in International Law*. Oxford: Oxford University Press, pp 46.

¹⁴⁹ Po Aty, pp 52-59.

për shkak të bashkësisë ndërkombëtare në tërësi. Në fakt, karakteri i detyrueshëm i normave të lartpërmendura është i atillë, ku detyrimet që rrjedhin prej tyre u takojnë të gjitha shteteve pra, jo në një optikë thjeshtë dypalëshe, por përballë bashkësisë ndërkombëtare në të gjithë tërësinë e saj. Në të vërtetë, këtu bëhet fjalë jo thjeshtë për detyrime që rëndojnë mbi të gjitha shtetet, por për detyrime të vëna në dobi të krejt rrethit të subjekteve ndërkombëtare, gjithsecilit prej atyre që u njihet zotërimi universal i së drejtës për të reaguar ndaj së paligjshmes, edhe pse mund të mos ketë pasur prej tyre asnjë paragjykim të drejtpërdrejtë. Për sa i përket zgjedhjes së formave dhe mënyrave të reagimeve të tilla, e drejta ndërkombëtare, me qëllim kryesor shmangien e shpërdorimeve të mundshme, dikton kalimin e administrimit, një vlerësimi kolektiv, duke ia nënshtruar e rezultatet e vlerësimeve të tilla një kontrolli të Këshillit të Kombeve të Bashkuara¹⁵⁰. Nëse kjo zgjidhje duket ende e parashikuar nga “legjitimiteti ndërkombëtar”, në bazë të ankesës në sistemin e Kombeve të Bashkuara, nuk mund ta mohojmë që nga ana e afateve kohore dhe e efektivitetit të së drejtës ndaj së jashtëligjshmes, do të ishte i pëlqyeshëm besimi në një koalicion shtetesh që veprojnë *uti singuli* në mbrojtje të interesave themelore të bashkësisë ndërkombëtare, përballë dukurive të vazhdueshme të paralizës e plogështisë nga ana e organeve të vëna në krye për mbrojtjen e rregullit ndërkombëtar.

Në kontekst të studimit tonë, problemi i përcaktimit të mjeteve të përdorshme për të reaguar ndaj ndonjë shkeljeje të parimit të vetëvendosjes, duket veçanërisht delikat, po t’i referohemi ndalimit të kërcënimit e përdorimit të forcës, të sanksionuar nga Karta e Kombeve të Bashkuara, tashmë e bërë edhe kjo, parim i natyrës së zakonshme, përforcuar nga deklarata të ndryshme të Asamblesë së Përgjithshme. Kryesisht, neni 2¹⁵¹ i Kartës së Kombeve të Bashkuara përcakton: “...anëtarët e organizatës duhet t’i zgjidhin kontradiktat e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore, në mënyrë që paqja dhe siguria ndërkombëtare si dhe drejtësia ,të mos vihen në rrezik...”, dhe gjithashtu, neni 4¹⁵² i detyron anëtarët e organizatës që “në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare, të heqin dorë nga kërcënimi e përdorimi i forcës, qoftë kundër integritetit territorial e pavarësisë politike të cilido shtet, qoftë nga çdolloj mënyre e papërputhshme me qëllimet e Kombeve të Bashkuara”. Në veçanti, profilet e kryqëzuara midis dy parimeve për t’u marrë në konsideratë janë të shumta.

¹⁵⁰Kolb, R. (2001). *Théorie du ius cogens international: essai de relecture du concept*. Paris: Presses Universitaires de France, pp 20.

¹⁵¹Neni 2 i Kartës së Kombeve të Bashkuara.

¹⁵²Po Aty, Neni 4.

Në radhë të parë, bëhet fjalë për vlerësimin e ligjshmërisë së rrugës së përdorimit të forcës nga ana e qeverisë në fuqi nëpërmjet së cilës parimi i vetëvendosjes bëhet i vlefshëm; në radhë të dytë, diktohet një gjykim i ngjashëm, referuar reaksionit të popullit viktimë të dhunimit të së drejtës së vetëvendosjes; në fund, mund të shpjegohet mundësia e përdorimit të forcës e në përgjithësi, masa të tjera trysnie nga ana e një shteti të tretë, në mbështetje, si nga shteti “shtypës”, ashtu edhe nga shteti “i shtypur”. Pra, do të jetë e nevojshme të hetojmë në cilat situata, në optikën e së drejtës ndërkombëtare në fuqi, duhet të mbizotërojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga parimi i vetëvendosjes së popujve dhe në cilat raste të tjera, përkundrazi, janë të dorës së parë të drejtat dhe detyrimet përkatëse për ruajtjen e integritetit territorial e pavarësisë politike të shteteve ekzistuese, mbi bazën e një vlerësimi krahasues mes kërkesave dinamike e nevojave ruajtëse nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Dhe kjo ka si qëllim, të verifikojë deri në ç’pikë mund të shtyhet vlerësimi i parimit të vetëvendosjes për ta shkelur ndalimin në shqyrtim, në dëm të integritetit e të pavarësisë së entiteteve ndërkombëtare.

2. Ndalimi i përdorimit të forcës në konfliktet e brendshme dhe kundër vetëvendosjes së popujve.

E drejta ndërkombëtare përballë një konflikti të përcaktueshëm si i brendshëm, u imponon anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare ndalimin e ndërhyrjes në “punët e brendshme” të shtetit të përfshirë në konflikt, i cili mund të hakmerret me të drejtën ekskluzive të menaxhimit të çështjes së tij të brendshme (e ashtuquajtura *domestic jurisdiction*). Me fjalë të tjera, qeveria në fuqi, në gjendjen e “normalitetit demokratik”, që vlen të thuhet kur ajo është me të vërtetë përfaqësuese e të gjithë popullit, zotëron të drejtën e përdorimit të forcës, kështu që mban fuqinë ekskluzive për t’i ndëshkuar ata që e rrezikojnë rregullin e krijuar në planin e brendshëm. Kjo e drejtë e posaçme nënkupton që veprimtaria e qeverisë për rivendosjen e rregullit mund të ushtrohet lirisht dhe mund të sjellë edhe përdorimin e masave shtrënguese, pa pranuar asnjë ndërhyrje të jashtme e më të vetmin kufi, respektimin e së drejtës ndërkombëtare njerëzore. Në fakt, në këtë hipotezë nuk gjen zbatim dispozita e nenit 2, paragr. 4 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila ndalon përdorimin e forcës, duke iu referuar konflikteve dhe marrëdhënieve ndërshtetërore, por në të kundërt nuk gjen zbatim në konfliktet e brendshme. Megjithatë, në rast se shteti në ushtrimin e fuqive të tij shtypëse, përfshirë ose jo përdorimin e masave shtrënguese (të armatosura ose jo), fshikullon synimin e një populli të ndrydhur për të vetëvendosur, shkon drejt

përgjegjesisë ndërkombëtare, duke nxitur ndërhyrjen e bashkësisë së shteteve, meqenëse, parimi në shqyrtim përbën objekt detyrimi (*erga omnes*) i sanksionuar nga një normë e detyrueshme e së drejtës ndërkombëtare. Në rastin e përdorimit të forcës për të çuar përpara aksione të tilla, pozita e tij, më së shumti, konsiderohet e përkeqësuar, mbasi konkurrenca në mënyrë edhe më depërtuese për të krijuar një situatë tensioni, që kërcënon mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, të cilat janë, siç e dimë, vlerat bazë të bashkëjetesës mes shteteve. Ky konkluzion është pohuar nga rezoluta të shumta të Kombeve të Bashkuara, që në shumë raste e kanë vlerësuar veprimtarinë e qeverive në dëm të parimit të vetëvendosjes, si mirëfilli “akte agresioni”, duke pohuar që jo në të gjitha rastet përdorimi i forcës në brendësi të një strukture sovrane, është një çështje që të çon në sferën e “lëmit të rezervuar” të secilit shtet, e si e tillë, e vënë përsëri në vlerësimin e saj të posaçëm. Në fakt, kur një veprimtari e tillë sjell përdorimin e forcës, edhe pse nuk është e drejtuar kundër një subjekti të pajisur me personalitet juridik ndërkombëtar, vë në lojë vlera e interesa të konsiderueshme për bashkësinë e shteteve, vlerësimi i saj vjen *ipso iure* i përfshirë në sferën e influencës së të drejtës ndërkombëtare. Sidoqoftë, baza juridike e një teze të tillë nuk mund të kërkohet në parimin që ndalon rrugën e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, por pikërisht në dispozitën që u dikton shteteve të përkrahin e nxisin realizimin e vetëvendosjes. Pra, në këtë hipotezë qeveria që e mohon të drejtën e popullit të shtypur për të vetëvendosur, zhvishet nga disa garanci, që normalisht drejtojnë subjektivitetin e enteve sovrane në urdhrin ndërkombëtar. Me fjalë të tjera, dhunimi i parimit të vetëvendosjes nuk sulmon personalitetin juridik të shtetit që e kryen, as nuk ia heq “titullin e legjitimitetit” qeverisë që e përfaqëson në planin politik, por ndikon në vlerësimin e legjitimitetit të sjelljes së të njëjtës (qeveri), duke e zhveshur nga e drejta e përdorimit të forcës kundër pjesëtarëve të popullit të vet. Sidoqoftë, duhet saktësuar që në rastin e një konflikti të armatosur, lindur në gjirin e një shteti, qeveria në luftë kundër një grupi kryengritësish, pa një organizatë të pavarur në planin e marrëdhënieve ndërkombëtare, mundet në mënyrë legjitime të thërrasë ndërhyrjen e shteteve të tretë, në mbështetje të ndërhyrjes së saj shtypëse¹⁵³.

Në të kundërt, kur ndërhyrja e jashtme është në mbështetje të qeverisë që dhunon parimin e vetëvendosjes, ajo nuk mund të konsiderohet e ligjshme, edhe pse e kërkuar nga kjo e fundit, për sa kohë një shtet, që me mbështetje të armatosur

¹⁵³ Ruiz. A. (1988). *Autodeterminazione (diritto dei popoli alla)*, EG, IV, pg.1.

bashkëvepron ose ndihmon regjimin shtypës, bëhet njësoj përgjegjës si i pari, në paligjshmërinë ndërkombëtare, duke penguar realizimin e parimit tonë.

Për sa i përket ndërhyrjes së armatosur të shteteve të treta në konfliktet e brendshme, ka qenë propozuar një tjetër orientim¹⁵⁴, që përjashtonte pranueshmërinë e çdolloj ndërhyrjeje nga ana e shteteve të treta, në një luftë civile, si në ndihmë të qeverisë legjitime, ashtu edhe në ndihmë të lëvizjes kryengritëse, ndërsa teoria klasike prirej të përligjte vetëm mbështetjen e jashtme të qeverisë së zgjedhur. Tejkalimi i të menduarit tradicional ka rezultuar në njohjen e efekteve destabilizuese mbi ekuilibrat ndërkombëtarë të ndërhyrjeve të jashtme të një shteti, pasojë e ndërhyrjes së Gjermanisë naziste e Italisë fashiste në mbështetje të regjimit diktatorial të Francisco Franco-s, kundër republikanëve me aspirata komuniste e socialiste, në Luftën Civile Spanjolle, që shpërtheu më 14 korrik 1936, e cila ka përfaqësuar një etapë të rëndësishme në procesin e ndërkombëtarizimit të konflikteve të brendshme. Gjithashtu, rezoluta e përshtatur në sesionin e Eiesbaden-it, të 6-15 gusht 1975, nga “*Institut de droit International*” mbi parimin e mosndërhyrjes në luftërat civile, dukej se shkonte në të njëjtin drejtim: ripohimin e detyrimit për shtetet e treta në lidhje me këtë tip konflikti, që ta shmangin ndërhyrjen përkrah njërit prej grupeve në dyluftim. Ajo saktëson që një ndërhyrje e tillë ka të bëjë me dërgimin e forcave të armatosura, furnizimin me materiale lufte, ndihma financiare e ekonomike e çfarëdolloj ndihme tjetër që mund të ndikojë në rezultatin e luftës. Kjo adresë është rishikuar pjesërisht me daljen në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, të një lajmi në mbështetje të përdorimit të forcës në përputhje me kreun VII të Kartës edhe në rrethin e luftërave civile, kjo me qëllim qoftë për ta siguruar ndihmën e nevojshme humanitare për popullsinë e përfshirë, qoftë për ta lejuar zbatimin e plotë të vendimeve me karakter ushtarak të ndërmarra nga Këshilli, në bazë të kreut VII, dhe në fund, për ta bërë të mundur dhënien e pafajësisë, përballë bojkotimit nga ana e njërit apo të dyja palëve në konflikt, të detyrave të lëna Forcave të mbrojtjes të OKB-së, në funksion të parandalimit e reduktimit të efekteve të mëtejshme të luftës civile. Marrin rëndësi, në këtë kontekst, të ashtuquajturit misione paqeruajtëse (pikërisht, operacione të mirëmbajtjes së paqes)¹⁵⁵ që, edhe pse nuk gjejnë një pikëmbështetje të qartë në Kartë, janë zhvilluar *de facto* mbi bazën e një interpretimi shtrirës të

¹⁵⁴ Grado. V. (1998). *Guerre civili e terzi Stati*, Padova, pg.76 .

¹⁵⁵ Picone. C. (1996). *Il peacekeeping nel mondo attuale tra militarizzazione e amministrazione fiduciaria*, RDI, pg.5

detyrave të Kombeve të Bashkuara, e mbi natyrën juridike që në teori diskutohet prej kohësh.

Sidoqoftë, për pjesët teorike, përfshirja e tyre normative mund të gjendet lehtësisht në kreun VI, në lidhje me ndërhyrjen e Këshillit, të përfunduar me zgjidhjen paqësore të kundërshtive, ndërsa të tjerët, me hamendësimin se ky krye nuk e parashikon rrugën e forcës së armatosur, as dhe të mirëmbajtjes së paqes, i referohen kreut VII, që parashikon pikërisht përdorimin e forcës së armëve. Në realitet, prurjet më të reja priren në pranueshmërinë e këtyre masave nëpërmjet referimeve në teorinë e fuqive të nënkuptuara, e cila ua lejon organizatave marrjen e aksioneve e mjeteve edhe jashtë parashikimeve të Kartës së San Francisco-s, mjaft të domosdoshme për të ruajtur e rivënë paqen e sigurinë mes shteteve. Po ashtu, është folur, në lidhje me këto operacione, për një “krye VI e gjysmë”, që do të ndërlidhte, pikërisht në mes rrugën midis dy hipotezave të ndërhyrjes, pa u identifikuar me asnjërën prej tyre¹⁵⁶.

Zbatimet e para të këtyre misioneve kanë nisur më 1957, me Forcën e Emergjencës së Kombeve të Bashkuara (Unef), të angazhuar në bisedimet për armëpushim mes Egjiptit e Izraelit, pas përfundimit të luftës për Kanalin e Suezit, e, prapë më 1961, me misionin Onur në Kongo që përfshiu trupat e Kombeve të Bashkuara në konfliktin pas tentimit të ndarjes së provincës rebele të Katanga-s, ku gjeti vdekjen sekretari i përgjithshëm, i atëhershëm, i Kombeve të Bashkuara, Dag Hammarskjöld. Këto zbatime të para kanë shërbyer mbi të gjitha, për ta saktësuar më mirë karakterin e këtyre misioneve, funksionale e në fund për të garantuar paanshmërinë absolute mes palëve ndërluftuese. Në radhë të parë, ato duhet të kryhen nga forca të armatosura të vendeve të papërfshira në konflikt dhe të ndryshëm nga anëtarët e përhershëm të Këshillit për arsye gjeografike apo politike; gjithashtu, trupat e përfshirë duhet të zhvillojnë ekskluzivisht detyra të ndërpozicionimit në gjendje armëpushimi ose të pushim zjarri, ose edhe të vëzhgimit e verifikimit të situatave të tilla. Ata mund të jenë të pajisur vetëm me armatime të lehta dhe t'i përdorin vetëm për vetëmbrojtje, në fund, rreshtimi i tyre i nënshtrohet kushtit vendimtar të përfaqësuar nga leja e përhershme e autoriteteve të shtetit ku vepron misioni. Pikërisht, disa prej elementeve të porsa evidentuara shfaqen në zanafillë të dështimeve të herëpashershme të këtyre misioneve, ndërsa mungesa e gjatë e një

¹⁵⁶Frulli. M. (2001) *Le operazioni di peacekeeping delle Nazioni Unite e l'uso della forza*, in RDI, pg,347.

statuti që të diktojë disiplinën përkatëse, sjell pashmangshmërisht paqartësi e vështirësi në kryerjen e tyre, siç dëshmojnë rastet që do të shqyrtojmë më tej.

Praktika më e fundit sjell dy shembuj domethënës që vërtetojnë konsideratën e fundit, por që në të njëjtën kohë e përforcojnë vlerën e orientimit të shqyrtuar: kriza në Somali dhe lufta në Bosnje-Hercegovinë. Në Somali, në fillim të viteve '90, ishte krijuar një situatë gjeopolitike e rëndë. Me rrëzimin e qeverisë së ligjshme, nuk ishte bërë i mundur formimi i një ekzekutivi të ri. Ndërsa gjendja e anarkisë dhe shkrirjes së shtetit, u jepte zjarr luftimeve mes fraksioneve e lëvizjeve kundërshtarë, duke e bërë të vështirë veprimin e misionëve humanitare në ndihmë të popullsisë vendore. Në një fazë të parë, Këshilli i Sigurisë¹⁵⁷ autorizoi nisjen e një misioni tradicional për mirëmbajtjen e paqes (Unosom) me detyrë mbrojtjen e ndihmave humanitare, e cila ndër të tjera, ndeshi mjaft pengesa. Në këtë pikë ndërhyri një rezolutë¹⁵⁸ e re në të cilën Këshilli i Sigurisë autorizoi në hapësirat e kreut VII, ndërhyrjen nga shtetet anëtare për të vendosur sigurinë dhe porositi përdorimin e “*all necessary means*”, në kohën më të shkurtër të mundshme, për t'i lehtësuar operacionet e ndihmave humanitare (Unosom II) përveç hyrjes me vonesë në zonën paqeruajtëse¹⁵⁹, deri në ndërprerjen përfundimtare të misionit dhe dështimin e tij për mungesë bashkëpunimi nga ana e fraksioneve të luftës¹⁶⁰.

Edhe për sa i përket rastit të konfliktit etnik të zhvilluar në Bosnje-Hercegovinë, Këshilli i Sigurisë së pari (1992) dërgoi një mision për mbajtjen e paqes me mandat tradicional. Nën trysinë e palëve në dyluftim, ai mori funksione shumë më të gjera, si atë të sigurimit të dorëzimit të ndihmave humanitare, garantimin e aeroportit të Sarajevës dhe paprekshmërinë e zonave të mbrojtura (“*safe havens*”). Më pas i njëjti organ¹⁶¹ i autorizoi shtetet anëtare, nën autoritetin e Këshillit dhe me bashkërendimin e Sekretarit të Përgjithshëm, për të përdorur “*all necessary means*” në hapësirën ajrore të Bosnje-Hercegovinës, me qëllim ruajtjen e ndalimit të fluturimit në një hapësirë të tillë, për të bërë të mundur zhvillim e programeve të asistencës humanitare për popullsinë civile, por mungesa e mjeteve të

¹⁵⁷ Shih Rezolutën nr.751 të vitit 1992.

¹⁵⁸ Referaur Rezolutës nr.754 të vitit 1992.

¹⁵⁹ Në Rezoluten nr. 897/1994. Ishte përcaktuar karakteri Unosom.

¹⁶⁰Pontecorvo. C. M. (1995). *Somalia e Nazioni Unite, in Interventi delle Nazioni Unite e Diritto Internazionale, (a cura di Picone)*, Padova, pg.201.

¹⁶¹ Shih Rezolutën nr.816 të vitit 1993.

mjaftueshme dhe mungesa e bashkëpunimit të autoriteteve vendore, kushtëzuan në fakt mosrealizimin e pjesëve thelbësore të mandatit të misionit¹⁶².

Është me rëndësi të vëmë në dukje se si me përdorimin e shprehjes “*necessary means*” në rezolutat e lartpërmendura, Kombet e Bashkuara jo vetëm kanë lejuar për të parën herë ndërhyrjen e shteteve të treta në konfliktet objektivisht të cilësuar si “të brendshme”, por edhe mbi të gjitha, kanë ndërfutur kufizim në ndalimin e forcës, me qëllim garantimin e sigurisë ndërkombëtare dhe sigurimin e ndihmave humanitare¹⁶³.

Gjithçka e konsideruar, vë në dukje në mënyrë të veçantë faktin se këto vendime janë justifikuar mbi bazën e “situatave emergjente humanitare”, hasur herë pas here, çka nuk duket e përshtatshme për të nxjerrë prej tyre parimet e përgjithshme, po edhe sjell argumente të mjaftueshme për ta refuzuar qasjen tradicionale të së drejtës ndërkombëtare, e cila mbron parimin e mosndërhyrjes së jashtme në luftërat civile.

3. Përdorimi i forcës nga ana e qeverisë në pushtet.

Në rastet kur qeveria aktuale është në luftë kundër një lëvizjeje për çlirim kombëtar, që është me të vërtetë përfaqësuese e popullit në luftë për vetëvendosje dhe që posedon një kapacitet efektiv qeverisës, konflikti fiton interesimin e ndërkombëtarëve, në praninë e të cilëve nuk shfaqet si kërkesë parësore e drejta për t’i menaxhuar punët e tyre të brendshme. Në fakt, në këtë rast të dyja palët janë të pajisura me personalitet juridik ndërkombëtar, ku e drejta ndërkombëtare nuk mund ta shpërfillë konfliktin që lind mes tyre dhe humbet asnjësinë tradicionale të saj, duke vepruar në qasjen kundrejt luftërave civile. Në veçanti, kjo sjell më shumë shqetësim në përcaktimin e rregullave të përpikta për rastet kur qeveria përdor forcën për t’i kundërshtuar lëvizjet çlirimtare, që veprojnë për ta zbatuar të drejtën e vetëve - ndosjes së popullit të cilin përfaqësojnë. Në këtë perspektivë, merret parasysh Deklarata për dhënien e pavarësisë popujve kolonialë¹⁶⁴ e cila, pasi shpreh detyrimin për shtetet që ta njohin dhe të përpiqen për çlirimin e popujve nga zgjedha koloniale, ofron një seri masash analitike dhe mjjetesh për ta arritur këtë rezultat: së pari, vihet re miratimi i masave të menjëhershme që kanë për qëllim bartjen e kompetencave

¹⁶²Picone. P. (1995). *Il Consiglio di sicurezza e la crisi jugoslava, in Interventi delle Nazioni Unite e Diritto Internazionale*, Padova, pg.201.

¹⁶³Pontecorvo. C. M. (1995). *Somalia e Nazioni Unite, in Interventi delle Nazioni Unite e Diritto Internazionale, (a cura di Picone)*, Padova, pg.245.

¹⁶⁴Asambleja e Përgjithshme rezoluta.n.1514-XV del 1960, *testo in Yearbook of the United Nations*, 1960, pp.46.

sovrane dhe së dyti, ndërmarrja për t'i dhënë fund përdorimit të forcave të armatosura, si dhe ndalimi i të gjithë masave shtrënguese që synojnë mbajtjen e një regjimi kolonial. Për më tepër, ajo që është e rëndësishme për Deklaratën mbi marrëdhëniet miqësore¹⁶⁵, e cila në mënyrë të qartë i urdhëron shtetet që të përmbahen nga çdo veprim i cili përfshin përdorimin e forcës me qëllimin e zhveshjes së popullit nga e drejta e tij për ta fituar pavarësinë. Në mënyrë të qartë jepet mundësia për të gjurmuar natyrën e detyrueshme të ndalimit në fjalë, të rezolutave të tilla provuese, për shkak të natyrës së tyre të detyrueshme, baza ligjore e ndalimit të forcës në situata të tilla duhet kërkuar gjetkë, në mënyrë që t'i atribuojë asaj një përmbajtje më të gjerë, në përputhje me fushëveprimin universal të paragrafit 2 të nenit 1 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në veçanti, duket se burimi i ndalimit të kërcënimit ose të përdorimit të masave shtrënguese, me armë ose pa armë, që kanë për qëllim ta shtypin lëvizjen e ligjshme për vetëvendosje mund të gjenden përsëri në Kartën e Kombeve të Bashkuara, por tashmë në nenin 2 pargr. 4, i cili i ndalon shtetet ta përdorin forcën, duke iu referuar ekskluzivisht marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe në nenin 1 paragrafi 2, i cili solemnisht shpall të drejtën e vetëvendosjes dhe detyrimet që rrjedhin prej saj¹⁶⁶. Në këtë kuptim, ndalimi ripohoi në 1970, Deklaratën që s'është gjë tjetër, veçse një konkluzion logjik dhe i nevojshëm i këtij parimi. Ky përfundim është konfirmuar nga fakti se neni 2 pargr.4, përqendrohet në ndalimin e përdorimit të forcave të armatosura, kur një përdorim i tillë është i drejtuar kundër ushtrimit të vetëvendosjes së një populli, kjo merr një hapësirë dhe një përmbajtje më të gjerë të mundshme për të mbuluar çfarëdo lloj mase e përmbajtjeje që e siguron ose jo përdorimin e armëve. Neni 2 pargr. 4 pra, do të zbatohet vetëm për rastet në të cilat qeveria e themeluar, e bën përdorimin ekskluziv të forcës së armatosur kundër një lëvizjeje çlirimtare me një personalitet të plotë juridik në nivel ndërkombëtar, dhe jo në rastet e ndryshme në të cilat popujt nuk përfaqësohen në luftë nga asnjë organizëm i pavarur dhe sovran, që do ta përfaqësonte atë në nivel ndërkombëtar dhe në rastin e fundit, ku pretendimet e "kombëtare" janë mbytur që në lindje nga operacionet policore shtypëse. Kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e vetëvendosjes, sepse kjo nuk do të konsiderohej si një çështje e brendshme e jetës së shtetit në fjalë. Nga ana tjetër, përdorimi i forcës nga ana e qeverisë në fuqi, nuk mund të përliqet as me rrethana lehtësuese të

¹⁶⁵Asambleja e Përgjithshme rezoluta.n.2625-XXV del 1970, *testo in American Journal of International Law*,1971,pp.243 .

¹⁶⁶Ronzitti. V. (1974). *le guerre di liberazione nazionale e il diritto internazionale*,Pisa, ,pg.62.

vetëmbrojtjes, siç parashihet me nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si përjashtim i vetëm në ndalimin e kërcënimit ose përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, kurse tani njihet si normë e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare nga ana e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë¹⁶⁷, në kontestin e oponencës së Shteteve të Bashkuara dhe Nikaraguas. Në të theksohet, se "asgjë në këtë Statut nuk do ta pengojë të drejtën e natyrshme për vetëmbrojtje individuale dhe kolektive, në rast të ndonjë sulmi të armatosur, i cili ndodh kundër një anëtari të Kombeve të Bashkuara, derisa Këshilli i Sigurimit ka marrë masa të nevojshme për t'i ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare". Këtu duhet theksuar se mbrojtja e ligjshme nuk mund të përdoret, aq më pak në rastet, kur përdorimi i forcës drejtohet kundër një populli të organizuar në luftë për vetëvendosje, pikërisht, për shkak se kjo bën përjashtim nga funksionimi i ndalimit të kërcënimit dhe përdorimit të forcës dhe jo një kufizim për efektivitetet e ndryshme të parimit në fjalë. Vlera ligjore dhe jo thjesht politike e përdorimit të forcës nga ana e një shteti për ta shtypur kërkesën e popujve për vetëvendosje, dënohet vazhdimisht dhe kjo është theksuar në aktet e zbatimit të përgjithshëm, prandaj duke iu referuar rasteve të veçanta, është vërtetuar më tej nga neni 19, i projektligjit mbi përgjegjësinë ndërkombëtare, i miratuar në lexim të parë në vitin 1996, nga Komisioni i të drejtës ndërkombëtare. Kjo marrëveshje, siç kemi thënë, përcakton rastin e krimit ndërkombëtar, ndër të tjera "b) shkelje e rëndë e një detyrimi ndërkombëtar të një rëndësie thelbësore për mbrojtjen e të drejtës së vetëvendosjes së popujve", duke cituar si një shembull tipik, pikërisht, rastin e "krijimit ose mbajtjes në fuqi të sundimit kolonial". Vlen të kujtohet, për hir të së vërtetës, se kjo dispozitë u shlye përfundimisht nga versioni përfundimtar i projektit për Përgjegjësinë Ndërkombëtar të miratuar në vitin 2001, edhe pse ajo përmban një konsideratë të veçantë për rastin e shkeljes së rëndë të ligjit ndërkombëtar detyrues.

4. E drejta popujve për t'i bërë qëndresë me forcë akteve të dhunës së ushtruar në mbrojtje të të drejtave të tyre.

Ne duhet të theksojmë se Kombet e Bashkuara i kanë inkurajuar dhe mbështetur gjithmonë luftërat për çlirim kombëtar, duke miratuar në thelb edhe përdorimin e mjeteve të dhunshme, në qoftë se kjo është dashur për të zhdukur shkaqet e shtypjes dhe atë që përmbahet brenda kufijve të tillë, dhe nuk ka stigmatizuar përdorimin e forcës nga ana e popullit të vetëvendosur. Kjo në bazë të

¹⁶⁷ Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i datës 06.27.1986, ne raportet fq. 92.

vlerësimi largpamës që situatat e mohimit të së drejtës për vetëvendosje mund të shkaktojnë fatkeqësitë e luftës me ndikim shumë më të gjerë dhe çlirimi i popullit të shtypur mund të shërbejë për t'izhdukur faktorët gjenetikë të konflikteve. Prandaj, që të jenë plotësuar kushtet ligjore dhe politike, Kombet e Bashkuara e kanë legjitimuar luftën e armatosur të ushtruar nga popujt apo nga një lëvizje çlirimtare kombëtare që i përfaqëson ata në këto raste. Në këtë drejtim, në *“Deklaratën mbi parimet e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1970”*¹⁶⁸, gjendet një pohim domethënës, ku pasi kritikohen veprimet e kryera nga shtetet që e privojnë një popull nga e drejta e tij për vetëvendosje, u njihet popujve e drejta për t'u bërë qëndresë me forcë akteve të dhunës së ushtruar në mbrojtje të të drejtave të veta. Por nuk mund të lëmë pa përmendur mospërputhjet që ky hap krijon, në aspektin e pajtueshmërisë së parimit tonë dhe ndërlikimet e tij të "dhunshme" të diskutuara tashmë, duke respektuar ndalimin e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, mishëruar në nenin 2 pargr. 4 i Kartës. Kështu nuk do të ishte i mjaftueshëm për ta kapërcyer këtë pengesë as konstatimi se deklarata në fjalë nuk ka fuqi detyruese për subjektet e së drejtës ndërkombëtare.

Në fakt, duhet theksuar se shumë prej dispozitave të kësaj deklarate kanë fituar tashmë në praktikë, vlerën e një rregulloreje të pamohueshme për faktin se shtetet vullnetarisht i përshtatin sjelljet dhe qëndrimet e tyre ndaj kësaj duke e konsideruar, mjet tipik të diplomacisë dypalëshe dhe shumëpalëshe; dhe nuk është rast i pazakontë që disa nga dispozitat e përmbajtura në Deklaratën e 1970, janë deklarime të pashkruara të normës së të drejtës ndërkombëtare, apo kanë karakter interpretues të dispozitave ekzistuese; në fund, është e pamohueshme se parimet e përfshira në të numërohen ndër faktorët, që në fakt, kontribuojnë në përcaktimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të shteteve, në konkurrencë me rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, është e dobishme, të kujtojmë përpjekjet e dështuara të bëra nga shtetet për ta vendosur legjitimitetin e luftës së armatosur antikolonialiste në bazë të parimit të vetëmbrojtjes, mishëruar në nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Linja e ndjekur e argumentit për të arritur një zgjidhje të tillë, është përqendruar në fakt, në njohjen nga ana e popullit kolonial të së drejtës së vetëmbrojtjes kundër pranisë së të ashtuquajturit “atdheu në territorin e tij”, me

¹⁶⁸ Asambleja e Përgjithshme, rezoluta.n.2625-XXV.

pasojën e klasifikimit të këtij të fundit si agresor, dhe njohjen automatike të të drejtave të parashikuara me këtë dispozitë. Por në këto konsiderata është e lehtë për të argumentuar¹⁶⁹ se tashmë mund të përlligjet *a priori* çdo kryengritje a rebelim, pa u menduar gjatë se nga njëra anë, popujt do të kenë një nxitje për t'u shkëputur dhe gjithashtu shtetet e treta do të inkurajohen për të ndërhyrë në luftëra. Por vëzhgimi vendimtar duket të jetë në një nivel sistematik ai për të cilën, ndalimi i përdorimit të forcës i ka kufijtë më të theksuar sesa ata që rrjedhin nga neni 51, në të cilin gjenden të gjitha rastet e tjera, që nuk janë agresion i armatosur, i skajshëm në dëm të një shteti (i cili më pas do të ketë të drejtë ta mbrojë veten e vet). Prandaj, ndalimi në nenin 2 pargr. 4 vlen edhe në rastet e sundimit kolonial, racist apo forcë e huaj, përveç nëse përdorimi i forcës nuk përfaqëson vetëm mjetet e mundshme për realizimin e vetëvendosje, sipas logjikës së qenësishme në konceptin e vetëmbrojtjes. Për më tepër, ky përfundim konfirmohet plotësisht nga udhëzimet që dalin nga praktika dhe nga vendimet e Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se është e vërtetë që ajo e ka konsideruar gjithmonë luftë të ligjshme atë që zhvillon një popull i shtypur, i organizuar në lëvizjen kombëtare çlirimtare kundër qeverisë shtypëse ose pushtuesit, për të mbërritur afirmimin e subjektivitetit të plotë në të njëjtën sferë ndërkombëtare, vendimet e saj nuk kanë kurrë shpjegim të përpiktë, ndërsa gjenden në mes pritshmëritë e dobishme të qëllimit, për shkak të konfliktit të papajtueshëm midis vendeve socialiste dhe afrikanë, në njërin anë, të cilat vendosin për pranueshmërinë e të gjitha mjeteve (të armatosur ose të paarmatosur) dhe vende të tjera perëndimore, jo të favorshme për përdorimin e mjeteve paqësore. Kështu, deklarata mbi marrëdhëniet miqësore¹⁷⁰ nuk e paragjykon ligjshmërinë e veprimeve të popujve, të cilët "reagojnë dhe rezistojnë" ndaj masave shtrënguese të përdorura nga qeveria sunduese, ndërsa nën agresion¹⁷¹ lejon që popujt nën regjimet koloniale, raciste ose forma të tjera të paraqitjes të mund të luftojnë për liri dhe pavarësi, shprehimisht duke siguruar në nenin 7, "të drejtën e popujve për të luftuar për realizimin e vetëvendosjes". Ky qëndrim është përforcuar disi nga fakti, se deklaratat e shumta të përpunuar brenda organizatës, në të cilën lufta e armatosur kuptohet edhe si një nga mjetet e ligjshme, që vihet në veprim për ta ushtruar të drejtën e vetëvendosjes, u miratuan pavarësisht refuzimeve të shumta, votave kundër, dhe kritikave të rënda nga vendet Perëndimore,

¹⁶⁹Treves, T. (2005). *Diritto internazionale problemi fondamentali*, Giuffrè, pg. 167.

¹⁷⁰Asambleja e Përgjithshme rezoluta.n.2625-XXV del 1970.

¹⁷¹Asambleja e Përgjithshme rezoluta.n.3314-XXIX del 1974, *In Revue générale de droit international public*, 1975, pg.261 .

të cilat kanë treguar gjithmonë rezistencë të fortë për ta pranuar përdorimin e forcës nga populli i poshtëruar, megjithëse, si mjetin e fundit. Objektivist, këto pozicione kanë qenë gjithmonë të diktuar nga motive politike, sesa nga argumentet përkatëse ligjrisht, por përdorimi i mjeteve të tilla të dhunshme për të kundërshtuar veprimin shtypës nuk u censuroi ose haptazi shpallet i paligjshëm edhe nga shtetet Perëndimore¹⁷².

Në fund të fundit, mund të themi se në gjendjen aktuale të së drejtës ndërkombëtare, nuk do të dalin zgjidhje unike dhe përfundimtare për çështjen e ligjshmërisë së përdorimit të forcës së armatosur në ushtrimin e të drejtës për vetëvendosje, por është e rëndësishme të thuhet që një përdorim i tillë është justifikuar në fakt, plotësisht nga bashkësia ndërkombëtare, kur ajo përfaqëson të vetmen mënyrë për ta arritur një qëllim të mishëruar në Kartën e OKB-së.

Kjo rezulton në përfundimin se, në qoftë se është e vërtetë që lëvizjet çlirimtare nuk mund të konsiderohen në të gjitha aspektet e përdorimit të drejtë të forcës, ato nuk mund të mbajnë përgjegjësi për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare, përderisa përdorin forca të armatosura për t'iu përgjigjur përdorimit të mjeteve të të njëjtit lloj nga shteti, që është kundër idealit të çlirimit të tyre.

5. Terrorizmi shtetëror.

Nuk mund të mos shënojmë si akte konkrete të terrorizmit ndërkombëtar edhe ato akte të përdorura gjithnjë e më shumë edhe nga shtetet e përfshira si subjekte pasive në luftën për afirmimin e vetëvendosjes. Ky konstatim nga njëra anë kap një aspekt të pakundërshtueshëm të zhvillimeve të fundit në praktikën ndërkombëtare dhe nga ana tjetër, paraqet probleme të ngjashme me ato të paraqitura nga i ashtuquajtur "terrorizmi popullor". Në veçanti, ky fenomen është zhvilluar edhe kundër individëve dhe grupeve përgjegjëse për terrorizmin ndërkombëtar, ashtu edhe kundër shteteve që mbështesin e janë përgjegjës për akte terroriste (të ashtuquajtura "shtete të papërgjegjshme"), por edhe pa dallim nga populli, me të cilin grupet terroriste lidhen në mënyra të ndryshme, ose të cilit i referohen, gjithsesi. Bëhet fjalë, në lidhje me përdorimin e formës "legjitime" të raprezaljeve të armatosura, apo edhe të "vetëmbrojtjes paraprake".

Së pari, duhet të theksojmë se edhe hakmarrjet e armatosura, të paracaktuara si reagim ndëshkues në mbrojtje të autorëve të një vepre të paligjshme, kur paraprakisht

¹⁷² Leanza. U. (2000). *Il diritto internazionale*, Torino, pg.97.

e ashtuquajtura ligjshmëri mbrojtjeje , kuptohet si veprim i armatosur me funksion parandalues, krahasuar me një sulm hipotetik të ardhshëm, janë konsideruar njëzëshëm të paligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare.

Së dyti, kur veprimtaria e armatosur e një shteti është duke u përballur për të goditur bazat e një grupi terrorist të vendosura në një shtet të caktuar, ajo krijon një shkelje të sovranitetit dhe për këtë arsye shkel një parim themelor të së drejtës ndërkombëtare, pa e konsideruar shtetin e sulmuar përgjegjës për çdo gjë, përveç, vigjilencës së keqe apo dështimit të shtypjes.

Shkelja e sovranitetit të një shteti, që gjendet duke pritur, apo mbrojtur grupet terroriste, mund të justifikohen vetëm në situata të një keqësimi të skajshëm apo për emergjenca humanitare, po edhe atëherë vetëm në funksion të shpëtimit të jetëve e në gjendje të rrezikut shumë të madh, siç e tregon edhe debati në Këshillin e Sigurimit pas bastisjes izraelite në Entebbe. Kjo i referohet episodit që ka ndodhur natën ndërmjet 3 dhe 4 korrikut 1976, kur trupat izraelite bastisën elitransportate në aeroportin e Entebbe të Ugandës, ku u përfshinë në një përleshje me armë për të liruar civilët e mbajtur peng nga terroristët palestinezë, në bordin e një aeroplani të rrëmbyer. Veprimi, i cili shkaktoi vdekjen e disa njerëzve dhe përfundoi me lirimin e pengjeve, është kryer pa autorizim nga qeveria e Ugandës. Izraelitët besohet të kenë bashkëpunuar me rrëmbyesit¹⁷³.

Në diskutimin e mëvonshëm që u zhvillua në Kombet e Bashkuara në veçanti, delegati izraelit evokoi të drejtën e mbrojtjes së ligjshme "shenjtëruar me ligjin ndërkombëtar dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara", në bazë të arsytimit që Uganda nuk ia kishte dalë për ta respektuar të drejtën ndërkombëtare, që i kërkon asaj mbrojtjen e shtetasve të huaj që ishin në territorin e saj. Përballë kësaj situatë, Këshilli regjistroi një ndarje të thellë në mesin e anëtarëve të saj, gjë që, në fakt, e pengoi arritjen e një pozicioni unanim: në njërën anë, në fakt, disa shtete, si Tanzania dhe Libia, propozuan një projekt rezolutë, që e dënonte veprimin izraelit, për shkak se përbënte "shkelje flagrante të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ugandës", ndërsa Britania dhe Shtetet e Bashkuara, duke ripohuar nevojën për ta mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjitha shteteve, përpunuan një tekst ku dënonin "rrëmbimin dhe të gjitha aktet e tjera, që kërcënojnë jetën e udhëtarëve dhe ekuipazheve, dhe sigurinë e aviacionit civil" dhe u bënë thirrje të gjitha shteteve që të

¹⁷³ Boyle. F. A. (1982). *The Entebbe Hostages Crisis*, NILR, pp ,3.

"marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i parandaluar dhe ndëshkuar aktet e terrorizmit si ky¹⁷⁴".

Përtej pasigurive që lidhen me interpretimin e kësaj historie, ne mund të themi se në rrethana të tilla, nuk ka konsensus të mjaftueshëm në bashkësinë ndërkombëtare, në lidhje me nevojën për të marrë parasysh mbizotërimin e "nevojave humanitare", sesa mbrojtjen e interesave të tjera në lojë¹⁷⁵.

Më në përgjithësi duke marrë për bazë përdorimin e masave shtrënguese të njëanshme, do të thotë nga shteti, vlefshmëria e kësaj qasjeje është konfirmuar nga komunikata e lëshuar nga *Foreign and Commonwealth Office* britanike, në vitin 1998. Kjo duket në fakt, si pranim i përdorimit të njëanshëm të forcës vetëm në praninë e një nevoje të madhe humanitare, që konstatohet në bazë të kriterëve të sakta: në mënyrë të veçantë, ajo duhet të jetë; "a) një situatë e nevojës së skajshme humanitare dhe në një shkallë të madhe e cila kërkon ndihmë të menjëhershme dhe urgjente; b) që është objektivisht e qartë se ekziston një alternativë e besueshme për përdorimin e forcës për të shpëtuar jetët; c) se përdorimi i forcës, që është propozuar, është i nevojshëm dhe proporcional, në mënyrë që të plotësojë një nevojë humanitare dhe është i kufizuar në mënyrë drejt në kohë dhe fushëveprimi, në mënyrë, që të jetë minimumi i nevojshëm për arritjen e këtij qëllimi". Pra nëse, janë objekt vetëm i kushteve të deklaruara, kjo nuk duket se mund të jetë arsye për të rënë dakord me përdorimin e forcës, që përfshin shkeljen e integritetit territorial të një shteti me qëllime ndëshkuese kundër grupeve terroriste, ndërsa kanë përgjegjësi për vepra të rënda apo kundër shtetit të vet, dhe aq më pak, nëse ka një funksion të parë e të përgjithshëm dhe mbrojtjen ndaj njërit apo tjetrit. Kjo nuk e përjashton mundësinë që një shtet mund t'u drejtohet masave të politike ose ekonomike, ose më në përgjithësi, për format e hakmarrjes paqësore para aktit, në të cilin është viktimë.

6. Mbështetja e qeverisë në fuqi.

Nëse nuk mund të gjendet asnjë justifikim, së paku në stadin aktual të evolucionit të së drejtës ndërkombëtare, për përdorimin e forcës për të shtypur një lëvizje që lufton për të shpallur të drejtën për vetëvendosje, një arsye më shumë për të thënë të njëjtën hipotezë, vlen edhe në rastet kur është një shtetet i tretë, ai që i jep

¹⁷⁴ Shih Rezolutën nr. 1224, të vitit 1976.

¹⁷⁵ Treves. T.(2005). *Diritto Internazionale problemi fondamentali*, Giuffrè, pg. 445.

mbështetje të armatosur në përdorimin e forcës qeverisë në fuqi¹⁷⁶. Kjo vlen edhe kur përdorimi i mjeteve shtrënguese përbën një përgjigje të ndërlidhur ndaj dhunës, të cilën përdor populli i organizuar, sepse mbrojtja e ligjshme siç kemi nënvizuar shpesh herë, përbën një kufi në përpjekjet e ndalimit të përdorimit të forcës, por nuk mundet, në të kundërt, të jetë e ndërfutur si një pengesë në realizimin e së drejtës së vetëvendosjes. Në këto konkluzione janë bashkuar edhe Kombet e Bashkuara, në rastet e herëpashershme, në të cilat janë ndeshur me problemin, qoftë edhe me referimet e luftërave çlirimtare të popujve nga sundimi kolonial, racist ose të huaj¹⁷⁷.

Nga qëndrimet e mbajtura, kuptohet se aty ku ndërhyrja e një shteti të tretë shkon në ndihmë të një qeverie që dhunon parimin e vetëvendosjes, edhe pse një ndërhyrje e tillë është kërkuar nga kjo e fundit, ajo nuk mundet kurrë, të quhet legjitime, sepse shteti që e mbështet dhe bashkëpunon me regjimin shtypës në formë të armatosur, kontribuon njësoj si i pari për ta penguar ose shkelur realizimin e parimit të vetëvendosjes, duke u bërë kështu përgjegjës për paligjshmëri ndërkombëtare.

Ky cilësim paligjshmërie në lidhje me sjelljen e shtetit të tretë vlen edhe në rastin, në të cilin bashkëpunimi në shtypje është realizuar përpara se sa lufta ta ketë mbërritur të ashtuquajturin prag (*insurgency*)¹⁷⁸, pasi ai nuk është tjetër veçse ndërlikim i natyrshëm i parimit të vetëvendosjes, që vendos detyrime të sakta, jo vetëm ndaj shtetit të përfshirë drejtpërdrejt në ngjarje, por edhe ndaj të gjithë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, dhe më në përgjithësi, të bashkësisë ndërkombëtare. Një vlerësim i tillë si antijuridik mbulon jo vetëm përdorimin e armëve, por më në përgjithësi çdo lloj tipi ndihme ose ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për ta penguar realizimit e parimit të vetëvendosjes ose favorizimin e shtypjes¹⁷⁹.

Nga ana tjetër, që lufta për njohjen e së drejtës për vetëvendosje të konsiderohet një çështje e *international concern* përpara mbërritjes në fazën e *insurgency*, gjen ballafaqim në nenin 1, të Protokollit të parë të Konventës së Gjenevës, të 1949, që shtron problemin e zgjidhjes së një kalibri të fortë politik, luftërat çlirimtare në rangun e konflikteve ndërkombëtare, me të gjitha pasojat që rrjedhin, si në profilin e trajtimit humanitar për qytetarët në luftë, ashtu edhe në anën

¹⁷⁶ Ronzitti. V. (1974). *le guerre di liberazione nazionale e il diritto internazionale*,Pisa, pg.108.

¹⁷⁷ Po aty.

¹⁷⁸ Po aty, pg.115.

¹⁷⁹ Pomerance. M. (1982). *Self-Determination in Law and Practice*,cit, pp.48 .

e shtetit shtypës e shteteve të treta, nga një anë, dhe mes këtyre të fundit dhe lëvizjes për çlirim nga ana tjetër.

7. Mbështetja e popujve në luftë për vetëvendosje.

Çështjet e vetëvendosjes së popujve shfaqen mjaft të ndryshme kur bëhet fjalë për të marrë në konsideratë dhe vlerësuar rëndësinë e qëndrimit të shteteve të huaja, në lidhje me popullin që lufton për të fituar sovranitetin e tij të plotë. Në fakt, është e njëzëshme njohja që e drejta ndërkombëtare u lejon shteteve të treta të ndërhyjnë në luftërat çlirimtare në mbështetje të një populli që gëzon një organizëm të vetin e kërkon të drejtën e tij për vetëvendosje, pikërisht sepse lindja e një konflikti të tillë, e tejkalon dukshëm sferën e së ashtuquajturit “domen i rezervuar”. Kjo është fillesa e implikimit natyral të efektit *erga omnes* të detyrimit për mbështetjen e realizimit të së drejtës për vetëvendosje, nga e cila rrjedh njohja në krye e të gjitha subjekteve të bashkësisë ndërkombëtare të së drejtës për të kërkuar nga shteti “tiran” respektin e së drejtës së tillë. Pra këtu problemi shtrohet edhe kur bëhet fjalë për të verifikuar se cilat janë format dhe mënyrat, nëpërmjet të cilave mund zhvillohet drejt ndihma e tillë për popullin në luftë, ose nëse ajo do të kufizohet në një bashkëpunim me natyrë njerëzore, ekonomike ose më shumë politiko-diplomatike, apo në të kundërtën, nëse mund të konkretizohet në një ndihmë me karakter ushtarak. Çështja nuk është me pak rëndësi, pasi vë në lojë parime e vlera nga përshtatja e saktë e të cilave, varet edhe sot rruga e drejtë e marrëdhënieve ndërkombëtare, sovraniteti i shteteve në fuqi, parimi i mosndërrhyrjes në punët e brendshme të shteteve, e drejta e popullit për vetëvendosje dhe ndalimi i kërcënimit e përdorimit të forcës. Në këtë pikë, një analizë sintetike e rezolutave kryesore të përshtatura në lidhje me këto çështje nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara na lejon të nxjerrim tregues të vlefshëm në lidhje me vlerësimin e qëndrimit të mbajtur nga shtetet e treta në përfaqje me instancat e popujve të shtypur nga një regjim “tiranik”. Në të njëjtën mënyrë, është e mundshme të pranohet me një dozë të mirë qartësie, besimi se luftërat çlirimtare të popujve nuk mund të trajtohen si luftëra thjeshtë civile, sepse është konstatuar se ndalimi i ndihmës së jashtme për popujt që luftojnë për vetëvendosje nuk zbatohet në këto raste. Kjo është e qartë sidomos nga lidhja e deklaratave të marrëdhënieve miqësore, të vitit 1970¹⁸⁰ dhe përkufizimit të agresionit

¹⁸⁰ Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta nr .2625 e vitit 1960.

të vitit 1974¹⁸¹, kur ata flasin pa mëdyshje për ligjshmërinë e ndihmës së dhënë popullit të nënshtruar me metoda shtrënguese, edhe pse në punët përgatitore nuk do të shfaqen pozitat mbështetëse të shteteve anëtare, sa i përket natyrës së kësaj ndihme. Ky problem zhvillohet më tej, veçanërisht nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth rastit të veprimtarisë ushtarake dhe paraushtarake në Nikaragua, nga i cili mund të merret më shumë informacion¹⁸². Në vendimin në fjalë, në fakt, Gjykata ka marrë në shqyrtim çështjen e ligjshmërisë së ndërhyrjeve nga shtetet e treta, në mbështetje të lëvizjes opozitare apo të rezistencës dhe arriti në përfundimin se kjo konsiderohet si shkelje e parimit të mosndërhyrjes, pavarësisht nga lloji i ndërhyrjes. Megjithatë, po kjo gjykatë nuk la pa përmendur ndryshimin e thellë dhe të dukshëm midis rastit të ndihmës së dhënë në mbështetje të forcave të opozitës dhe atë të ndërhyrjes në luftërat për vetëvendosje. Në të njëjtën mënyrë, duke e kaluar në heshtje problemin e ligjshmërisë së rastit të dytë, është pranuar në mënyrë nënkuptuese se disiplina tipike e luftërave civile është e pazbatueshme në situatat kur vihet në rrezik parimi i vetëvendosjes, pasi ngjarje të tilla nuk hyjnë në sferën e domenit të rezervuar të etnitetit të caktuar shtetëror, prandaj, për këtë arsye nuk janë të mbrojtur nga parimi i mosndërhyrjes.

Siç e thamë, problemi qëndron në përcaktimin e llojit të bashkëpunimit që mund të realizohet në të mirë të popujve në luftë dhe në veçanti, nëse është i ligjshëm bashkëpunimi ushtarak apo paraushtarak (drejtpërdrejt apo tërthorazi). Rastet në të cilat përqendrohen papajtueshmëritë midis anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar, të cilat duken se pajtohen mbi pranueshmërinë e llojeve të tjera të ndihmës, të tilla si: financiare, ekonomike dhe politiko-diplomatike. Zakonisht, shtetet afrikano-aziatike, ato latino-amerikane dhe vendet socialiste janë të prirura për një pretendim të mundshëm shumë të gjerë të tipit mbështetës (duke përfshirë atë ushtarake), ndërsa vendet perëndimore kundërshtojnë këto vizione. Për më tepër, për të gjetur një bazë ligjore për ligjshmërinë e një ndërhyrjeje të armatosur në këto raste bëhet problem i ndërlikuar. Nga njëra anë nëse nuk është e mundshme të gjejnë ligjshmërinë e një veprimi të tillë, në shkronjën e nenit 51 të Kartës (me referencë të veçantë për vetëmbrojtje kolektive), aq më pak mund të besohet se ky mund të jetë një konkluzion i parimit në fjalë.

¹⁸¹Asambleja e Përgjithëshme, Rezoluta nr.3314 e vitit 1974.

¹⁸²Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i vitit 27-06-1986, raporti, fq.92.

Nuk do të lodhemi së përsërituri se krahas detyrimeve universale për të ndihmuar në promovimin e vetëvendosjes së popujve, ka një detyrim me të njëjtën vlerë në lidhje me ndalimin e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Ndoshta, atëherë ligjshmëria e ndërhyrjeve të armatosura në mbështetje të kërkesave të popujve të shtypur mund të formulohet zbatimi i përjashtimit të statusit të nevojshëm, sot i kodifikuar në nenin 25, paragrafi 1, të dispozitave në fushën e përgjegjësisë ndërkombëtare, i cili përcakton në terma negativë duke pohuar se ajo nuk mund të përdoret nga një shtet për të përjashtuar paligjshmërinë e një fakti që ajo përmbush, përveç kur: a) fakti mund të ishte e vetmja zgjidhje për të ruajtur një interes esencial, përballë një rreziku të rëndë dhe të pashmangshëm; dhe b) fakti nuk komprometon seriozisht një interes esencial të shtetit, apo shteteve në lidhje me të cilin ka pasur një detyrim, ose bashkësia ndërkombëtare në tërësi. Por thirrja e shtetit në nevojë mund të jetë për përkufizim i parashikuar vetëm në raste të veçanta nevojë reale dhe emergjence të vërtetë humanitare, kështu qëllimi i saj është shumë i kufizuar. Duhet gjithashtu të mbahet mend fakti se ndalimi në nenin 2 paragr. 4, mund të ketë kuptim për atë që ekziston dhe është i aftë për drejtimin e një sistemi të armatosur policor ndërkombëtar, të tilla si ato të theksuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, për t'u përballur me të dyja rastet e agresionit të armatosur të një shteti anëtar, ose më në përgjithësi çdo situatë potencialisht të rrezikshme për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Përveçse në praktikën e ndjekur deri më sot, mekanizmat e projektuar për këtë qëllim nga Kombet e Bashkuara, për arsye të ndryshme, kanë provuar absolutisht pakënaqësi dhe ende nuk mund të japin përgjigje në kohë dhe efektive në lidhje me krizat e shpeshta ndërkombëtare, kështu që përkufizimi për këto çështje përfundon duke i besuar të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, veçanërisht, kur në këto ngjarje përfshihen palë nga shtete të ndryshme si lëvizje çlirimtare. Dhe kjo është e njohur si praktikë ndërkombëtare, për lejimin e tolerimeve më shumë se sa ndalimin e fjalës të asaj çka është përfshirë në shkronjën e Kartës së San Franciskos. Në këtë kuptim, përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera shtrënguese për të promovuar të drejtën e vetëvendosjes nuk mund të interpretohet përveçse në raste me të vërtetë të jashtëzakonshme, duke marrë parasysh edhe shpërdorimin e kësaj praktike, që mund të rezultojë edhe e atillë që mund të çojë me rreziqe. Nga ana tjetër, mund të jetë më efektiv dhe më pak i rrezikshëm, adaptimi i matjeve nëpërmjet presionit diplomatik dhe ekonomik, në funksion të promovimit të vlerave humanitare, të cilat mund të jenë, para së gjithash, detyrimi i shteteve të përfshira për të hequr dorë nga shkelja e parimit në fjalë.

Për më tepër, mundësia që një sanksion i hollësishëm i ligjshmërisë së përdorimit të forcës së armatosur në mbështetje të luftës së popujve për çlirim, mund të hapë rrugën për dallimin e përjashtimit të ndalimit për përdorimin e forcës që tregon rezistencën e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara për t'u përfshirë në hapa të favorshëm të këtij obsioni që dëshirohen prej disave. Pikërisht, duke marrë shkas nga dallimi dhe shtrembërimet e sistemit kolektiv të mbrojtjes të Kapitujve VI dhe VII të Kartës së OKB-së, një studiues¹⁸³ ka argumentuar nisur nga rezolutat e panumërta të miratuara nga Këshilli për ta jetësuar idenë se nuk do të kishte guxuar të pranonte se shtetet kanë të drejtë të ndërhyjnë ushtarakisht në rastet e mbështetjes për vetëvendosjen e popujve. Duke pohuar paarsyeshmërinë e këtyre tezave të fundit, ajo që duhet mbajtur mend është se shumë herë në të shkuarën, shumica e shteteve afrikane (shtetet e ashtuquajtura të vijës së Frontit), kanë ofruar territoret e tyre përkatëse, për të mirëpritur bazat e trajnimit, depo armësh dhe madje edhe baza operative, nga të cilat janë organizuar sulme të armatosura, në mbështetje të lëvizjeve çlirimtare kombëtare. Sulme të tilla, janë bërë shpesh pasoja të hakmarrjeve ushtarake nga shtetet e prekura, të motivuara nga kërkesat e ligjshme të mbrojtjes. Përballë situatave të tilla, Këshilli i Sigurimit nuk ka nguruar të bëjë të dëgjohet zëri i tij, për t'i dënuar veprimet e qeverive shtypëse, ndërsa ka heshtur në respektimin e ngjarjeve të të ashtuquajturave “Shtetet e linjës së Frontit” dhe kështu ka pranuar njohjen se mbështetja që u është dhënë popujve që luftojnë për vetëvendosje nuk mund të konsiderohet si e paligjshme.

8. E drejta për t'u shkëputur dhe integriteti territorial.

Siç e shqyrtuam në paragrafin e mëparshëm, të gjithë njerëzit kanë një të drejtë të qenësishme për të vetëvendosur. Kjo e drejtë përfshin lirinë e popujve për ta përcaktuar lirisht statusin e tyre politik dhe të ndjekin zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor. Çfarë referohet me termin vetëvendosje e jashtme ose ndarje dhe si kjo “e drejtë” shprehet më pas në terma praktikë sidoqoftë është një çështje shumë më e madhe. Në diskutimin mbi Deklaratën mbi Marrëdhëniet Miqësore¹⁸⁴, është përmendur që ka tri situata, në të cilat duhet të lindë një e drejtë ndarjeje. Për dy rastet e para, duke iu referuar situatave koloniale dhe pushtimeve të huaja, rezultati

¹⁸³Leanza. U. (1995). *Il diritto internazionale*, cit., pg.101.

¹⁸⁴Shih, Deklaratën mbi parimet e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1970, Paragrafi I.

është më i lehtë, pasi ka mirëkuptim të gjerë se e drejta e ndarjes në ato raste është ligj i zakonshëm. Ndërsa është thënë se ajo përfshin edhe një të drejtë ndarjeje që njihet gjithashtu për një individ, e drejta e të cilit për vetëvendosje të brendshme është shkelur plotësisht nga një qeveri që nuk e përfaqëson atë.

Ndërsa e drejta ndërkombëtare nuk ua jep specifikisht të drejtën ligjore për t'u ndarë në mënyrë të njëanshme nga shteti i tyre "mëmë" pjesëve përbërëse të shteteve sovrane, ajo gjithashtu nuk shpreh mohim të caktuar të një të drejte të tillë.¹⁸⁵

Arsyeja për këtë është se e drejta ndërkombëtare i jep rëndësi të madhe integritetit territorial të shteteve kombe dhe i lë vend krijimit të një shteti të ri në zgjedhjen e të drejtës vendase të shtetit ekzistues, në të cilin bën pjesë tani edhe autoriteti i shkëputur¹⁸⁶. Njëkohësisht njihet gjerësisht se shkëputja është një nga mënyrat për zbatimin e vetëvendosjes¹⁸⁷. Në fakt, kjo është e pamohueshme që përballë të drejtës ndërkombëtare të mirëkrijuar, të drejtës për vetëvendosje shtetet, në rrethana të caktuara, e kanë të nënkuptuar detyrën për ta njohur ligjshmërinë e një thirrjeje për shkëputje.¹⁸⁸

E drejta ndërkombëtare paravendos se e drejta për vetëvendosje duhet të ushtrohet në kuadrin e shteteve sovrane ekzistuese¹⁸⁹ dhe në përputhje me ruajtjen e integritetit territorial të këtyre shteteve. Në fakt, Konventat e OKB-së mbi të Drejtat e Njeriut përcaktojnë fushëveprimin e së drejtës për vetëvendosje, si të arritshme në kuadrin e një shteti ekzistues, edhe pa iu referuar drejtpërdrejt mbrojtjes së integritetit¹⁹⁰ territorial. Aktet ndërkombëtare të tilla si „Deklarata për Marrëdhëniet Miqësore dhe Deklarata e Vjenës, deklarojnë menjëherë pas afirmimit të së drejtës së popujve për të përcaktuar statusin e tyre politik, ekonomik, social dhe kulturor, që: *“...këto të drejta nuk duhet të interpretohen si autorizuese ose nxitëse të ndonjë veprimi, i cili do ta copëtojë ose pengojë, tërësisht ose pjesërisht, integritetin territorial ose unitetin politik të shteteve sovrane të pavarura, që e drejtojnë veten e*

¹⁸⁵ Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë, shënimi 66 në paragraf. nr. 112.

¹⁸⁶ Jennings, R.Y. (1963). *Përvetësimi i Territorit në të Drejtën Ndërkombëtare*, fq. në 8-9.

¹⁸⁷ Shih Deklaratën mbi parimet e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1970, Paragrafi nr. 4.

¹⁸⁸ Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë, shënimi 66, në paragrafin. nr. 111.

¹⁸⁹ Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë, shënimi 66, në paragrafin. nr. 122.

¹⁹⁰ Po aty, në paragrafin. nr. 130.

tyre në përputhje me parimin e të drejtave të barabarta dhe vetëvendosjes së popujve”.¹⁹¹

Studiuesit e të Drejtës Ndërkombëtare, nga ana e tyre, nuk e mohojnë të drejtën e shkëputjes plotësisht, por theksojnë rëndësinë e parimit të integritetit territorial,¹⁹² i cili është mbajtur për të interpretuar rregullin, ndërsa e drejta e shkëputjes përjashtimin e tij. Megjithatë integriteti territorial nuk do të thotë mungesa e detyrimit ligjor. Përkundrazi statusi i brendshëm dhe i jashtëm i shteteve, edhe pse i karakterizuar nga parimi i sovranitetit përcaktohet me një numër rregullash të së drejtës ndërkombëtare të cilat kufizojnë lirinë e veprimit të shteteve në të dyja çështjet e brendshme dhe të jashtme.¹⁹³ Kështu, parimi i sovranitetit nuk mund të përdoret i vetëm si argument kundër vetëvendosjes.¹⁹⁴

Rrjedhimisht, mund të argumentohet se ruajtja e integritetit territorial të shteteve ekzistuese dhe e drejta e një “populli”, për të arritur një masë të plotë të vetëvendosjes nuk janë reciprokisht ekskluzive. Megjithatë, sipas Gjykatës së Lartë të Kanadasë, kjo është e vërtetë vetëm kur shteti në fjalë qeveris në një mënyrë që përfaqëson të gjithë popullin apo popujt që banojnë brenda territorit të tij, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Si e tillë, mënyra e qeverisjes duhet të respektojë parimet e vetëvendosjes, si pjesë e marrëveshjeve të veta të brendshme.

Vetëm kur shtetet janë plotësisht në përputhje me këta faktorë, ato do të konsiderohen të drejta për mbrojtje sipas të drejtës ndërkombëtare të integritetit të tyre territorial.¹⁹⁵

Kjo u tha, edhe pse, ka me të vërtetë rrethana të caktuara në të cilat mund të lindë e drejta e shkëputjes. Përveç situatave të pranuar tradicionalisht, ku është njohur e drejta për shkëputje, për popujt që ndodhen nën sundimin kolonial ose të huaj, ose në regjime raciste¹⁹⁶, shumë studiues të së drejtës ndërkombëtare tani janë duke mbrojtur tezën që një popull që e gjen veten të bllokuar tërësisht nga ushtrimi

¹⁹¹ Shih, për shembull paragr. nr. 7 të Deklaratës për Marrëdhëniet Miqësore.

¹⁹² Murswiek. D.(1993). *shënimi 14*, vol 25, fq.78.

¹⁹³ Po aty.

¹⁹⁴ Po aty.

¹⁹⁵ Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë, shënimi 66, në paragrafin. nr. 130.

¹⁹⁶ Shih Deklaratën mbi parimet e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1970, Paragrafi nr.5.

kuptimplotë i brendshëm i së drejtës së vet për vetëvendosje ka të drejtë, si mjet i fundit, ta ushtrojë atë nëpërmjet vetëvendosjes së jashtme, apo shkëputjes.¹⁹⁷

Kërkesa e fundit e Deklaratës së Vjenës, sipas së cilës qeveritë përfaqësojnë “të gjithë popullin që i përket territorit, pa dallim të çfarëdo lloji” jep besim për pohimin se një bllokim i tillë i plotë i ushtrimit të së drejtës së vetëvendosjes (së brendshmi) potencialisht mund të japë rritje të një ushtrimi të jashtëm të kësaj të drejte, d.m.th. shkëputje.¹⁹⁸ Ashtu siç ka deklaruar edhe Gjykata e Lartë Kanadeze në lidhje me çështjen e ndarjes së Kebekut:

*“E drejta ndërkombëtare lind në të mirë, të drejtën e vetëvendosjes ... kur një popull i shtypur ... ose kur një grup i caktuar i është mohuar qasja kuptimplotë ndaj qeverisë për të ndjekur zhvillimin e tij politik, ekonomik, social dhe kulturor. Në të tria situatat, njerëzit në fjalë kanë të drejtë për vetëvendosje të jashtme, sepse atyre u është mohuar mundësia për të ushtruar të drejtën e tyre të brendshme për vetëvendosje”.*¹⁹⁹

Pavarësisht nga kjo jurisprudencë progresive, megjithatë në fakt, ka pak dëshmi të drejtpërdrejta për sa i përket mbështetjes së të drejtës për t’u shkëputur nga e drejta zakonore ndërkombëtare.²⁰⁰

Përkundrazi, studiuesit e sotëm duhet t’i shikojnë praktikën shtetërore në dhjetëvjeçarin e fundit, të cilat duket se sugjerojnë shfaqjen e një të drejte të njohur për shkëputje në rrethana të veçanta.²⁰¹

Shembujt e vetëvendosjes së dhunshme, që janë mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare dhe shtete të ndryshme fqinje, si pasojë e rënies së Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërjes së Jugosllavisë janë veçanërisht të ndriçuara. Përveç kësaj, reagimi ndërkombëtar për përpjekjet për shkëputje në kontekstin e dekolonizimit në Eritrea dhe Timorin Lindor, po dhe jashtë kontekstit të dekolonizimit, për shembull në ish-

¹⁹⁷Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë, shënimi 66, në paragraf. 134.

¹⁹⁸Po aty.

¹⁹⁹Shih: Vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë, shënimi 66, në paragraf. 138.

²⁰⁰Eastwood. L.S *Seksioni: Praktika e Shtetit dhe e Drejta Ndërkombëtare pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë*, 3 Duke. J. Int’l L. 299, në 300.

²⁰¹Eastwood. L.S *Seksioni: Praktika e Shtetit dhe e Drejta Ndërkombëtare pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë*, 3 Duke. J. Int’l L. 299, në 300.

Bashkimin Sovjetik, dhe në ish-Jugosllavi janë të rëndësishme pasi ato ndihmojnë në vendosjen e ligjit për zhvillimin zakonor mbi të drejtën për shkëputje, në ndjekje të vetëvendosjes, ku një ushtrim i tillë është brendësisht i pamundur. Duhet të theksohet, megjithatë, se suksesi i kërkesave për shkëputje i atribuohet në pjesën më të madhe vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare për ta zgjeruar njohjen me to.

9. Rastet e lëvizjes separatiste

9.1. Rasti i Eritresë.

Rasti i **Eritresë** ka të bëjë me dekolonializimin, por ai ka një natyrë të veçantë, aq sa Etiopia, shteti që ka pretenduar për një kohë të gjatë të drejta territoriale mbi të, i është nënshtruar vetë sundimit kolonial nga Italia²⁰² (Eritreja ishte një koloni italiane). Etiopia ka pretenduar se kishte ligjshmëri absolute të Eritresë, duke qenë një pjesë përbërëse e Etiopisë. Ndërkaq, eritreanët konstatuan se ata kishin të drejtë për vetëvendosje dhe se Etiopia e kishte injoruar dhe në fakt e kishte mohuar këtë të drejtë.²⁰³

Midis shekujve XI dhe XIX, Eritreja u bë pjesë anësore e Etiopisë. Ajo u pushtua nga Italia në 1885, dhe më pas u shndërrua në një koloni italiane në përputhje me Traktatin e Ucciali-t të 1889-ës, së bashku me Etiopinë. Prandaj, nga ky Traktat, Etiopia ra dakord për përvetësimin e sovranitetit nga ana e Italisë mbi Eritrean. Kështu rajoni u bë një njësi koloniale.²⁰⁴

Kur sundimit kolonial italian i erdhi fundi, Britania e Madhe administroi Eritrean nën një kujdestari, deri në vitin 1952. OKB-ja vendosi për t'i ndarë dy çështjet: atë të ardhmes së Eritresë dhe atë të statusit të pavarur të Abisinisë/Etiopisë. Një Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (Rezoluta 269 IV e 21 nëntorit 1949) caktoi një Komision përgjegjës për dorëzimin e propozimeve. Asambleja e Përgjithshme nuk parasheh mbajtjen e një referendumi apo një votim për të konstatuar dëshirat e popullatës. Rrjedhimisht, Komisioni vlerësoi “dëshirat politike të partive dhe njerëzve”, duke mbledhur pikëpamjet e “partive kryesore politike dhe shoqatave” dhe duke “mbajtur seanca të popullatës vendore”.²⁰⁵

²⁰² Etiopia ishte Anëtare e Lidhjes së Kombeve. Ajo u pushtua nga Italia në mes të 1935-1941.

²⁰³ Shih Vetëvendosja: Një Rivlerësim Ligjor, shënimi supra 4, në 218-222.

²⁰⁴ Po aty, në 222.

²⁰⁵ Raporti i OKB-së i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Eritrean, 1950, DOC i OKB-së. A/1285, 17 ff., në parag. 106-31

Kështu ai arriti në përfundimin se shumica e eritreanëve i ka favorizuar shoqatat politike me Etiopinë.²⁰⁶ Rruga e ndjekur nga Komisioni për t'i mbrojtur dëshirat e popullatës së Eritresë mbetet e diskutueshme, dhe konsiderata e fundit do të ishte ndryshe, duhej mbajtur një referendum. Duket se konsideratat politike dhe strategjike mbizotërojnë mbi të drejtën e vetëvendosjes, si shprehje e vërtetë dhe e lirë e vullnetit të një populli.²⁰⁷

Asambleja e Përgjithshme ka vendosur: “Eritrea përbën një njësi autonome të federuar me Etiopinë nën sovranitetin e Kurorës Etiopiane”.²⁰⁸ Administrata Britanike e Eritresë përfundoi në vitin 1952 dhe në të njëjtën kohë, u krijua Federata. Megjithatë Federata ishte jetëshkurtër, sepse Kuvendi eritrean votoi në nëntor të 1962-së për përfshirjen e Eritresë në Etiopi, kështu Eritrea u bë një provincë e Etiopisë. Eritreanët kanë krijuar, që nga viti 1961, një lëvizje çlirimtare, Fronti Eritrean Çlirimtar, që u pasua në 1970 nga një tjetër lëvizje dhe që ishte e angazhuar në një luftë të armatosur me autoritetet etiopiane. Kohët e fundit, pas rënies së qeverisë Mengitsu, eritreanët kanë fituar kontroll të plotë mbi Eritrenë dhe pas një referendumi në vitin 1993 shpallën pavarësinë e tyre.

Në përputhje me rrethanat si dhe me referendumin e mbajtur nën vëzhgimin e ndërkombëtarëve, u vendos me vullnetin e lirë dhe të mirëfilltë të eritrejanëve për t'u bërë të pavarur.

Është e qartë nga ky rast, se eritreanët patën sukses në pretendimet e tyre për pavarësi për këto arsye: 1) lëvizjet e tyre çlirimtare morën përsipër kontrollin e territorit të Eritresë; 2) e drejta e tyre për vetëvendosje nuk është zbatuar për shkak të vendimit të bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar një Federatë. Pra, në këtë rast, pretendimi i integritetit territorial është dashur, të jepet në mbështetje të së drejtës për vetëvendosje.

9.2. Rasti i Timorit Lindor.

Timori Lindor u bë pjesë e agjendës ndërkombëtare në vitin 1960, kur Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e shtoi këtë territor në listën e territoreve jo vetëqeverisëse. Para kësaj, Timori Lindor administrohej nga Portugalia. 14 vjet më vonë, Portugalia u përpoq të krijojë një qeveri të përkohshme dhe një asamble popullore, që do të përcaktonte statusin e Timorit Lindor. Një luftë civile shpërtheu

²⁰⁶ Aty. 21, në 132-5.

²⁰⁷ Shih Vetëvendosje: Një rivlerësim ligjor, shënimi 4, në paragraf. nr. 58.

²⁰⁸ Po aty .

mes përkrahësve të pavarësisë dhe atyre që mbështetën integrimin me Indonezinë. Portugalia u tërhoq duke mos qenë në gjendje për ta kontrolluar situatën. Më pas, Indonezia ndërhyri me mjete ushtarake të përfshira në Timorin Lindor si krahinë e saj e 27-të.²⁰⁹

Kombet e Bashkuara nuk e njohën asnjëherë përfshirjen e Timorit Lindor në Indonezi dhe të dy: Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme kërkuan që Indonezia të tërhiqet nga Timori Lindor. Në vitin 1982, OKB-ja, Portugalia dhe Indonezia filluan negociatat për çështjen e statusit të Timorit Lindor. Në vitin 1998, Indonezia propozoi një autonomi të kufizuar për Timorin Lindor brenda Indonezisë. Diskutimet çuan në përfundimin e një marrëveshjeje ndërmjet Indonezisë dhe Portugalisë, nënshkruar në Nju Jork në 5 maj 1999. Të dy qeveritë caktuan Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për të filluar procesin e konsultimeve popullore me qëllim vendosjen e vullnetit të timorezëve lindorë për ta pranuar ose për ta refuzuar autonominë e veçantë që u ishte ofruar atyre brenda Indonezisë. Këshilli i Sigurimit vendosi për krijimin e Misionit të Administrimit të Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (UNAMET) në 11 qershor 1999 ,për të organizuar procesin e konsultimit dhe për ta vëzhguar për një periudhë kalimtare zbatimin e vullnetit të popullit të Timorit Lindor. Votimi, i cili u mbajt më 30 gusht 1999, rezultoi në 78,5% të votave për refuzimin e autonomisë së propozuar dhe fillimin e një procesi kalimtar drejt pavarësisë.²¹⁰

Pas shpalljes së rezultatit të referendumit, policia që ishte pro-integrimin dhe me mbështetjen e forcave të sigurisë të Indonezisë, filloi një fushatë dhune dhe shpifjesh në të gjithë vendin. Si pasojë, shumë njerëz u vranë dhe 500,000 u zhvendosën nga shtëpitë e tyre gjysma e të cilave u dëbuan me forcë nga territori. Si përgjigje UNSC-ja autorizoi vendosjen e një force shumëkombëshe (INTERFET) për të rivendosur paqen dhe sigurinë në Timorin Lindor si dhe për të mbështetur dhe për të mbrojtur UNAMET-në në kryerjen e detyrave të saj. Autoritetet indoneziane u larguan nga Timori Lindor, dhe më 28 shtator 1999, Indonezia dhe Portugalia ranë dakord që OKB-ja ta merrte përsipër autoritetin mbi Timorin Lindor. Më 25 tetor të po atij viti, SC-ja vendosi me anë të Rezolutës 1272 (1999) për të krijuar një administrim kalimtar të OKB-së në Timorin Lindor (UNTAET) me përgjegjësi të plotë për administrimin e territorit të Timorit Lindor.

²⁰⁹ Për më shumë informacion, Shih <http://www.un.org/peace/etimor>.

²¹⁰ Aty

9.3. Vetëvendosja dhe shpërbërja e BRSS-së.

Pas revolucionit komunist të vitit 1917, Bolshevikët trashëguan një mozaik të një perandorie që qeverisej me Romanovët, e cila po përballlej me rrezikun e shpërbërjes në kombësi përbërëse. Duke marrë në konsideratë prirjet e forta separatiste të disa kombësive, Lenini mbështeti një strategji sipas të cilës, kombësitë nuk do të ishin subjekt i dominimit rus por do të kishin autonomi dhe do të kishin të drejtën të shkëputeshin nëse donin të vepronin kështu. Rezultati ishte krijimi i një shteti federal me 15 republikat e bashkimit, 20 republikat autonome, 8 oblasts (ndarje administrative) autonome, dhe 10 oblasts kombëtare.²¹¹

Në Kushtetutën Sovjetike, e drejta për vetëvendosje, e cila u perceptua kryesisht si një e drejtë për shkëputje, ishte menduar si një mjet politik për t'i bashkuar kombësitë dhe jo për të siguruar mjetin për shkëputje²¹². Pavarësisht prej kësaj njohjeje, në praktikë nuk ekziston një e drejtë e tillë për vetëvendosje. Krijimi i një sistemi të rreptë diktatorial shtypi çdo pakënaqësi apo mospëlqim të kombësive joruse. Megjithatë ata ruajtën identitetin e tyre etnik. Reformat politike, të njohura si *glasnost* dhe *perestrojka*, të paraqitura nga Gorbaçov-i krijuan një atmosferë lirie që zgjeruan kërkesat e dhjetëra kombësive për vetëvendosje. Trazirat e përgjithshme etnike, të përkeqësuar nga rënia ekonomike, siguruan një bazë të shkëlqyer për të rritur kërkesat separatiste. Akti i parë erdhi nga Parlamenti Lituanez, në dhjetor 1989, me një deklaram të njëanshëm mbi pavarësinë. Në prill të vitit 1990, Sovjeti Suprem miratoi një ligj që parashikonte një periudhë pritjeje prej pesë vjetësh për t'u shkëputur nga federata. Prandaj shpërbërja e Bashkimit Sovjetik ishte e pashmangshme në një moment. Më 17 shtator të vitit 1991, tri shtetet baltike - Lituania, Letonia dhe Estonia u pranuan si anëtare të Kombeve të Bashkuara²¹³. Në dhjetor të po atij viti, udhëheqësit e Rusisë, Ukrainës dhe Bjellorusisë u takuan në Minsk dhe shpallën krijimin e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (CIS). Shpërbërja e BRSS-së ishte një akt vullnetar, që u plotësua me përfundimin në Alma-Ata të Protokollit të Marrëveshjes së Minskut, ku të gjitha republikat e mbetura, përveç Gjeorgjisë, iu bashkuan CISE-së dhe si rrjedhojë, e drejta për vetëvendosje dhe pranueshmëria në OKB e ish-Republikave Sovjetike, të cilat u bënë shtete të

²¹¹Blay. S. (1994). *Vetëvendosja: Një Rivlerësim në Zonën Post Komuniste*, 22 DENV. J. Int'l L. & POL'Y, fq. 285.

²¹²Arkitektët e Bashkimit Sovjetik besonin se një garanci e vetëvendosjes separatiste do të inkurajonte pjesëmarrjen e grupeve kombëtare separatiste në bashkimin.

²¹³Shih Rezoluten nr 46/4 të vitit 1991.

pavarura, nuk u vu asnjëherë në dyshim. Shkëputja e Shteteve Baltike ndryshon nga shkëputjet e tjera me të cilat është përballur OKB-ja, pasi ato kanë ekzistuar si shtete të pavarura para aneksimit të tyre të paligjshëm nga Bashkimi Sovjetik. Refuzimi për ta njohur aneksimin sovjetik u bazua mbi këtë paligjshmëri. Prandaj Shtetet Perëndimore kishin justifikimin ligjor për t'i njohur republikat nëse e zgjidhnin këtë. Pavarësisht prej bazës së paligjshme të aneksimit të republikave, realitetet politike para vitit 1990, vepruan kundër njohjes së tyre. Është e vërtetë se, edhe pse njohja ka ndikime gjyqësore, ajo është në thelb me karakter politik. Pa dyshim, të tria republikat zotëruan atributet themelore të shtetësisë: tokën, popullsinë dhe qeverinë, si dhe aftësinë për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare. Tri karakteristika duhet të theksohen në këtë rast: a) shteti-amë ose nuk ishte i gatshëm ose ishte i paaftë për ta ushtruar ose për ta rimarrë kontrollin mbi territoret që u shkëputën, b) një shkallë e konsiderueshme e pavarësisë dhe c) mungesa e protestës kundër njohjes së shteteve.

Ndërsa republikat e tjera Sovjetike lidhën Marrëveshjen e Minskut dhe Protokollin Alma-Atës, ku ato shprehën marrëveshjen e përbashkët të republikave përbërëse për ta shpërbërë bashkimin, republikat nuk u shkëputën si të tilla nga bashkimi, ato e shpërbënë atë vullnetarisht. Megjithatë, kjo është arsyeja që njohja ndërkombëtare për anëtarët e CIS-së erdhi pas shpërbërjes kushtetuese të BRSS-së dhe dorëheqjes së Gorbaçovit. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik nuk u kundërshtua nga qeveria e BRSS-së. Pas shpërbërjes, statusi i republikave përbërëse ishte ai i subjekteve të pavarura, që zotëronin atributet themelore të shtetësisë.

KREU VI: VETËVENDOSJA DHE KRYENGRITJA. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1. Kryengritësit.

Kryengritësit dhe lëvizjet kryengritëse mund të përkufizohen si një grup individësh, të cilët kanë fituar kontrollin e një pjese të caktuar të territorit dhe të armëve që përdoren gjatë luftës civile apo lëvizjeve të brendshme revolucionare, për të arritur qëllime të caktuara politike. Mund të veçojmë dy skenarë tipikë të kryengritjes, pikërisht, në lidhje me qëllimet e kryengritjes: i pari është kur lëvizja popullore lind në funksion të qeverisë së formuar në shtetin me një përbërje ndryshe nga e kryengritësve; i dyti ndodh, kur të njëjtët kanë si qëllim ndërtimin e një shteti të ri, krahas atij ekzistues, në një pjesë të hapësirës territoriale në të cilin ata janë të vendosur. Për të qenë të sinqertë, në thelb kjo dukuri është e huaj në sferën e së drejtës ndërkombëtare, sepse veprimet u atribuohen kryengritësve që gjithmonë janë brenda organizimit të brendshëm, edhe kur behet fjalë për organizimin e shtetit kundër të cilit luftohet për të fituar pavarësinë, ashtu edhe kur bëhet fjalë për organizimin e shtetit, të cilin më në fund e formojnë. Në këtë këndvështrim, mjafton të mendosh se çfarë diferencash bëhen menjëherë në planin e perceptimit të zakonshëm, midis luftës civile (konflikt i thjeshtë i brendshëm) dhe një lufte ndërkombëtare, që është një konflikt midis shteteve sovraane, rregulluar si e tillë nga e drejta ndërkombëtare luftarake. Por nuk duhet të neglizhohet fakti, se problemi i kryengritësve pasqyrohet në një plan më të përgjithshëm marrëdhëniesh ndërmjet ligjit të brendshëm të shtetit, të prekur nga trazirat dhe sistemit juridik ndërkombëtar. Ose, me fjalë të tjera, këto dukuri, duke qenë delikate të brendshme, shoqërohen me implikime domethënëse ndërkombëtare.

Së pari, ndodh zakonisht që palët në konflikt, qeveria e quajtur e ligjshme dhe kryengritësit, të respektojnë një bazë minimale (e cila, ka ardhur gradualisht duke u zgjeruar, në sajë të punës së gjykatave të ndryshme specifike, së pari, të ngritura *ad hoc* për krimet e kryera në ish-Jugosllavi) të së drejtës humanitare, kështu që nuk është praktikë e pazakontë që ata të hyjnë në marrëveshje të krahasueshme me traktatet e vërteta ndërkombëtare.

Përveç kësaj, është e mundshme që kryengritësit të vendosin marrëdhënie dhe kontakte të llojeve të ndryshme me vendet e treta e në këtë mënyrë, ku edhe në këtë rast do të jetë e zbatueshme e drejta ndërkombëtare (për shembull, për trajtimin

e shtetasve të vendeve të treta, të cilët janë në territorin që është nën kontrollin e tyre).²¹⁴

Bazuar në sa thamë më sipër, për të folur për subjektivitetin ndërkombëtar të kryengritësve, janë të nevojshme dy supozime: 1) që kryengritësit janë të organizuar në një zinxhir komandash të përgjegjshme dhe të identifikueshme qartë; 2) ata ushtrojnë kontrollin *de facto* në një pjesë të territorit të shtetit²¹⁵.

Sigurisht, subjektiviteti i tyre ndërkombëtar nuk mund të jetë kurrë i plotë dhe do të ketë, për nga natyra e tyre kryengritëse, efikasitetin e nevojshëm të përkohshëm. Prandaj, një status ligjor i tillë duhet zgjidhur domosdoshmërisht, ose duhet shpërbërë lëvizja rebele, atëherë kur lufta e tyre nuk ka sukses, ose të shndërrohet në një shtet të ri, në rast se supozojmë se arrihen qëllimet fillestare. Nënkuptime të lehtësimit të atribuar nga e drejta ndërkombëtare për kryengritësit janë zhvillimet e kodifikimit të së drejtës ndërkombëtare të luftës, nga të cilat vlerësohet veç të tjerave, rëndësia e dallimit të konflikteve të brendshme dhe atyre ndërkombëtare. Së pari, merren në konsideratë të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, në të cilat është gjetur një dispozitë, e cila përfshin rastin e një konflikti të armatosur, të lindur brenda një shteti, pjesë të zbatimit të disa dispozitave thelbësore të të drejtave të njeriut, si dhe ato që përmes marrëveshjeve të veçanta, merren përsipër vullnetarisht për t'u vëzhguar.

Së dyti, një vend të rëndësishëm zë Protokollin i dytë plotësues për të njëjtat konventa, lidhur me mbrojtjen e viktimave të konflikteve jondërkombëtare, i nënshkruar në Gjenevë, më 8 qershor 1977. Ky zbatohet "në konflikte të armatosura, të ndryshme nga ato ndërkombëtare, që zhvillohen në territorin e një Pale të Lartë Kontraktuese midis forcave të saj të armatosura dhe forcave disidente të armatosura ose grupeve të armatosura, të organizuara nën drejtimin e një komande përgjegjëse, që ushtrojnë kontroll tërësor, në një pjesë të territorit, gjë që ua bën të mundur atyre, të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe ua lejon bashkërendimin dhe zbatimin e Protokollit aktual." Siç e shohim, në shkronjat e dispozitës, janë të pranishme pikërisht elementet që pamë pak më parë e që i karakterizojnë ontologjikisht kryengritësit, përgjegjësinë komanduese dhe kontrollin e territorit. Të dy elementet kontribuojnë për t'i dalluar veprimet kryengritëse nga ngjarje të ndryshme, të tilla si situatat e tensionit të brendshëm, trazirat e brendshme, lëvizjet,

²¹⁴ Benvenuti, P. (1981). *Movimenti insurrezionali e Protocolli aggiuntivi alle Convenzioni di Ginevra del 1949*, in RDI, ,pg.527.

²¹⁵ Po Aty ,pg.528.

aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës dhe të tjera të ngjashme, të cilat nuk hyjnë në fushën e zbatimit të Protokollit. Teknikisht, Protokollin në të vërtetë sjell një detyrim vetëm ndaj pjesëve të tjera të protokollit, që të sigurojë një trajtim të caktuar për kryengritësit nga ana e shtetit të përfshirë në ngjarjet e shfaqura në mjedisin e tij, që nuk janë shpërblime për mbartësit e së drejtës, por vetëm përfitime ligjore *inter alios*. Veçse është e pamohueshme se i njëjti parashikim i këtyre detyrimeve të jetë më tej një argument në favor të njohjes së subjektivitetit ndërkombëtar për kryengritësit, qoftë edhe pjesërisht. Në përgjithësi, cilido të jetë termi i mundshëm që vendoset për ta përcaktuar një formë rebelimi, do të rrjedhin akuza në lidhje me krerët e palëve ndërluftuese dhe me shtetet e treta, për të gjitha të drejtat dhe detyrimet tipike të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme të luftës, dhe në veçanti atyre relative, midis statusit dhe trajtimit të luftëtarëve legjitimë, si dhe të asaj që imponon detyrimi i asnjansisë nga ana e shteteve të treta. Ndërsa në rastin e një konflikti të kualifikuar si të brendshëm, e drejta ndërkombëtare kërkon që bashkësia ndërkombëtare të mos ndërhyjë në punët e brendshme të shtetit në fjalë, për të cilin me të drejtë mund të pretendojnë edhe të drejtën për menaxhimin ekskluziv të punëve të brendshme, përputhur me ndalimin e njohjes së parakohshme të kryengritësve (d.m.th., para se ata të kenë arritur fuqinë e vërtetë të qeverisjes mbi një pjesë të territorit). Pra, një detyrim për të abstenuar që buron nga përmbajtja, sigurisht më e gjerë dhe specifike, sesa ajo e asnjansisë së përgjithshme që ushtrohet në rastin e një konflikti ndërkombëtar. Megjithatë, në mënyrë që të shmanget pështjellimi, duhet të kujtojmë këtu atë që kemi thënë më parë dhe të vihet një vijë e qartë ndarëse midis fenomeneve kryengritëse dhe lëvizjeve çlirimtare kombëtare. Ndërsa të parat organizohen me rastin e një lufte civile apo nga lëvizjet të brendshme revolucionare, me qëllim kryesor zëvendësimin e qeverisë aktuale me një të re, (e ashtuquajtura qeveri e përgjithshme *de facto*), ose për të krijuar një shtet të ri në një pjesë të territorit ekzistues (i njohur *de facto* si pushtete vendore); të dytët punojnë për çlirimin e popullit që ata e përfaqësojnë nga një lloj dominimi kolonial ose racist, përgjithësisht të huaj. Duke bërë këtë sqarim, ne mund të përfundojmë se për kryengritësit kërkohet një vlerësim objektiv me detyrimin për ta kuptuar pse e drejta ndërkombëtare është indiferente në lidhje me mënyrën e qeverisjes së popujve, duke qenë para së gjithash një e drejtë ndërshtetërore, nuk do të thotë se kryengritësit janë tërësisht të lirë nga ligjet që kushtëzojnë fuqinë, duke i detyruar të paktën kundrejt njëri-tjetrit, që të sigurojnë një trajtim të caktuar për popullin të cilin ata e qeverisin dhe t'u sigurojnë atyre respektimin e të drejtave themelore njerëzore.

2. Levizjet e qeverive kolonialiste dhe raciste.

Problemi kolonial ishte një nga teoritë e hershme të parimit të vetëvendosjes, në krye të shqetësimeve të shteteve. Në të vërtetë, pozicioni i rëndësishëm që kanë fituar disa prej shteteve sunduese të zotërimeve koloniale në bashkësinë ndërkombëtare, siç e kemi parë, pengoi për një kohë të gjatë dëshirën e popujve për vetëvendosje, për shkak të pasojave logjike që mund të rridhnin nga shpërbërja e perandorive të ndërtuara prej tyre. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, në gjetjen e kufijve të shteteve, nuk u mbajt parasysh në asnjë mënyrë, dëshira e popujve në fjalë, por u kufizua në ratifikimin e aseteve të shteteve dhe në përcaktimin e kufijve, ashtu siç u përcaktua nga raporti i forcave fituese midis Fuqive (parimi i *uti possidetis iuris*). Në këtë drejtim, Karta e Kombeve të Bashkuara padyshim i dha një rëndësi të madhe parimit të vetëvendosjes, por vetëm parimisht, sepse nuk caktoi ndonjë detyrim shtrëngues për shtetet evropiane, në mënyrë që të hiqnin dorë nga kolonitë e tyre e për t'u lejuar atyre autonominë, duke përcaktuar kështu thjesht një të ardhme hipotetike të emancipimit të tyre. Megjithatë, sot gjendja është përmirësuar ndjeshëm, për hir të zhvillimit të mëvonshëm të së drejtës zakonore ndërkombëtare, duke filluar që nga Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Dekolonializimin (1960), e cila parashikon shprehimisht një detyrim pozitiv të shteteve për ta përkrahur vetëvendosjen; me deklaratën e marrëdhënies miqësore (1970), e cila nga ana e vet, përcakton përdorimin e forcës për t'i privuar popujt nga identiteti i tyre kombëtar, si shkelje të të drejtave të tyre të patjetërsueshme për të arritur në përkufizimin e agresionit (1974), i cili njeh parimin e mosndërhyrjes dhe ndalon pikërisht, kërcënimin dhe përdorimin e forcës kundër rasteve të vetëvendosjes.

Nuk duhet të harrojmë as paragrafin 4 të Nenit 1 të Protokollit të parë Shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, që është i barasvlershëm me konfliktet e luftërave ndërkombëtare, në të cilat popujt luftojnë kundër sundimeve koloniale, regjimeve raciste dhe pushtimeve të huaja, përveç "elementeve materiale të kontrollit efektiv të një zone, për t'ihënë përparësi fundit e penalizimit të kryengritësve. Kolonializmi atëherë mund të krahasohet në mënyrë të arsyeshme me aparteidin (d.m.th. regjimet që praktikojnë në shkallë të gjerë, përmes legjislacionit specifik, diskriminimin racor), e cila sot është konsideruar gjerësisht një krim kundër njerëzimit. Në pohim të vlerësimeve negative të së drejtës ndërkombëtare, një studiues vuri në dukje se klasifikime të tilla janë kuptuar në disa raste si mohim i personalitetit juridik ndërkombëtar të Shtetit, i cili praktikon aparteidin, si në rastin e

Rodesë Jugore, kundër së cilës Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi masa izolimi tërësore, duke përjashtuar në thelb subjektivitetin²¹⁶.

Prandaj, bazuar në këto të dhëna, mund të konkludohet, se e drejta ndërkombëtare e ka ligjëruar tani, edhe pse në rrethana të veçanta, luftën e kryengritësve, që armatosen për të mbrojtur të drejtën e tyre për vetëvendosje.

Por kush ka të drejtë për të verifikuar natyrën e qeverisë raciste dhe/ose koloniale kundër së cilës kryengritësit janë duke luftuar?

Duket e pamjaftueshme që shteti ndërhyrës të bëjë deklarata të njëanshme për ta përligjur përkrahjen e saj eventuale ushtarake ndaj rebelëve, që qeveria legjitime diskriminon në bazë të racës apo zbaton një lloj sundimi kolonial²¹⁷.

Prandaj duhet ligjëruar disi lufta e lëvizjeve çlirimtare kombëtare nga një akt i Kombeve të Bashkuara, i tillë si, rezoluta e dënimit ndaj regjimit, apo një deklaratë mbështetëse për kryengritësit²¹⁸.

A do të ishte e lejueshme ndërhyrja e një shteti të tretë për të ndihmuar një qeveri haptazi kolonialiste apo raciste për të shtypur një revoltë?

Është e pëlqyeshme t'ipërgjigjesh negativisht kësaj pyetjeje. Nëse qeveria e krijuar nuk mund ta përdorë forcën kundër kryengritësve që luftojnë për çlirimin nga një regjim kolonial apo racist, në më të shumtën e rasteve është e nevojshme të përjashtohet pranueshmëria e ndërhyrjes së shtetit të huaj, si me "instruksione" për të plotësuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në të njëjtin konflikt, ashtu edhe me ndonjë mënyrë tjetër (për shembull, furnizimet me armë që kanë për qëllim nxitjen e shtypjes së kryengritësve, që do të lejonte vazhdimin e situatës së kolonializmit, në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare)²¹⁹.

Praktika ndërkombëtare është përdorur për ta mbështetur këtë përfundim, prandaj asnjë shtet nuk i ka mbështetur qëndrimet e Izraelit, Portugalisë dhe Afrikës së Jugut me bindjen për paligjshmërinë e tyre.

Nga ana tjetër, për sa i përket mundësisë së dhënies së ndihmës ose të sjelljes së ndihmave ndaj kryengritësve që ngrihen për të arritur vetëvendosjen (gjithmonë kundër një qeverie kolonialiste apo raciste), ndiqet një ushtrim i veçantë i ndalimit

²¹⁶Conforti, B. (1996). *Diritto Internazionale*, Napoli, pg.18.

²¹⁷Roscini. M. (2000). *Autodeterminazione tramite realtà*, Università di Roma "La Sapienza", pg.3.

²¹⁸Shih, Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për njohjen e legjitimitetit të luftës së Namibisë kundër pushtimit të Afrikës së Jugut (1970), dhe rezolutën 390 e 1950 të Asamblesë së Përgjithshme.

²¹⁹ Roscini. M. (2000). *vep e cit*, pg.33.

tradicional për asistencë. Në fakt, lufta e kryengritësve, e klasifikuar nga fakti i të qenit revoltë për vetëvendosje, është konsideruar në mënyra të ndryshme nga kryengritja e përgjithshme: të parët luftojnë për një territor që është kulturalisht, etnikisht dhe shpesh gjeografikisht (shih rastin e kolonive) i dallueshëm nga koncepti e atdheut; lufta e tyre merr shpesh, në përputhje me objektivin e ndjekur, vlera ndërkombëtare dhe jo vetëm të brendshme; dhe në më të shumtën e herëve njihet nga OKB-ja me anë të akteve, që edhe pse nuk kanë efekt detyrues, në një farë mënyre kanë efektin "legjitimues". Nuk bashkohen me konstatimin e mësipërm ata që në mënyrë të paligjshme për të ndjekur një rekomandim të Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit të Sigurimit, shkelin detyrimin e një marrëveshjeje apo tradite të mëparshme. Në këtë kuptim, rezolutat e ndryshme të OKB-së²²⁰ i ftojnë të gjitha shtetet t'i miratojnë të gjitha masat e nevojshme për ta lehtësuar ushtrimin e së drejtës së popujve për vetëvendosje, ndërsa deklarata për marrëdhënie miqësore²²¹ njeh të drejtën e rezistencës së popullit, i cili mundet në këtë mënyrë të kërkojë dhe të marrë ndihmë nga shtetet e tjera. Ligjshmëria e kësaj sjelljeje mund të shihet veçanërisht, në rastet e rekomandimeve të Këshillit të Sigurimit, i cili u bën thirrje shteteve të marrin masa shtrënguese sipas Kreut VII të Kartës²²².

Vlen të përmendet rezoluta²²³ që dënoi si agresion veprimin e Portugalisë ndaj Senegalit, në bazë të karakterit kolonialist të politikës portugeze, megjithëse Shteti Afrikan do të mbështeste luftëtarët e lirisë kundër Guine-së.

Në një rezolutë të mëvonshme²²⁴, Këshilli rithekson se vetëm respektimi i plotë i kufijve të shteteve dhe parimit të vetëvendosjes do të lejojë zhdukjen e motiveve të tensionit²²⁵.

Këto udhëzime janë mishëruar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila ka njohur ligjshmërinë e kryengritjes që synon çlirimin kombëtar²²⁶ duke marrë përsipër dy pasoja të mëdha:

²²⁰Asambleja e Përgjithshme në, Rezolutën.n.2160 të 1966.

²²¹Asambleja e Përgjithshme në, Rezolutën n.2625-XXV të 1970

²²²Asambleja e Përgjithshme në, Rezolutën n.221 të1966.

²²³Asambleja e Përgjithshme në, Rezolutën n.294 të 1971 e Këshillit të Sigurimit.

²²⁴Asambleja e Përgjithshme në, Rezolutën n.321 të 1971 e Këshillit të Sigurimit.

²²⁵Bennouna, M. (1974). *Le consentement à l'ingérence militaire dans les conflits internes*,Parigi, pp.164.

²²⁶Shih njoftimin e 21 Qershorit 1971,fq.52 e 53.

- **ligjshmërinë** e mbështetjes morale dhe materiale ndaj kryengritësve për rivendosjen e të drejtave të tyre të patjetërsueshme;

- **paligjshmërinë** e çfarëdo forme të ndihmës në shtypjen e luftërave kryengritëse.

Pra, ne mund të themi se në një situatë të tipit kolonial, shkëputja e mundshme e territorit kryengritës mund të konsiderohet si një restaurim i një sovraniteti uzurpues²²⁷, sepse në fakt territori i një kolonie duhet të konsiderohet si një territor që gëzon një status të veçantë dhe të mëvetësishëm nga ai i shtetit sundues. Në të vërtetë ajo pranon atëherë, çuditërisht, përdorimin e forcës nga ana e një shteti në rastin e shpërbërjes, edhe pse një përdorimi i tillë lejohet vetëm për ato subjekte që garantojnë respektimin e parimeve të barazisë dhe vetëvendosjes. Një shembull mund të jetë sqarues: Situata në Bangladesh, i cili u nda nga Pakistani për hir edhe të ndihmës ushtarake të Indisë, ishte konsideruar si e tipit kolonial. Dhe kjo për disa arsye: për shkak të largësisë gjeografike mes dy vendeve; për nga ndryshimet gjuhësore, kulturore, etnike, ekonomike; për shkak të vullnetit popullor, që në zgjedhjet e 28 shkurtit 1971, ishte shprehur në mbështetje të mëvetësisë (autonomisë); për faktin se shkëputja mund të bëhej pa paragjykim ndaj atdheut, sepse Pakistani në shuarjen e revoltës ishte fajtor për mizori të tilla sa që meritonte akuzën për gjenocid. Në Kombet e Bashkuara vetëm disa shtete e dënuan krijimin e Bangladeshit, ndërsa të tjerat, duke mos e miratuar në mënyrë eksplicite veprimin indian, deklaruan se për çdo zgjidhje do të duhej marrë parasysh vullneti i popullit të Bangladeshit. Nga ana e saj Asambleja e Përgjithshme miratoi një rezolutë për armëpushim dhe për tërheqjen e të gjitha trupave të huaja (duke përfshirë edhe Pakistanin), ratifikoi praktikën e ndarjes, ndërkohë që pa asnjë censurë, goditi Indinë. Megjithatë duhet të theksohet se ndihma ndaj kryengritësve nuk mund të marrë në asnjë mënyrë formën e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë, sepse ndihma duhet të jepet në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe nuk ka asnjë dispozitë që ligjëron përdorimin e forcës përtej dispozitave të Kartës. Në një kontekst krejt tjetër mund të thuhet se shtetet e Botës së Tretë dhe ato ish-socialiste e kanë pohuar gjithmonë nevojën e bashkëpunimit të jashtëm edhe të një natyre ushtarake në mbështetje të kryengritësve dhe kundër regjimeve koloniale, dhe kjo në bazë të parakushteve të padiskutueshme se këto shtete nuk janë pajisur me forcën e armatosur, të përshtatshme dhe të aftë për luftën kundër ushtrive të rregullta.

²²⁷Emerson. R. (1971). *Self-Determination, in American Journal of International Law*, pp.464.

Gjithsesi, shtetet Perëndimore e kanë penguar prej kohësh zhvillimin e një zakoni që përkon me këto teza.

Praktika e pjesës tjetër ka qenë në mënyrë unike në një drejtim diametralisht të kundërt. Në vitin 1963, Konferenca e Parë e Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të organizimit të Unitetit Afrikan propozoi krijimin e një force të veçantë, me detyrë dhënie ndihme ushtarake për lëvizjet çlirimtare afrikane si dhe një fond, i cili do t'i garantonte operacionet financiare, por propozimi nuk ka gjetur zbatim praktik. Pastaj edhe qe unanimisht i dënuar akti i ndërhyrjes ushtarake të Indonezisë në Timorin Lindor për të ndihmuar popullsinë e ishullit të ushtronte të drejtën e vet për vetëvendosje, mohuar nga Portugalia më parë, dhe fraksioni i Fretilin (Fronti Popullor për Çlirimin Timori Lindor) më pas, edhe pse në këtë rast u pa të ketë një konflikt midis popullsisë vendase dhe vendit amë, por vetëm një luftë në mes të fraksioneve që konkurronin për kontrollin. Vetëvendosja mund të arrihej vetëm me tërheqjen e pushtuesit dhe jo për shkak të ndërhyrjes së tyre²²⁸.

Megjithate, duhet të theksohet se disa autorë²²⁹ janë përpjekur ta quajnë të ligjshme ndërhyrjen e drejtpërdrejtë duke e konsideruar atë si një rast të vetëmbrojtjes kolektive kundër agresionit të armatosur të qeverisë në fuqi. Por nuk duket se kjo pikëpamje qëndron, përderisa neni 51 i Kartës së OKB-së (i cili rregullon çështjen e mbrojtjes së ligjshme) e njeh këtë të drejtë vetëm për shtetet dhe jo për kryengritësit në ushtrimin e vetëvendosjes. As përpjekjet për të arritur një ndryshim të gjerë të nenit 51, nuk kanë qenë të suksesshme, për shkak të opozitës së fortë të shteteve Perëndimore dhe mungesës së interesit të Kombeve të Bashkuara.

Lidhur me sa u tha më sipër, për ta ilustruar me një tjetër rast domethënës, mund të kujtojmë se në vitin 1961, India ndërhyri ushtarakisht në koloninë portugeze të Goa-s, duke pretenduar ta cilësonte veprimin e saj si një rast mbrojtjeje të ligjshme kundër kolonializmit, por ky veprim nuk gjeti miratim të qartë nga bashkësia ndërkombëtare dhe si pasojë, përpjekja e Këshillit të Sigurimit për të miratuar një rezolutë dënimi shkoi kot, për shkak të vetos sovjetike (Portugalia iu shmang referimit të çështjes në Asamblenë e Përgjithshme, duke e ditur fare mirë se pozicioni i saj do të ishte i pamundshëm).

²²⁸Elliot, D. P. (1978). *The East Timor Dispute, in International and Comparative Law Quarterly*, pp.238.

²²⁹ Emerson, R. (1971). *Self-Determination, in American Journal of International Law*, pp.465.

3. Kryengritja e një pakice të kufizuar territorialisht kundër një qeverie as kolonialiste, as raciste.

Në hipotezën e kryengritësve që luftojnë kundër regjimeve koloniale apo një qeveri që praktikon institucionalisht aparteidin (vetëm mundësinë e kryengritjes, e cila tani për tani ka arritur njohjen e njëzëshme e ligjimërinë e saj nga bashkësia ndërkombëtare), ka edhe një tjetër situatë tipike për ta marrë si shembull, atë të rebelimit të një pakice etnike kundër një qeverie që nuk e përfaqëson të gjithë popullsinë, edhe pse mund të mos konsiderohet vërtetë raciste. Në këtë hipotezë, është e dukshme se objektivi që vë në lëvizje kryengritësit, nuk është zëvendësimi i qeverisë aktuale, por shpëputja nga shteti në të cilin bëjnë pjesë. Është e qartë se si një situatë e tillë si ajo që sapo hamendësuam vë në lojë çështje shumë më të ndërlikuara sesa ato të shqyrtuara më parë dhe kjo shpjegon pse diskutimi i zhvilluar në kuadër të së drejtës ndërkombëtare për pranueshmërinë e lëvizjeve të tilla kryengritëse, por edhe praktika, janë ende larg të gjeturit të një zgjidhjeje të besueshme.

Në fakt, siç e kemi theksuar në mënyrë të përsëritur, njohja e së drejtës së ndarjes për një bashkësi, do të çonte në mënyrë të pashmangshme në ripërcaktim të shumë prej kufijve që aktualisht ekzistojnë, duke e ndryshuar strukturën politike të një pjese të madhe të rruzullit. Është e dukshme se si kjo ngjarje shihet me shqetësim, nga shtetet që përshkohen nga frika e trysnisë përçarëse të kërkesave separatiste. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara U-Thant, në një konferencë shtypi të mbajtur në Dakar, më 4 janar 1970, u bë zëdhënësi i këtyre rreziqeve duke mbajtur qëndrim në lidhje me revoltën separatiste në Biafra: *“Kur një Shtet Anëtar është pranuar në Kombet e Bashkuara, kjo nënkupton se të gjitha shtetet anëtare të Organizatës e pranojnë parimin e integritetit territorial, të pavarësisë dhe sovranitetit të shtetit në fjalë... OKB-ja asnjëherë nuk ka pranuar, nuk pranon dhe kurrë nuk do të pranojë, mendoj, parimin e shpëputjes së një pjese të ndonjë prej shteteve anëtare të saj ”.*

Edhe deklarata për marrëdhëniet miqësore e vitit 1970, nuk lë vend për dyshime në lidhje me përparësitë e mbrojtjes së integritetit territorial të shteteve ekzistuese. Në fakt, thuhet me kujdes se “në paragrafët paraprakë asgjë nuk do të interpretohet si autorizues apo inkurajues i ndonjë veprimi, që do ta copëtonte apo dëmtonte, tërësisht ose pjesërisht, integritetin territorial ose unitetin politik të shteteve sovrane dhe të pavarura”. Ky përcaktim i së drejtës ndërkombëtare, kohët fundit bëri jehonë në arenën ndërkombëtare. Gjatë luftës në Kosovë, shpërbërja e Federatës

Jugosllave rrezikonte të shkaktonte një "efekt domino", që do të mund të turbullonte tërë balancën e hartës së Ballkanit dhe t'i destabilizonte ish republikat sovjetike. Prandaj, bashkësia ndërkombëtare, në mënyrë të përsëritur, kishte pohuar të drejtën e Serbisë për integritetin e saj territorial, duke propozuar për Kosovën një status autonom nën sovranitetin e Beogradit, në vend të pavarësisë së plotë. Në këtë mënyrë, zgjidhja e këtij konflikti do të ishte rrudhur në një nivel të brendshëm, duke qenë rezultat i një kompromisi të baraspeshuar në mes të kërkesave të të dy palëve.

Në këtë pikë, është i nevojshëm një sqarim rreth kësaj. Njohja dhe dhënia e pavarësisë së Kosovës rrezikonte t'ipërforconte apo t'i ligjëronte pretendimet ndarëse të pakicave të tjera, si: baskët, kurdët apo gjermanishtfolësit e Tirolit Jugor. Mëdyshja që kishte bashkësia ndërkombëtare në atë kohë ishte rreth të kuptuarit të arsyeve për ligjëse që do të mund ta bindnin Serbinë ta pranonte ndryshimin e jashtëm që do ta cungonte territorin e saj, ndërsa shtetet e tjera, si Spanja dhe Italia, në asnjë rrethanë nuk do ta pranonin një detyrim të ngjashëm që do të çonte në "çlirimin" e pjesëve të territorit të tyre.

Në realitet, e meta e këtij arsyetimi është në rrjedhën e mësipërme, sepse është absolutisht e gabuar të krijosh një paralelizëm ose të predikosh ngjashmëri të situatës ballkanike me ato të territoreve të tjera. Në fakt, tani është e konsoliduar mirë që një pretendim separatist është i ligjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse një popull është përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes, në pjesën më esenciale të qarkut vendimmarrës pra, në pamundësi të ushtrimit plotësisht të të drejtave të veta qytetare dhe politike.

Kjo ndodhi padyshim në Kosovë, autonomia e së cilës u fshi substancialisht nga shteti qendror, por jo për Evropën Perëndimore ku pakicat janë vendosur në pozitën e të ushtruarit plotësisht të privilegjeve të tyre civile. Me rastin e konfliktit në Ballkan, Sekretari i Përgjithshëm, Javier Solana, në këtë kontekst, tha se ndërhyrja e NATO-s në Ballkan nuk kishte si qëllim ta shtypte Serbinë, por ta bënte diktatorin Millosheviç të vinte në pozita të arsyeshme dhe të çonte në ndërprerjen e shkeljes së të drejtave themelore të njeriut për popullsinë shqiptare të rajonit. Pra, gjendemi në këtë rast para të ashtuquajturës hipotezë të "ndërhyrjes humanitare", si rezultat i dështimit të trysnisë ekonomike dhe diplomatike të përdorura pa sukses në muajt para Luftës së Kosovës. Në rastin konkret të Serbisë, as nuk mund të bëhet fjalë për shkelje të parimit të mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti. Ajo që e bën të përjashtohet ka të paktën dy arsye: mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nisur nga deklarata e vitit 1948, e cila ka fituar tashmë rëndësi ndërkombëtare dhe përcakton

për këtë arsye një cak a kufizim për ndalimin e ndërhyrjes, gjë që nuk e lejon një shtet ta ndëshkojë dhe ta përndjekë një pjesë të popullsisë së vet; së dyti, duhet marrë parasysh lidhja e pandashme ndërmjet shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut dhe vendosjes së paqes. Edhe pse nuk mund t'i japim këtij pohimi të fundit vlerë absolute (në fakt, ka shumë raste të diktaturave joagresive si Spanja e Frankos apo Argjentina e Pinoçetit), është fakt i pamohueshëm se në më të shumtën e herëve, e dyta varet nga e para dhe ky arsyetim duhet të zbatohet sidomos në një rajon si Ballkani i cili sapo kishte dalë nga një luftë civile e përgjakshme. Në këtë pikë, duket e përshtatshme për ta parashikuar çështjen e mundësisë ose më mirë të themi përputhshmërisë me të drejtën ndërkombëtare të mbështetjes së mundshme apo miratimit për kryengritësit nga shtetet e treta. Në të vërtetë, praktika duket mjaft konstante në këtë drejtim. Në fakt, edhe kur është realizuar ndihma për kryengritësit në shumicën e rasteve nuk ka qenë e qartë si në rastin e popujve afrikanë që luftonin për çlirimin e atdheut. Pra, Franca ishte e kufizuar deri në sigurimin e armëve, nën tryezë, rebelëve Ibo të Nigerisë kundër Biafras (1967-1970), siç dhe bënë edhe Siria, Libia, Jemeni Jugor dhe Iraku, në mbështje të Frontit Eritrean për çlirimin. Si rast i vetëm i asistencës së hapur dhënë kryengritësve mund të quhet mbështetja ushtarake dhe ekonomike e vendeve arabe për Organizatën për Çlirimin e Palestinës, që u shoqërua me shkeljen e qartë të një norme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë nuk mund t'i quajmë praktika të tilla si rregull të përgjithshëm. Siç do të shohim më poshtë statusi ligjor i PLO-së është mjaft i veçantë, sepse edhe nëse qeveria izraelite nuk mund të konsiderohet si raciste apo kolonizuese, bashkëpunimi me organizatën palestineze për ligjet ende nga rezoluta të ndryshme të Kombeve të Bashkuara²³⁰ që ua njeh popujve të tillë të drejtën e krijimit të entitetit politik autonom. Nga ana tjetër, duket më e diskutueshme çështja e mbështetjes së jashtme të një shteti që nuk i jep garanci të mjaftueshme përfaqësimit të popullit duke respektuar sovranitetin e tij. Nëse nga pikëpamja etike nuk duhet të ketë dyshim ndaj fenomenit negativ të ndihmës ndaj një qeverie që shfaq mangësi në nivelin e përfaqësimit të popullit të vet, ekziston sot një rregull zakonor që e ka këtë efekt: askush nuk i kundërshtoi as Britaninë, as Bashkimin Sovjetik, për shembull për mbështetjen e përmendur tashmë

²³⁰Shih Rezolutën nr .252 të vitit 1968, nga ku konsiderohen të pavlefshme të gjitha masat legislative dhe administrative të ndërmarra nga Izraeli që kanë për qëllim ndryshimin e statusit të Jerusalemit.

më lart, që iu dha Nigerisë kundër separatistëve të Biafras, apo Iranit dhe Izraelit për mbështetjen që i dhanë Etiopisë kundër rebelëve të Eritresë²³¹.

4. Kryengritja kundër një qeverie jopopullore

Hipoteza e fundit që mbetet për t'u shqyrtuar është kryengritja e kryer kundër një qeverie që nuk bën asnjë lloj diskriminimi (ndoshta, sepse territori i shtetit është i banuar nga një grup i vetëm etnik), por që nuk gëzon mbështetjen popullore dhe funksionon me anë të përdorimit të forcës. Në fakt, nuk ekziston ndonjë lidhje me raste të këtij lloji, e ndërhyrjeve me gamë të gjerë të Kombeve të Bashkuara dhe nuk mund të gjendet as formalisht në të drejtën ndërkombëtare, një praktikë konstante në lidhje me këtë. Mund të shihet shpesh një prirje për ta kufizuar apo përjashtuar mbështetjen e qeverive që paraqesin këto kërkesa, pa të cilat kjo qasje, me siguri mund të interpretohej si një përjashtim për ndalimin tradicional të ndihmës së kryengritësve.

Parimi i vetëvendosjes ka një përmbajtje ende shumë të paqartë i cili mund të arrihet në përfundime të ngjashme. Mendoni se çfarë shpërdorimi mund të sjellë kristalizimi i një praktike të tillë që mund të rezultojë për shembull, në rast se Fuqitë e Mëdha ndërhyjnë në një luftë civile për të mbështetur partitë apo fraksionet më të pëlqyeshme të tyre, në bazë të hamendësimeve, se qeveria aktuale nuk ishte e pëlqyeshme apo nuk gëzonte mbështetjen popullore. Nga ana tjetër, në këtë situatë, do të ishte e vështirë për të thënë me siguri, se cili prej fraksioneve apo grupeve në luftën për shtënë në dorë të qeverisurit mund të kishte mbështetjen e shumicës së popullsisë. Për të rikujtuar një rast të rëndësishëm në hipotezën e shqyrtuar, mund të kujtojmë se Shtetet e Bashkuara bënë thirrje për nevojën për t'izhdukur diktaturat në Grenada dhe Panama që të përlligjin ndërhyrjet e tyre ushtarake në shtetet e sipërpërmendura (përkatësisht, në vitin 1983 dhe në vitin 1989). Në rastin e parë, një forcë e përbashkët e Shteteve të Bashkuara dhe e gjashtë shteteve të tjera të Karaibeve (me një prevalencë të parë) zbarkoi në ishull në vitin 1983, pas grushtit të shtetit të gjeneralit Austin kundër Maurice Bishop. Operacioni ndeshi një qëndresë të dobët dhe solli në fuqi Eric Gairy, kryeministrin që ishte rrëzuar më parë nga Bishopi. Që të mund ta shqyrtojmë çështjen e parimit të vetëvendosjes, kjo nuk qe më e përfshirë midis justifikimeve juridike të operacionit, (të cilat kishin në fakt

²³¹Ronzitti. N. (1974). *Le guerre di liberazione nazionale e il diritto internazionale*, Pisa, ,pg.111.

mirëkuptim për qeverinë e ligjshme, mbrojtja e nacionalistëve jashtë vendit dhe ruajtja e paqes në bashkëpunim me OECD-në)²³².

Edhe në rastin panamez, dëshira për të sjellë demokracinë dhe lufta kundër trafikut të drogës, qenë vënë si alternativë mbizotëruese në aspektet e motiveve zyrtare (pra, marrëveshja me qeverinë panameze, mbrojtja e ligjshme individuale, mbrojtja e bashkatdhetarëve jashtë vendit dhe garantimi i lirisë së lundrimit në Kanal), që thuajse nuk të bindnin për vlefshmërinë e tyre. Megjithatë në të dyja rastet, dënimi i OKB-së dhe bashkësisë ndërkombëtare ishte i qartë, pavarësisht se u vlerësuan *de facto* rezultatet e arritura në rastin e parë, kthimi i një qeverie të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe në rastin e dytë, kapja e gjeneralit Noriega. Edhe Franca, në kuadrin e traditës së saj të gjatë të ndërhyrjeve në Afrikë, ndërhyri në vitin 1996, në Republikën e Afrikës Qendrore, në frontin kryengritës të disa njësisive të ushtrisë, “në mbajtjen e shtetit demokratik”, me kërkesë të qeverisë së presidentit Patasse. Operacioni ushtarak, edhe pse i kurorëzuar me sukses, nuk gjeti mirëkuptimin e popullsisë e cila në fakt, demonstroi përpara Ambasadës Franceze në Bangui dhe shprehu zhgënjimin e saj duke djegur një qendër kulturore franceze. Mund ta përmbyllim diskutimin tonë duke theksuar me pak fjalë se vetëvendosja shpreh mundësinë për t’i dhënë formë qeverisjeje pa ndërhyrje të jashtme, duke e lënë të papërzier këtu parimin, cilado qoftë natyra e tij, pra, qoftë demokratike apo autoritare dhe pa lejuar subjekte të tjera të jashtme që të kenë fuqinë për të vlerësuar se çfarë duhet të konsiderohet e mirë apo e pëlqyeshme për të tjerët (si modeli i sotëm i demokracisë perëndimore që është, *de facto*, gjerësisht i përhapur).

²³²Audeoud. O. (1983). *L'intervention americano-caraiibe à la Grenade*, in *Annuaire francais de droit international*, pp.217.

KREU VII: TRAJTIMI I PARIMIT TË VETËVENDOSJES NË PRAKTIKËN E GJYKATËS NDËRKOMBETARE TË DREJTESISË DHE ORGANEVE TË DREJTESISË

1. Mendimi këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me çështjen e pranisë së Afrikës së Jugut në Namibi (1971).

Dokumentet e miratuara në nivel ndërkombëtar në vitet 1960-1966, provokuan një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën e të kuptuarit të parimit të vetëvendosjes së popujve. Kjo çoi që Këshilli i Sigurisë të binte dakord me Asamblenë e Përgjithshme për dhënien fund të mandatit të Afrikës së Jugut mbi Namibinë dhe t'i kërkonte Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të shprehej për pasojat juridike të kësaj pranie. Gjykata kishte hequr dorë nga kjo çështje deri në çastin që Liberia dhe Etiopia në vitin 1966, sollën në gjykim Afrikën e Jugut për shpërdorimin e mandatit të saj në Namibi dhe për shkeljen e së drejtës së këtij populli për vetëvendosje. Në këtë rast, Gjykata u përgjigj duke e mohuar juridiksionin e vet dhe me këtë vendim e humbi mundësinë për t'i konfirmuar shkeljet e së drejtës ndërkombëtare të Afrikës së Jugut. Por ndërkaq mjedisi gjeopolitik kishte ndryshuar dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në “*Advisory Opinion*”²³³ e saj, të vitit 1971 konfirmoi nevojën për ta respektuar parimin e vetëvendosjes së popujve, duke kujtuar që rezultati i mandateve duhet të ishin pikërisht vetëvendosja dhe pavarësia. Më vonë, gjykata shfaqti dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në Namibi me anë të praktikës *apartheid* dhe e detyroi kështu Afrikën e Jugut që të tërhiqej menjëherë nga ai rajon duke iu imponuar shteteve të tjera mosndërrhyrjen në njohjen apo mbështetjen e këtij pushtimi të paligjshëm. Nga ky vendim erdhi njohja e parë e parimit të vetëvendosjes, e cila ishte nënshkruar në akatet ndërkombëtare të drejtpërdrejta dhe të padiskutueshme. Gjykatësi Ammoun konfirmoi që, edhe pse parimi i vetëvendosjes nuk ishte i shprehur ende në një formë juridike, ky parim ishte shumë i rëndësishëm për luftën e të gjithë popujve, të cilët çdo ditë luftonin për pavarësinë e tyre. Gjithashtu konfirmoi se “e drejta e popujve për vetëvendosje, përpara se të njihet në formë juridike, ishte e shkruar me gjakun dhe djersën e popujve”²³⁴.

²³³ Security Council Resolution 276, Advisory Opinion, June 21, 1971.

²³⁴Dixon. Mc. C. (2003). *Self-determination, in International Human Rights Law , Cases and materials on International Law*, 4111 edition , Oxford. Marzo, pp.216.

2. Vendimi i GJND-së i vitit 1975 për Saharanë Perëndimore.

Duke vlerësuar mënyrat me të cilat e drejta e vetëvendosjes mund të zbatohet, duhet konsideruar detyrimi për t'u konsultuar me popujt e nënshtruar. Kjo është deklaruar për herë të parë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në vitin 1971²³⁵ dhe më 10 tetor 1975, në lidhje me Saharanë Perëndimore. Kur Spanja kishte përfunduar politikën e saj koloniale, Maroku dhe Mauritania shfaqën pretendimet e tyre në rajonin e Saharasë Perëndimore, në bazë të traktateve dhe marrëveshjeve të parakoloniale. Gjykata u shpreh se në këto raste, duhej dëgjuar vullneti i lirë dhe i mirëfilltë i popujve të shtypur, përmes procedurave të përcaktuara dhe të kontrolluara nga Asambleja e Përgjithshme. Sipas mendimit të saj "Vlefshmëria e parimit të vetëvendosjes... nuk është zvogëluar nga fakti se, në raste të caktuara, Asambleja e Përgjithshme nuk e ka konsideruar të nevojshëm konsultimin e banorëve të një territori të caktuar. Këto përjashtime përligjen për dy arsye: për faktin se disa popuj nuk mund t'i përkufizojmë si "popull", që të mund të pretendojnë për vetëvendosje, si edhe për faktin, se në disa rrethana të caktuara²³⁶, konsultimi nuk ishte i detyrueshëm²³⁷.

Praktika tregon se në qoftë se procesi i vetëvendosjes përfundon, për Kombet e Bashkuara pak rëndësi ka mënyra se si populli është konsultuar: me votën e asamblesë përfaqësuese, me referendum, me votim e sondazhe, ose me pëlqimin e përfaqësueseve të lëvizjes nacionalçlirimtare²³⁸.

Kjo formulë e përcaktuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila u zhvillua më pas nga praktika e Asamblesë së Përgjithshme, hapi derën për episode të shumta të zgjedhjeve, të vëzhguara nga Kombet e Bashkuara, që kanë garantuar për ata popuj të cilët përfituan mundësinë për pavarësi, për jetë politike dhe shoqërore demokratike²³⁹.

Në vitin 1998, Maroku pranoi që në Saharanë Perëndimore të zhvilloheshin zgjedhjet nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, ku do të ishte populli që zgjidhte, nëse donte apo jo të mbetej pjesë e shtetit marokian. Në mënyrë të ngjashme, Qeveria

²³⁵ Security Council Resolution n. 276.

²³⁶ CJ Reports, 1971, pg. 81, Par. II.

²³⁷ Case of "Western Sahara", ICJ Reports, 1975, pp. 12.

²³⁸ Tancredi, A. (1995). *La Secessione nel Diritto Internazionale*, Padova, pg. 672 ss; Tosid, E. (2007). *Secessione e Costituzione tra prassi e teoria*, Napoli, pg. 279.

²³⁹ Palmisano, G. (1997). *Nazioni Unite e autodeterminazione interna. II principio alla luce degli strumenti rilevanti dell'ONU*, Milano, pg. 335.

Sudaneze ka lejuar realizimin e një referendumi, në të cilin populli i Sudanit Jugor do të mund të vendoste, nëse do të shkëputej apo do të zgjidhte rrugën e bashkimit kombëtar; “në Porto Riko, qeveria amerikane organizoi një votim (jodetyrues), me të cilin populli mund të zgjidhte çfarë statusi të mbante brenda Commonëalth-it, domethënë në do ishte një shtet më vete apo një shtet brenda Shteteve të Bashkuara”.

Në Kebek, popullsia vendore mbajti një referendum i cili rezultoi në vullnetin e tij për t’u shkëputur nga Kanadaja, edhe pse Gjykata e Lartë e Kanadasë (siç do ta shohim), e konsideroi të paligjshëm këtë vendim. Ndër shumë shembuj të tjerë mund të kujtojmë atë të Kaledonisë së Re, një ish koloni franceze, ku vetë shteti përtej alpeve mbajti një referendum për të përcaktuar statusin e ishullit. Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në rastin e Saharasë Perëndimore, u konsiderua për shumë sy²⁴⁰, si njohja e një rregulli të ri të së drejtës ndërkombëtare që po zhvillohej dhe ishte i zbatueshëm për të gjithë popujt e territoreve nën sundimin kolonial.

Vetëvendosja në fakt, përkonte me zgjedhjen e lirë të popullit dhe meqë ishte shprehje e vullnetit të popullit, e kundërshtonte idenë se shtetet ishin të vetmet që pranoheshin nga e drejta ndërkombëtare.

3. Vendimi i GJND-së për çështjen e ndarjes së kufijve ndërmjet Burkina Faso-s dhe Malit (1986).

Në Afrikë, gjatë procesit të asgjësimit të kolonive, ruajtja e integritetit territorial është parë shpesh si mënyra më inteligjente që duhej ndjekur, për të ruajtur atë që ishte arritur nga ata të cilët kishin luftuar për pavarësinë e tyre. Kërkesa thelbësore e stabilitetit për të mbijetuar, për ta zhvilluar e për ta konsoliduar gradualisht pavarësinë e tyre, ka bërë që shumë vende afrikane t’irespektojnë kufijtë kolonialë, duke i marrë në konsideratë edhe në interpretimin e parimit të vetëvendosjes.

Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë iu kërkua në vitin 1986, të përcaktonte rreth 300 kilometra të mosmarrëveshjeve kufitare mes ish kolonive franceze të Burkina Faso-s dhe Republikës së Malit²⁴¹, për të parandaluar shfaqjen e tensioneve të reja që ndodhën në një rishikim të kufirit, ku u shpreh se ushtrimi i së drejtës së vetëvendosjes duhej të realizohej në kuadër të kufijve kolonialë, në përputhje me parimin e *Juris uti*

²⁴⁰ Opinioni i gjyqtarit Abdul G. Koroma në "*The International Court of Justice: A Legacy of Peace and Justice*", prezantuar gjatë sipoziumit “*The Right to Self-Determination in International Law*”, zhvilluar në Aja nga 29 shtatori më 1 tetor 2006.

²⁴¹ The issue titled "*Delimitation of a Frontier in Western Africa*".

*Possidetis*²⁴².

Sipas mendimit të Gjykatës “*Possidetis UT*” është një parim i cili ka çuar në “promovimin” dhe në deklaratën përfundimtare të kufijve, të krijuar gjatë periudhës koloniale dhe ka karakterin e një parimi të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, lidhur logjikisht me episodet dekolonializimit²⁴³. Ky parim, siç është vendosur nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në rastin e vendimit për Bissali Guinea dhe Senegali, merr gjithashtu karakterin e një rregulli të “*jus cogens*”.

Gjithashtu, domethënës është fakti që shumë prej rezolutave që lidhen me parimin e vetëvendosjes së popujve, këmbëngulja në respektimin e një parimi të lidhur ngushtë me të, atë të integritetit territorial të shteteve dhe kufijve të tyre, megjithëse të tërhequr në mënyrë arbitrare nga kolonizatorët, dhe kjo për nevojën për stabilitet²⁴⁴.

Nuk kanë munguar rastet e “konflikteve territoriale” midis shteteve të reja dhe fuqive koloniale si rasti i ishujve në brigjet e Namibisë, i diskutuar në rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, nr. 35/227 dhe 36/121 A, të 1980 dhe 1981, si dhe mosmarrëveshja që vuri përballë Spanjën dhe Marokun për enklavat e Ceuta-së dhe Mellilä-së në territorin marokian. Parimi i respektimit të integritetit territorial u shkel tërësisht në ngjarjet që lidhen me Kamerunin, Somalinë, Timorin Lindor dhe Komoreve. Në këtë drejtim, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit kanë kërkuar nëpërmjet rezolutave 32/90 të 4 nëntorit 1977 dhe 432 e 1978, ripërfshirjen e Ëlvis Bay në Namibi që ishte një territor i lashtë i Perandorisë Britanike dhënë Afrikës së Jugut në vitin 1922. Për t’u dhënë një përkufizim parimeve të përmendura më sipër, mund të themi se “*Uti Possidetis*” është një koncept më pragmatik se *jus cogens*, sepse nëse nuk do të ishte kështu, kufijtë kolonialë nuk do të ndryshonin as në bazë të një marrëveshje të përbashkët, e cila u zhvillua në raste të shumta si te bashkimi i Somalisë Britanike dhe Somalisë Itaiane, Tongo-s Britanike me Ganën, Zanzibar-it dhe Tanganikës dhe Kamerunit Britanik me Nigerinë dhe Kamerunin, ashtu dhe në rastin e ndarjes mes Ruandës dhe Burundit²⁴⁵. Nuk do të ekzistonte as rasti i përcaktimit të kufijve në Azinë dhe Amerikën Latine, ku marrëveshjet përkatëse do të kishin shkelur

²⁴² Kjo rrjedh nga një normë latine për të mbrojtur status quonë: “*uti possidetis, ita possideatis*”.

²⁴³ Duursma. J. (1996). *Fragmentation and the international relations of Micro-States. Self-determination and statehood*, Cambridge, pg. 68.; Castellin. O. J. dhe Allen S. (2000). *The Doctrine of Uti Possidetis: Crystallization of Modern Post-Colonial Identity*, in German Year book of International Law, Vol. 43, pg. 205.

²⁴⁴ CIJ, Chambre, arret del 22 dicembre 1986, Differend.frolltalier, Rec. 1986, Pg. 567.

²⁴⁵ Kufinj të midis Burkina Faso e Mali, në C/G Reports e 1986, Pg. 652-653.

parimin e *Utì Possidetis*, edhe pse në praktikë ndodhi. I njëjti argument mund të bëhet për parimin e pandryshueshmërisë së kufijve i cili e kompenson dhe e kufizon parimin e vetëvendosjes, në Aktin Final të Helsinkit për të cilin shumë shtete²⁴⁶, në projektin e kësaj marrëveshjeje vunë në dukje se “papakshmëri” nuk do të thotë “pandryshueshmëri”, duke rënë dakord se kufijtë mund të ndryshohen në bazë të marrëveshjeve të ndërsjella.

4. Vendimi i GJND-së për çështjen e Timorit Lindor (1995).

Analiza e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ka rëndësi themelore për të përcaktuar vlerën e parimit të vetëvendosjes së popujve dhe në veçanti, për të parë nëse kjo mund të atribuohet në formën e një norme të *jus cogens* dhe *erga omnes* të vlefshme kundër të gjithë anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare. Për sa i përket çështjes së parë, domethënë për mundësinë e njohjes së parimit në fjalë, si njërit prej normave të së drejtës ndërkombëtare, duhet të pranohet se shprehjet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (dhe jo vetëm te saj), kanë qenë të shumta. Mund të përmendim shqyrtimin e 1971, në lidhje me Namibinë dhe atë të 1975, në lidhje me Saharanë Perëndimore, ndërsa një miratim përfundimtar na vjen edhe nga vendimi i rastit të Timorit Lindor. Vetëvendosja është e njohur përfundimisht si “një nga parimet themelore të së drejtës bashkëkohore ndërkombëtare, me karakterin e një norme të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare²⁴⁷.

Për sa i përket konceptit për të drejtën *erga omnes*, duhet marrë parasysh se historiku i saj është shumë i gjatë dhe që për herë të parë u formulua në rastin e Barcelona Traction, të shqyrtuar në 1970, nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Gjykata kërkonte që të bëhej dallimi mes “detyrimeve të një shteti kundrejt bashkësisë ndërkombëtare dhe detyrimeve të dy shteteve kundrejt njëri-tjetrit. Duke marrë parasysh rëndësinë e të drejtave, të gjitha shtetet kanë interes juridik për mbrojtjen e tyre. Këto janë të drejtat *erga omnes*”²⁴⁸.

Gjykata sugjeroi një listë të detyrimeve *erga omnes* ku bënin pjesë aktet e agresionit, gjenocidit, “të drejtat themelore të njeriut, duke përfshirë këtu mbrojtjen nga skllavëria dhe diskriminimi racial”. Më vonë, pikërisht në rastin e Timorit Lindor²⁴⁹,

²⁴⁶ CSCE, I”Irlanda, Danimarca, Canada, Belgio, Stati Uniti, I “ex Germania Federale, Regno Unito, Ia Grecia, Svezia, Spagna.

²⁴⁷ Disa mendime të Gjykatës të aksesueshme në website <http://www.icj-cij.org>.

²⁴⁸ Case of (Belgium v. Spain), ICJ Reports 1970, Par. 32-33.4.

²⁴⁹ Case considering East Timor (Portugal v. Australia), ICJ Reports 1995, Par. 102.

Gjykata shtoi në këtë listë edhe të drejtën e popujve për vetëvendosje. Në rastin e Barcelona Traction, në fakt, gjykata krijoi një përshtjellim rreth zbatimit konkret të detyrimeve *erga omnes*, aty ku ka treguar që mjetet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk u japin shteteve mundësinë për të mbrojtur viktimat nga mungesa e respektimit të këtyre të drejtave, pa pasur parasysh kombësinë e tyre. E gjithë kjo krijonte idenë që mund të kufizohej ndikimi i këtyre të drejtave në zbatimin e tyre konkret dhe si pasojë, edhe e drejta për vetëvendosje. Rasti konkret, ku shihet ky kufizim, është pikërisht përplasja mes Portugalisë dhe Australisë. Më parë, Indonezia dhe Australia kishin arritur një marrëveshje, Traktatin e Timorit, për shfrytëzimin e përbashkët të zonës detare të Timorit Lindor. Portugalia e kundërshtoi duke deklaruar se në këtë mënyrë shkeleshin si të drejtat e saj në rolin e Fuqisë administruese *de jure*, ashtu edhe të drejtat e popullit të Timorit Lindor. Kjo në fakt pohonte se “njohja e aspiratës joligjore të Indonezisë mbi Timorin Lindor, mohonte të drejtën ndërkombëtare që populli i Timorit Lindor, njihte si vetëvendosje dhe sovranitet mbi burimet natyrore në zonën detare të bregdetit të saj”²⁵⁰.

Shumica e Gjykatës²⁵¹ përcaktoi se një çështje gjyqësore (fakti është se Indonezia nuk ishte pjesë e diskutimit) e përjashtonte mundësinë për të vendosur për rastin në fjalë, por ka njohur edhe faktin që pohimi i Portugalisë se parimi i vetëvendosjes i takon popullit të Timorit Lindor kishte karakter *erga omnes* dhe kjo ishte e padiskutueshme²⁵².

Në kundërshtim me vendimin e gjykatës për t’i hetuar apo jo meritat, gjykatësi Weeramantry ka shpjeguar se cilat do të ishin pasojat ligjore të një interpretimi të tillë të normave dhe cili, sipas tij, do të ishte përdorimi i saktë i të drejtave *erga omnes*. Ai theksoi se si Australia shpesh kishte pohuar se nuk e vinte në dyshim faktin, që e drejta për vetëvendosje ishte një parim i vlefshëm *erga omnes*. Meqë një e drejtë *erga omnes* është e ndërtuar mbi disa të drejta të tjera *erga singulum*, të përfshira, një e drejtë *erga singulum* kundër Australisë dhe një e drejtë *erga singulum* kundër Indonezisë, të pavarura njëra nga tjetra, e drejta *erga omnes* bëhet e ekzekutueshme *erga singulum* për shtetin që kryen shkeljen²⁵³. Në bazë të këtij argumentimi, “sugjerimi që Indonezia është një pjesë e domosdoshme për ta stabilizuar shkeljen e detyrimit të Australisë do të thotë,

²⁵⁰ Case considering East Timor (Portugal v. Australia), ICJ Reports 1995, Par.94.

²⁵¹ Me 14 vota, kundër 2.

²⁵² Case East Timor, 1995 ICJ, Par. 105. La C.I.G.

²⁵³Case considering East Timor (Portugal v. Australia), Dissenting Opinion of Judge Weeramantry, Pg. 172, <http://www.icj-cij.org>.

të pengosh anën operative të parimit *erga omnes*²⁵⁴ ... Në fushën ligjore, e drejta *erga omnes* nuk do të ishte më efektive²⁵⁵. Australia u përgjigj duke mbështetur faktin që nuk mund të kishte shkelje të parimit të vetëvendosjes së popujve, në mungesë të një dispozite të shprehur nga një rezolutë e OKB-së. Pavarësisht prej një norme apo rezolute të shkruar, vetëvendosja është një e drejtë e padiskutueshme, që duhet të zbatohet prej çdo shteti dhe për të mirën e çdo populli. Nëse shtetet marrin përsipër detyrimin për ta respektuar këtë të drejtë, ata duhet të respektojnë domosdoshmërisht dhe ushtrimin nga të gjithë popujt dhe për ta pohuar këtë ka shumë dokumente, rezoluta dhe vendime. Për sa u përket mjeteve ndërkombëtare, kujtojmë Rezolutën 1514, që në nenin 1 par.2 shkruhej: “Të gjithë popujt kanë të drejtë për vetëvendosje”. Kjo u përsërit dhe në nenin 1 par.2, në Paktin për të drejtat e njeriut, ashtu si dhe në Deklaratën mbi Marrëdhëniet Miqësore. Akti final i Konferencës së Helsinkit i 1975-ës, ishte ai që hoqi çdo dyshim (nëse kishte ende) mbi universalitetin e parimit, aty ku parimi i 8-të nga dhjetë të tillë, përcaktonte se “të gjithë popujt kanë gjithmonë të drejtën në liri të plotë, për të vendosur kur dhe si e dëshirojnë regjimin e tyre politik të brendshëm dhe të jashtëm”²⁵⁶.

Nëse u referohemi komunikimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, kjo e adreson në veçanti, parimin në fjalë “për të gjithë popujt” në rastin e ndërtimit të Murit në Palestinë²⁵⁷, ndërsa Këshilli mbi të Drejtat e Njeriut, në Komentin e Përgjithshëm, nr. 12, pohon se parashikimi i tij duhet të shtrihet për të gjithë popujt të cilëve nuk iu është lejuar ta ushtrojnë të drejtën²⁵⁸.

Në fund, meriton që të përmendet dhe një vendim i dhënë nga gjykata e brendshme e Gjykatës Kushtetuese Ruse, një shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara, që në “*Tatarstan Case*” shpjegon se si detyrimi për ta respektuar të drejtën e vetëvendosjes së popujve u drejtohet “të gjitha shteteve” dhe në të mirë “të gjithë popujve”.

Nga kjo arrihet në përfundimin se e drejta e vetëvendosjes është pjesë përbërëse e së drejtës ndërkombëtare zakonore. Gjykata ka pasur rol thelbësor duke pohuar se parimi kishte karakter *erga omnes*, duke e përkufizuar “një nga të drejtat më të

²⁵⁴Lattanzi. F. (1987). *Autodeterminazione dei popoli in Digesto delle discipline Pubblicistiche*, 4o edizione, Torino, Pg. 11.

²⁵⁵Case considering East Timor (Portugal v. Australia), Opinioni i Gjyqtarit Weeramantry, Pag.173.

²⁵⁶ Neni 5 i Kartës së Algjerit.

²⁵⁷ Advisory Opinion, del 12 luglio 2004, reperibile sui sito <http://www.icj-cij.org>, par.88.

²⁵⁸General Comment W 12 (21), Supplement W40, A/39/40, 142, par.6

rëndësishme bashkëkohore²⁵⁹ ndërkombëtare” dhe ka përdorur një gjuhë të ngjashme në shumë raste, si ai i Kanalit të Korfuzit²⁶⁰, Konventa e Gjenocidit²⁶¹, Barcelona Traction²⁶², stafit diplomatik të SHBA-së në Teheran²⁶³, ajo e Nikaraguas²⁶⁴ dhe në fund mbi rastin ku flitej për përdorimin e armëve bërthamore²⁶⁵. Nuk mungojnë as ata, të cilët e mohojnë karakterin *erga omnes* të parimit të vetëvendosjes, ose si Summers²⁶⁶ që kundërshtoi Gjykatën për faktin se nuk kishte qenë e qartë në shpjegimin se në çfarë konsiston realisht karakteri *erga omnes*. Ndërsa Sloss e Cassese besojnë se që nga çasti që e drejta për vetëvendosje nuk kishte më lidhje me kontekstin kolonial, ka arsye për të dyshuar që ICG-ja do t’ua japë të drejtën popujve jokoloniale për të vetëvendosur karakterin *erga omnes*²⁶⁷.

Ka dhe nga ata si Brandt Ahrens që mbështesin idenë se ka shumë pengesa deri në arritjen e plotë operative të konceptit të detyrimeve *erga omnes* dhe nëse kjo do të kishte ndonjë efekt: “*hat effect will only appear in extremely limited circumstances*”²⁶⁸ (ky efekt do dukej vetëm në situata të skajshme e të kufizuara).

Gjithsesi, një gjë është e qartë nga pikëpamja e kuptimit të vetëvendosjes. Përkufizimi i vetëvendosjes si një e drejtë *erga omnes*, sugjeron që kjo të jetë diçka më shumë se vetëm një e drejtë. Debatet që u zhvilluan nga Gjykata rreth të drejtave *erga omnes* në rastet e Barcelona Traction, East Timor e Palestinian Wall janë plot me mbiemra të tillë si: "i rëndësishëm", "thelbësore" e "karakteristike"²⁶⁹.

Më e qartë është metafora e Summers-it, sipas të cilit “karakterin *erga omnes*, pavarësisht nga kuptimi i tij i paqartë juridik, mund të përdoret si emblemë që i

²⁵⁹ Case considering East Timor (Portugal v. Australia), ICJ Reports, 1995, par.29.

²⁶⁰ ICJ Report s 22, del 1949.

²⁶¹ ICJ Reports 23, del 1951.

²⁶² ICJ Reports 32, del 1970, par. 33-34.

²⁶³ ICJ Reports 42, del 1980, par. 71.

²⁶⁴ ICJ Reports 113, del 1986, par. 218.

²⁶⁵ ICJ Reports 258, del 1996, par. 82.

²⁶⁶ Summers J. J. (2003). *The Status of Self-determination in International Law: A Question of Legal Significance or Political Importance?* in Finnish Yearbook of International Law, Vol. XIV, pp.290.

²⁶⁷ Sloss. D. (2002). *Using International Court of Justice Advisory Opinions to Adjudicate Secessionist Claims*, Santa Clara, pg. 374-375; Cassese. A. (1995). *Self Determination of Peoples- A legal Reappraisal*, Cambridge, pp. 126-133.

²⁶⁸ Brandt. A C. (2004). *Chechnya and the Right of Self - determination*, Columbia Journal of Transnational Law, Columbia Law School - New York, Vol. 42 ..

²⁶⁹ (Advisory Opinion), 1 2 Korrik 2004, <http://www.icj-cij.org>, par. 1 59. Case considering East Timor (Portugal v. Aust ra lia), ICJ Reports de l 1995, Par.29 e 155.

bashkëngjitet vetëvendosjes për të nxjerrë në pah rëndësinë e saj dhe ligjshmërinë e detyrimeve që ajo imponon”²⁷⁰.

Nuk ka asnjë dyshim mbi faktin që parimi i vetëvendosjes së popujve ka marrë formën e një të drejte ndërkombëtare zakonore, ose më mirë të një parimi të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare, në bazë të gjitha praktikave të përmendura tashmë duke u manifestuar me shumë rezoluta të nxjerra nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Karakteristike është që parimi sipas natyrës së tij dhe sipas mjeteve që përdoren, shpesh realizohet mbi bazën e zgjedhjeve të zbatuara nga shteti në nivel të brendshëm dhe jo në bazë të marrëveshjeve apo normave që janë fryt i marrëdhënieve ndërkombëtare.

5.Vendimi i GJND-së për ndërtimin e murit në Palestinë (2004).

Me 9 korrik 2004, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shprehu (“*Advisory Opinion*”) opinionin e saj në lidhje me pasojat juridike të ndërtimit të murit që ndau pjesën e “*Eest Bank*” nga Izraeli²⁷¹.

Me 14 vota “pro” dhe një “kundër”²⁷², Gjykata u shpreh se ndërtimi i murit në “territoret e pushtuara palestineze” ka shkelur shumë norma ndërkombëtare dhe për këtë ky mur duhej të shembej menjëherë dhe Izraeli duhej të dëmshpërblente. Në pjesën e parë pasi pohoi juridiksionin për këtë rast, Gjykata hodhi poshtë teorinë e propozuar nga SHBA-ja, sipas së cilës do të vihej në rrezik procesi i paqes dhe do të pengohej realizimi “*Roadmap*”. Në vazhdim në analizën mbi këtë çështje, gjykata ka treguar se territoret për të cilët po flitej, duke përfshirë “linjën e gjelbër” dhe ish-kufirin lindor Palestinez, ishin konsideruar si të pushtuar nga Izraeli, duke filluar nga 1967 ,i cili kishte rolin e Fuqisë zotëruese. Gjykata më shumë se njëherë i është referuar parimit të vetëvendosjes duke nënvizuar që vetëvendosja është një e drejtë *erga omnes*²⁷³ dhe ashtu siç ka mbështetur edhe gjykatësi Higgins në opinionin e tij, detyrimet e mbuluara nga karakteri *erga omnes* bazohen mbi një teori të dukshme që “një situatë e paligjshme nuk duhet të njihet ose të mbështetet nga palët e treta ose nga e drejta ndërkombëtare”²⁷⁴. Bazuar mbi Kartën e Kombeve të Bashkuara, mbi Deklaratën e marrëdhënieve miqësore u vu në dukje se në

²⁷⁰Summers. J. J. (2003),*The Status of Selfdetermination in International Law: A Question of Legal Significance or Political importance?* in Finnish Yearbook of International Law , Vol. XIV , pp.292.

²⁷¹ UN Doc. E/CN.4/2004/6, a t 6 (Sept. 8, 2003).

²⁷² U prononca kundër Gjyqtari Thomas Buergenthal (U.S.A.).

²⁷³ (Advisory Opinion), e 12 Korrikut 2004, <http://www.icj-cj.org>, par.88.

²⁷⁴ Gjyqtari Higgins, *Separate Opinion*, Par. 38-39.

atë kontekst shkeleshin dy parime thelbësore të së drejtës ndërkombëtare: ndalimi i përdorimit të forcës dhe parimi i vetëvendosjes së popujve. Në atë zonë, në fakt, shumica e kolonive izraelite (81%) kanë shkelur ndalimin e marrjes së një territori me anë të forcës dhe “kanë ndërprerë ushtrimin e të drejtës për vetëvendosje nga populli palestinez”. Siç kanë vënë në dukje shumë analiza doktrinare²⁷⁵, fakti që Gjykata ka përfunduar duke mbështetur se “detyrimet e shkelura nga Izraeli përfshijnë disa norma të vlefshme si *erga omnes*, është shume e rëndësishme, sepse njeh edhe njëherë tjetër që populli palestinez ka të drejtën për vetëvendosje dhe që Izraeli ka shkelur shumë të drejta ndërkombëtare të njeriut. Të gjithë shtetet e tjera kanë interes juridik për të garantuar me anë të mjeteve paqësore respektimin e këtyre detyrimeve.

6. Krijimi i Komisionit të Arbitrazhit të Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (1991).

Komisioni i arbitrazhit për ish-Jugosllavinë, i njohur edhe si Komisioni Badinter, duke marrë emrin e presidentit të tij, u formua në vitin 1991 për të diskutuar mbi çështjet juridike në lidhje me procesin e paqes në Jugosllavi. Interesante për analizën e parimit të vetëvendosjes ishte në veçanti, pika nr.2 e shprehur në kërkesën e Republikës Serbe që iu dorëzua Presidentit të Konferencës mbi Jugosllavinë. Në këtë të fundit kërkohej: “Popullsia serbe e Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës, duke qenë se është një nga popujt e Jugosllavisë, ka të drejtën për vetëvendosje?”. Kësaj kërkesë Gjykata iu përgjigj duke pohuar se çdo bashkësi etnike, fetare apo kulturore ka të drejtën që të njihet dhe të mbrohet, por kjo duhet të ndodhë gjithmonë në respekt të parimit të “*uti possidetis*”, pra, pa shkeljen e integritetit territorial. E drejta ndërkombëtare ka njohur si element thelbësor mbrojtjen e të drejtave të pakicës, kështu që edhe të popullit serb, të ndarë nga kufijtë e tij siç u vendos në Konventën e 4 nëntorit 1991. Sipas komisionit, çështja mund të zgjidhej edhe me anë të marrëveshjeve midis shteteve për t’idhënë të drejtën popullit të zgjidhte kombësinë që donte. Sipas nenit 1 të Konventës së vitit 1966, në fakt, “në përputhje me këtë të drejtë, çdo individ ka të drejtë të jetë pjesë e cilido bashkësi që zgjedh”. Një normë e vendosur në kontekstin e Bashkimit Evropian mund të zbatohet edhe në kontekstin ballkanik, ku një popull mund të ndihej se ishte serb, edhe pse jetonte në Kroaci apo Bosnje-Hercegovinë dhe të ushtronte në këto vende të drejta, si ajo e votës në zgjedhjet vendore. Në këtë mënyrë komisioni arriti të sigurote

²⁷⁵ Pieter H.F. Korrik 2004, <http://www.asil.org/index.html>.

respektimin e të drejtave të njeriut si individ ose si bashkësi, duke marrë parasysh integritetin territorial të shteteve²⁷⁶.

Gjykata ka sqaruar edhe që situata që përfshinte ish-Jugosllavinë nuk ishte e tipit ndarës dhe që Republikat të cilat kishin deklaruar pavarësinë e tyre, nuk kishin kryer një akt ndarjeje nga vendi i tyre. Në opinionin nr.1, të 29 nëntorit të vitit 1991, Komisioni i Arbitrazhit ka mbështetur faktin se duke marrë parasysh strukturën e Federatës Jugosllave dhe duke analizuar kriteret pjesëmarrëse dhe përfaqësuese të çdo shteti Federal, Republika Federale Socialiste Jugosllave ka pasur një proces ndarjeje. Kjo, sepse shteti “qendror”, duke mos qenë më përfaqësues dhe duke qenë se i kishte humbur të gjitha fuqitë, nuk ekzistonte më.

7. Vendimi i Gjykatës së Lartë Kanadeze në lidhje me çështjen e shkëputjes të Kebekut, në vitin 1996. Ndikimi dhe pasojat e tij në lidhje me çështjen e Kosovës

Analiza e parimit të vetëvendosjes së popujve nuk do të ishte e plotë nëse nuk do merrej parasysh edhe vendimi i Gjykatës së Lartë Kanadeze, në rastin e shkëputjes së Kebekut. Kjo sjell shumë të reja të rëndësishme, sepse sqaron në cilat çështje e drejta ndërkombëtare lejon të zbatohet e drejta për vetëvendosje. Sipas Gjykatës Kanadeze, e drejta për vetëvendosje mund të çojë në një vetëvendosjevetem atëherë kur një grupi i është mohuar e drejta e hyrjes në qeverisje dhe mundësia për ta ndjekur zhvillimin e vet politik, ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Gjykata e Lartë Kanadeze e hodhi poshtë kërkesën e Kebekut, pikërisht, sepse kjo zonë dhe qytetarët e saj kishin të drejtën e plotë për të marrë pjesë në qeverisjen federale të Kanadasë dhe nuk ishte vënë re asnjë lloj “praktike e racizmit në mënyrë sistematike, e tillë sa të mos i jepej e drejta një pjese të popullit, pakicë apo shumicë për t’u shprehur dhe për t’u ndjerë i përfaqësuar”²⁷⁷.

Sipas një pjese të doktrinës ndërkombëtare²⁷⁸, në fakt populli kosovar brenda shtetit serb nuk kishte një situatë të tillë të shkeljes së të drejtave të njeriut, saqë ta përlligjte praktikën e ndarjes. Sipas kësaj doktrine, shkëputja kaq e urryer dhe e dënuar nga shtetet sovrane, është pranuar vetëm në një rast, që do të thotë “ai i viteve

²⁷⁶Pellet. A. (1992). "The Opinion s of the Badinter Arbitration Committee. A Second Breath for the Self Determination of Peoples", 3 EJI L, pg. 178-1115.

²⁷⁷ Reference, Re Secession of Quebec 11 998] 2 S.C.R. 217.

²⁷⁸ Në, La Repubblica 15 dicembre 2007, pg. 14.

‘70, duke pasur parasysh situatën “apartheid” në Afrikën e Jugut të cilën pakicat (apo dhe shumica, si në rastin e Afrikës së Jugut) apo grupe të tjera diskriminoheshin për arsye raciale apo fetare në mënyrë kaq të rëndë sa që ishin të përjashtuar nga çfarëdo lloj pjesëmarrjeje efektive në qeverinë e Shtetit. Këto grupe kanë të drejtën e vetëvendosjes dhe nëse është e nevojshme dhe shkëputja nga shteti duke formuar një shtet të ri apo duke u përfshirë në një tjetër. Nëse nuk ekzistonin këto kushte atëherë nuk kishte asnjë të drejtë vetëvendosjeje”. Duke analizuar me kujdes rastin specifik të Kosovës, duhet nënvizuar që një formë autonomie i ishte njohur nga ana e Serbisë, por kjo nuk mjaftoi që populli kosovar të mos kërkonte pavarësinë. Pavarësisht nga çdo argument i vlefshëm mbi të drejtën, duhet kujtuar se nëse flasim për faktet edhe nëse mungon e drejta për shkëputje, një bashkësi nëse ka forcën politike, mund të shkëputet nga shteti: “...është kjo ajo që ndodhi me anë të luftës për Bangladeshin në vitin 1971, dhe në vitet 1991-92, për ish-Republikat Jugosllave (Slloveni, Kroaci, Bosnje-Hercegovinë)”. Behët fjalë për dukuri historiko-politike mbi të cilat e drejta nuk zotëron dot dhe në këtë mënyrë hesht. Pavarësia e Kosovës u arrit jo në bazë të një të drejte ndërkombëtare objektive, por në respekt të zhvillimit të një procesi që u mbështet politikisht nga disa shtete e evropiane dhe SHBA. Ajo shkëputje, edhe pse e gjymtoi rëndë Serbinë, nuk shkel të drejtën ndërkombëtare as nga shtetet e tjera (ato që njohën shtetin e ri) dhe as nga ana e kosovarëve.

8. Rëndësia e jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për parimin të vetëvendosjes së popujve dhe pasojat politike dhe juridike në kontekstet e prekura nga zhvillime të tilla.

Nga përfundimet e analizës së mësipërme është e mundshme të jepet një vlerësim mbi veprimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe rreth ndikimit të jurisprudencës së saj mbi të drejtën ndërkombëtare. Mund të thuhet me siguri se jurisprudenca e Gjykatës ka kontribuar në shumë çështje dhe në zgjidhjen në mënyrë paqësore dhe përfundimtare të tyre, aty ku është përfshirë parimi i vetëvendosjes së popujve siç është shembulli i debatit të gjatë dhe shumë të diskutuar mbi pushtimin e Namibisë nga Afrika e Jugut. Grumbullimi i komunikimeve të bëra nga Gjykata, në 20 vite me radhë mbi këtë çështje solli në konfirmimin e parimit të vetëvendosjes, në dënimin e praktikës “apartheid”, në mbështetjen e rolit të Asamblesë së Përgjithshme dhe dhënien fund të pranisë së Afrikës së Jugut në Namibi. Duhet thënë se Afrika e Jugut nuk ia ka dhënë pavarësinë Namibisë deri në 1990, që do të thotë 19 vjet mbas vendimit të Gjykatës, por siç e thotë edhe Këshilli i Sigurimit, nuk e dimë nëse kjo do të ndodhte pa ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe Gjykatës

Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ka pasur dhe komunikime të tjera që kanë sjellë përfitime interesante për sigurinë ndërkombëtare, ndër të cilat caktimi i kufijve mes Burkina Faso-s dhe Republikës së Malit, që ka shërbyer për ta garantuar pavarësinë e dy shteteve. Duhet kujtuar dhe përmendur se mbas vendimit të Gjykatës mbi murin në Palestinë, Gjykata e Lartë Izraelite ndërhyri duke urdhëruar bërjen e disa ndryshimeve për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut, në mënyrë që të arrihej qëllimi për të cilin ishte ndërtuar ky mur. Vetëm 4 vite me vonë nga vendimi i gjykatës që kishte kërkuar të respektohej e drejta e popullit të Timorit Lindor për vetëvendosje, Indonezia lejoi që të bëhej një referendum nën kontrollin e Kombeve të Bashkuara për të verifikuar vullnetin e popullit, ashtu siç ishte vendosur në çështjen e Saharasë Perëndimore. Për fat të keq, duhet thënë se çështja e Saharasë Perëndimore nuk pati zgjidhje dhe statusi i saj mbeti ai i një territori “*jo i vetëqeverisur*”, duke nxitur tensionin midis palëve. Gjithsesi, mund të themi që kompetencat e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe të Kombeve të Bashkuara u rritën me kalimin e kohës. Jurisprudenca dhe juridiksioni i Gjykatës, me kalimin e viteve shihej si burim i sigurisë, sepse kishte dëshmuar shpesh kompetencën në zgjidhjen e problemeve dhe tensioneve ndërkombëtare, ashtu siç edhe ka treguar se mund të zgjidhë në mënyrë efektive çështje që i përkasin së drejtës së vetëvendosjes së popujve dhe ndalimit të përdorimit të forcës. Veprimtaria e saj ka qenë thelbësore në procesin e zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare, ashtu si edhe në luftën për një të ardhme paqësore dhe të drejtë.

KREU VIII: ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME PARIMIN E VETËVENDOSJES SË POPUJVE DHE ME MUNDËSITE PËR T'I TRAJTUAR NË DRITËN E INSTRUMENTAVE NDËRKOMBËTAR DHE DOKTRINAL

1. Parimit i vetëvendosjes dhe jus cogens.

E drejta ndërkombëtare ka një mekanizëm për të klasifikuar rregullat dhe për të përcaktuar vlefshmërinë e tyre dhe nga ana e doktrinës mbështet faktin se jo vetëm parimi i vetëvendosjes është normë e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, por kjo ndërton një parim thelbësor të së drejtës ndërkombëtare ose një normë të *jus cogens*. Një normë *jus cogens* është e përkufizuar nga neni 53, i Konventës së Vjenës, mbi të Drejtën e Traktateve e vitit 1969, si një “normë e pranuar dhe e njohur nga komuniteti ndërkombëtar i shteteve, nga e cila nuk mund të shmangen dhe që mund të modifikohet vetëm nga një normë pasardhëse e të drejtës ndërkombëtare që ka të njëjtën vlerë”. Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare në raportin e tij të vitit 1966, mbi të drejtën e traktateve shtoi, pikërisht, parimin e vetëvendosjes së popujve në listën e normave të detyrueshme, ndërsa në nenin 19, të projekt-neneve mbi përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve²⁷⁹, në vitin 1996. Kjo bënte pjesë në detyrimet ndërkombëtare me rëndësi thelbësore. Një pjesë e pakicës së doktrinës gjithsesi, e kufizon operativitetin e parimit, siç thamë më sipër dhe karakterin *jus cogens* të situatave të sundimit kolonial, të huaj dhe racist²⁸⁰. Për të arritur njohjen

²⁷⁹ Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare i vitit 1966, shiko nenin 19, par. 2, ai përkufizoi një krim ndërkombëtar si një shkelje nga një shtet me detyrim ndërkombëtar, për mbrojtjen e interesave themelore të bashkësisë ndërkombëtare, këto janë disa shembuj të krimeve: Agresioni (Neni 19, par. 3, shkronja a), sundimi kolonial (Neni 19, par. 3, shkronja b), skllavëria dhe genocidi, apartheid (neni 19, par. 3, shkronja c) si dhe ndotja masive e "atmosferës dhe dete (neni 19, par. 3, shkronja d).. web - <http://www.cepadu.unipd.it>

²⁸⁰Ciciriello M. C. (2006). *Appunti delle lezioni di diritto internazionale e diritto nazionale*, Napoli, Pag. 65; il Giudice AMMOUN, *Separate Opinion, Barcelona Traction. Second Phase. ICJ Reports del 1970*, Par. 304; Cassese.A. (1995). *Self-Determination of Peoples - A legal Reappraisal*, Cambridge, pp.140; Tomuschat C. (1995), (Edited by) Simma B. *The Charter of the United Nations, A commentC/1*)1, Oxford, pp. 70-71; Raic.D. (2002). *Statehood and the Law of Self determination, The Hague*, pp. 444; Bedjaoui. M. (1991), "The Right to Development", in M. Bedjaoui (Edited by), *International Law: Achievements and Prospects*, Paris, pp. 1177-1184; ROSA R.(2006). *Evoluzione e prospettive della protezione delle minoranze nel diritto internazionale e nel diritto europeo*, Milano, pp. 315.

Ne kundërshtim: Pomerance.M (1992). *Self-Determination in Law and Practice: The New Doctrine of the United Nations, The Hague*, pp.70; Hannum H. (2002) (edited by) Beck R. J. and Ambrosio T., *Rethinking self-determination in International law and the rise of nations. The state system and the*

universale të vetëvendosjes si normë *jus cogens*, janë të nevojshëm disa faktorë, ndër të cilët është njohja nga ana e bashkësisë ndërkombëtare të shteteve²⁸¹.

Disa ndikime të padiskutueshme mund të dalin nga dokumente të Konventës së Vjenës, Deklaratës mbi Marrëdhëniet Miqësore, Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror si dhe Komitetit mbi të drejtat e njeriut²⁸².

Thelbësore ishte dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë që kujtojmë se ka njohur ekzistencën e parimit të detyrueshëm në dy mendimet e dhëna mbi kërkesën e Asamblesë së Përgjithshme (mendimi i 1971, mbi Namibinë dhe ai i vitit 1975, mbi Saharanë Perëndimore), si dhe në vendimin në lidhje me Timorin Lindor, ku e ka përkufizuar vetëvendosjen si “një ndër parimet esenciale të së drejtës ndërkombëtare moderne”. Duhet kujtuar se vëzhgimet e Gjykatës në lidhje me çështjen e Murit të Palestinës, dëshmojnë sesi karakteri i detyrueshëm i parimit njihet nga shumë shtete.

Një element tjetër mund të përfaqësohet nga statusi i traktateve²⁸³. Dua të them me këtë se meqë vetëvendosja është një normë *jus cogens*, mund të gjejmë shembuj të traktateve të pavlefshme, sepse bien në kundërshtim me të drejtën që po analizojmë, ose traktate të mbyllura në kohë të largëta dhe të konsideruara të pavlefshme më tej, sepse binin në kundërshtim me parimin e vetëvendosjes së popujve që në atë periudhë ishte konfirmuar²⁸⁴.

Mes shumë deklarimeve për ta njohur natyrën e detyrueshme të parimit janë edhe ato të Gjykatës së Kasacionit Penal Italian²⁸⁵, sipas së cilës “parimi i vetëvendosjes së popujve konsiderohet si normë zakonore e detyrueshme” dhe ajo e Komisionit Arbitrar për ish-Jugosllavinë, e cila ka shtuar ndër normat e tjera të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, “të drejtat e popujve dhe të pakicave”²⁸⁶.

challenge of ethnic groups, New York-London, pp.31; Crawford.J. (1996) "Book review of Antonio Cassese, Self-Determination of Peoples: A Legal Reappraisal", in American Journal of International Law, pp, 332.

²⁸¹Rosa,M. (2006) *Secondo cui "Il fatto di essersi affermato nel contesto di tale Organizzazione (l'ONU), in Evoluzione e prospettive della protezione delle minoranze nel diritto internazionale e nel diritto europeo*, Milano, pg. 315.

²⁸² Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Sigurimit, shih Rezolutën 2005/1.

²⁸³ Cassese.A. (1995). *Self-Determination of Peoples - A legal Reappraisal*, Cambridge, pp.190.

²⁸⁴ Tomuschat C. (1995). (Edited by) Simma B. *The Charter of the United Nations, A commentary*, Oxford, pp.70.

²⁸⁵Gjykata e Kasacionit Penal Italian në gjykimin e 28 Qershor 1985,Imputati Arafat e Salah.

²⁸⁶Gjykata e kasacionit Penal Italian ne gjykimin e datës 29 Nentor 1991,R.G.D.I.P.1992, Pag.265.

2. Parimi i vetëvendosjes dhe e drejta për shkëputje.

Mungesa e një kuadri normativ të qartë dhe sidomos e një praktike ndërkombëtare unitare, solli zhvillimin e shumë teorive të kundërta me njëra-tjetrën, një doktrinë dhe në të drejtën ndërkombëtare. Sipas disa studuesve, pavarësisht prej mungesës së normave që u lejojnë popujve apo pakicave të shkëputen nga një shtet sovran, do të jetë e mundshme gjithsesi ligjshëria e një hipoteze të shkëputjes në rastin kur një shtet është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe politike në drejtimin e pakicave që jetojnë në brendësi të tyre²⁸⁷.

Kjo lloj praktike përkufizohet si *remedial secession* dhe është e realizueshme me praninë e dy faktorëve²⁸⁸. Së pari, është e nevojshme që popullsia ose pakica ta mohojë të drejtën për t'u shprehur, qeverisur dhe ta zgjedhë lirisht statusin e vet politik të brendshëm. Në një situatë të tillë duhet t'i bashkohen edhe shkelje të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut nga shteti në lidhje me popullsinë.

Për të provuar këtë hipotezë merret në konsideratë vendimi i Gjykatës së Lartë Kanadeze, e cila lejon që të arrihet në shkëputje, atëherë kur një pakice i ndalohet ushtrimi i së drejtës së vetëvendosjes së brendshme²⁸⁹. Duhet konsideruar se nga leximi i tekstit të vendimit, opiniononi i Gjykatës është më i përqendruar të orientojë veprimtarinë e qeverisë kundrejt një politike demokratike dhe të lirë dhe jo për të lejuar një të drejtë të përgjithshme shkëputëse si shfryrje e parimit të vetëvendosjes së brendshme.

Një orientim tjetër doktrinal shfaqet në të drejtën ndërkombëtare si një *due process clause*, në lidhje me praktikën e shkëputjes, sipas së cilës shkëputja është e rregullt, më shumë sesa nga pikëpamja përmbajtësore, nga ajo procedurale: në veçanti, përcakton kushtet e nevojshme që të arrihet në një shkëputje dhe mënyrat me të cilat mund të arrihet. Si fillim, është e nevojshme që lëvizja e shkëputjes të ketë mirëkuptimin e bashkësisë të përfshirë, e shprehur me anë të konsultimeve të

²⁸⁷Arangio Ruiz G. (1995) *Autodeterminazione (diritto dei popoli alla)* in *Enciclopedia Giuridica*, Roma, 1988, Pag.6; Cassese A.(1996), *Self-Determination of Peoples- A legal Reappraisal*, Cambridge, pg.19; ROSA R. (2006), *Evoluzione e prospettive della protezione delle minoranze nel diritto internazionale e nel diritto europeo*, Milano, Pg. 324; Lattanzi F. (1995). *La secessione nel diritto internazionale: autodeterminazione dei popoli e delimitazione di territorio nazionale* neff " *es perien za recente in Stato, etnicità e nazionalismo tra due ordini mondiali* ", Urbino, pg. 22 ss; Tomuschat.C. (1993). *Self-Determination in a Post Colonial World*, in *Modern Law of Self-Determination*, Dordrecht, pp.16.

²⁸⁸ Tancredi. A. (1995). *La Secession e nel Diritto Internazionale*, Padova, pg. 21.

²⁸⁹Sessioni per shkëputjen e Quebec, Paragrafi 1, pp134- 135.

drejtpërdrejta, që tregon miratimin e pjesës më të madhe të popullsisë; duke specifikuar gjithmonë parimin e ndalimit të forcës për të bërë ndarjen e ligjshme. Shtetet e treta nuk duhet t'iofrojnë ndihmë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë popullsisë së përfshirë në procesin e shkëputjes. Në fund, në respekt të parimit uti possidetis juris, shkëputja nuk duhet të sjelli as shkeljen e kufijve të jashtëm të vendit dhe as ndarjet e brendshme të territorit të shtetit, dhe nëse ndarje të tilla nuk ekzistojnë, zona gjeografike e përfshirë në ndarje është e përcaktuar nga ballafaqimi midis shtetit dhe lëvizjes shkëputëse.

Rreth kësaj teorie procedurale duhet vëzhguar se kjo nuk është e mbështetur nga e drejta ndërkombëtare dhe vetëm një praktikë mund të sjellë në të ardhmen, një përkushtim të *due process clause* si normë e zakonshme. Sipas një mendimi tjetër, aty ku përfshihen pjesa më e madhe e autorëve²⁹⁰ dhe që mund ta përcaktojmë si asnjë, në të drejtën ndërkombëtare nuk është e njohur as si shembull substancial, as procedural. Realizimi i një hipoteze të shkëputjes nuk do të ishte i miratuar nga e drejta, por thjesht nga një çështje dhe nga prania e kërkesave esenciale, për krijimin e një entiteti shtetëror; që do të thotë populli, territori dhe një qeveri, ku specifikohet sovraniteti i brendshëm dhe i jashtëm.

Në veçanti, Hannum, duke kundërshtuar teorinë e *remedial secession* mbështet se nuk ekziston, në bazë të mjeteve ndërkombëtare dhe praktikës, asnjë e drejtë e shkëputjes, e miratuar nga e drejta ndërkombëtare. Në rastin e Jugosllavisë, Bashkimit Sovjetik dhe Çekosllovakisë nuk ka pasur asnjë shkëputje, por shpërbërje të shtetit, sepse në rastin e parë krijimi i shteteve të reja u lehtësua dhe u mbështet nga konteksti ndërkombëtar, ndërsa në dy rastet e tjera duhet të kujtojmë se Kushtetutat e dy shteteve e lejonin hipotezën e copëtimit.

Si përfundim mund të pohojmë, se për të drejtën ndërkombëtare shkëputja shihet ende si një çështje e brendshme e shtetit, duke e kufizuar klasifikimin ndërkombëtar e duke marrë në konsideratë edhe rezultatin e ngjarjeve; reagimet e ndryshme që janë regjistruar nga anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare në hipotezën e shkëputjes që janë motivuar nga arsye politike dhe nga njohja e një shteti, ku siç do të përcaktojë edhe më

²⁹⁰Giuliano. M. Scovazzi.T & TREVES. T. (1991) *In Dirillo int ema zionole. Part e gene ra/e*. Milano,Pg.84;Hannum.H.(1996).*International Re ponses to Secessionist Conflicts, 90 AS/L Proceedings ,Danver*,Pg 315; Pecoraro.M.L. (2003). *Lo prote zione int erna zional e delle minoran ze*, Napoli, pg. 1 00;Quadri.R. (1989). *Diritto Interna zionale Pubblico so edizione, Napoli*,Pg. 809 ; Tosi.D.E. (2007). *Secessione e Costituzione tra pra ssi e teoria* , Napoli, Pg. 280 ss.

vonë, ka vetëm fuqinë për të manifestuar vullnetin për të pasur marrëdhënie miqësore me shtetin e ri²⁹¹.

3. Njohja ndërkombëtare e legjitimitetit dhe çështja e lindjes së një shteti të ri, Analiza e fenomenit në dritën e ngjarjeve të fundit në Kosovë .

Koncepti modern i vetëvendosjes, i përpiluar pas vitit 1960 kur asambleja e përgjithshme e OKB-së nxori të drejtën për vetëvendosje për të gjithë popujt kolonialë, është në lidhje të drejtpërdrejtë me demokracinë dhe, posaçërisht, me konceptin e të drejtave themelore të njeriut. Duhet theksuar që, gjatë viteve të fundit, asnjë dokument i rëndësishëm ndërkombëtar nuk është përpiluar në lidhje me të drejtën e vetëvendosjes. Një shembull konkret është Marrëveshja Përfundimtare e Helsinkit mbi paqen dhe sigurinë evropiane, e cila parasheh që kufijtë në Evropë mund të ndryshohen vetëm me pëlqimin e të gjitha shteteve përkatëse. Deklaratat e bëra nga Kombet e Bashkuara insistojnë, kryesisht, në integritetin territorial të shteteve. Ashtu siç është, për shembull, çështja e vetëvendosjes, edhe koncepti i sovranitetit ka dy anë: ato të jashtme dhe ato të brendshme. Dimensioni i jashtëm i sovranitetit është relativisht lehtë për t'u matur; meqë ky është koncept i "sistemit të së drejtës ndërkombëtare", do të thotë që një shtet vepron si një entitet i njohur ndërkombëtarisht, pa iu nënshtruar formalisht ndonjë shteti të huaj. Sovraniteti i brendshëm është një fenomen më kompleks. Në thelb, ky përshkruan ekzistencën e vetëm një autoriteti suprem shtetëror brenda kufijve të një shteti. Hapësira dhe kufijtë e sovranitetit janë shumë më të paqarta. Ky proces filloi me miratimin e të ashtuquajturës Marrëveshjes për Minoritete në Konferencën e Paqes në Versajë më 1919, e cila kufizoi pushtetin e disa shteteve, dhe më vonë u konfirmua, me rastin e themelimit të Ligës së Kombeve dhe, në vitin 1945, me organizimin e Kombeve të Bashkuara, të cilat shpallën Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, më 1948. Koncepti i të drejtave të njeriut është përmirësuar që atëherë dhe është bërë qendër e së drejtës ndërkombëtare si dhe e matjes së demokracisë bile edhe i ligjshmërisë së disa qeverive.

Domethënë, sovraniteti absolut nuk ekziston më. Pavarësisht nga ky fakt, e drejta ndërkombëtare ka zhvilluar një koncept i cili garanton më tepër sovranitetin e shteteve sesa të drejtën për vetëvendosje. Fuqizimi i një koncepti për të drejtat e

²⁹¹Duursma. J. (1996). *Fragmentation and the international relations of Micro-States. Self-determination and statehood*, Cambridge pp. 89 .

njeriut ndryshoi qëllimin e sovranitetit, i cili konsiderohet të mos jetë më absolut. Kuptimi i përgjithshëm shkaktoi që sovraniteti të jetë kufizuar seriozisht në mbrojtjen e të drejtave themelore të njerëzve të një shteti përkatës.” Popujt dhe minoritetet të cilët nuk i gëzojnë të drejtat themelore të njeriut në shtetin ku ata jetojnë apo të cilët janë të shtypur, kanë të drejtën për vetëvendosje të jashtme. Kjo ishte saktësisht arsyeja të cilën përdorën shqiptarët e Kosovës në mbrojtjen e së drejtës së tyre për vetëvendosje të jashtme dhe së drejtës për pavarësi. Në vitet 1990, regjimi i Milosheviqit ndryshoi statusin të cilin e kishte Kosova në kornizën kushtetuese të ish-Jugosllavisë të miratuar në vitin 1974. Regjimi i Milosheviqit shfuqizoi tërësisht kushtetutën, e cila përcaktonte Kosovën si pjesë përbërëse të Federatës Jugosllave, duke qenë vetë përfaqësuese në Parlamentin Federativ. Kosova ishte njësi kushtetuese federative (Neni 1,2 i Kushtetutës Federative) e përfaqësuar në të gjitha organet federative, duke përfshirë këtu edhe presidencën kolektive, parlamentin, ekzekutivin dhe gjyqin federativ (Neni 381). Ajo gëzoi të drejtën e mbrojtjes territoriale dhe pjesëmarrjen në bashkëpunime ndërkombëtare (Neni 277). Ajo kishte buxhetin e vet, i cili miratohej nga Asambleja Federative si dhe institucionet e veta bankare (Neni 250). 19 Jo vetëm që regjimi i Milosheviqit shfuqizoi statusin autonom Kosovës brenda Federatës Jugosllave, por ai ushtroi edhe sundim të ashpër në Kosovë, që shkaktoi dëbimin e pothuajse gjysmës së popullatës shqiptare-kosovare nga Kosova në vitin mënyre skandaloze. Kjo gjendje përfundoi me ndërhyrjen direkte të NATO-s, me bombardimet në Serbi edhe pa miratimin e Këshillit të Sigurisë. Shtetet udhëheqëse perëndimore e justifikuan ndërhyrjen direkte kundër Serbisë me argumentin që koncepti i të drejtave të njeriut është koncept suprem i së drejtës globale dhe që sovraniteti i shteteve është në shërbimin e këtij parimi. Përndryshe, komuniteti ndërkombëtar nuk mund të tolerojë dhunë skandaloze dhe mospërfillje të të drejtave themelore të njeriut në një vend, edhe nëse kjo bie në kundërshtim me parimin e sovranitetit të shteteve.

Referuar sa më sipër, ishte 17 shkurti i 2008, kur kryeministri i Shtetit të ri që po lindte, Kosovës, Hashim Thaçi thotë fjalën pavarësi, duke pohuar kështu lindjen e shtetit të shtatë në ish-Jugosllavi. Kjo ngjarje, me shumë rëndësi për të drejtën ndërkombëtare, është një ngjarje e madhe historike; një shtet evropian ka lindur dhe u shpall i pavarur, duke ushtruar kështu të drejtën e vet për vetëvendosje. Në të vërtetë, drejtuesit kosovarë ishin të ndërgjegjshëm për faktin se Asambleja, ku u përcaktua pavarësia, ishte një organ gjithmonë “tutorial transit”, nën kontrollin e UNMIK-së,

dhe nuk kishte asnjë të drejtë juridike për të kërkuar apo imponuar pavarësinë njëherë e përgjithmonë.

Forca e aktit të shpalljes së shtetit të ri shton, në pjesë të dukshme, njohjen e shumë shteteve, shpesh për arsye të natyrës politike; shtetet të cilat e mbështetën menjëherë ishin: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Italia, Gjermania, Franca, Irlanda, Shqipëria dhe një pjesë e mirë e Bashkimit Evropian, të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka gjetja e aleatit perëndimor në një tokë si Kosova. Serbia kishte komunikuar edhe më herët, që nuk do ta njihte pavarësinë e Kosovës dhe u bazua mbi parimin e sovranitetit dhe mbi integritetin territorial të shteteve, mbi rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, që urdhëronte se për çdo modifikim të statusit të një vendi do duhej miratimi paraprak i Këshillit të Sigurisë.

Për arsyet e kundërta me ato të vendeve Perëndimore, Rusia mohoi njohjen e shtetit të ri, dhe të shumë shteteve të tjera, që ishin të shqetësuara, se kjo ngjarje do të provokonte një “efekt domino” në territoret e tjera, ndër to: Spanja, Rumania²⁹², Qipro-ja, Greqia, Sllovakia dhe Bullgaria, nuk e njohën Kosovën. Shumë shpejt, në fakt, shumë vende kanë mbështetur Prishtinën dhe kanë pretenduar për të një trajtim të ngjashëm; mund t’u referohemi Transnistriës, Kurdistanit dhe, sidomos, Abkazisë dhe Ossecisë së Jugut²⁹³, ndër të cilat, pikërisht, kjo e fundit, më 5 mars 2008, kërkoi njohjen e pavarësisë, me thirrje drejtuar OKB-së, Presidentit të Rusisë dhe kryetarëve të shteteve të Bashkimit Evropian, Bashkësisë së shteteve të pavarur të URSS-së.

Sipas qeverisë së Ossetisë së Jugut, në fakt, çështja e Kosovës përbën një precedent që tregon sesi konfliktet rajonale mund dhe duhet të zgjidhen, jo duke u nisur gjithmonë nga parimi i integritetit territorial të shteteve. Praktika e njohjes së shtetit të ri, nga ana e shteteve të tjera, nuk ka në të vërtetë rëndësi konstitutive të personalitetit ndërkombëtar. Në doktrinë pohohet se njohja e një shteti është një akt politik dhe jo juridik. Shtetet që ekzistonin edhe më parë janë të lirë ta njohin një shtet sovran dhe të pavarur, ashtu sikundër edhe të mos e njohin, duke qenë se ky vendim është i lidhur me konsiderata të karakterit diplomatik. Dobia e saj është e kufizuar me vendosjen e marrëdhënieve normale diplomatike mes dy shteteve dhe formave të ndryshme, që vërtetojnë jetën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

²⁹²Azkarate. M. (2008). *Spinte autonomiste vengono dalla Catalogna e dai Paesi Baschi, che subito attraverso il portavoce del governo regionale basco, hanno indicato la vicenda del Kosovo come "Un'altezione da seguire".* febbraio, pg.3.

²⁹³ Shih artikullin në Gazetën italiane La Repubblica, të 6 marsit 2008, Pg.I 8.

Nuk është e rastit që konkluzionet e dokumentit të zakonshëm nga Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian, të 18 shkurtit, ua lejojnë të drejtën shteteve anëtare për të vendosur lirisht, në lidhje me njohjen e shtetit kosovar në linjë me praktikën kombëtare dhe normat juridike.

Njohja është një akt tërësisht i ligjshëm, dhe tërësisht e ligjshme është edhe mosnjohja: të dyja nuk sjellin pasoja juridike. E dukshme është që në rastin e Kosovës ishte një situatë e një mundësie politike dhe një procesi që lejoi zbatimin e parimit të vetëvendosjes, edhe pse ishte në kundërshtim me të drejtën e brendshme të Serbisë. Hapat e parë të shtetit të Kosovës kanë qenë ata të krijimit të një kushtetute, që legjitimoi pavarësinë dhe orientimin juridik e legjislativ të Kosovës, i cili nuk varet më nga ai serb. Së bashku me një demokraci shumetnike, kushtetuta është një klauzolë thelbësore e vënë nga Plani Ahtisaari për respektimin e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe të lirisë.

Kushtetuta u miratua nga Asambleja Kosovare me konsultën e Bashkimit Evropian dhe hyri në fuqi në fund të periudhës kalimtare, pikërisht atëherë kur u mbyll edhe mandati i UNMIK-së, i zëvendësuar nga misioni diplomatik EULEX-së. Autoritetet kosovare morën të gjitha fuqitë legjislative dhe ekzekutive dhe, mbas disa muajsh, u zhvilluan zgjedhje të reja të përgjithshme dhe vendore. Ishin këta hapat e parë që i siguruan Kosovës arritjen e një efektiviteti në arenën ndërkombëtare dhe që, me kalimin e kohës, çuan në një normalizim të jetës politike dhe shoqërore të vendit, siç dëshmohet edhe sot.

4. Rasti Krimesë-Vështrim Historik.

Transferimi i Krimesë në vitin 1954 ishte një veprim administrativ i Presidiumit Suprem Sovjetik i cili transferoi gadishullin e Krimesë nga administrimi i qeverisë së Republikës Sovjetike Socialiste Ruse për RSS Ukrainase. Më 19 shkurt 1954 Presidiumi i Suprem i Bashkimit Sovjetik lëshoi me një dekret transferimin e Krimesë nga Republika Sovjetike Socialiste Ruse për RSS Ukrainase. Sipas Kushtetutës Sovjetike (neni 18), kufijtë e një republikë brenda Bashkimit Sovjetik nuk mund të ri-hartohet pa pëlqimin e republikës në fjalë. Transferimi është miratuar nga Presidiumi Suprem i Bashkimit Sovjetik; megjithatë, sipas nenit 33 të Kushtetutës, Presidiumi nuk ka autoritetin për ta bërë këtë. Ndryshimi kushtetues (neni 22 dhe 23) për të akomoduar transferimin u bë disa ditë pas dekretimit të lëshuar nga Presidiumi i Suprem Sovjetik.” Dekreti u njoftua për herë të parë, në faqen e parë të Pravda, në 27 shkurt 1954. Teksti i plotë i dekretit ishte: “Dekreti i

*Presidiumit të BRSS e transfëron krahinën e Krimesë nga RSS ruse në RSS të Ukrainës. Duke marrë parasysh karakterin integral të ekonomisë, afërsisë territoriale dhe lidhjeve të ngushta ekonomike dhe kulturore në mes të Krahinës së Krimesë dhe të RSS të Ukrainës, Presidiumi i Lartë i BRSS vendosi me dekret: Të miratojë prezantimin e përbashkët të Kryesisë së BRSS. Suprem Sovjetik dhe Kryesisë së RSS të Ukrainës RSS Supreme Sovjetik në transferimin e Provincës Krimesë nga SFSR ruse të RSS të Ukrainës.*²⁹⁴

Dekreti u njoftua për herë të parë, në faqen e parë të Pravda, në 27 shkurt 1954. Pyetja duhet të ketë qenë paraqitur në diskutimin e hapur të Këshillit të Lartë të RSS ruse. Për më tepër që ky ndryshim kërkon një referendum në popull, pasi duhet për të respektuar mendimin e banorëve të të dy republikave. Mirëpo asgjë e tillë nuk ka ndodhur²⁹⁵. Presidiumi i Këshillit të Lartë u mbledh për një seancë më 19 shkurt 1954 - vetëm 13 e 27 anëtarë ishin të pranishëm. Nuk kishte kuorum, por vendimi u miratua njëzëri. Transferimi i Krahinës së Krimesë në Ukrainë ka qenë përshkruar si një "gjest simbolik," duke shënuar përvjetorin e 300 të Ukrainës si një pjesë e carizmit të Rosisë. Nina Hrushcheva, shkencëtare politike dhe stërmbesë e Nikita Hrushovit, atëherë Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik tha se motivi i Hrushovit "ishte disi simbolik, duke u përpjekur për të riorganizojë sistemin e centralizuar dhe gjithashtu, Nikita Hrushovi ishte shumë i dhënë pas Ukrainës, kështu që unë mendoj se në një farë mase ishte gjithashtu një gjest personal ndaj republikës së tij të preferuar. ai ishte rus etnikisht, por ai me të vërtetë ishte shumë i dhënë pas Ukrainës"²⁹⁶.

Mirëpo një arsye tjetër sipas Sergei Hrushov, djali i Hrushovit, pohoi se vendimi ishte për shkak të ndërtimit të një dige hidro-elektrike në lumin Dnieper dhe dëshirën konsekuente që i ati kishte për të gjithë administratën për të qenë nën një trup, dmth të bashkuar. Sevastopoli në Krime duke qenë vendi i Flotës Sovjetike në Detit të Zi, një element thelbësor për rusinë dhe pastaj i politikës së jashtme sovjetike, transferimi kishte synuar efekte të detyrueshme dhe të pashmangshme për

²⁹⁴ David (2014), *Historical claim shows why Crimea matters to Russia*". PunditFact by Tampa Bay Times, PolitiiFact.com.

²⁹⁵ Calamur. K. (27 February 2014). "Crimea: A Gift To Ukraine Becomes A Political Flash Point". NPR.

²⁹⁶ USSR's Nikita Khrushchev gave Russia's Crimea away to Ukraine in only 15 minutes, 19 February 2009, Pravda.

Ukrainën. Rusia doli me sloganin, "përjetësisht së bashku", që e shpalli si posterin përkujtimor të ngjarjes së vitit 1954. Transferimi është përshkruar nga disa Sovjetë Suprem si një dhuratë për të përkujtuar përvjetorin e 300 të Traktatit të Pereyaslavit' në 1654, kur Kozak Rada me sa duket ka vendosur të bashkohet me Moskën, duke vënë në vend blerjen eventuale të Ukrainës nga Rusia. Arsye të tjera të dhëna kanë qenë integrimi i ekonomive të Ukrainës dhe Krimesë dhe ideja se Krimea ishte një zgjerim natyror i stepave ukrainase. Ka pasur edhe një dëshirë për të ripopulluar pjesët e Krimesë e cila kishte pësuar dëbimet në shkallë të gjerë të Tatarëve të saj amtarë në Azinë Qendrore në vitin 1944. Transferimi rriti popullsinë etnike ruse të Ukrainës nga pothuajse një milion njerëz. Politikanë të njohur rusë si Aleksandër Ruts koy konsideruan se transferimet lënë vend për të diskutuar.²⁹⁷

Kontradiktat që rrethojnë ligjshmërinë e transferimit ka mbetur një pikë që ka "lënduar" në marrëdhëniet midis Ukrainës dhe Rosisë për vitet e para pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, dhe në veçanti në politikën e brendshme të Krimesë. Megjithatë, në një traktat 1997 midis Federatës Ruse dhe Ukrainës, Rusia njohu kufijtë e Ukrainës, dhe pranoi sovranitetin e Ukrainës mbi Krimenë. Në janar 1992 Presidiumi Suprem i Rosisë ka vënë në pikëpyetje kushtetutshmërinë e transferimit, duke e akuzuar Nikita Hrushovi për tradhti ndaj popullit rus dhe tha se transferimi ishte i paligjshëm. Aleksandër Ruts koy, ish-nënkryetar i Rosisë, tha se kjo ishte një "Skemë mendjehetë", për të cilën Hrushovi thoshte se ata që e nënshkruan dokumentin duhet të ketë qenë duke vuajtur nga ndonjë "sëmundje". Nuk ishte një konfuzion në lidhje me statusin e Sevastopolit dhe nëse kjo ishte një pjesë e transferimit se ajo kishte një shkallë të pavarësisë nga Krahina e Krimesë dhe kurrë nuk ka ratifikuar zyrtarisht transferimin, edhe pse është përmendur më vonë si territori i Ukrainës në Kushtetutë Sovjetike dhe Marrëveshja Belavezha midis Ukrainës dhe Rosisë.²⁹⁸

Në vitin 1994 një administratë nacionaliste ruse bëri në Krime premtimin për t'u kthyer Krimea në Rusi, edhe pse këto plane janë braktisur më vonë. Pas presidentit pro-rus të Ukrainës Viktor Janukoviç që u rrëzua nga protestuesit në vitin 2014, një revoltë e mbështetur nga forcat ruse pasuan. Pas një referendumi, në të cilin 96% e popullsisë së Krimesë votuan me "Po", gadishulli i Krimesë u bë pjesë e Rosisë. Ky veprim u denoncua nga qeveria e re e Ukrainës, duke u shpërfillur nga Perëndimi dhe

²⁹⁷Subtelny.O. (2000). *Dynamics, Challenges and Prospects*, edited by Maria Drohobycky, A History (University of Toronto Press), Ukraine ISBN 0-8020-8390-0, 600 * Crimea.

²⁹⁸Forget. K. (2014). *The Real Fight Will Be for Crimea*, Andrei Magin, Moscow Times, February 25,.

aleatët e saj. Komisioni i Venecias ka deklaruar se referendumi ishte i paligjshëm sipas kushtetutës të Ukrainës, i cili kërkon që çdo ndryshim në kushtetutën e Krimesë të miratohet nga Verkhovna Rada ose Këshilli Suprem i Ukrainës, duke qënë kështu dhe në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare²⁹⁹. Duke bërë një krahasim të Kosovës dhe Krimesë nisur nga faktet historike, të dyja këto krahina “kanë vuajtur” mos respektimin e parimit të vetëvendosjes. Neni 1 i Konventës mbi të Drejtat e Njeriut deklaroi se, popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes”. Sipas kësaj të drejte ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe zhvillimin e tyre ekonomik, Social dhe kulturor. Fjalja përsëritet në gjuhën e paragrafit 2 të Rezolutës 1514 të vitit 1960 dhe ka formuar qartësisht bazën për përafërsinë e një fjalie të njëjtë të Rezolutës 2635 të vitit 1970^o(2). Kjo e fundit deklaroi se koncepti i vetëvendosjes politike i referohet së drejtës së përcaktimit të statusit politik dhe fati i tyre është endur sa nga lëvizjet e veta politike aq edhe nga forumet ndërkombëtare.

4.1. Aneksi i Rusisë në Krimesë dhe e drejta për tu shkëputur (Mars 2014).

E njohur ndërkombëtarisht si territor i Ukrainës, Krimea u aneksua nga Federata Ruse në mars 2014. Që nga koha e aneksimit më 18 mars 2014 Rusia ka administruar de facto territorin si dy subjekteve federale, Republika e Krimesë dhe qyteti Sevastopol” nën mbikqyrjen e Qarkut Federal të Krimesë. Kriza politike e ndodhur atje si edhe aneksi i gadishullit, njihet si Kriza e Krimesë. Intervenimi ushtarak dhe aneksimin nga Rusia u zhvillua si pasojë e revolucionit ukrainas. Kjo ishte një pjesë e trazirave të ndodhura në të gjithë pjesën jugore dhe lindore të Ukrainës. Më 22-23 shkurt, presidenti rus Vladimir Putin thirri në një takim shefat e shërbimeve të sigurimit për të diskutuar rrëzimin e Presidentit, Viktor Janukoviç, dhe në fund të atij takimi Putin u shpreh se "ne duhet të fillojmë të punojmë për kthimin e Krimesë në Rusi. Më 23 shkurt demonstrata pro-ruse u mbajtën në qytetin Sevastopol të Krimesë. Më 27 shkurt të maskuar trupat, ruse morën Këshillin e Lartë të Krimesë," dhe morën pikat strategjike nëpër Krime, kjo çoi në instalimin qeverisë pro-Ruse në Krime, shpalljes së Krimesë të pavarur dhe mbajtjen e një referendum të kontestuar." Ngjarja u dënua nga shumë liderë botërorë, si dhe NATO Si një aneksi i paligjshëm i territorit të Ukrainës, në kundërshtim me Memorandumin e Budapestit të 1994 mbi sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, nënshkruar nga Rusia.

²⁹⁹ Russia vs. Ukraine. (1994): *A Case of the Crimean Jitters*, Celestine Bohlen, New York Times, March 23,.

Kjo çoi në pezullimin e përkohshëm nga G8 të Ruisë. Rusia kundërshton etiketimin “aneksim”, dhe Putin e mbron referendumin duke thënë se është plotësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Ukraina kundërshton këtë, pasi ajo nuk e njeh pavarësinë e Republikës së Krimesë dhe nuk e konsideron si legjitime. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara gjithashtu hodhi poshtë dhe nuk pranoi të votojë aneksimin, miratimin duke adoptuar një rezolute për të afirmuar "integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht³⁰⁰.

Lëvizja pro-europiane filloi në fund të nëntorit 2013 me protesta në Kiev kundër Presidentit prorus Viktor Janukoviç, i cili fitoi zgjedhjet në vitin 2010 me mbështetje të fortë në Republikën Autonome të Krimesë dhe pjesës jugore e lindore të Ukrainës. Qeveria e Krimesë mbështeti fuqishëm Janukoviçin dhe dënoi protestat, duke thënë se ata ishin duke "kërcënuar stabilitetin politik në vend". Këshilli i Lartë i Krimesë mbështeti vendimin e qeverisë për të pezulluar negociatat në pritje të Marrëveshjes së Asocimit Ukrainë-BE dhe i kërkoi banaorëve të Krimesë për të "forcuar lidhjet miqësore me rajonet ruse". Më 4 shkurt 2014, Presidiumi i Këshillit të Lartë, mbajti një referendum mbi statusin e gadishullit duke i kërkuar qeverisë të Ruisë për të garantuar votën. Shërbimi i Sigurimit të Ukrainës u përgjigj duke hapur një çështje penale për të hetuar një "përmbysje" të mundshme të integritetit territorial të Ukrainës³⁰¹.

Protestat pro-europiane arritën kulmin në shkurt 2014, dhe Janukoviç dhe shumë nga ministrat e tij u larguan nga kryeqyteti. Pas fraksioneve të opozitës dhe të larguarit nga Partia e Rajoneve Janukoviçit së bashku me një kuorum parlamentar në Rada Verkhovna, legjislatura kombëtare që u votua më 22 shkurt për të hequr Viktor Janukoviç nga posti i tij për arsye se ai nuk ishte në gjendje për të përmbushur detyrat e tij, edhe pse heqja legjislativ mungonte kërkuar tre votën e katërta e deputetëve ulur sipas kushtetutës në fuqi në kohën që Rada gjithashtu votoi për ta anuluar. Ministri i jashtëm rus Lavrov e përshkroi atë si një grusht shteti edhe pse ajo ishte e njohur gjerësisht ndërkombëtarisht. Traktati ndërmjet Ruisë dhe Ukrainës për Statusin dhe Kushtet e Flotës Detit të Zi të nënshkruar në vitin 1997 dhe të zgjatur në vitin 2010, vendos statusin e bazave ushtarake dhe anijeve në Krime para krizës aktuale. Rusia u lejua për të ruajtur deri në 25,000 trupa, 24 sisteme artilerie (me një kalibër më të

³⁰⁰Oleksandr.T. (2014). "Declaration "On the struggle for the liberation of Ukraine" (in Ukrainian). Parliament of Ukraine.

vogël se 100 mm), 132 automjete të blinduara, dhe 22 avionë ushtarakë, në bazën ushtarake në Sevastopol dhe infrastrukturë të ngjashme në gadishullin e Krimese. Flota ruse e Detit të Zi e kishte bazuar të drejtën e vendosjes në Krime deri në 2042 përdorimi i stacioneve të navigimit dhe lëvizjet e trupave u mbuluan në mënyrë të paligjshme nga traktati dhe ishin shkelur shumë herë, si dhe vendimet përkatëse gjyqësore. Lëvizjet e trupave në shkurt ishin në "mospërfillje të plotë" të traktatit³⁰².

Si Rusia dhe Ukraina janë nënshkruese të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ratifikimi i kartës në fjalë ka disa degëzime në aspektin e të drejtës ndërkombëtare, veçanërisht ato që mbulojnë lëndët e deklaratave të pavarësisë, sovranitetit, vetëvendosje, akteve të agresionit, dhe emergjencave humanitare. Vladimir Putin ka deklaruar se trupat ruse në gadishullin e Krimesë janë për qëllim "për të siguruar kushte të duhura për popullin e Krimesë të jenë në gjendje të shprehin lirisht vullnetin e tyre kurse Ukraina dhe vende të tjera argumentojnë se ndërhyrje e tillë është një shkelje e sovranitetit të Ukrainës Presidenti rus gjithashtu vuri në dukje se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka dhënë një mendim këshillimor në vitin 2010 ku thuhej qartë se shpallja e njëanshme e pavarësisë në Kosovë (për të cilin nuk kishte asnjë referendum as marrëveshje nga Beogradi) nuk ishte e ndaluar nga e drejta ndërkombëtare. Në anën tjetër, Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina vënë në dukje se duke aneksuar Krimenë Rusia ka shkelur kushtet e Memorandumit të Budapestit të sigurimit të garancisë, me të cilën Rusia, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar ripohuan detyrimin e tyre për të respektuar integritetin territorial të Ukrainës (duke përfshirë Krimenë) dhe të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të Ukrainës. Shtetet e Bashkuara nuk e konsiderojnë Memorandumit të detyrueshëm. Sipas Kushtetutës së Rusisë, pranimi i subjekteve të reja federale është i legjitimuar nga ligji federal kushtetues (neni. 65.2). Një ligj i tillë u miratua në vitin 2001, dhe ai thekson se pranimin e një shteti të huaj apo një pjesë e tij në Rusi duhet të bazohet në një marrëveshje të ndërsjellë midis Federatës Ruse dhe shtetit përkatës dhe do të bëhet në bazë të një traktati ndërkombëtar ndërmjet dy vendeve; për më tepër, ajo duhet të iniciohet nga shteti në fjalë, me nënndarje të saj ose nga Rusia. Ky ligj do të duhej që Ukraina të kërkojë të iniciojë negociatat që përfshijnë aneksimin e Krimesë nga Rusia³⁰³.

³⁰² UN General Assembly adopts resolution affirming Ukraine's "territorial integrity". (8 Mars 2015).

³⁰³ Parliament of Ukraine (17 November 1994). Декларация о государственном суверенитете Крыма (in Russian). Government of Ukraine. (24 prill 2014).

Më 28 shkurt 2014 deputeti rus Sergej Mironov, së bashku me disa anëtarëve të tjerë të Dumas, paraqiti një projekt-ligj për të ndryshuar procedurën e Rusisë për të qëvërisur subjektet federale. Sipas projekt-ligjit, anëtarësimi mund të iniciohet nga një nënndarje e një vendi, me kusht që nuk është "mungesa e efikase qeverie sovrane të shtetit në shtet të huaj"; kërkesa mund të bëhen ose nga organet nënndarëse të tyre ose në bazë të një referendumi të mbajtur në nënndarjen në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës.³⁰⁴ Komisioni i Venecias ka deklaruar se ligji ka shkelur "Në veçanti, parimet e integritetit territorial , sovraniteti kombëtar, jo-ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti tjetër dhe pacta sunt servanda "dhe për këtë arsye ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare³⁰⁴.

Më 11 mars 2014 si Këshilli i Lartë i Krimesë dhe Këshilli i Qytetit Sevastopol miratoi një deklaratë të pavarësisë, e cila ka deklaruar synimin e tyre për të shpallë pavarësinë dhe të kërkojë pranimin e plotë të Rusisë, përgjigja pro-ruse e referendumit ka marrë më shumë vota. Deklarata e ka përmendur direkt pavarësinë e Kosovës, me të cilën Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë shqiptare me popullsi shpalli pavarësinë nga aleati i Rusisë. Shumë analistë e panë deklaratën e Krimesë si një përpjekje të hapur për të hapë rrugën për aneksimin Krime-së nga ana e Rusisë dhe sipas tyre nuk ka vend për krahasime. Më 27 shkurt, pas marrjen e ndërtimit të saj, Këshilli i Lartë i Krimesë votoi për të mbajtur një referendum më 25 maj nëse Krimea duhet të përmirësojë autonominë e saj brenda Ukrainës. Data e Referendumit u zhvendos nga 25 maj - 30 mars. Një gjykatë ukrainase e shpalli referendumin të paligjshëm³⁰⁵. Më 4 mars, Presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se Rusia nuk ishte marrë parasysh aneksimin e Krimesë. Ai tha se i gadishullit që "vetëm vetë qytetarët, në kushtet e shprehjes së lirë të vullnetit dhe të sigurisë së tyre mund të përcaktojnë të ardhmen e tyre"³⁰⁶. Putin më vonë pranoi se ai kishte urdhëruar "të punojnë për të sjellë Krimenë përsëri në Rusi", në fillim të shkurtit. Ai gjithashtu pranoi se në fillim të marsit kishte "sondazhet e opinionit sekret" të mbajtur në Krime, e cila, sipas saj, raportohet mbështetje dërmuese popullore për përfshirjen Krime-së në Rusi. Më 6 mars, Këshilli i Lartë lëvizur datën e

³⁰⁴"Sindelar,D (23 February 2014). "Was Yanukovich's Ouster Constitutional?". Radio Free Europe, Radio Liberty (Rferl.org). 25 shkurt 2014).

³⁰⁵"Ukraine MPs appoint interim president as Yanukovich allies dismissed - 23 February as it happened". The Guardian. 23 February 2014.12 qershor2014).

³⁰⁶ YerOshko, Ir (4 mars 2014). "Ukraine. Russia shows 'complete disregard' for Black Sea Fleet agreement in Crimea". Kyiv Post

referendumit në 16 mars dhe ndryshoi qëllimin e saj për të kërkuar një pyetje të re: nëse Krimea duhet të bëhet pjesë e Rusisë apo duhet të rivendosë kushtetutën e 1992 që e lë atë brenda Ukrainës, të cilën qeveria e Ukrainës nuk e njihte më parë. Ky referendum, ndryshe nga ai i shpallur më parë, nuk përmbante asnjë mundësi për të ruajtur status quo-në e qeverisjes nën kushtetutën e vitit 1998. Më 14 mars, referendumi statusit të Krimesë u shpall jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese e Ukrainës, dhe një ditë më vonë, Rada Verkhovna shpërbëu zyrtarisht parlamentin e Krimesë. Referendumi u mbajt megjithë kundërshtimin nga Kievi. Rezultatet zyrtare raportuar rreth 95% e votuesve që marrin pjesë në 'Rezultatet e referendumit janë në pikëpyetje, Një tjetër raport nga Evgeny Bobrov, një anëtar i Këshillit të Presidentit rus të Drejtat e Njeriut, sugjeroi rezultatet zyrtare ishin të ekzagjeruara dhe vetëm 15% deri 30% e popullsisë së Krimesë në fakt kanë votuar për opsionin rus. Mjetet me të cilat është kryer referendumi janë kritikuar gjerësisht nga qeveritë e huaja dhe në shtypin e Ukrainës si edhe ato ndërkombëtare, me raportet që dikush mban një pasaportë ruse, pavarësisht nëse është resident në Krime u lejua të votojë. Rusia ftoi një grup të vëzhguesve të partive të ndryshme evropiane të ekstremit të djathtë politik paralel me Putin, i cili ka deklaruar se referendumi u zhvillua në mënyrë të lirë dhe të drejtë³⁰⁷.

Më 17 mars, pas shpalljes zyrtare të rezultateve të referendumit, Këshilli i Lartë i Krimesë shpalli pavarësinë formale të Republikës së Krimesë, i përbërë nga territoret e Republikës Autonome të Krimesë dhe qytetit të Sevastopol. Parlamenti Krimesë ka deklaruar "shfuqizimin e pjesshëm" e ligjeve të Ukrainës dhe filloi shtetëzimin e pronës private dhe ukrainase shtetit e vendosur në gadishullin e Krimesë, duke përfshirë edhe portet e Ukrainës. "Parlamenti zyrtarisht kërkoi që qeveria ruse ta njohë republikën të ndarë nga qeveria ruse, port e jetë pjesë e territorit të Rusisë. Në të njëjtën ditë, de facto Këshilli i Lartë riemëroi veten Këshilli i Shtetit të Krimesë, shpalli rublën ruse si monedhë zyrtare krahas hryvnia, dhe njoftoi se Krimea do të përdori orën e Moskës (UTC + 4) më 30 mars³⁰⁸. Putin njohur zyrtarisht Republikën e Krimesë me dekret dhe miratoi pranimin e Krimesë dhe

³⁰⁷Procedure of Admission to the Russian Federation and creation of a new subject of the Russian Federation in its composition' of the Russian Federation (translation)". 10 Mars 2014).

³⁰⁸CDL-AD(2014)004-e Opinion on "Whether Draft Federal constitutional Law No. 462741-6 on amending the Federal constitutional Law of the Russian Federation on the procedure of admission to the Russian Federation and Creation of a new Subject within the Russian Federation is compatible with international law" endorsed by the Venice Commission at its 98th Plenary Session (Venice, 21-22 March 2014)". Venice Commission, 12 Mars 2014).

Sevastopolit si subjekte federale të Rosisë. Lidhur me referendumin e mbajtur në Krime, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë ka publikuar një deklaratë për shtyp në të cilën ajo shprehete se ka ndjekur me shqetësim referendumin e mbajtur më 16 mars 2014 në Krime, me anë të të cilit synohet shkëputja e këtij territori nga Ukraina si dhe paralajmërohet bashkimi me Federatën Ruse. MPJ i bashkohet qëndrimit të shprehur nga komuniteti ndërkombëtar se ky referendum përbën një precedent të rrezikshëm për rendin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. MPJ shprehu qëndrimin e saj se çdo zgjidhje e krizës në Ukrainë, duhet të bazohet në respekt për integritetin territorial, sovranitetin e Ukrainës dhe të drejtën ndërkombëtare. Sipas juristit ndërkombëtar Sean Murphy, si Ukraina ashtu edhe Rusia janë anëtare të OKB-së, sipas Nenit 2 (4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, asnjë shtet nuk mund të përdori forcën kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shteti tjetër anëtar të OKB-së. Kjo është arsyeja që ndërhyrja ushtarake e rosisë në krime e “njollos” shkëputjen e bën këtë incident shumë serioz. Federata Ruse ka pushtuar territorin sovran dhe të paprekshëm të Ukrainës me Republikën Autonome të Krimesë. Pushtimi dhe nënshkrimi i "Traktatit" i vetëdeklaruar nga presidenti Putin si edhe autoritetet e paligjshme në Krime më 18 mars, flet për aderimin e Republikës së Krimesë në Federatën Ruse për formimin e Subjekteve të reja përbërëse brenda Federatës Ruse, të cilat do të “zbatohen përkohësisht nga data e nënshkrimit dhe do të hyjnë në fuqi në datën e ratifikimit” është në kundërshtim flagrant me të drejtën ndërkombëtare dhe disa traktateve ndërkombëtare në të cilat Federata Ruse është një nënshkruese.

5. Krimea dhe Kosova, dy raste të ndryshme.

Pasi kemi analizuar burimet historike të lindjes dy çështjeve në studim, rastin e Kosovës dhe atë të Krimesë, pasi kemi parashtruar krejtësisht peisazhin e ngjarjeve dhe konflikteve përreth tyre, kemi evidentuar gjeostrategjitë dhe gjeopolitikën në rrafsh kontinental dhe botëror, kemi krahasuar dhe parashtruar raportet dhe situatat konkrete dhe të ndryshueshme të të dy rasteve, nuk na mbetet veçse ti rimarrim në shqyrtimin pyetjen themelore të studimit “Krimea dhe Kosova, pse ndryshojnë?”. Pa asnjë dyshim arrijmë në një konkluzion të përgjithshëm historic dhe politik se kemi të bëjmë me dy raste në dukje të afërt dhe të ngjashëm, por në thelb krejt të pangjashëm dhe me qasje dhe interesa të ndryshme historike, juridike, diplomatike e politike. Por kjo nuk mjafton, kërkohet një analizë, një ballafaqim, një krahasim dhe argumentim bazuar në normën dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare. Pretendimet e shtetit rus

për ngjashmëri kanë për qëllim që: duke i interferuar si raste tek njeritjetri, duke i krahasuar, duke i afruar dhe duke e bërë sa më të ngjashëm çështjen e Krimesë me atë të Kosovës, politika dhe strategjia e tyre e njëanshme të mundë që të justifikojë dhe interpretojë në arenën ndërkombëtare me të njëjtat argumenta si në rastin e Kosovës, veprimet e veta arbitrare, të njëanshme dhe të dhunshme për aneksimin e Krimesë. Rusia synon që të sigurojë për aneksimin e Krimesë suport të njëjtë ndërkombëtar si në rastin e Kosovës, gjoja të bazuar në parimet e së drejtës ndërkombëtare, në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB dhe të marrëveshjeve të tjera, sikurse gjetën mbështetje në parimet e së drejtës ndërkombëtare pavarësia dhe krijimi i shtetit të ri të Kosovës. Nëpërmjet shtjellimit të kësaj teme dhe pasi kemi bërë një analizë krahasuese të të dy rasteve Kosovë dhe Krime, konkludojmë dhe parashtrojmë disa përfundime:

1. Mes çështjes së Kosovës dhe asaj të Krimesë nuk ka ngjashmëri sepse së pari fillesa e problematikës së tyre ka origjinë dhe rrethana të ndryshme historike dhe për këtë arsye kanë qasje të ndryshme ndaj parimeve të së drejtës ndërkombëtare.
2. Palët e përfshira në konflikt në të dy rajonet Kosovë dhe Krime kanë qasje dhe interesa të ndryshme dhe për realizimin e qëllimeve të tyre kanë përdorur rrugë dhe instrumenta të ndryshme, ndërkohë që edhe reagimet dhe suportin ndërkombëtar ka qënë i ndryshëm, në rastin e Kosovës reagimi ndërkombëtar në zanafillë të lindjes së çështjes ka qënë i pafavorshëm, ndërsa zgjidhja e saj është shoqëruar nga një mbështetje e fuqishme ndërkombëtare bazuar në disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB ku veçoj rezolutën 1244. E parë në këtë optikë, ndryshimi thelbësor në rastin e Kosovës ishte fakti se, Këshilli i Sigurimit i OKB ishte i përfshirë në proces dhe nëpërmjet rezolutës 1244 me anë të së cilës vendosi për praninë civile të UMNİK që qëndroi që nga viti 1999 e në të njëjtë vitet në vazhdim, pra këtu procesi u iniciua nga OKB dhe jo nga ndonjë shtet³⁰⁹. I dërguari Marti Ahtisari zhvilloi bisedime rreth dy vjet me palën kosovare dhe atë serbe duke u përjekur për të gjetur një status përfundimtar dhe arriti në konkluzionin se nuk kishte alternative tjetër veçse Kosova të shpallte pavarësinë. Ndërsa në Krime nuk ka asgjë që t'i përngjajë këtij procesi, pasi nuk kemi përfshirje të OKB-së, KS nuk autorizoi proces për të vendosur të ardhmen e Krimesë apo shpalljen e pavarësisë, që të ketë ardhur si rezultat i natyrshëm i një procesi të tillë ku vetë OKB të thoshte se ska mundësi të

³⁰⁹ <http://www.zeriamerikes.com/media/video/1878148.html> (14 qershor 2017).

tjera të vlefshme. Në rastin e Krimesë nuk ishte e qartë përse duhet të kishte një proces të ngutur brenda fare pak javëve që drejtohej jo nga OKB por nga Rusia.

3. Ndryshim tjetër i madh është se në rastin e Kosovës kemi të bëjmë me shkelje flagrante të të drejtave të njeriut për të cilat Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e luftës për ish Jugosllavinë i cilësoi si krime kundër njerëzimit. Ndërsa në kontekstin e Krimesë nuk kemi diçka të tillë.

4. Për zgjidhjet e dy çështjeve dhe konflikteve në të dy rajonet kanë qënë të ndryshme dhe janë përdorur instrumenta të ndryshëm, bie fjala në Kosovë janë përdorur mjete dhe instrumenta diplomatike, bisedimet, rezistenca pasive, referendum, lufta çlirimtare (UÇK) dhe ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare me anë të një koalicioni të gjerë shtetesh antare të NATOS. Ndërsa në rastin e Krimesë u përdorën mjete dhe instrumenta krejt të njëanshëm që nuk gjetën mbështetje ndërkombëtare dhe të pabazuara në parimet e së drejtës ndërkombëtare pasi Rusia ka shkelur traktatet e lidhura mes saj dhe Ukrainës në të cilat zotohet se do të respektojë integritetin territorial të saj dhe se nuk do të ketë qëllime ekspansioniste në drejtim të kufijve të fqinjët të saj. Si Rusia dhe Krimea janë nënshkruese të Kartës së Kombeve të Bashkuara me anë të së cilës iu lindi disa detyrime dhe të drejta reciproke sa i takon aspektit të së drejtës ndërkombëtare. Ato gjithashtu janë nënshkruese të Aktit Final të Helsinkit i cili kufizon përdorimin e forcës.

5. Zgjidhja e çështjes dhe shteti i ri i Kosovës u shoqërua me njohje të gjerë diplomatike ndërkombëtare nga vende të ndryshme në botë ku për të cilën ka arritur në 96 numri i shteteve që e kanë njohur atë. Ndërsa ndërhyrja ushtarake dhe referendumi i improvizuar në Krime, jo vetëm që nuk gjeti mbështetje dhe miratim ndërkombëtar por ndërkombëtarish u konsideruan si veprime të dhunshme dhe arbitrare nga Rusia dhe u shoqërua me vendosjen e sanksioneve ndërkombëtare ekonomike nga BE, si vendi përgjegjës për nxitjen dhe organizimin e konfliktit, anksonet përfshijnë një ndalim të eksportit të armëve, si dhe të ashtuquajturën teknologji me përdorim të dyfishtë, e cila mund të përdoret për qëllime civile dhe ushtarake. Krimea është njohur vetëm nga një shtet anëtar i OKB-së që është Rusia, asnjë organizatë apo institucion juridiko ndërkombëtar nuk e legjitimon Republikën e shpallur atje.

6. Kombinimi i pazakontë i faktorëve që gjendet në situatën e Kosovës duke përfshirë edhe kontekstin e shpërbërjes së Jugosllavisë historinë e spastrimit etnik dhe krimet kundër civilëve në Kosovë, dhe periudha e zgjatur e administrimit të OKB-së nuk janë gjetur në asnjë vend tjetër dhe prandaj bëjnë Kosovën një rast të veçantë. Sipas

Condoleezza Rice, Kosova nuk mund të shihet si një precedent për asnjë situatë tjetër në botë sot³¹⁰. BE-ja vendosi që anëtarët e saj ta njihnin atë në mënyrë individuale, sipas saj secili shtet duhet të zgjedhë nëse do të njohë pavarësinë e Kosovës apo jo. Pjesa më e madhe e bëri me përjashtimin e dukshëm të Spanjës e cila përballet me separatizmin brënda vendit, në rajonin e Baske dhe Katalonjës. Rusia nuk e njohu shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës duke thënë se ajo vendos një precedent të rrezikshëm. Precedenti Kosovës është i tmerrshëm, pasi praktikisht ajo prish gjithë sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila mori jo dekada, por shekuj për tu formuar, ajo mund të shkaktojë një zinxhir pasojash të paparashikueshme. Kjo është një shpatë me dy tehe; është shprehur Presidenti rus Vladimir Putin në 2008.

7. Referendumi në Krime ishte shkelje e qartë e Kushtetutës së Ukrainës dhe të drejtës ndërkombëtare, dhe nuk do të njihet nga komuniteti ndërkombëtar Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Obama në 17 mars³¹¹. BE-ja hodhi poshtë referendumin Krimesë dhe tha se nuk do të marrë parasysh rezultatet e saj. Referendumi është i paligjshëm në bazë të Kushtetutës së Ukrainës dhe sipas ligjit ndërkombëtar, shefja e politikës së jashtme të BE Catherin Ashton³¹² është shprehur se nuk mundet thjesht të rrimë duarkryq dhe të themi se kjo situatë mund të lejohet të ndodhë. Rusia përmendi precedent Kosovën si një nga justifikim për përligjen dhe shkëputjen e Krimesë nga Ukraina. Nëse partnerët tanë thonë se rasti i Kosovës është i veçantë, atëherë përgjigjja jonë është që atëherë rasti i Krimesë është edhe më i veçantë, Gjithkush e kupton se Krimea është shumë më e rëndësishme për Rusinë, ashtu si Komoros janë për Francën dhe Falklands për Britaninë e Madhe është shprehur Lavrov ministri i jashtëm rus në mars³¹³.

8. Kronologjia e ngjarjeve në Kosovë e Krime shënon vektorë të ndryshëm me bazueshmëri të ndryshme juridike të së drejtës ndërkombëtare. Nëse në Kosovë kishim praninë e Forcave të NATO-s, në Krime kemi vetëm bazën e flotës ruse të Detit të Zi në qytetin e Sevastopolit.

9. Gjithashtu një tjetër pyetje që shtrohet në rastin e Krimesë është nëse ajo mund të argumentohet si rast ku ka vend për vetëvendosje? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet më parë të citojmë së vetëvendosja përqëndrohet në tre mundësi të ndryshme.

³¹⁰ <http://2001-2009.State.gov/secretary/rm/2008/02/100973.htm> (27 qershor 2017).

³¹¹ <http://www.politico.com/story/2014/03/barack-obama-crimea-referendum-international-law-104363.html> 27.

³¹² http://eeas.europa.eu/statements/docs/2014/140317_04_en.pdf (15 qershor 2017).

³¹³ <http://rt.com/news/lavrov-crimea-ukraine-west-181> (23 qershor 2017).

A) Kur kemi të bëjmë me një koloni, atëherë ajo koloni ka të drejtë për vetëvendosje. B) Kur një territor gjëndet në një pushtim të huaj. C) Një pjesë e një shteti pëson abuzim sistematik të të drejtave të njeriut. Kjo do të ishte një situatë të cilën shumë studjues do ta argumentonin se kjo zonë do të kishte nevojë për vetëvendosje riparuese. Ndoshta Kosova mund të ishte pjesë e kësaj kategorie, por edhe në këtë rast kemi të bëjmë kryesisht me procesin e drejtuar nga KS dhe OKB dhe jo me një të drejtë të njëanshme për t'u bërë një shteti ndarë. Në rastin e Krimesë nuk ekzistojnë nuk ekzistojnë shkeje të të drejtave të njeriut. Rasti i Krimesë është i ngjashëm me Kebekun në Kanada, për të cilën Gjykata e Lartë e Kanadasë është shprehur me një vendim që është pranuar nga një pjesë e madhe e studiuesve. Sipas këtij vendimi Kebeku nuk ka të drejtën e vetëvendosjes pasi këtij rajoni nuk i janë shkelur të drejtat demokratike dhe të drejtat e njeriut. Mirëpo, cilat janë alternativat e zgjidhjes së konfliktit në Ukrainë? Qeveria e Kievit ndoshta do të vazhdojë të mbajë qëndrimin aktual, dmth që ta konsiderojë Krimenë si pjesë të Ukrainës pa i bërë rezistencë asaj që po bën Rusia apo mbajtjes së referendumit. Gjithashtu fakti që Ukraina tërhoqi trupat nuk e minon këtë qëndrim të saj, ky veprim sipas prof. Sean Murphy-it do të thotë që Ukraina është dukë shmangur një përplasjë të armatosur dhe qeveria e Ukrainës ka të drejtë të vazhdojë të mbajë qëndrimin aktual. Diçka tjetër që mund të bëjë Ukraina sipas tij, është që ajo të bashkëpunojë me vendet e tjera dhe një mënyrë për ta bërë këtë janë sanksionet dhe diplomacia. Sipas një krahasimi i parë nga një këndvështrim politik i cili po ashtu e kundërshton një paralelizëm rastin e Kosovës me atë të Krimevë, Presidenti i SHBA Barak Obama shprehet se: “Kur dëgjoj krahasime me Kosovën, ku mijëra njerëz po masakroheshin nga qeveria e tyre, ky është një krahasim që nuk ka absolutisht asnjë kuptim. Është e rëndësishme që gjithkush ta ketë të qartë se këto janë justifikime, në rast të një veprimi tjetër të mundshëm të rusëve”.³¹⁴

13. Një tjetër krahasim që mund të bëhet për këto dy rajone është në të cilat dalin në pah ndryshime por edhe ngjashmëri është fakti se ato që të dyja kanë në përbërjen e tyre grupe të ndryshme etnike. Në rastin e Kosovës e cila ka në përbërje të saj popullsi nga etniciteti shqiptar që zë 92%, etniciteti serb 5.3%, etniciteti turk dhe rom që zënë afërsisht 2.7% të popullsisë ku gjithësej janë 2.513.830 banorë. Ndërsa

³¹⁴ <http://www.zëriamerikës.com/media/video/1878148.html> (14 qershor 2017).

në Krime 60.4% janë rusë, 24 % janë ukrainas, tatarët e krimesë përbëjnë 10.2%, Bjellorusë 1.5%.

KREU IX: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Vlerësime përfundimtare për përcaktimin e fushëveprimit dhe përmbajtjes së parimit të vetëvendosjes dhe zhvillimet e mundshme.

Në përfundim të këtij punimi, në të cilin u përpoqa të nxjerr aspektet teorike dhe praktike, rrjedhimet juridike dhe historike të parimit të vetëvendosjes, arrijmë në konkluzionin se e drejta për vetëvendosje është një e drejtë ligjore në bazë të së drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtave të njeriut, edhe pse qëllimi i saj ekzakt nuk është i qartë dhe është e dyshimtë nëse ndonjëherë do t'i jepet natyra politike e së drejtës.

Në këtë studim, analizat dhe idetë nuk mungojnë, por më duket se nga gjithçka që kam pasur rastin të konsultohem, del një e vërtetë e trishtueshme dhe e papranueshme: të drejtat e njeriut, për më shumë se pesëdhjetë vjet, nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe qytetarit, paraqiten edhe sot, një “zonë gri” dhe një nerv i zbuluar i së drejtës ndërkombëtare.

Thujse, është harruar se koncepti i së drejtës subjektive është i lidhur pazgjidhshmërisht me atë të detyrës. Në raste specifike, detyra qëndron në krye të sistemit ndërkombëtar dhe konsiston në garantimin dhe përmbushjen e të drejtave të njohura njerëzore.

Nuk është rasti për t'u ndalur mbi propozimet që janë formuluar në një kuptim të tillë, dhe që shkojnë në drejtimin e përcaktimit të një katalogu të të drejtave themelore me natyrë ekonomike dhe sociale, për forcimin e procedurave të kontrollit, për të forcuar mekanizmat e shtypjes ekzistuese, dhe në fund, të njohjes së juridiksionit universal nga gjykatat kombëtare në lidhje me rastet më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut. Nevoja për të vepruar në këto drejtime po bëhet gjithnjë e më e përhapur. Dhe kjo aq më tepër në një fazë mijëvjeçare të historisë së njerëzimit, në të cilën janë të panumërta rreziqet që njeriu dhe të drejtat e tij, me një fjalë dinjiteti i tij, të shkojnë mbrapsht.

Është e pashmangshme në këtë pikë, të pyesësh se cili duhet të jetë roli i parimit të vetëvendosjes së popujve dhe të shihet nëse ka ende hapësirë për të në realitetin bashkëkohor.

Në fakt, ekziston rreziku se parimi në fjalë mund të zëvendësohet nga një lexim i së drejtës ndërkombëtare, që tenton t'i favorizojë pashmangshmërisht shtetet, tashmë të ndërtuara në kurrizin e të drejtave të popujve dhe individëve.

Për më tepër, në kontekstin ku paqja dhe siguria në raportet ndërkombëtare janë bërë tashmë parësore dhe vlera të domosdoshme për bashkëjetesën midis shteteve, synohet vazhdimisht shkurajimi për ushtrimin e të drejtës për vetëvendosje.

Duhet mbajtur parasysh, gjithashtu, pamundësia që e drejta t'illërë fushë të lirë opcioneve dhe aksioneve që s'kanë ligjshmëri dhe që në të vërtetë, shumë shpesh, fshehin konturime ideologjike dhe instrumente politike.

Në krahun tjetër, rreziqet e njohjes, pa dallim dhe jo në mënyrë selektive, të vetëvendosjes nuk na lejonë t'i kalojmë në heshtje formulimet e këtij parimi që janë përfshirë në burimet e ndryshme ndërkombëtare dhe që shënjojnë për këtë një vlerë universale.

Është e pamundur të lëmë në heshtje zërat dhe ankesat që në pjesë të ndryshme të globit do të ngrihen kundër diskriminimit dhe dhunimit që ndodhin ndaj pakicave etnike, fetare dhe kulturore dhe të lejohet që grupe sunduese, nën pretekstin e karakterit të brendshëm të çështjes, të vazhdojnë të mbajnë qëndrime joliberalë në kundërshtim me parimet më elementare të çdo qytetërimi. Prandaj, duhet të përqendrohemi në karakterin dinamik ose, thënë ndryshe, mbi “virtualitetin e përhershëm” të parimit në shqyrtim, për skicimin e rrugës drejt së ardhmes, pa i shkelur për këtë, vlerat e tjera.

Rekomandim: Në këtë drejtim, theksi duhet të vihet në përmasën e brendshme të parimit të vetëvendosjes dhe kështu u japim vlerë implikimeve politike, ekonomike, sociale e kulturore, mbi të cilat ende nuk ka shumë hapësirë për ta shprehur plotësisht potencialin e saj.

Sigurisht, nuk është pa vend të kujtojmë në këtë çast, vëzhgimet e mprehta të shembullit të një studiuesi, i cili argumenton se “nëse njerëzit do ta shihnin qartë, që të drejtat e tyre nuk janë një dhuratë e natyrës, por një nënshtrim i përhershëm, një betejë pa fund ndaj rikthimit në gjendjen kafshërore, një lloj krijimi aktiv dhe i përditshëm, një rebelim që i jep jetës kuptimin e saj, origjinalitetin e saj dhe fisnikërinë e saj, aksioni ynë mund të grumbullojë më shumë njerëz, do të jetë më i vërtetë, më shumë ngjithës dhe më shumë efikas”.

Nën këtë profil, është ***emblematic neni 1, par. 1, i përbashkët në të dy paktet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të vitit 1966, që thotë: “Tous les peuples ont le droit de disposer d’eux-memes. En vertu de ce droit ils determinent librement leur statut politique et assurent librement leur development economique, social e culturel”.***

Rekomandim: Në vend të komentit mbi këtë dispozitë, duhet shënuar që pikërisht për hir të përfshirjes në pakt, vetëvendosja bën pjesë në tematikën e të drejtave të njeriut, që është fusha e objektit të së drejtës së brendshme.

Teza e mbështetur nga pjesa më e madhe e doktrinës ndërkombëtare dëshiron që parimi në fjalë të jetë i kufizuar në tri situatat klasike, domethënë ajo e popujve të sundimit kolonial, e popujve të nënshtruar me forcë nga një regjim i huaj dhe ajo e nënshtrimit nga një regjim racist. Për ta provuar këtë tezë mund mund të themi se parimi i vetëvendosjes ka përfunduar, duke u kuptuar shpesh në doktrinë dhe në praktikë, si i drejtuar vetëm popujve në tri situatat e lartpërmendura; popujve të cilëve u njihej e drejta për ta zgjedhur fatin e tyre politik dhe në veçanti, statusin e tyre ndërkombëtar, formimin e një shteti të pavarur që do të thotë, të integroheshin me një shtet tjetër nga ai prej të cilit vareshin.

Në një logjikë ndërkombëtare, në fakt, nuk duket se mund të ligjërohet (legjitimohet) çdo lloj pretendimi. Bashkë me parimin e vetëvendosjes së popujve, bashkësia ndërkombëtare njihet dhe bashkohet me parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve të pavarura dhe që kanë një qeveri demokratike, përfaqësuese të të gjithë popullit dhe që garanton të drejtat e individëve dhe grupeve shoqërore që ekzistojnë në territorin e tyre.

Përmbajtja shumëformëshe e parimit të vetëvendosjes lejon që të zbatohet në situata të ndryshme, por jo që për këtë arsye të mos respektohet integriteti territorial i shteteve me qeveri demokratike. Në këtë pikë të shtrohet pyetja nëse parimi mund të kuptohet, në atë kuptim që shpesh i jepet nga pikëpamja politike e vetëvendosjes së brendshme. Ky koncept tregon mënyrën sesi rregullohet marrëdhënia mes shtetit nga njëra anë, dhe të qeverisurve, nga ana tjetër, dhe në veçanti, sjell për shtetin detyrimin për të pasur konsensusin e popullit, mundësi kjo për të marrë pjesë në jetën politike dhe shoqërore dhe mundësinë për ta ndryshuar strukturën e shtetit, në rastin kur ky i fundit nuk kishte pëlqimin e popullsisë; me fjalë të tjera sjell të drejtën për të pasur një qeveri demokratike. Ky aspekt u pranua në nivel rajonal dhe në veçanti, në Organizatat për sigurimin dhe bashkëpunimin në Evropë.

Parimi, në fakt, u pranua nga marrëveshjet e Helsinkit, të 1975 dhe në vitin 1990, nga konferenca e Kopenhagës dhe nga Karta e Parisit. Gjithsesi, nga pjesa më e madhe e doktrinës, në zbatimin konkret kufizohet nga dënimi i qeverive që praktikojnë forma sistematike të diskriminimit racial kundrejt subjekteve që u përkasin pakicave apo grupeve të popullsisë civile. Kjo është e vërtetë, siç e kam

thënë, sepse Karta e Kombeve të Bashkuara, bazohet mbi respektimin e parimit të integritetit territorial dhe pavarësisë politike të çdo shteti.

Një pohim tjetër i kësaj është i pranishëm dhe në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme nr.2625-XXV, sipas së cilës nuk autorizohet apo shtyhet një veprim që ndan apo kërcënon, tërësisht apo pjesërisht, integritetin territorial ose unitetin politik të çdo shteti sovran dhe të pavarur, që sillet në përputhje me parimet e barazisë së të drejtave të njeriut dhe respekton të drejtën e një populli për t'u përfaqësuar.

Integriteti territorial i shteteve imponohet si kufiri i përgjithshëm për ushtrimin e parimit të vetëvendosjes dhe siç dëshmon rasti i Kosovës, ishte pikërisht shkelja e parimit të integritetit territorial dhe sovranitetit, që çoi në reagimin e Serbisë dhe të gjithë atyre vendeve që së bashku me këtë të fundit, e mohuan njohjen e këtij shteti të ri.

*Pavarësisht prej vështirësive dhe komunikimit me parimet e tjera, profili i brendshëm i parimit të vetëvendosjes së popujve ka evoluar me kalimin e kohës dhe ka ndryshuar. Nga vitet '70 e më pas, parimi filloi të shihej si një rregull që e kundërvinte popullin dhe qeverinë dhe që i jepte të parit në raste të caktuara mundësinë për t'u liruar nga shteti. Parimi i vetëvendosjes, duke qenë një parim i të drejtës ndërkombëtare, vendos detyrimin e një qeverie kundrejt qeverive të tjera dhe bashkësisë ndërkombëtare, që t'ilejojë popullit të lirohet nga prania e tij. Pa asnjë dyshim që kjo krijon një normë të së drejtës cogente. Statusi i shumë qeverive dhe fakti që, më shumë se gjysma e shteteve të cilat sot ekzistojnë, kanë pranuar të drejtën e vetëvendosjes mbi bazën e Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe mbi të drejtat e njeriut, dëshmojnë ekzistencën e të drejtës së vetëvendosjes si normë e të drejtës ndërkombëtare. Si aparatet politike, edhe doktrina nga të gjitha rajonet dhe të çdo ideologjie politike, kanë pranuar ekzistencën e të drejtës së popujve për të vetëvendosur, si dhe janë dakord, që kane të bëjmë me natyrën *jus cogens* të parimit.*

Kjo e drejtë ka një zbatim universal dhe jo të gjitha shtetet do t'ua njihnin këtë të drejtë të gjithë popujve. Është e saktë vetëm nëse do të barazonim vetëvendosjen me shkëputjen apo pavarësinë.

Një gjë tjetër që duhet sqaruar është se ndryshe është e drejta për vetëvendosje e bazuar mbi territorin, siç është vendosur nga Kombet e Bashkuara në kontekstin kolonial, dhe tjetër gjë është parimi etnik-gjuhësor-nacional i vetëvendosjes, siç ishte kuptuar nga Wilson-i, në 1919. Ndryshimi, në fakt, tregon një kufizim thelbësor në 40 vitet e fundit, saqë është dalluar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin e kufijve mes Burkina Fasos dhe Malit dhe nga Gjykata Arbitrare në

pozicionin e saj, në lidhje me Jugosllavinë. Si përfundim, parimi i vetëvendosjes nuk ka një kuptim që përputhet me këtë fjalë. Duke besuar se çdo bashkësi etnike, e identifikuar apo i vetidentifikuar, duke u bazuar mbi karakteristikat specifike të saj, mundet në çdo çast apo situatë të vendosë fatin e vet, do të ishte e rrezikshme për bashkësinë ndërkombëtare, sepse do të sillte në një shpërbërje të çdo lloj shteti, në të cilin janë të pranishme bashkësi, pakica, popullsi indigjene apo etnike. Është e domosdoshme të shihet me kujdes pretendimi që ka bashkësia ndërkombëtare se të gjitha qeveritë që ekzistojnë në tokë, gëzojnë marrëveshje të shumicës së subjekteve dhe janë zgjedhje të lirë e tyre... Jemi ende larg nga një situatë e tillë, edhe pse nuk mund ta mohojmë që pjesa më e madhe e shteteve, ashtu siç është shprehur edhe në deklaratën të ndryshme dhe rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme, e konsideron vetëvendosjen si sinonim të demokracisë, kurse me demokraci kuptojnë ligjshmërinë demokratike të qeverive”.

Në të vërtetë, janë një sërë situatash në të cilat rezultatet nuk janë arritur ende dhe shumë qeveri të shteteve diktatoriale apo demokratike janë në fuqi, pa pëlqimin dhe ligjshmërinë e popullsisë. Mendoni se çfarë ndodhte në regjimet komuniste të Evropës Lindore, apo ajo çka vijon të ndodhë edhe sot në disa vende arabe të Lindjes së Mesme, ose në shumë vende afrikane dhe aziatike; mund të përmendim rastin më të fundit të Birmanisë, ku regjimi ushtarak nuk e ka pranuar kërkesën për zgjedhje të lira apo mohimin e shprehjes së mendimit të lirë, siç po ndodh në Tibet.

Fakti që duhet vënë re, është se për fat të keq, shumë nga këto shtete gëzojnë mbështetjen e shumë shteteve të fuqishme jo vetëm Perëndimore dhe kjo, sepse pozicionimi në mbështetje të demokracisë nuk ndiqet nga një veprim konkret dhe i përgjithshëm kundër vendeve jodemokratike.

Një gabim tjetër, siç e kemi përmendur më sipër, është ai i të besuarit se parimi i vetëvendosjes mund të veprojë në mënyrë që të plotësojë dëshirat dhe aspiratat shpirtërore të rajoneve apo zonave autonome edhe se këto paraqesin karakteristikat që i bëjnë të ishin etnikisht të ndara nga pjesa tjetër e vendit, ashtu siç dëshmon çështja e Kosovës. Ky aspekt mund të sillte edhe probleme brenda një shteti shumëkombësh që është rreziku i krijimit të disa mikro-shteteve, që nuk kishin mundësinë për të garantuar mbrojtjen e interesave të popullsisë, siç ndodh me një shtet unitar. Një e dhënë tjetër që duhet konsideruar si e tillë, ishte ajo çka pohohej në Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut: *“It is essential. If man is not to be compelled to have recourse, as a last resort, to rebellion against tyranny and oppression, that human rights should be protected by the rule of law”*.

Rekomandim: Në këtë kuptim, duhej bërë e mundshme që të ekzistojë respektimi i të drejtave për grupet njerëzore, me një status të stabilitetit dhe paqes ndërkombëtare, me anë të mbajtjes së sistemit aktual të shteteve shumëkombëshe. Sigurisht, që kur shumicat e refuzojnë ekzistencën e një pakice dhe të drejtën e saj për t'u shprehur, vetëvendosja e jashtme ose shkëputja mund të jenë të vetmet zgjidhje vetëm për ata, që ndihen të trajtuar si “alien” në shtëpinë e vet.

Në pjesën më të madhe të rasteve, përdorimi i zgjidhjeve që mbeten në brendësi të një shteti unik dhe që e njeh “vlerën e diversitetit” del si zgjidhja më e praktikueshme dhe që mund të garantonte arritjen e një statusi paqësor dhe demokratik. Në këtë kuptim, është e vështirë t'u referohesh situatave ndërkombëtare, domethënë nuk ka modele të vlefshme, edhe pse kemi shumë shembuj pozitivë të formave të ndryshme të decentralizimit, mëvetësisë (autonomisë) apo federalizimit, siç dëshmojnë çështjet e Belgjikës, Spanjës, Nikaraguas dhe të Kanadasë.

Vetëvendosja shihet më shumë në kuptimin e brendshëm të shteteve, sesa në atë të jashtëm dhe shihet ndryshimi i realitetit të marrëdhënieve ndërmjet fuqisë qendrore dhe entitetit sub-shtetëror. Rëndësia e kufijve ndërkombëtarë për interesat e qytetarëve duket se po zhduket, gjithmonë e më shumë, dhe kjo nënkupton se shteti i konceptuar në kuptimin klasik po shpërndahet, sigurisht që sot është ende më e vështirë për ta përsëritur barazinë e parimit të vetëvendosjes = e drejta e një shteti të pavarur, dhe si dëshmi e kësaj është realiteti evropian, ku kufijtë nuk janë më pengesa e atyre kohëve midis dy shteteve.

- Dilema e dy aspekteve kontradiktore të vetëvendosjes.

Paradoksi i qenësishëm i të drejtës për vetëvendosje është shumë i njohur. Ky problem vë në mëdyshje çdo autor dhe jurist që niset të shqyrtojë të drejtën dhe pasojat e saj. Kjo dyjarësi (dualitet) e bën të drejtën aq të dobët, por në të njëjtën kohë edhe aq të fuqishme. Dobësia e saj rrjedh nga fakti se është një mjet ligjor shumë i vështirë për t'u përdorur në të drejtën ndërkombëtare, gjë që bëhet shumë e dukshme kur shqyrton Deklaratën e Marrëdhënieve Miqësore. Është përcaktuar si një parim themelor në mënyrë të pagabueshme ligjore, por gjuha e deklaratës është jashtëzakonisht e kufizuar për shkak të paqartësisë që ngërthen ajo, një paqartësi që pasqyron natyrën politike të së drejtës.

Në të njëjtën kohë, kjo e drejtë si një slogan politik mund të jetë jashtëzakonisht e fuqishme, për shembull, kur përdoret nga një popull që kërkon lirinë dhe pavarësinë siç është bërë gjatë dekolonizimit. Por gjithashtu, mund të jetë e

rrezikshme kur përdoret për të ndezur ndjenjat e nacionalizmit të skajshëm të njerëzit. Konfliktet etnike në ish-Jugosllavi nuk filluan në fund në vitet nëntëdhjetë, por kanë një histori shumë më të gjatë dhe më të ndërlikuar. Në mënyrë të ngjashme, ajo që çoi në gjenocidin në Ruandë, ishte një situatë komplekse që daton në periudhën koloniale. Sigurisht, ilaçi këtu duhet të jetë demokracia dhe jo ripërcaktimi i termit “popull” ose parimit të integritetit territorial.

Në çdo rast, kjo mëdyshje nuk duket të ketë një zgjidhje për çastin, as në të ardhmen e afërt. Sipas mendimit tim, është e qartë nevoja për natyrën e dyfishtë të së drejtës për vetëvendosje në ligjin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Për këtë arsye është e vështirë, pothuaj e pamundshme, të arrihet një marrëveshje mbi një përcaktim më të saktë të së drejtës, mbi përmbajtjen dhe qëllimin e saj.

-Ku qëndron sot e drejta për vetëvendosje?

Ajo që mbetet tani është t’i përgjigjemi pyetjes nëse aspekti kolonial i të drejtës për vetëvendosje është i vjetëruar dhe vetëm me rëndësi historike. Nuk është e habitshme që përgjigjja është komplekse. Ky aspekt i së drejtës konsiderohet i vjetëruar në kuptimin që dekolonializimi konsiderohet si i marrë fund. Në të njëjtën kohë, liria prej kolonizimit ende konsiderohet si një e drejtë themelore në të drejtën ndërkombëtare, para së gjithash, për kolonitë e pakta të mbetura. Për më tepër, e drejta për vetëvendosje është themeluar në kuadër të dekolonizimit, gjë që është një kontekst i kufizuar, por e drejta ndërkombëtare dhe e drejta për vetëvendosje kanë evoluar për të mbuluar një spektër më të gjerë situatash dhe jo vetëm kolonializmin.

Është konstatuar që të gjitha format e sundimit të huaj ose racor, të nënshtrimit apo shfrytëzimit janë të ndaluara në të drejtën ndërkombëtare, gjë që e bën të parëndësishme të bëhet dallimi midis kolonializmit në kuptimin klasik të fjalës dhe të formave të tjera të sundimit, edhe pse shumë regjime joperëndimore, në retorikën e tyre, bëjnë një dallim midis imperializmit perëndimor dhe formave të tjera të dominimit. Në çdo rast, një pjesë e madhe e botës, përkatësisht vendet në zhvillim, së bashku me avokatët e Botës së Tretë nuk mund të heqin dorë nga e kaluara koloniale. Për ta trashëgimia koloniale është ende të përshtatshme edhe sot dhe përveç kësaj, ekziston një mendësi koloniale dhe sjellje që është ende e pranishme, ndonëse e mbuluar me një “kostum neo-kolonial”. Për më tepër, e drejta është zhvilluar në fushën e ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në këtë zonë të veçantë ka dalë e drejta për zhvillim, edhe pse kjo nuk është ende një parim ligjor dhe është e paqartë nëse ajo ndonjëherë do të zhvillohet në një të vetme.

Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me të drejtën për vetëvendosje dhe aspektet e saj që mund të gjurmohen në dekolonizim, pra e drejta për vetëvendosje ekonomike dhe doktrina e disponimit të lirë të burimeve natyrore. Pra, edhe pse aspekti kolonial i të drejtës për vetëvendosje është në prag të shuarjes ligjore, ka forca politike dhe ideologjike në botë që dëshirojnë ta mbajnë ndezur dritën e së drejtës për vetëvendosje në kontekstin e saj kolonial dhe dëshmi për këtë mund, para së gjithash, të shihet në fushën e të drejtave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe brenda kuadrit të OKB-së.

Në fund të fundit, e drejta për vetëvendosje, edhe pse shihet si një e drejtë themelore me një status ligjor të një rëndësie të madhe, është e paqartë në qëllimin e saj. Dy aspektet e saj kontradiktore i japin asaj rolin e dyfishtë, duke qenë një mjet i dobishëm, por edhe i padobishëm në të drejtën ndërkombëtare. Në fund, mospërputhja në praktikën e shtetit e bën praktikisht të pamundshëm krijimin e një përkufizimi më të saktë dhe qëllimi të qartë të parimit.

E drejta për vetëvendosje është një mjet i fuqishëm politik dhe juridik, që mund të shfaqet në çdo formë. Për këtë arsye, është e vështirë për të parë nëse ajo do të marrë ndonjëherë një formë më të qartë. As nuk do të ndodhë ndonjë konsensus i plotë në elementet dhe mënyrën e zbatimit të saj. Megjithatë, ajo që e bën këtë të drejtë kaq të fuqishme është fakti se ajo, pavarësisht se si është interpretuar, bën thirrje drejt në thelbin e çdo qenieje njerëzore. Kjo është natyra e së drejtës për vetëvendosje.

-Vetëvendosja në praktikë

Mund të hartohet një model i qartë që përshkruan mendimet kontradiktore lidhur me të drejtën e vetëvendosjes, por ky model nuk do ta pasqyrojë gjithmonë realitetin në mënyrë të përkryer. Është e rëndësishme të theksohet se, ndërsa nuk ekziston një vijë ndarëse, ka shumë nuanca në këtë tablo komplekse. Në të vërtetë, problemi më i madh në lidhje me të drejtën është mënyra me të cilën shtetet veprojnë në skenën ndërkombëtare. Ka mospërputhje në lidhje me deklaratat, pozicionet dhe veprimet e shteteve. E drejta për vetëvendosje është një e drejtë me dy fytyra, që ka lidhje të ngushtë me mospërputhjet e praktikës së shtetit. Ky është realiteti i marrëdhënieve ndërkombëtare. Një realitet, që sipas mendimit tim, më shpesh nuk e ndryshon të drejtën ndërkombëtare sesa e kundërta.

- Një shtet apo një popull. Dilema lidhur me të drejtën e vetëvendosjes

Dilema lidhur me të drejtën e vetëvendosjes, në fund të fundit, mund të përshkruhet në termat e atij që është bartësi i së drejtës për vetëvendosje, një shtet apo një popull. Kjo na sjell përsëri në pyetjen se si përkufizohet një popull, një pyetje në të cilën autorët perëndimorë e vendosin theksin, siç e kam treguar edhe gjatë studimit. Ne e shohim anën tjetër të së njëjtës medalje në kuadrin e OKB-së, ku ky problem është paraqitur nëpërmjet çështjes së integritetit territorial. Këtu pozicioni i fortë i parimit të integritetit territorial është në pikëpyetje, por kryesisht në përputhje me ndarjen Veri-Jug. Kjo do të thotë se vendet e Botës së Tretë kanë një qëndrim negativ ndaj dobësimit të parimit, ndërsa Shtetet Perëndimore kanë prirje për të kërkuar një rishikim të statusit të këtij parimi. Ky version është përdorur në rastet kur një shtet nuk vepron në pajtim me dispozitat e Kartës së OKB-së në lidhje me të drejtat e njeriut për të gjithë njerëzit brenda territorit të tij. Këto çështje trajtohen plotësisht në fjalën përmbyllëse të Konferencës Vjetore të Këshillit Kanadez të së Drejtës Ndërkombëtare, në vitin 1999, nga Hans Corell, Nën-Sekretari i Përgjithshëm për Çështjet Ligjore në Këshillin Ligjor të Çështjeve Ligjore të Kombeve të Bashkuara. Për shkak të natyrës së ndjeshme të kësaj çështjeje, ai e gjen të rëndësishme të bëjë një mohim në lidhje me pozicionin e tij, duke thënë se kjo nuk do të pasqyrojë mendimin e OKB-së.

Pozicioni i Corell-it është në përputhje me atë që unë e quaj pikëpamja perëndimore. Ai thekson se një shtet duhet të dëshmojë besueshmëri në pajtueshmërinë e tij me të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e vet për të mbrojtur veten nga ndërhyrja nga jashtë. Më tej, ai thekson ndarjen Veri-Jug në lidhje me këto çështje, si dhe pranon se ,ndërsa shumë shtete nuk kundërshtojnë kategorikisht një qëndrim më të çlirtë (fleksibël) në parimin e integritetit territorial, shumica e shteteve kanë qëndrim negativ ndaj dobësimit të parimit.

Ai nënvizon parimet e integritetit territorial dhe të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve që janë të përcaktuara në Kartën e OKB-së dhe në Deklaratën e Marrëdhënieve Miqësore, por thekson se këto dispozita nuk duhet të shqyrtohen të izoluara. Ai thotë se ato duhet të shqyrtohen së bashku me dispozitat që afirmojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë, pa dallim. Megjithatë, ndërsa ai e bën pozicionin e tij të qartë, thekson nevojën për një aplikim të kufizuar të mendimit të tij për dy arsye.

Së pari, ai pranon se ka rreziqe që lidhen me këtë vijë të argumentimit, rreziqet që mund të nxisin ose të çojnë në fragmentarizimin e shteteve në emër të vetëvendosjes. Sipas tij, fragmentimi i shteteve për shkak të garantimit të mbrojtjes së vetëvendosjes dhe të drejtave të njeriut dhe popujve nuk i garanton paqen dhe sigurinë në vend, por të kundërtën. Së dyti, ai pranon rëndësinë e kufijve dhe integritetit territorial.

Corelle, gjithashtu, pohon faktin se nuk ka përcaktim të qartë mbi “integritetin territorial” në doktrinë, edhe pse janë bërë shumë përpjekje për ta formuluar një të tillë. Për më tepër, ai thotë se ende nuk ka një përkufizim.

Ai thekson se e drejta ndërkombëtare po u nënshtrohet ndryshimeve dhe nënvizon rëndësinë e ngjarjeve të cilat e goditën botën në periudhën pas Luftës së Ftohtë, veçanërisht në ish Jugosllavi. Ajo çfarë Cornell-i kërkon është rishikimi i afateve fikse të sovranitetit, duke përfshirë edhe sovranitetin territorial në kontekst të vetëvendosjes. Por fjala e tij ofron shumë më tepër. Ajo pasqyron pikëpamje të ndryshme për sa i përket integritetit territorial dhe vetëvendosjes. Ajo reflekton kufizimet e natyrshme që ekzistojnë në mjetet juridike të së drejtës ndërkombëtare, në këtë rast , para së gjithash, Karta e OKB-së dhe Deklarata e Marrëdhënieve Miqësore.

BIBLIOGRAFIA

A. LITERATURA

- Arangio Ruiz G. (1988), *Autodeterminazione (diritto dei popoli alia) in Enciclopedia Giuridica*, Roma.
- Audeoud, O. (1983). *L'intervention americano-caraibe à la Grenade*, in *Annuaire francais de droit international*.
- Azkarate. M. (2008). *Spinte autonomiste vengono dalla Catalogna e dai Paesi Baschi, che subito attraverso il portavoce del governo regionale basco, hanno indicato la vicenda del Kosovo come "Un'azione da seguire"*. Febbraio.
- Bedjaoui, M. (1979). *Towards a New International Economic Order*, UNESCO Holmes and Meier Publishers: London, Paris.
- Bennouna, M. (1974). *Le consentement à l'ingérence militaire dans les conflits internes*, Parigi.
- Benvenuti, P. (1981). *Movimenti insurrezionali e Protocolli aggiuntivi alle Convenzioni di Ginevra del 1949*, in RDI..
- Blay, S. (1994). *Vetëvendosja: Një Rivlerësim në Zonën Post Komuniste*, 22 DENV. J. Int'l L. & POL'Y.
- Boyle, F.A. (1982). *The Entebbe Hostages Crisis*, NILR.
- Cassese, A. (1995). *Self-Determination of Peoples - A legal Reappraisal*, Cambridge.
- Cassese, A. (1984). *Diritto internazionale nel mondo contemporaneo*. Bologna.
- Cassese, A. (1995). *The main thrust of the section on the Declaration on Friendly Relations devoted to self-determination is the right of external self-determination*, in *Self determination of Peoples - A legal Reappraisal*.
- Cassese, A. (2006). *Diritto internazionale*, Bologna.

- Cassese, A. e Pellet A. (1991). *La Charte des nations Unies, Commentaire article par article*, 2^o edition, Paris.
- Castellin, O J. e Allen S. (2000). *The Doctrine of Uti Possid etis: Crystallization of Modem Post-Colonia /Identity*, in German Year book of International Law.
- Ciciriello M. C. (2006). *Appunti delle lezioni di diritto internazionale*, Napoli.
- Conforti B. (2003), *Scritti di diritto internazionale II*, Napoli, pg. 230-231.
- Conforti, B & Leanza U. (2002). *Da diritto per gli Stati a diritto per gli individui*, Torino.
- Conforti, B. (1996). *Diritto internazionale*, Napoli.
- Craëford, J. (2001). *Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts* Alston,
- Craëford, J. (2001). “*E drejta për vetëvendosje në të drejtën ndërkombëtare: Zhvillimi i saj dhe e ardhmja*”, në Alston, New York.
- Dixon Mc C. (2003). *Self-determination, in International Human Rights Law, Cases and materials on International Law*, 4111 edition, Oxford. Marzo.
- Donnelly, J. (1998). *Të drejtat njerëzore ndërkombëtare*, Boulder.
- Duursma, J. (1996). *Fragmentation and the international relations of Micro-States. Self-determination and statehood*, Cambridge.
- Elliot, D. Paul. (1978). *The East Timor Dispute, in International and Comparative Law Quarterly*.
- Emerson, R. (1971). *Self-Determination, in American Journal of International Law*.
- Errico, S. (2007). *Popoli e minoranze, La Dichiarazione delle Nazioni Unite sui diritti dei popoli indigeni in Dirilli umani e Dirillo intemazionale*, Vol. In. I, Milano.
- Ferrajoli, F. (2002). *Diritti fondamentali. Un dibattito teorico*, Laterza.
- Frulli, M. (2001). *Le operazioni di peacekeeping delle Nazioni Unite e l'uso della forza*, in RDI.

- Gerry, J.S. (1996). ” *Shpërndarja e sovranitetit: Vetëvendosja në epokën post-koloniale* “, Oxford / Washington DC.
- Gilbert. J. (2007). *Historical Indigenous peoples” land claim a comparative and international approach to the Common Law doctrine on Indigenous title in International & Comparative Law Quarterly*, Oxford.
- Giuliano, M & Scovazzi.T& Treves. T. (1991). *In Dirillo int emazionole. Parte generaLe*. Milano.
- Grado,V.(1998). *Guerre civili e terzi Stati*, Padova.
- Guarino.(1984). *Autodeterminazione dei popoli e diritto internazionale*,Jovene.
- Hannum H. (2002) (edited by) Beck R. J. and Ambrosio T., *Rethinking seljdetemzination in International Law and the rise of nations. The state system and the challenge of eth11.ic groups*, Neë York-London.
- Hannum.H.(1996). *International Reponses to Secessionist Conflicts*, 90 ASIL *Proceedings*, Danver.
- Hans. K, (1994). *Ideja e nacionalizmit, citon në Furedi Frank, Luftat Koloniale dhe Politika nacionalizmit e Botës së Tretë*.
- Jennings, I. (1956). *The Approach to Self-Govenunent*, Cambridge.
- La Rosa R. (2006). *Evoluzione e prospettive della prote zione delle minoran ze net diritto inte rna zionale e nel diritto europeo*, Milano.
- Lattanzi F. (1987), *Autodeterminazione dei popoli in Digesto delle discipline Pubblicistiche*, 4 o edizione, Torino.
- Lattanzi F. (1995). *La secessione nel dirillo internazionale: autodeterminazione dei popoli e delimitazione di un territorio Nazionale nell “ esperienza recente in Stato, etnicita e nazionalismo tra due ordini mondiali*, Urbino.
- Leanza, U. (2000). *Il diritto internazionale*,Torino.
- Leanza, U. (2002). *Da diritto per gli stati a diritto per gli individui*, Torino.

- Marcelli, F. (1994). *Gli accordi fra Israele e OLP nel diritto internazionale*, in Rivista di diritto internazionale.
- Margiotta, C. (2005). *L'Ultimo diritto. Profili storici e teorici della secessione*. Bologna,.
- McCorquodale, R. (2000), *Self-determination in International Law*, Ashgate, Dartmouth.
- Nguyen. Q. D. (1994). *Creation de l'Etat dans le monde contern porain in Droit international public* , Parigi.
- Pallieri B. *E drejta publike ndërkombëtare*, Giuffrè.
- Palmisano G. (1997). *Nazioni Unite e autodeterminazione interna. Il principio alla luce degli strumenti rilevanti dell'ONU*, Milano.
- Pecoraro, M. L. (2003). *La protezione internazionale delle minoranze*. Napoli.
- Pellet A. (1992). *The Opinions of the Badinter Arbitration Committee. A Second Breath for the Self-Determination of Peoples* , 3 EJIL.
- Pellet A. (1994). *Quel avenir pour le droit des peuples a disposer d'eux - memes*, in *Internacional en Mundo en Trosfonnocidn*, Montevideo.
- Picone, C. (1996). *Il peacekeeping nel mondo attuale tra militarizzazione e amministrazione fiduciaria*, RDI.
- Picone, P. (1995). *Il Consiglio di sicurezza e la crisi jugoslava*, in *Interventi delle Nazioni Unite e Diritto Internazionale*, Padova.
- Pomerance, M. (1992). *Self-Determination in Law and Practice: The New Doctrine of the United Nations*, The Hague.
- Pomerance.P. (1976). *The United States and Self-Determination: Perspectives on the Wilsonian Conception* in AJIL.
- Pontecorvo, C.M. (1995). *Somalia e Nazioni Unite*, in *Interventi delle Nazioni Unite e Diritto Internazionale*, (a cura di Picone), Padova.

- Quadri, R. (1989). *Diritto Internazionale Pubblico*, 2 edizione, Napoli.
- Raic, H & Rosalyn, H .(2000). *Të drejtat e njeriut në kontekstin Ndërkombëtar*. Neë York.
- Raic, D. (2002). *Statehood and the Law of Self determination*, The Hague.
- Bedjaoui, M. (1991). *The Right to Development* , in M. Bedjaoui (Edited by), *International Law: Achievements and Prospects*, Paris.
- Rigaux, F. (1988) . *La Carta di Algeri-La Dichiarazione universale dei diritti dei popoli*.
- Ronzitti, V. (1974). *le guerre di liberazione nazionale e il diritto internazionale*, Pisa.
- Rosa, R. (2006). *Evoluzione e prospettive della protezione delle minoranze nel diritto internazionale e nel diritto europeo*, Milano.
- Rosa, M. (2006). *Secondo cui "Il fatto di essersi affermato nel contesto di tale Organizzazione (l'ONU), in Evoluzione e prospellive della protezione delle minoranze nel diritto intemazionale e nel dirillo europeo*, Milano.
- Ruiz, G. Arangio. (1989). *Diritto dei popoli*, in enciclopedia giuridica, vol. IV, Roma.
- Ruiz, A. (1988). *Autodeterminazione (diritto dei popoli alla)*, EG, IV.
- Sloss D. (2002). *Using International Court of Juslice Advisory Opinions to djudicate Secessionist Claims*, Santa Clara.
- Tancredi, A. (1995). *La Secessione nel Diritto Internazionale*, Padova.
- Tomuschat, C. (1995). (Edited by) Simma B. *The Charter of the United Nations, A comment C/I)I*, Oxford.
- Tomuschat, C. (Edited by) Simma B. (1995). *The Charter of the United Nations, A commentary*, Oxford.
- Tomuschat, C. (1993). *Self- Determination in a Post Colonial World* , in *Modern Law of Self- Determination*, Dordrecht.

- Tomuschat, C. (1994). *L'adaptation institutionnelle des Nations Unies au nouvel ordre mondial*, in Ben Achour, Laghmani, *Les nouveaux aspects du droit international*, Paris, vol.I.
- Tosid, E. (2007). *Secessione e Costituzione tra prassi e teoria*, Napoli.
- Treves, T. (2003). *Elementi di diritto internazionale, problemi fondamentali*. Giuffrè.
- Treves, T. (2005). *Diritto Internazionale problemi fondamentali*, Giuffrè.
- Tully, J. (1995). *Strange Multiplicity: Constitutionalism in an Age of Diversity*, Cambridge.
- Udombana, N. (2000). *Towards the African Court on Human and Peoples Rights Better late than never*.
- Young Y. M. (2007). *Global challenges. war, Self-Determination*. Cambridge.
- Orakhelashvili, A. (2006). *Peremptory Norms in International Law*. Oxford: Oxford University Press.
- Kolb, R. (2001). *Théorie du ius cogens international: essai de relecture du concept*. Paris: Presses Universitaires de France.
- Puto. A. (2010). *E Drejta Nderkombetare Publike*, Botimet Dudaj, Tirane
- Gruda. Z. (2009). *E drejta Nderkombetare Publike*, Furkan-ISM, Shkup

B. BURIME PARËSORE

- Paktit i Lidhjes së Kombeve, i vitit 1920 dhe 1945.
- Akti final i Helsinkit, i vitit 1975
- Karta e Algjerit, e datës 4 korrik 1976.
- Kartae Kombeve të Bashkuara, e vitit 1945.
- Deklarata për parimet e së drejtës ndërkombëtare që kanë të bëjnë me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputje me kartën e OKB-së e vitit 1970.
- Deklarata për dhënien e pavarësisë vendeve dhe popujve kolonial (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, numër 1514 (XV), me datën 14 dhjetor, 1960)

- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 3314 (XXIX) e datës 14-12- 1974.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 1541-XV e datës 15-12-1960.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 39/5 e datës 30-10-1984.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.1546 e datës 8-6-2004.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.2625-XXV, e datës datës 24-10- 1970.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.3280-XXIX e datës 3412-X
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.3281 (XXIX) e datës 2-12-1974.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.46/4 te vitit 1991.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.754 te vitit 1992.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.816 te vitit 1993.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr.te vitit 1992.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 2160 te vitit 1966.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 221 te vitit 1966
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 321 te vitit 1971 e Keshillit te Sigurimit.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 55-2 e datës 13-09-2000.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 59 e datës 03.03.2005.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 3013-XVIII.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 2625-XXV e vitit 1970.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 3314-XXIX e vitit 1974.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 1514-XV e vitit 1960.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, Nr. 1569-XY e datës 18-12-1960.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr 1605-XV e datës 7-4-1961.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr I 044-XI e datës 1 3-12-1 956.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr. 1350-XIII, date 3-3- 1959.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr.2625 e vitit 1960.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr.3314 e vitit 1974.

- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme.Nr 294 del 1971 e Keshillit te Sigurimit.
- Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme. Nr. 59/178 e datës 3-3-2005, 591180 e datës 3-3-2005, 60/14 e datës 8- 12-2005.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr.47/135 e datës 1992.
- Rezolutat e Keshillit te Sigurimit n. 143 e datës 14-7-1960, 145 e datës 22-7-1960, 146 e datës 9- 8-1960.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr.1224, e vitit 1976.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme. Nr..252 e vitit 1968, *nga ku konsiderohen të pavlefshme të gjitha masat legislative dhe administrative të ndërmarra nga Izraeli që kanë për qëllim ndryshimin e statusit të Jerusalemit.*

C. BURIME DYTËSORE

- **Artikuj revistash dhe burime nga website zyrtare**
- Advisory Opinion, del 12 luglio 2004, reperibile sui sito <http://www.icj-cij.org>.
- Brandt Ahrens C. (2004). *Chechnya and the Right of Self – determination*, in Columbia Journal of Transnational Law.Columbia Law School - Neë York, Vol. 42.
- Cammarat, *I diritti dei popoli indigeni,lotte per il riconoscimento e principio di autodeterminazione*, Pubblicazioni del Dipartimento di studi sociali e politici, Università degli studi di Milano.
- Castellin, O J . e Allen S. (2000). *The Doctrine of Uti Possid etis: Crystallization of Modem Post-Colonia /Identity*, in German Year book of International Law.
- Center for International Development and Conflict Management, e dispnueshme në: <http://www.cidcm.umd.edu/inscr/pc03print.pdf>.
- Chomsky, N. *A guardia del mondo*,da Il Manifesto, 4 Dicembre 1999.
- Craëford, J. (1996) "*Book revieë of Antonio Cassese, Self- Determination of Peoples: A Legal Reappraisal*", in American Joumal of International Law.
- Documento CCPR/C/NOR/Q/5 Add. I dell'8 marzo 2006.

- East Timor (Portugal v. Australia), Dissenting Opinion of Judge Eeramantry, <http://www.icj-cij.org>.
- Guarino G. *Autodeterminazione dei popoli e successione di norme contrattuali aile radici di un conflitto, Il ruolo del diritto internazionale generale nella Carta Araba dei diritti dell " uomo,* in Rivista della cooperazione giuridica internazionale. Quadrimestrale dell" Istituto Interna zionale di Studi Giuridici, anno VII, n°22, Gennaio-Aprile 2006.
- Hannum, H. (1996). *International Responses to Secessionist Conflicts*, 90 ASIL Proceedings.
- ICJ Report s 22, del 1949.
- ICJ Reports 113, del 1986, par. 218.
- ICJ Reports 23, del 1951.
- ICJ Reports 258, del 1996, par. 82.
- ICJ Reports 32, del 1970, par. 33-34.
- ICJ Reports 42, del 1980, par. 71.
- Konferenca e Krereve të Shteteve dhe qeverive të Organizatës së bashkaur Afrikane. Hyrë në fuqi më 21 tetor 1986; www.africa-union.org.
- N. J. Udombana, "Bota e tretë dhe e drejta për Zhvillim: Agjendën për mijëvjeçarin e ardhshëm" Universiteti Press John Hopkins, të drejtat e njeriut tremujor 22.3 (2000), në: http://muse.jhu.edu/journals/human_rights_quarterly/v022/22.3uombana.html.
- Pamphile Sebahara, "Krijimi i ndarjes etnike në Ruanda", UN-NGLS (Jo- Shërbimi Ndërlidhëse Qeveritare OKB) në: <http://www.unngls.org/documents/publications.en/voices.africa/number8/7sebahara.htm>.
- Pieter H.F. Korrik 2004, <http://ëëë.asil.org/index.html>.

- Raporti i OKB-së i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Eritrean, 1950, DOC i OKB-së. A/1285.
- Ronzitti, N. (1975). *Wars of National Liberation-A Legal definition*, in Italian Yearbook of International Law.
- Roscini, M. (2000). *Autodeterminazione tra mito e realtà*, Università di Roma “La Sapienza.
- Ruiz, G. Arangio. *Diritto dei popoli*, in enciclopedia giuridica, vol. IV, Roma, 1989.
- Summers J .J. (2003). *The Status of Self-determination in International Law: A Question of Legal Significance or Political Importance?* in Finnish Yearbook of International Law ,Vol. XIV.
- UN Doc. E/CN.4/2004/6, a t 6 (Sept. 8, 2003).
- <http://www.cepadu.unipd.it>
- <http://www.un.org/peace/etimor>.

- **Praktike Gjyqesore**

- Çështja (Belgium v. Spain), ICJ Reports 1970..
- Çështja Westem Sahara, ICJ Reports, 1975.
- Çështja, East Timor (Portugal v. Australia), ICJ Reports 1995.
- Çështja Tatarstan, 1994.
- Gjykata e Kasacionit Penal Italian në gjykimin e 28 qershor 1 985, n1981, Imputati Arafat e Salah.
- Gjykata e kasacionit Penal Italian në gjykimin e datës 29 nëntor 1991, R. G. D. I. P. 1992.
- Gjykata Ndërkombetare e Drejtësisë, për Çështjen (*Barcelona Traction già nel 1970, testo in C.I.J., Recueil,1970*).
- Vendim i Gjykatës së Kasacionit penal të vitit 28 qershor 1985, nr 1981.

- Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare e Arbitrazhit, ne 31 korrik 1989 31 korrik 1989 në *rastin e caktimin e kufijve shelfit kontinental midis Guinea-Bissau dhe Senegalit.*
- Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për çështjen (Nicaragua v. Shtetet e Bashkuara), Gjykimi 27 qershor 1986.
- Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i datës 06.27.1986.
- Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në njohjen e legjitimitetit e luftës së Namibisë kundër pushtimit të Afrikës së Jugut (1970).

